



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 11
QERSHOR
2018

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2018



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Policimi
dhe **SIGURIA**

B O T I M P E R I O D I K
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR 11
QERSHOR
2018

Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe Siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe Siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjisllacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.



Botues

AKADEMIA E SIGURISË
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

NR **11**
SHTATOR
2018

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Fatmir TARTALE

Dr. Frank HARRIS

Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

Përkthyes

Dr. Irvin FANIKO

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

Revista shkencore "**Policimi dhe Siguria**", botohet nga "Qendra Kërkimore Shkencore" e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P È R M B A J T J A

1. **Prof. Dr. Vasilika HYSI**
Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve, për shkak të marrëdhënieve familjare 8
2. **Prokurori kombëtar i Antimafies dhe Antiterrorit Italian, Federico Cafiero DE RAHO**
Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë (Fjalimi në italisht, faqe 154). 12
3. **Dr. Bilbil MEMAJ**
Lidershipi i efektshëm 22
4. **Dr. Xhavit SHALA**
Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj 30
5. **MSc. Xhafer BARJAMI**
Buxhetimi dhe misioni i policisë. 38
6. **Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI**
Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë 60
7. **MSc. Besnik SHEHAJ**
Trajnimi i punonjësve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike. 82
8. **MSc. Adriatik AGO**
Riorganizimi i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, kërkesë e kohës . . . 96
9. **MSc. Osman QYSTRI**
Riorganizimi i policisë kriminale, si domosdoshmëri e kohës. 107
10. **MSc. Roland ALUSHANI**
Policimi në komunitet: sfidë dhe nevojë 114
11. **Dr. (proc.) Besnik MUÇI**
Aspektet juridiko-penale të vrasjes në familje, metodika e hetimit dhe mjetet e kërkimit të provave. 124

12.	Cav. Dr. Ervin IBRAHIMI, Dr. (proc.) Silva IBRAHIMI, Dr. Eglantina DERVISHI	
	Kiberdevianca te të miturit dhe roli i punonjësit të policisë e strukturave mbështetëse, në profilaksinë e krimit kibernetik	136
13.	Dr. (proc.) Kozeta LIGEJA	
	Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas	144
	Abstraktet në anglisht / Abstracts	154



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve, për shkak të marrëdhënieve familjare



Prof. Dr. Vasilika Hysi

ZËVENDËSKRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË



Sot, do të duhet të rishohim sa dhe si shteti, shoqëria, organet ligjzbatuese dhe ligjbërëse punojnë për të parandaluar veprat penale në familje dhe shkaqet e tyre dhe jo vetëm të mendojmë se rruga më e dobishme është si të ashpërsojmë kodin penal. Në vlerësimin tim, dështimi në trajtimin e shkaqeve që çojnë në dhunë në familje ose lehtësojnë dhe favorizojnë atë, jo në pak raste ka ndikuar që ligjbërësit të ashpërsojnë dënimet penale ndaj autorëve të këtyre krimeve, pa mundur të zgjidhin problemet që i shkaktojnë ato.

Hysi, V.
« Dhuna
ekstreme në
familje
dhe masat për
parandalimin
dhe, reduktimin
e vrasjeve, për
shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Fjala e Prof. Dr. Vasilika Hysi, zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë, mbajtur në konferencën e II-të shkencore kombëtare të Akademisë së Sigurisë, me temë: "Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare", Tiranë, 26 Prill 2018

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi të marrësh pjesë në një konferencë shkencore që ka mbledhur së bashku studiues dhe punonjës të profesioneve të ndryshme të kërkimit, botës akademike, të agjencive ligjzbatuese, të sistemit të drejtësisë dhe të profesioneve ligjore për të trajtuar një temë me rëndësi siç është dhuna në familje në formën më të ashpër dhe të rëndë të saj: vrasjen.

Si pjesë e politikëbërjes, por edhe me një përvojë të gjatë në fushën e kërkimeve kriminologjike dhe të mësimdhënies e vlerësoj konferencën dhe mirëpres me shumë interes përfundimet shkencore të saj për shumë arsye, që për pamundësi kohe, nuk mund t'i rendis të gjitha, por disa prej tyre do të doja t'i nënvizoja në fjalën time.

Së pari, dhuna në familje në formën ekstreme të saj nuk ndodh për një ditë dhe nuk ka një shkak të vetëm, por është produkt i ndikimit të faktorëve të ndryshëm shoqërorë, psikologjike etj në familje dhe jashtë saj. Për të parandaluar dhunën në familje, ne duhet të identifikojmë shkaqet e saj dhe të ndërmarrim masat e nevojshme për të parandaluar ndikimin e tyre dhe minimizuar sa më shumë pasojat që mund të sjellin ato. Është koha që vlerësimi i faktorëve që shkakton probleme në marrëdhëniet familjare të bëhet jo në përgjithësi, por konkretisht sipas çdo familje, në zona dhe komunitete të caktuara. Sot mundësitë të tilla ekzistojnë nëse angazhohen ndërlidhësit me komunitetin që veprojnë pranë njësive qeverisjes vendore, inspektorët e policisë në komunitet dhe kërkuesit e rinj nga bota akademike. Rëndësi kanë studimet jo vetëm sasiore, por edhe cilësore të cilat duhet të bëhen në nivele vendore dhe sipas çështjeve specifike.

Së dyti, fakti që jemi së bashku të gjithë profesionistët e fushave, përshirë edhe nga politikëbërja është treguesi më i mirë i nevojës së një qasje shumëdisiplinore të këtij problemi. Kuvendi i Shqipërisë ka ndërmarrë reformën më të rëndësishme: reformën në sistemin e drejtësisë. Pjesë e saj është drejtësia penale, profesionet ligjore dhe ndryshimet në ligjet procedurale penale dhe civile.

Sistemi i drejtësisë penale ka një rëndësi të veçantë lidhur me hetimin e veprave penale në familje dhe trajtimin e viktimës. Do të ishte me shumë interes, që në këtë konferencë, bazuar në problematikat që hasen në sistemin e drejtësisë penale të ketë disa rekomandime konkrete sesi mund të përmirësojmë në mënyrë rrënjësore parandalimin, zbulimin, hetimin, gjykimin dhe të zbatojmë një politikë penale efektive

Hysi, V.
« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve, për shkak të marrëdhënieve familjare »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

ndaj veprave penale në familje.

Sot, do të duhet të rishohim sa dhe si shteti, shoqëria, organet ligjzbatuese dhe ligjbërëse punojnë për të parandaluar veprat penale në familje dhe shkaqet e tyre dhe jo vetëm të mendojmë se rruga më e dobishme është si të ashpërsojmë kodin penal. Në vlerësimin tim, dështimi në trajtimin e shkaqeve që çojnë në dhunë në familje ose lehtësojnë dhe favorizojnë atë, jo në pak raste ka ndikuar që ligjbërësit të ashpërsojnë dënimet penale ndaj autorëve të këtyre krimeve, pa mundur të zgjidhin problemet që i shkaktojnë ato.

Së treti, hartimi i ligjeve të mira në këtë fushë dhe zbatimi i tyre varet shumë nga studimi sistematik i veprave penale, i faktorëve kriminogjenë, i profilit të autorëve dhe viktimave të tyre. Si pjesë e ligjbërjes, jo në pak raste kam ngritur shumë pyetje dhe kam pasur dilema nëse duhet të ndryshoja dhe të votoja një projektligj kur argumentet shkencore dhe të dhënat studimore për një çështje të caktuar mungojnë ose nuk janë të mjaftueshme.

Unë vlerësoj nevojën e studimeve shkencore, periodike të këtij fenomeni dhe vënien në dispozicion të tyre, atyre që hartojnë politika dhe atyre që i miratojnë politikat. Është e lehtë të kritikosh një ligj të hartuar jo mirë, kur të gjithë profesionistët mund dhe duhet të kontribuojnë me mendimet dhe sugjerimet e tyre që në fazën e inicimit të nismës, të diskutimit, miratimit të saj dhe të ndjekin me kujdes zbatimin e tyre.

Me këtë rast me lejoni t'ju bëj me dije se së shpejti Kuvendi i Shqipërisë do të nisë diskutimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare. Të gjitha mendimet dhe sugjerimet konkrete të dala nga kjo konferencë janë të mirëpritura dhe secili prej jush, që ka dëshirë të thotë diçka, është i mirëpritur të dëgjohet në seancat dëgjimore.

Gjithashtu, me lejoni t'ju bëj me dije se në dhjetor të vitit 2017, GREVIO bëri publik raportin për Shqipërinë. Shqipëria ka bërë progres në fushën e përmirësimit të ligjeve lidhur me detyrimet që burojnë nga Konventa e Stambollit, por në terma afatshkurtër, ne duhet të bëjmë disa përmirësime ligjore në Kodin Penal dhe në ligjet e tjera që kanë lidhje me parandalimin e dhunës në familje. Ju ftoj që, së bashku me institucionet përgjegjëse në fushë, të punojmë për të bërë përmirësimet ligjore përkatëse.

Së katërti, parandalimi i veprave penale të dhunës në familje ka nevojë për statistika, të sakta, në kohë reale, realiste, të detajuara dhe të bëhen publike dhe të vihen në dispozicion të publikut, të kërkuesve, hartuesve të politikave dhe zbatuesve të tyre. Publiku ka nevojë që të ketë këto të dhëna, për të na vlerësuar; dhe ne, për të qenë llogaridhënës dhe të përgjegjshëm në punët që bëjmë.

Do të doja shumë të përfitoja nga rasti që të theksoja nevojën për një qasje tërësisht ndryshe lidhur me statistikat e veprave penale, duke filluar nga ato të policisë, prokurorisë, gjykatave, të cilat duhet të jenë jo vetëm të standardizuara, por edhe të harmonizuara. Duke filluar nga ky vit, do të mirëprisja të kisha në dorë statistika konkrete për faktorët konkretë kriminogjenë të veprave penale, të dhëna sa më të detajuara, jo vetëm për autorët, por edhe për viktimat dhe këto të jenë në dispozicion të publikut, por edhe të politikëbërësve. Pa këto të dhëna, procesi i hartimit të ligjeve dhe mbikëqyrja parlamentare e zbatimit të tyre do të jetë joefektive dhe akoma më pak efektiv do të jetë buxhetimi i programeve, shërbimeve dhe organeve të ngarkuara me ligj për parandalimin e veprave penale në familje.

Së pesti, duke qenë së bashku si profesionistë dhe politikëbërës, do t'ju ftoj që të kontribuojmë dhe të angazhohemi së bashku me njësitë e vetëqeverisjes vendore; të

Hysi, V.
« Dhuna
ekstreme në
familje
dhe masat për
parandalimin
dhe, reduktimin
e vrasjeve, për
shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

ngremë mekanizmat e referimit të dhunës në familje, aty ku nuk janë ngritur dhe të forcojmë ato ekzistuese; të koordinojmë mirë me shoqërinë civile dhe mediet, si aleatët më të mirë në parandalimin e dhunës në familje.

Së gjashti, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dy rezoluta të rëndësishme: a) rezolutën "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas" dhe rezolutën "Për angazhimin e Kuvendit për përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Axbenda 2030".

Në kuadër të angazhimit të zbatimit të objektivit 5: *Barazia gjinore* dhe objektivit 4: *Edukimi*, janë ringritur dhe kanë filluar nga funksionimi 2 grupe parlamentare: "Aleanca e Grave Parlamentare" dhe grupi i deputetëve "Miqtë e fëmijëve" si dhe, Kuvendi ka ngritur 4 nënkomisione parlamentare që janë të fokusuar në objektiva konkrete si: a) barazia gjinore dhe parandalimi i dhunës ndaj grave; b) të drejtat e njeriut; c) çështjet që lidhen me qeverisjen vendore; d) çështjet që lidhen me administratën publike.

Ne jemi të bindur se përmbushja e objektivave kërkon bashkëpunim mes partive politike në parlament, ekspertëve akademikëve, institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe biznesit dhe një monitorim sistematik të tyre. Si parlamentare, do të dëshiroja të ftoja të gjithë bashkorganizatorët e kësaj konference, që brenda fushës së kompetencave dhe përgjegjësiave e pa cenuar pavarësinë tuaj, të bashkëpunojmë lidhur me arritjen e çdo objektivit në këtë fushë, ku parandalimi i dhunës në familje është objektivit kryesor për vitin 2018.

Do doja të dëgjoja nga Policia e Shtetit se cili është objektivit i përcaktuar, sipas viteve, në lidhje me indikatorin e parandalimit të vrasjeve në familje dhe të formave të tjera të dhunës ndaj grave dhe vajzave, e në shoqëri, dhe të kishin një plan konkret veprimi, për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, të ndarë në vite, me tregues të matshëm dhe transparent.

Të nderuar pjesëmarrës!

Së fundi, për nga radha, por jo nga rëndësia do t'ju inkurajoja që krahas bashkëpunimit në procesit legjislativ dhe të kontrollit parlamentar, t'ju ftoja të ishit aktiv në monitorimin e punës së Kuvendit në lidhje me qasjen ndaj dhunës në familje dhe adresimin e zbutjes së ndikimit të faktorëve kriminogjenë të saj. Kontributi juaj konkret dhe profesional është i mirëpritur dhe shpejt ju rikthehet juve duke ndikuar në forcimin e një shoqërie të paqme, me rend dhe siguri që jeton në harmoni dhe të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe me mundësi të barabarta për të gjithë.

Si parlamentare vë re se kemi nevojë për një koordinim më të mirë të mbështetjes dhe asistencës së agjencive të UN dhe të aktorëve të tjerë për Qeverinë dhe Kuvendin dhe agjencitë ligjzbatuese, për universitetet dhe profesionet ligjore. Kjo asistencë do të jetë e frytshme atëherë kur ne të parashtrojmë problematikat dhe dëshmojmë seriozitetin në trajtimin e tyre dhe të punojmë së bashku dhe të zbatojmë programe konkrete në nivel bashkie, njësie administrative.

Edhe njëherë, ju faleminderit për vëmendjen tuaj dhe uroj e shpresoj që bashkëpunimi ynë në të afërmen të forcohet!

Mirëpres me shumë interes përfundimet e kësaj konference dhe shumë urime organizatorëve të saj!

Hysi, V.
« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve, për shkak të marrëdhënieve familjare»

Policimi dhe Siguria nr.11, 2018

Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë



z. Frederico Cafiero DE RAHO

PROKURORI KOMBËTAR I ANTIMAFIES DHE ANTITERRORIT ITALIAN



Gjatë vizitës së tij, më datë 26 shkurt 2018, z. De Raho mbajti një leksion për studentët e rinj të kësaj akademie. Për më shumë se një orë, nga ana e prokurorit u trajtuan çështje shumë të rëndësishme, ku ndër të tjera u theksua bashkëpunimi midis institucioneve të së dy vendeve, në luftën kundër grupeve kriminale që bashkëpunojnë me mafien. Gjithashtu, prokurori i njohu studentët e Akademisë së Sigurisë, me format e reja të mafies në Itali dhe lidhjen e kriminelëve shqiptarë me këto organizata. Pjesë e leksionit të z. De Raho, ishin edhe të dhënat me interes të madh, lidhur me procedimet penale të trafikantëve shqiptarë në fushat e drogave si të kanabisit, ashtu edhe drogave të forta (kokaina e heroina). Gjatë fjalës së tij, prokurori italian dha porosi për hetuesit dhe prokurorët shqiptarë, në drejtim të përdorimit të metodave të reja, për të arritur sukses në dokumentimin procedural-shkencor të krimit të organizuar. Eksperiencën e tij të gjatë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ai e tregoi duke nënvizuar se: "organizatën e dëmton rëndë qoftë edhe një polic i inkrimnuar apo i korruptuar." Fjala e tij, u ndoq me shumë interes nga studentët dhe pedagogët e Akademisë së Sigurisë.

De Raho, F. C.

« Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

12

Fjala prokurorit kombëtar të Antimafies dhe Antiterrorit Italian, z. Frederico Cafiero De Raho, e mbajtur Akademinë e Sigurisë, gjatë vizitës së tij, më datë 26 shkurt 2018.

Fillimisht, më lejoni të falënderoj Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë për ftesën dhe të përshëndes të gjithë autoritetet e pranishme në këtë iniciativë! Jam vërtet i nderuar të flas në një kontekst të tillë të kualifikuar, në Akademinë prestigjioze të Sigurisë të Republikës së Shqipërisë!

Siç shumë prej jush me siguri mund ta dini, para se të emërohesha nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës në funksionin Prokurori Kombëtar i Antimafies dhe Antiterrorizmit, unë kam pasur, ndër të tjera, funksionet e Prokurorit të Atashuar në Prokurorinë e Napolit dhe Prokurorit të Shtetit në *Reggio Calabria*.

Mendoj se është me vend të përmend këtu dy përvojat me rëndësi më të veçantë në karrierën time profesionale: në Napoli unë koordinova hetimet për Camorrën e Napolit dhe në veçanti, atë pjesë të asaj organizate të njohur si klani “i Casalesi”, ndërsa në Kalabri koordinova dhe drejtova hetimet kundër “Ndrangheta”-s.

Ndrangheta dhe *Camorra* janë dy organizata mafioze që veprojnë në Italinë e jugut: konkretisht, *Ndrangheta* në Kalabri dhe *Camorra* në *Campania*. Një karakteristikë e përbashkët e këtyre dy organizatave mafioze është aftësia për t’u zgjeruar jashtë territoreve ku kanë qenë vendosur më herët, dhe ku kanë vepruar dhe ndërvepruar për një kohë të gjatë, në mënyrë që të zgjerojnë interesat e tyre kriminale, në veçanti për të riinvestuar në aktivitete të ligjshme të ardhurat e mëdha që burojnë nga aktivitetet e paligjshme të kryera në të gjithë territorin kombëtar.

Për këto arsye si *Ndrangheta* ashtu edhe *Camorra* janë zgjeruar jo vetëm në rajonet italiane, përveç Kalabrisë dhe *Campania*-s, por edhe në vende të tjera, evropiane dhe joevropiane. Mënyrat me të cilat u konstatua ky zgjerim janë të zakonshme për të dy organizatat kriminale, megjithëse secila me veçoritë dhe specifikat e tyre: shtyrsa kryesore që përcaktoi zgjerimin e tyre jashtë vendit ishte kryerja e aktivitetit kriminal. Në fakt,

De Raho, F. C.
« Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

edhe *Ndrangheta* edhe *Camorra* kanë nisur të kenë interes jashtë territorit vendas, kryesisht për furnizimin me substanca narkotike dhe, për të siguruar çfarë i nevojitet për kryerjen e veprimtarive specifike kriminale. Prandaj *Camorra*, duke qenë e interesuar në kontrabandën e cigareve, ka vendosur kontakte me vendet e Evropës Lindore të cilat shtrihen pranë Adriatikut ose vendet e Afrikës Veriore që shtrihen pranë Mesdheut. Në këtë mënyrë, të dy organizatat kanë importuar, sipas nevojës, armë të së gjitha llojeve nga vendet e Evropës Lindore.

Furnizimi me substanca narkotike, tregu i të cilave përfiton shuma të konsiderueshme, ka bërë që organizatat kriminale të jenë dinamike në skenarin ndërkombëtar, duke fituar në mënyrë progresive një rol më të rëndësishëm në zinxhirin e furnizimit të këtij tregu. Si prokuror i *Reggio Calabria* kam parë nga afër zgjerimin e vazhdueshëm të rolit të *Ndranghetës* në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar për substancat narkotike, ashtu siç kam parë zgjerimin progresiv të aspekteve operacionale të kësaj organizate kriminale që nga Kalabria në të gjithë Italinë, Evropën dhe kontinentet e tjera.

Për këtë arsye jam plotësisht bindur se lufta kundër krimit të organizuar, që të ketë sukses, duhet domosdoshmërisht të përfitojë nga bashkëpunimi i vendeve të huaja në të cilat ky krim është prezent, qoftë për të siguruar lëndët e para për tregtinë e tyre, qoftë për të investuar fitimet e paligjshme dhe për t'i mbajtur ato të sigurta nga hetimet që zhvillohen në Itali. Bashkëpunimi ndërkombëtar duket se është e vetmja rrugë për një luftë efikase ndaj organizatave mafioze që veprojnë në bashkëpunim me grupet e tjera kriminale të krijuara jashtë, ose që zhvillojnë një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë së tyre kriminale jashtë shteti, ose që kanë interesa të veçanta ekonomike në këto territore. Ky bindje frymëzoi dhe karakterizoi aktivitetin tim të mëparshëm në Prokurorinë Kombëtare të Antimafies dhe të Antiterrorizmit.

Në pozicionin që ushtroj aktualisht, bindja për rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër mafies dhe terrorizmit është forcuar më tej, pasi kam fituar njohuri më të thelluara lidhur me organizatat mafioze dhe terroriste që veprojnë në Itali, në krahasim më njohuritë që mund të ketë një prokuror rrethi. Nuk ka dyshim se parakushti thelbësor për luftën kundër organizatave kriminale është njohja e dinamikës së këtyre organizatave, karakteristikat e tyre specifike, marrëdhënia që ato kanë me shoqërinë civile, forca e tyre ekonomike, kapaciteti për t'u infiltruar brenda institucioneve dhe pushteti ekonomik real në territoret ku ushtrojnë influencën e tyre: e gjitha kjo përbën objektin specifik të hetimeve të shumta mbi organizatat mafioze që operojnë çdo ditë në Itali dhe nga të cilat Drejtoria Kombëtare e Antimafias dhe Antiterrorizmit informohet vazhdimisht nga prokuroritë e rretheve.

Ideja e *Giovanni Falcones* për krijimin e Drejtorisë Kombëtare të Antimafies si një zyrë gjyqësore që ka për detyrë mbledhjen, koordinimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi organizatat kriminale që veprojnë në Itali, duket se, në këtë moment aktual historik, është vendimtar në luftën kundër së gjitha formave të shfaqjes së krimit të organizuar dhe terrorizmit. Mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e informacionit, koordinimi i hetimeve ndërmjet zyrave të ndryshme gjyqësore, në fakt, përbën një model operacional dhe organizativ, tashmë të përhapur edhe në nivel ndërkombëtar. Nga ideja kryesore që frymëzoi krijimin e Drejtorisë Kombëtare Antimafie, e cila më vonë u bë Drejtoria Kombëtare e Antimafias dhe Antiterrorizmit, buron besimi dhe bindja që kjo drejtori ka në rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar si një mjet i domosdoshëm në luftën kundër organizatave kriminale. Unë, pa dyshim mund

De Raho, F. C.

« Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë »

Policimi dhe Siguria nr.11, 2018

të them se Drejtoria Kombëtare e Antimafies i parapriu kohës, në identifikimin, mbledhjen dhe shkëmbimin spontan të informacionit, si një mjet i shpejtë dhe efektiv si dhe për të aktivizuar bashkëpunimin ndërmjet zyrave të ndryshme gjyqësore. Do të doja të kujtoja këtu se ishte viti 1997 kur Drejtoria Kombëtare e Antimafies bashkë me Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë përcaktuan të parin “propozim për marrëveshje për bashkëpunim në sektorin e krimit të organizuar”, ku konfirmohej parimi i shkëmbimit spontan të informacionit mbi “organizatat kriminale aktive në territoret përkatëse dhe mënyrën e tyre të veprimit” (neni 3). Kjo iniciativë lidhej me faktin se një qytetar i vendit të tyre ishte duke u hetuar për veprën penale të krimit të organizuar.

Ky protokoll, i cili mbeti në fuqi deri në vitin 2014, i parapriu për tre vjet Protokollit të OKB të Palermos, i nënshkruar më 12-15 dhjetor 2000 në të cilin Drejtoria Kombëtare Antimafie dha një kontribut të rëndësishëm. Protokollin e Palermos në paragrafin e katërt të nenit 18 përfshin mundësinë e “transmetimit të informacionit në çështjet penale tek një autoritet kompetent i një shteti tjetër palë nëse ata besojnë se informacioni mund të jetë i dobishëm për autoritetin për të ndërmarrë apo përfunduar me sukses hetimet apo procedimet penale ose mund të pasohet nga përgatitje e një kërkese nga Shteti i dytë Palë në përputhje me këtë Konventë”.

Që nga ai moment deri më tani, ka pasuar memorandume të tjera me të njëjtën përmbajtje, 39 memorandume (ose protokolle) të nënshkruara me zyrat e prokurorive të shteteve të tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare të rëndësishme, për bashkëpunim të cilat janë ndjekur nga zyra ime; shkëmbimi jozyrtar i informacioneve të dobishme për të aktivizuar, brenda një kohe të shkurtër, veprimtari hetimore që mund të komprometohen në mënyrë të pariparueshme nga vonesat e shkëmbimit të informacionit përmes procedurës standarde, letërporosive.

Me kalimin e kohës, edhe Bashkimi Evropian ka ndjekur të njëjtën rrugë në Konventën për Ndhimë të Ndërsjellët Juridike në çështjet penale midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Bruksel më 29 maj 2000, për mundësinë e shkëmbimit spontan të informacionit. Në tekstin e dekretit legjislativ të ratifikimit dhe zbatimit, miratuar në Itali më 5 prill 2017, në neni 9 përcaktohet “Shkëmbim spontan i informacionit 1. Lejohet shkëmbimi i drejtpërdrejtë dhe spontan i informacioneve dhe e akteve me autoritetin kompetent të një Shteti tjetër Palë në kuadër të një hetimi penal ose administrativ. 2. Informacionet dhe aktet e marra mund të përdoren brenda kufijve të përcaktuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Palë.” Aktualisht, legjislacioni evropian mbi bashkëpunimin në fushën penale ka shkuar më tej, duke parashikuar me ligj *rendin evropian hetimor* të instrumenteve të tjera ligjore që kanë për qëllim përsheptimin maksimal të procedurave të bashkëpunimit gjyqësor.

Por, instrumente të tilla gjyqësore aplikohen vetëm në vendet e Bashkimit Evropian (dhe jo në të gjithë vendet e tjera në të njëjtën mënyrë), si dhe në pritje që Shqipëria të hyjë në Evropë (ngjarje që Italia shpreson të ndodhë brenda një kohe të shkurtër), këta instrumente ligjorë, nuk mund të zbatohen në marrëdhëniet midis dy sistemeve tona gjyqësore, edhe pse, më lejoni të them, marrëdhëniet midis Italisë dhe Shqipërisë në këtë çështje janë sa intensive, aq dhe unike për sa i përket bashkëpunimit dypalësh gjyqësor me një shtet që nuk është vend anëtar i Bashkimit Evropian. Në fakt, përmes instrumenteve të marrëveshjeve dhe protokollove dypalëshe të bashkëpunimit, dhe të atij mekanizmi thelbësor që konsiston në njohjen, respektin dhe besimin e ndërsjellët, u mundësua një bashkëpunim intensiv me Autoritetet Gjyqësore Shqiptare, që rezultoi të jetë në niveleve të kënaqshme për të dyja palët.

De Raho, F. C.
« Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

Me një ndjesi krenarie, më lejoni të them se Drejtoria Kombëtare (Antimafia përpara dhe tani Antimafia dhe Antiterrorizmi) ka qenë dhe është në pararojë për ndërtimin, - ditë pas dite, - të një marrëdhënie dypalëshe në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, marrëdhënie që karakterizohet nga respekti i ndërsjellët dhe besimi që rrjedh nga njohja e drejtpërdrejtë e palës tjetër bashkëpunuese. Drejtoria Kombëtare e ka mbështetur këtë bashkëpunim me Shqipërinë bazuar në respektin dhe besimin e ndërsjellët, që unë besoj se deri më tani ka dhënë fryte të mira, si në shkëmbimin e përvojave që synojnë njohje më të mirë reciproke të ligjeve përkatëse kombëtare dhe mbështetje për zhvillimin legjislativ, ashtu dhe në nivelin e veprimtarisë së duhur gjyqësore (edhe pse është e nevojshme të theksohet, për shembull, se ekipet e përbashkëta hetimore midis Zyrave të Prokurorive, - deri më tani, - konsistojnë vetëm me Shqipërinë dhe Zvicrën, jashtë Bashkimit Evropian, rezultojnë të jenë kryer hetime të panumërta, rezultat i bashkëpunimit të hershëm për shkak të përputhshmërisë me protokollin e lartpërmendur. Në sajë të këtyre bashkëpunimeve, u aplikuan dhe ekzekutuan në të njëjtën kohë masa të ndryshme gjyqësore - arrestime dhe madje sekuestrime që synonin konfiskimin e pasurisë - në dy vendet tona).

Më lejoni të kujtoj se besimi në përfitimet e bashkëpunimit u shpreh qartë nga ministri aktual i Brendshëm (në atë kohë ministri i Drejtësisë) kur u kërkua ekspertiza e Drejtorisë Kombëtare të Antimafies për përgatitjen e ndryshimeve legjislative në Kodin Penal dhe Procedurën Penale që deri tani njihen si “paketa antimafia” dhe se ai mori menjëherë përgjigje. Njëri nga paraardhësit e mi të shquar, i ndjeri Piero Vigna, i cili autorizoi një koleg nga zyra ime për të studiuar këto reforma, që më pas u miratuan menjëherë nga Parlamenti.

Por nuk mund ta kthejmë kokën vetëm në të shkuarën për sa i përket bashkëpunimit të ngushtë dypalësh, por **domosdoshmërisht duhet të shikojmë në të ardhmen;** edhe nëse e shkuara përbëhet nga shumë episode dhe momente kënaqësie, siç janë trajnimet nga magistratët e A.D.N-së në Shkollën e Magjistraturës dhe të Prokurorisë së Përgjithshme në Tiranë apo inaugurimi i qendrës antitrafik në Vlorë.

Lidhur me realitetin e përhapjes së kriminalitetit në Itali, i përbërë nga subjekte që vijnë nga Shqipëria, dhe që kërkon një rritje dhe një përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit tonë, po Ju paraqes disa shifra:

Subjektet e lindura në Shqipëri, që hetohen në Itali për veprat penale, që janë nën juridiksionin e drejtorive rajonale të antimafies, deri më 30 qershor 2017, janë:

- 979 subjekte, nga të cilët 504 në procedim dhe për të cilat hetimet ende nuk kanë përfunduar.

- Veprat penale më të përhapura lidhen me natyrën transnacionale të trafikimit të lëndëve narkotike.

- Shpërndarja territoriale e hetimeve mbulon të gjithë territorin kombëtar.

Në atë datë u zhvilluan hetime në ngarkim të personave të lindur në Shqipëri, hetime të kryera nga Prokuroritë vendore në Ankona, Bari, Bolonjë, Brescia, Cagliari, Caltanissetta, Campobasso, Catania, Catanzaro, Firenze, L'Aquila, Lecce, Napoli, Perugia, Reggio Calabria, Roma, Torino, Trento, Trieste, Venecia dhe Milano.

Këto të dhëna, në vetvete, tregojnë thelbin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar që lidh Italinë me Shqipërinë dhe nevojën për të bërë çdo përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar dhe forcuar një bashkëpunim të

tillë, i cili aktualisht është në nivele të larta, me qëllim arritjen e rezultateve më të mira të mundshme. Është mëse e qartë që forcimi i bashkëpunimit nënkupton njohuri të plota të procedurës penale të vendeve në fjalë dhe të legjislacionit të tyre të brendshëm.

Zyra ime, e cila gjithmonë ka ndjekur me vëmendje të madhe evoluimin e legjislacionit shqiptar për çështjet penale, ka studiuar ndryshimet e paraqitura kohët e fundit në legjislacionin shqiptar në lidhje me organizimin e sistemit të drejtësisë, procedurën penale, si dhe të drejtën materiale penale. Reforma kushtetuese ka përcaktuar një sistem gjyqësor modern, dhe në mendimin tim, është një sistem që mund të rezultojë potencialisht efektiv. Krijimi dhe ngritja e një komisioni të posaçëm për vlerësimin e përshtatshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, vlerësimi i figurës si dhe kontrolli i pasurisë së tyre apo familjarëve të tyre, lidhur kjo me aktivitetin e tyre të mëparshëm, përbën një filtër të fuqishëm për të siguruar cilësinë e përzgjedhjes së atyre funksionarëve publikë që janë emëruar në funksione të rëndësishme në sistemin e drejtësisë.

Gjithsesi, sipas mendimit tim, reforma më e rëndësishme kushtetuese, lidhet me strukturën e organit të akuzës: përkatësisht neni 148 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, përcakton në mënyrë të qartë se prokuroria është organ i pavarur, që funksionon pranë sistemit gjyqësor; neni 149 përcakton Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i përbërë nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga radhët e prokurorëve të së gjitha niveleve të prokurorisë dhe ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 149/a të Kushtetutës duke garantuar në këtë mënyrë pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Së fundi, krijohet zyra e Prokurorit të Posaçëm dhe njësia e posaçme e hetimeve për zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimeve të kryera nga zyrtarë të lartë të përcaktuar në nenin 135/paragrafi 2 i Kushtetutës.

Veçanërisht të rëndësishme, për pasojat e kësaj reforme në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Drejtorisë Kombëtare të Antimafies dhe autoriteteve gjyqësore shqiptare, shfaqen rrethanat ku zyra e Prokurorit të Posaçëm është e pavarur nga ajo e Prokurorit të Përgjithshëm dhe që njësia speciale e hetimit do të jetë në vartësi të zyrës së Prokurorit të Posaçëm. Këto dispozita pasohen nga rregullime të tjera ligjore që kanë lidhje me zyrën e Prokurorisë (respektivisht nenet 24-29 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar me Ligjin nr. 35/2017) dhe dispozita të tjera që lidhen me Policinë Gjyqësore (përcaktuar respektivisht në nenet 30-33 të Kodit të Procedurës Penale) të cilat sigurojnë një lidhje të drejtpërdrejtë midis seksioneve dhe shërbimeve të policisë e prokurorisë. Neni 32 i Kodit të Procedurës Penale përcakton funksionet që konsiderohen oficerë dhe agentë të policisë gjyqësore, si dhe paragrafi 3 përcakton se në caqet e shërbimit që u është besuar dhe sipastributeve përkatëse, personat, të cilëve me ligj u njihen funksionet e parashikuara nga neni 30, janë gjithashtu oficerë dhe agentë të policisë gjyqësore. Dispozitat përcaktojnë në mënyrë të qartë lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Kjo lidhje është akoma më e theksuar nëse konsiderojmë se Zyra e Prokurorit të Posaçëm bashkëpunon me “Byronë Kombëtare të Hetimit” (BKH) dhe se hetuesit e kësaj zyre kanë statusin e oficerëve të policisë gjyqësore. Është e qartë se kuadri ligjor aktual kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrës së Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore.

Por, nga ana tjetër, duhet të ketë një bashkëpunim edhe më të ngushtë ndërmjet

De Raho, F. C.
« Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

hetuesve të BKH dhe Prokurorisë së Posaçme, gjatë hetimeve të kryera në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Hetime të tilla kërkojnë një nivel të lartë profesionalizmi si dhe nivel të lartë besueshmërie reciproke me qëllim kryerjen me sukses të hetimeve. Porë në këtë këndvështrim, roli i policisë gjyqësore në kryerjen e hetimeve merr një vlerë të veçantë dhe nuk minimizohet nga funksionet e Prokurorit i cili drejton hetimet, sipas parashikimeve ligjore në Kodin e ri të Procedurës Penale. Duke marrë në konsideratë ngjashmërinë e kuadrit ligjor ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, mund të themi që përvoja dhe eksperiencia italiane padyshim ka treguar se marrëdhëniet e ngushta ndërmjet policisë gjyqësore dhe prokurorit, kanë ndikuar në forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore. Ajo që dua të theksoj lidhur me këtë aspekt, është fakti që gjatë hetimeve, prokurorët kanë përdorur përvojën specifike të policisë gjyqësore në protokollet hetimore. Por, nga ana tjetër, edhe policia gjyqësore, ka shfrytëzuar kompetencat e prokurorit, i cili jo vetëm drejton hetimin, por është përgjegjës i drejtpërdrejtë për strategjinë e hetimit, që synon përcaktimin e veprës penale, të vënë në funksion të kryerjes me sukses të hetimeve.

Faza e hetimeve paraprake, në fakt, ka për qëllim verifikimin e njoftimit të veprës penale, fazë e cila konkludohet me një vendim përfundimtar vënë në dispozicion të prokurorit, për të proceduar më tej me marrjen e provës dhe njohjen në gjykatë, për kryerjen apo jo të veprës penale, ose në mungesë të elementëve të mjaftueshëm, konfirmimin apo jo të kryerjes së veprës penale dhe për të vijuar me arkivimin e çështjes. Vlen të theksohet fakti që departamenti i policisë gjyqësore është thelbësor për të sqaruar çështjen nën hetim, në të gjitha aspektet e saj.

Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, jurisprudenca apo njohja e vendimeve të unifikuara – si dhe bazuar në rezultatet e hetimeve – prokurori mund të konkludojë, nëse është e nevojshme, kryerjen e hetimeve të tjera më të thelluara, si dhe mbledhjen e provave të tjera shtesë (si në Itali, apo në Shqipëri, sanksionuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale) me qëllim verifikimin e çdo elementi të hetimeve. Ndërveprimi midis policisë gjyqësore dhe prokurorisë kërkon një nivel të lartë profesionalizmi, si nga ana e prokurorisë ashtu dhe nga ana e policisë gjyqësore. Një ndërveprim i tillë, është një kusht thelbësor për suksesin e reformave të paraqitura në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria Kombëtare për Antimafien dhe Antiterrorizmin, ashtu si në të kaluarën, është e gatshme të ofrojë, në format dhe mënyrat më të dobishme dhe të përshtatshme, përvojën dhe njohuritë e saj për rritjen profesionale të policisë gjyqësore dhe prokurorëve. Gjithnjë kemi përkrahur Republikën e Shqipërisë dhe institucionet e saj, dhe nuk do të anashkalojmë ndonjë kërkesë për mbështetje drejtuar nga institucionet shqiptare për zyrën tonë. Për sa i përket bashkëpunimit, legjislacioni përcakton rregulla të veçanta për marrëveshjet midis shteteve; prandaj, gatishmëria jonë e plotë, e konkretizuar disa herë përmes shkëmbimit spontan të informacionit, mbetet e fortë.

Sa i përket marrëdhënieve midis Italisë dhe Shqipërisë, shkëmbimi i informacionit është parashikuar nga neni. V i ligjit nr. 97, më datë 14. 6. 2011, të ratifikimit të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike dypalëshe, “Shkëmbimi spontan i informacionit”, i cili parashikon:

1. Brenda kufijve që vendos e drejta e brendshme, autoritetet gjyqësore kompetente të Palëve Kontraktuese mund të procedojnë për një shkëmbim informacioni, pa qenë paraqitur një kërkesë për këtë qëllim, në lidhje me vepra penale që ndiqen nga ana e autoritetit marrës në momentin e transmetimit të informacionit.

2. Informacionet shkëmbehen në mënyrë të shkruar, ose nëpërmjet çdo mjeti të aftë për të prodhuar një regjistrim të shkruar, me kushtet që i lejojnë Palëve Kontraktuese që të verifikojnë vërtetësinë e tyre.

3. Autoriteti që siguron informacionin, sipas të drejtës së brendshme, mund t'i imponojë autoritetit gjyqësor marrës kushte për përdorimin e këtij informacioni. Autoriteti gjyqësor marrës i respekton këto kushte.

4. Midis autoriteteve gjyqësore kompetentë të parashikuara nga paragrafi 1, për palën italiane, Drejtoria Kombëtare e Antimafies procedon me shkëmbimin e informacioneve dhe të aktiviteteve të tjera të dhëna asaj nga e drejta e brendshme e vendit.

Prandaj, legjislacioni i lartpërmendur lejon shkëmbimin spontan të informacionit dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të kërkesave për ndihmë juridike (neni IV i të njëjtës marrëveshje): rregullat e posaçme të përfshira në marrëveshjen dypalëshe garantojnë shpejtësinë e bashkëpunimit, pasi ato prevalojnë mbi legjislacionin e brendshëm (Neni 1, paragrafi 2 i Ligjit të Republikës së Shqipërisë nr. 10 193, më datë 3.12.2009, për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja që parashikon moszbatimin e dispozitave të këtij ligji kur parashikohet ndryshe nga marrëveshjet ndërkombëtare, siç është rasti me Italinë).

Në fazën aktuale të tranzicionit, në legjislacionin e miratuar së fundmi nga Parlamenti, autoritetet gjyqësore italiane do të vazhdojnë transmetimin e drejtpërdrejtë të kërkesave për ndihmë juridike, edhe kur ka të bëjë me kryerjen e aktiviteteve të tjera, përveç shkëmbimit spontan të informacionit, pranë Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare si dhe Prokurorisë për Krime të Rënda për çdo aktivitet (që nga shkëmbimi i informacionit deri në ngritjen e ekupeve të përbashkëta hetimore) për veprat penale nën juridiksionin e asaj zyre. Kodi i Procedurës Penale përcakton se “deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuar në nenin 75/a të Kodit Penal do të hetohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në rastet e përmendura në shkronjën “b) për çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur,” dhe sipas procedurës para hyrjes në fuqi të ligjit.

Bazuar në reformat e miratuara nga Parlamenti shqiptar në sistemin e drejtësisë, konstatohet që ka një dëshirë të madhe për të forcuar besimin e qytetarëve në drejtësi.

Me qëllim që të arrihet ky rezultat, nuk është e mjaftueshme vetëm ekzistenca e legjislacionit: faktet janë po aq të nevojshme dhe të rëndësishme.

Faktet janë rezultatet që drejtësia shqiptare do të arrijë suksesshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

De Raho, F. C.
« Fjala e prokurorit De Raho, në Akademinë e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

Në Shqipëri, ashtu si në një pjesë madhe të Italisë, të gjithë i njohin njerëzit që pasurohen, p.sh., përmes trafikimit paligjshëm, dhe shumica e njerëzve mendojnë se fuqia e parave u siguron atyre mosdëshkim: është përgjegjësia jonë që të dëshmojmë të kundërtën, duke dëmtuar organizatat kriminale dhe, mbi të gjitha, duke i privuar ata nga të ardhurat e aktivitetit kriminal që ata kanë akumuluar. Të gjitha instrumentet ligjore duhet të përdoren pa asnjë hezitim, dhe theksoj që Drejtoria Kombëtare për Antimafien dhe Antiterrorizimin është, si gjithmonë, e gatshme për të luajtur rolin e saj. Dorëzimet e kontrolluara, përdorimi i agjentëve të fshehtë, ekipet e përbashkëta hetimore, shkëmbimi i menjëhershëm i informacionit ndërmjet autoriteteve gjyqësore për çështjet në hetim, janë vetëm disa nga teknikat që kemi aplikuar me qëllim rritjen e efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar transnacional. Këto teknika të posaçme hetimore parashikohen në legjislacionin e brendshëm të së dy vendeve tona, kështu që duhet t'i aplikojmë sa më shpesh dhe me një besim më të madh.

Më lejoni të mbyll fjalën time me këtë konstatim: kur i kemi përdorur gjerësisht këto mjete të posaçme hetimore (veçanërisht ekipet e përbashkëta hetimore, që mundësojnë kombinimin e përdorimit të teknologjive të avancuara për kryerjen e aktiviteteve të caktuara, me njohjen e territorit të duhur për ata që punojnë dhe banojnë në atë territor), edhe rezultatet janë parë dhe perceptuar menjëherë.

Duhet të vazhdojmë të punojmë së bashku, me besimin dhe bindjen se, siç tha *Giovanni Falcone*, “mafia është një fenomen njerëzor dhe, ashtu si gjithë fenomenet njerëzore, ka një fillim, një zhvillim dhe për këtë arsye ka edhe një fund”.



De Raho, F. C.
« Fjala e
prokurorit De
Raho,
në Akademinë
e Sigurisë
së Republikës
së Shqipërisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018



**Rica, A.
dhe
Rica, E.**

« Parandalimi i
krimit mjedisor,
si përgjegjësi
e policisë
gjyqësore »

Policimi
dhe
Siguria
nr.7, 2017

Zgjedhja e liderit të efektshëm



■ **Dr. Bilbil MEMAJ**
Drejtor/Rektor
Akademia e Sigurisë
bilbil.memaj@asp.gov.al

Abstrakt

Në një organizatë të një rëndësie të veçantë, si policia, menaxhimi i burimeve njerëzore është jetikë për realizimin e misionit të saj, sa të vështirë aq edhe fisnik. Në këtë proces menaxhimi, momente kulmore janë ato të vendimmarrjes për zgjedhjen e liderit të policisë në nivel qendror e vendor. Vendimi për zgjedhjen e një lideri për drejtimin e një organizate policie është një përgjegjësi e madhe për autoritetin vendimmarrës, nisur nga rëndësia që ai ka. Lideri është një faktor kyç i suksesit të organizatës së policisë, por gjithashtu mund të kthehet në një pengesë serioze për realizimin e objektivave të saj, kjo është në varësi të plotë nga lloji i liderit që kemi zgjedhur. Është një fakt i pakundërshtueshëm nga të gjithë, se strukturat policore duhet të kenë në krye një lider dhe jo një drejtor/menaxher. I një rëndësie të veçantë për evidentimin e një lideri, është edhe personaliteti që e karakterizon atë. Në këtë punim, do të japim, mes të tjerash, disa parime të përgjithshme, që një lider duhet t'i ketë të mishëruara, si kusht për t'i besuar atij detyrën për udhëheqjen e një organizate policie. Ka studime që japin disa orientime të përgjithshme, të cilat janë me interes për mënyrën se ku duhet të bazohemi për përzgjedhjen e një lideri të efektshëm.

Fjalëkyçe:

lider, lidership policor, organizatë, parimet e lidershipit, personalitet.

Memaj, B.
« Zgjedhja
e liderit
të efektshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Drejtor apo lider?

Suksesi i organizatës së policisë arrihet kur kombinohen pozitivisht: strategjitë, strukturat, sistemet, stafi, aftësitë, stilit e punës dhe vlerave më të mira të përbashkëta. Liderët nuk gjykohen vetëm nga influenca personale. Ata duhet patjetër të marrin në konsideratë aspektet organizative si kontrolli i punës, sistemet e komunikacionit, matja e performancës, niveli i aftësive ne forcën e punës dhe struktura e kontakteve¹. Nisur nga ky përfundim, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e personit që do të udhëheqë një njësi, apo vetë një organizatë policore. Në rastet kur do të vendosim për zgjedhjen e një drejtuesi policor lind nevoja e një analize ose e një bilanci të punës së organizatës së drejtuar prej tij. Në analizë krahasohen treguesit e kriminalitetit, gjendja e rendit gjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin e tij. Janë zbatuar strategjitë e miratuara apo jo? Kush ka qenë impakti i tyre? Është momenti të vlerësojmë edhe gjendjen e brendshme të strukturës së policisë. Vlerësimi duhet bërë për dy arsye:

- *E para*, për të përcaktuar se çfarë drejtori kemi pasur në krye të kësaj strukture policore. Kemi pasur drejtor që ka qenë në nivelin vendimmarrës strategjik, apo jo? Ka arritur të jetë i pavarur në zbatim të ligjit, apo ka qenë i ndikuar nga presioni i ushtruar prej faktorëve të jashtëm? Shkaqe këto, të cilat nuk e kanë lejuar drejtuesin të arrijë performancën në nivelin e duhur. Përgjigjet e këtyre pyetjeve mundësojnë renditjen e problematikave të organizatës, si p.sh.: realizimi i pjesshëm i objektivave strategjik, keqmenaxhimi i burimeve njerëzore, mungesa e theksuar e disiplinës në punë, probleme me integritetit, etj.

Analiza mbi ecurinë e punës në organizatën e policisë, nëse bëhet, duhet të përcaktojë

¹ Adlam, R., dhe Villiers P. (2003) *Police Leadership in the Twenty-first Century*. Winchester: Waterside Press, f. 238

Memaj, B.
« Zgjedhja
e liderit të
efektshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

qartë problemet për të cilat drejtimi i strukturës policore ka dështuar, ose nuk është në nivelin e kërkuar, por mbi të gjitha duhet të evidentojë qartazi faktin, që gjendja e krijuar është pasojë e një paaftësie dhe keqmenaxhimi, apo neglizhencë e drejtuesit. Shpeshherë kjo analizë nuk kryhet, pasi na intereson dhe përqendrohemi se kush vjen për të drejtuar organizatën, duke anashkaluar totalisht faktin, se kush ikën. Të gjithë fokusohemi më shumë tek marrëdhënia me atë që vjen pa hedhur një këndvështrim dhe pa pasur një vlerësim mbi ndryshimet pozitive, apo negative, që kjo strukturë policie ka pësuar në sajë të drejtimit të ushtruar nga lideri që e udhëhoqi atë. Për një strukturë apo për një organizatë policie, ka ardhur momenti që të shihet me transparencë se si ka qenë ushtrimi i këtij funksioni nga ana e drejtuesit, me qëllim që ta kemi të qartë dhe të kuptojmë, nëse kemi pasur të bëjmë me një drejtor të zakonshëm, apo lider të policisë; dhe, nëse ky drejtues gjatë qëndrimit në krye të një organizate të policisë, i ka zbatuar apo jo parimet themelore të një lideri të efektshëm. Për sa i takon pjesës së ushtrimit të funksionit, është shumë e nevojshme që të përcaktojmë llojin e ushtrimit të detyrës, të ndajmë mirë ndikimin e tij si lider: nëse e vlerësojmë si të tillë apo si një menaxher policie, nëse nuk ka arritur të vlerësohet si lider. Ky vlerësim, duhet bërë duke përcaktuar llojin e fuqisë drejtuese që ka ushtruar drejtuesi i policisë, e cila lidhet me efektet që ka prodhuar, në radhë të parë te vetë organizata dhe mandej, në nivelin e shërbimit që organizata i ka dhënë publikut. Kjo fuqi drejtuese buron nga ushtrimi i fuqisë ligjzbatuese nga ana e drejtuesit të një organizate policie.

- *E dyta*, në bazë të parametrave që ka policia të përcaktuara nga analiza e bërë më lartë, do të zgjedhim edhe liderin e përshtatshëm. Ne do të zgjedhim liderin që do të jetë i spikatur në ato drejtime që janë edhe problemet më të mprehta të strukturës policore. Kështu do të jemi në gjendje të zgjedhim drejtorin që për momentin organizata jonë ka nevojë. Ky, mund të jetë lider *demokrat, liberal* apo *autokrat*, me qëllim që të ndryshojmë pozitivisht gjendjen e policisë ku zgjidhet. Është shumë e rëndësime cilësia e liderit për të realizuar objektivat e policisë.

*Cilësia e lidërsipit policor ka qenë subjekti i interesit të vazhdueshëm, debateve të forta dhe dhënies së detajeve kritike këto vitet e fundit. Si rezultat i kësaj, është dashur kohë, energji, përpjekje dhe analiza të konsiderueshme për të eksploruar karakterin e lidërsipit policor.*²

Duhet të theksojmë se qëllimi është të krijojmë një portret “Lideri” të mirë policor, i cili është edhe i efektshëm, por edhe që zgjat në kohë: të dyja të rëndësishme për organizatën e policisë. Më shumë, kjo vlen për të përmirësuar defektet e punës së organizatës së policisë të shkaktuara nga ushtrimi i fuqisë ligjore nga ana e drejtuesit të saj dhe për të korrigjuar pengesat apo ndërhyrjet e jashtme jo ligjore, që ndikojnë në vendimmarrje. Për ta bërë të mundur këtë, pra që të zgjedhim lider të efektshëm duhet të kemi të hartuar një doktrinë për lidërsipin. Doktrina është e nevojshme për të përcaktuar parimet dhe kriteret ku duhet të mbështetemi, në përzgjedhjen e drejtuesit/liderit në organizatat e sigurisë publike si dhe modalitetet e largimit nga funksioni³. Kërkesat thelbësore që duhet të përmbajë kjo doktrinë janë:

- të ofrojë cilësitë, kërkesat që duhet të plotësoi lideri në nivele të ndryshme të shërbimit policor, pra që nga drejtuesit e vijës së parë dhe deri tek drejtuesit më të lartë të policisë;

² ibid.

³ Memaj, B. (2016) *Lidërsipi në Policinë e Shtetit*. Tiranë: Kristalina, f. 19.

- modalitetet e zgjedhjes dhe të largimit të liderit të policisë nga funksioni;
 - të përmbajë filozofinë dhe parimet bazë të drejtimit dhe menaxhimit të policisë;
 - të jetë e qartë, gjithëpërfshirëse, lehtësisht e kuptueshme dhe e përshtatshme për t'u zbatuar në praktikë;
 - të jetë shprehëdhënëse, motivuese dhe frymëzuese për gjithçka që ka të bëjë me realizimin korrekt të detyrave gjatë shërbimit policor në komunitet;
 - të synojë që të bëjë më së miri një rritje organike, se sa një punë mekanike.
- Pra, ajo duhet të na jap një zhvillim në vazhdimësi.

Policisë në drejtim, në çdo nivel, i duhen lider, pasi vetëm ata mund ta transformojnë atë në një organizatë moderne, ku çdo anëtar i organizatës të ndihet një kontribuues dhe të vlerësohet si i tillë nga të tjerët; ku, qytetarët të kenë besim gjithnjë e në rritje tek policia. Praktika ka treguar, se jo çdo drejtor është apo mund të bëhet lider. Ka shumë nga ata që janë dhe mbeten menaxherë të mirë, por nuk arrijnë të bëhen lider. Drejtuesi i policisë i çdo niveli të hierarkisë duhet të jetë menaxher i shkëlqyer, por njëkohësisht duhet të jetë lider. Ja përfundimi i një studimi për profilin e drejtuesit të nivelit strategjik në Europë.

Profili i një lideri strategjic policor “tipik” europian është një “mashkull i zbehtë në fytyrë”, rreth të 50-tave, konservativ, mjaft i edukuar (shpesh me një diplomë), i cili i ka ngjitur vetë të gjitha gradat policore. Ai ka eksperiencë, si me uniformën po ashtu edhe me hetimin si dhe, ai është testuar në mjaft poste operacionale. .⁴

Për të arritur në përfundime se si duhet të jetë një drejtor policie, po trajtojmë disa nga parimet kryesore dominuese në punën e një punonjësi policie, të cilit i besohet drejtimi i një organizate policie apo të i një institucioni sigurie publike.

2. Parimet e një lideri të efektshëm të policisë

Eksperienca ka treguar se për të udhëhequr një organizatë policore jo vetëm që duhet të jesh lider, por duhet njëkohësisht t'i përmbahesh disa parimeve, të cilat janë: përkushtimi ndaj shërbimit, mosqenia egoist, vetëdija strategjike, mbështetja totale te organizata, ekselencia profesionale, kohëzgjatja me integritet⁵.

Kandidati për lider duhet të jetë udhëhequr dhe të udhëhiqet nga këto parime, për të qenë në krye të njësisë të policisë, pra, për tu zgjedhur në nivelet e saj të drejtimit. Po i sqarojmë parimet e mësipërme për të bërë një ballafaqim të subjektit lider në nivele të ndryshme të policisë, me cilësitë dhe parimet që ata duhet të përmbushin.

- Parimi i përkushtimi ndaj shërbimit

Niveli i liderëve në organizatën policore është i ndryshëm. Në përgjithësi janë të angazhuar për të siguruar shërbimin më të mirë të mundshëm policor për çka drejtojnë. Në vazhdimësi ata mendojnë të menaxhojnë policinë, me qëllim të që të ulin krimet në të gjithë territorin dhe të garantojnë një siguri publike të kënaqshme për qytetarët e vendit. E gjithë kjo përbën detyrën “makro” të një drejtuesi të organizatës policore. Nëse kjo detyrë përmbushet me sukses, atëherë ne mund të themi se kemi një drejtues të mirë dhe që ka zbatuar parimin më kryesor të së qenit drejtues organizate, atë të

⁴ Caless B. dhe Tong S. (2015), *European Police Science And Research Bulletin*, no. 12, University of Bristol's Policy Press.

⁵ Adlam. R., dhe Villiers, P., *Policie ...*, f. 238.

Memaj, B.
« Zgjedhja
e liderit të
efektshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

shërbimit. Ky qëndrim është pothuajse metodologji në shumicën e drejtuesve të policisë; këtu bëhet me të gjithë ata që kanë ushtruar një funksion drejtori, pra vlerësohet pjesa kryesore e veprimtarisë. Ky vlerësim për ta, do të ishte i plotë, nëse kjo mendësi e shoqëruar me veprim dhe me arritje të prekshme të gjendjes të zgjatej në kohë, pra duhet që të kemi rezultate të cilat të jenë të qëndrueshme. Vlerësimi duhet të bëhet në një afat kohor më të gjatë dhe për të gjithë anëtarët e organizatës, në këtë rast kemi qëndrueshmëri të gjendjes. Pra kërkohet që puna e drejtuesit të organizatës të jetë e ndërtuar në atë mënyrë që të krijoj kushte dhe të japë impakt pozitiv tek anëtarët e organizatës, me qëllim që të gjithë të punojnë të motivuar.

Ka edhe një qëndrim tjetër që ka lidhje me parimin, të cilin kërkohet që ta ketë e ta zbatojë Drejtori i Policisë. Ky është qëndrimi i tij ndaj vartësve, ndaj një oficeri të sëmure apo ndaj një qytetari që mund të jetë dhunuar nga policia. Në pamje të parë duket si pa rëndësi, por në fakt ka impakt shumë të madh në publik. Qëndrimi ndaj episodeve të tilla tregon dimensionin tjetër të një drejtori që mund të jetë i nivelit “mikro”, por që për nga rëndësia nuk është i vogël pasi tregon dimensionin njerëzor. Nëse do që të vlerësohesh si lider, duhet që të njihesh si i tillë dhe këto dy anë të këtij parimi duhet të jenë të mishëruara tek drejtori, për t’u njohur si një drejtues lider në polici. Kjo shihet, ose duhet të vlerësohet te lideri i policisë, në të gjitha nivelet e një lideri.

- Parimi i mosqenies egoist

Drejtesit e policisë ndër vite për shumë faktorë nuk kanë arritur të krijojnë një filozofi dhe një doktrinë për zgjedhjen e tyre në karrierë, ku vlerësimi me meritë të ishte kryefjala dhe drejtori, të ishte një lider i vërtetë i njësisë së policisë që drejton. Kjo organizatë e meriton që të udhëhiqet nga drejtues që mbartin vlerat më të mira personale dhe profesionale dhe këta liderë janë dhe gjenden në radhët e policisë. Mungesa e një doktrine, ka shtuar egoistët të cilët në shumicën e rasteve e dinë edhe vetë që nuk i kanë cilësitë për tu bërë lider, por natyrisht ata mund të emërohen dhe të bëjnë drejtorin. Lideri që i duhet policisë për ta udhëhequr nuk mund të jetë një egoist sepse një i tillë drejtor nuk do ishte lider. Lideri i policisë vendos gjithmonë interesat e stafit, organizatës dhe të publikut para interesave personale, kurse një drejtor egoist vendos si parësore interesat e veta personale. Policia ka nevojë për liderë në të gjitha nivelet e drejtimit të saj, me qëllim që ushtrimi i autoritetit të përputhet më vlerësimin e vartësve dhe ata ta ndjekin atë, si kolegjin që ka cilësitë më të mira në të gjitha drejtimet.

- Parimi i vetëdijes strategjike

Liderët policorë të efektshëm duhet të vijnë natyrshëm dhe gradualisht në detyrë. Ata duhet të bazohen në praktikën e tyre përmes një vargu pushtetesh personale dhe cilësish individuale, të njohura si të tilla nga vartësit dhe eprorët e tyre në vitet e karrierës. Përvoja e një lideri është një shkollë më vete dhe kur ajo mbart arritje pozitive, është mësim vlerash për pasardhësit dhe ndjekësit e tyre. Kjo përfshin një gamë të gjerë virtyesh intelektuale që në kombinim me njohuritë dhe eksperiencën profesionale, gjeneron kredibilitet dhe vetëbesim. Një drejtues i mirë duhet të ketë demonstruar që është vizionar dhe që nuk kënaqet asnjëherë me arritjet, por që i vlerëson ato, duke motivuar policët që të shkëlqejnë. Liderët efektivë të policisë janë të ndjeshëm ndaj mjedisit social, kulturor, politik dhe ekonomik brenda të cilit operojnë shërbimet policore. Ata duhet të jenë në gjendje të komunikojnë me publikun e gjerë në të gjitha

nivelet drejtuese dhe komunikimi i tyre të jetë frymëzues dhe mobilizues dhe jo dekurajues e bezdisës.

- Parimi i mbështetjes në drejtim policor

Drejtimi është një proces i pandërprerë ndikimi, mbi të tjerët dhe mbi vetveten. Pra, drejtimi është arti i sjelljes me njerëzit, me pikësynimin që drejtuesi të ndikojë te vartësit e bashkëpunëtorët, duke i bindur ata të veprojnë sipas idesë së tij. Drejtuesi vë në jetë këtë proces duke zbatuar atributet e tij të drejtimit (besimit, vlerat, etikën, karakterin, njohuritë dhe aftësitë e tij). Leadershipi policor dhe komandimi janë dy elementë të lidhur ngushtë për udhëheqjen e një organizate policie me strukturë dhe drejtim të centralizuar. Në këto raste është e vështirë, ndoshta e pamundur, për të vlerësuar njërin pa pasur në konsideratë tjetrin. Gjenerali Kolin Pouell, për raportet midis liderit dhe komandantit shprehet: “Si një organizues dhe komandant i mirë ju kërkohen aftësi leadershipi, por kapja e një pozicioni autoritar nuk kupton aspak se ky person është një lider. *Leadership nuk do të thotë thjesht autoritet, por aftësi për të drejtuar të tjerët.* Komandantët nuk mund të jenë liderë, nëse ata bëjnë pak për të ndikuar dhe inspiruar vartësit e tyre. Komandanti, në të vërtetë bëhet lider vetëm kur ai është pranuar si i tillë nga vartësit e vet. Leadershipi kërkon shumë më tepër se aftësi menaxhuese apo autoritet ligjor.”⁶

Liderët policor të efektshëm duhet të kenë një gamë të gjerë aftësish lidhur me “njerëzit” midis të cilëve aftësitë thelbësore janë ato te: dëgjimit, përbaljes me vështirësitë, menaxhimit të konflikteve, negocimit dhe bashkëpunimit në zgjidhjen e problemeve. Ato venë në përdorim këto aftësi dhe të tjera, që i mundësojnë atyre t’i lejojnë dhe fuqizojnë stafin si individualisht ashtu edhe në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ekipeve të efektshme. Shkurtimisht, drejtorët e mirë mbështesin, vlerësojnë dhe inkurajojnë stafin e tyre, te cilët ndjejnë që ekziston një ambient i tillë pune, në të cilin ata mund të lulëzojnë dhe shfaqin aftësitë e tyre më të mira. Është pa diskutim e rëndësishme që vartësit të kuptojnë vizionin e drejtorit, me qëllim mbështetjen e realizimit të tij.

- Parimi i ekselencës profesionale

Një nga parimet më të rëndësishme që e bën liderin e policisë të jetë i respektuar dhe i përkrahur nga të tjerët është padyshim niveli i shkëlqyer (shembullor), i përsosur, i profesionit të policimit. Është ky parim, që vendos dhe mban standarde te larta personale dhe profesionale në vendin e punës. Pra, ata janë profesionistët rigorozë që luftojnë shumë për ekselencën. Këtë nivel e demonstrojnë me modesti duke treguar virtyte si intelektuale ashtu edhe morale. Në këtë rast efektshëmria e liderit të policisë është e madhe, pasi ai është i besueshëm, i hapur, i ndershëm, i drejtë dhe i dhembshur. Është ky lider që ka vullnetin e mirë të përballet me performanca të dobëta, qëndrime të kundërta dhe të padrejta, për t’i bindur ata për më të mirën e tyre dhe të organizatës. Liderët policorë bëhen të efektshëm, kur operojnë me metoda të efektshme ndaj sfidave me të cilat përballet organizata e tyre policore. Ata për shkak të integritetit të tyre të veçantë janë të dukshëm si individë dhe bien në sy, ofrojnë mençuri dhe urtësi dhe kanë komunikim të ngrohtë.

- Parimi i kohëzgjatjes me integritet

Lidershipi i mirë policor kërkon cilësi stoike dhe jetëgjatësisë. Nuk mundet të

Memaj, B.
« Zgjedhja
e liderit të
efektshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

⁶ Powell, C. (2012) *It worked for me: in life and leadership*. New York: Harper Collins, f. 74.

vlerësojmë dhe ta konsiderojmë lider, një drejtues që ka bërë një operacion policor të suksesshëm, por kur ai ka pasur dhe ka realizuar një vizion për organizatën që drejtoi. Për suksesin e një apo edhe disa operacioneve, drejtuesit vlerësohen me medalje. Drejtimi dhe transformimi i organizatës në përputhje me një vizion dhe objektiv të organizatës, tregon padyshim nivelin strategjik të drejtorit. Thënë ndryshe integriteti i një drejtori nuk duhet të vlerësohet për një periudhë të shkurtër, por për një kohë të gjatë. Në këtë rast kemi integritet të qëndrueshëm, që përbën edhe një nga vlerat thelbësore të një lidërshipi të efektshëm. Drejtuesi i policisë diskuton dhe kontribuon së bashku me oficerët e lartë të policisë për të përkrahur dhe përforcuar ligje për të cilat njohuritë dhe gjykimet profesionale mund të sugjerojnë të jenë në interes të organizatës për arritjen e qëllimit strategjik. Lideri i policisë me integritet, bëhet imponues pozitiv në publik dhe ndikon shumë në besueshmërinë që duhet të ketë publiku te policia. Në një demokraci pluraliste, që beson tek policimi me konsensus, policia ka të drejtë të dëgjohet. Liderët policorë kanë nevojë të jenë, dhe duhet të jenë, të asnjanshëm dhe neutral: por nuk është e nevojshme që ata të jenë të heshtur.

3. Personaliteti - garanci për suksesin e liderit

Nëse duhet që të përcaktojmë çelësin e suksesit të një organizate, natyrisht që këtë në radhë të parë duhet ta kërkojmë tek personeli që e përbën këtë organizatë dhe pastaj, te zbatimin e politikave efikase për vënien në punë të tyre, duke shfrytëzuar në maksimum mjetet e punës për të arritur performancë maksimale. Meqenëse çelësi janë njerëzit, atëherë në radhë të parë vjen zgjedhja e liderit, i cili do të jetë vizionari dhe frymëzuesi i gjithë personelit si dhe drejtuesi i punëve për realizimin e objektivave të organizatës. Drejtori që duam për policinë, në radhë të parë është një njeri, dhe si i tillë, ka personalitetin e vet, i cili në vetvete është një ndër treguesit apo cilësitë, për përcaktimin e modelit të liderit.

“Personaliteti është një grup karakteristikash dhe prirjesh që përcaktojnë të përbashkëtat dhe dallimet në sjelljen psikologjike (mendimet, ndjenjat dhe veprimet), që kanë vazhdimësi në kohë dhe që nuk mund të kuptohen lehtë nga rezultatet e presioneve psikologjike dhe fizike të çastit”⁷. Njohja e personalitetit të kandidatit për lider, do ta ndihmonte shumë vendimmarrjen për të zgjedhur të duhurin, ndaj duhet përgatitur (nga specialistë) një renditje e karakteristikave të sjelljes organizative, cilësive të personalitetit të personit kandidat për lider; dhe kjo duhet plotësuar. Në përfundim të këtij plotësimi, bëhet dallimi midis kandidatëve dhe zgjidhet më i përshtatshmi për organizatën.

Të gjithë e dimë se njerëzit janë qenie shoqërore të ndërjegjshme, por edhe që kanë dallime që i bëjnë ata të ndryshëm midis tyre. Dallimet janë fizike (të dallueshme), por edhe jofizike (të brendshme), të dalluara me vështirësi, në rastin e dytë hyn edhe personaliteti. Çdo njeri ka veçoritë e tij, të dallueshme nga të tjerët. Veçoritë janë të shumta, por më klasiket janë gjurmët e gishtave, ADN-ja, etj., të cilat janë të papërsëritshme te të tjerë njerëz. Personaliteti i drejtuesit është përcaktues për performancën dhe modelin e tij dhe është faktor vendimtar për të vendosur, nëse një drejtues është i përshtatshëm apo jo për tu ngjitur në lartësinë e një drejtuesi të kërkuar, pavarësisht nga përmbushja e të gjitha kritereve të dukshme (fizike) profesionale, që

Memaj, B.
« Zgjedhja
e liderit
të efektshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

⁷ Kasimati, M., Manxhari, M., (2010), *Sjellje organizative*, Tiranë, f. 55.

kërkohen për një drejtues. Për të zgjedhur llojin e personalitetit i cili është i përshtatshëm për një drejtues të kërkuar, mund t'i referohemi metodës së klasifikimit të personalitetit në: “Dominues, influencues, relatues, analizues”⁸. Për të arritur në seleksionimin e personalitetit që duam atëherë, ka shumë metoda, por një nga këto është testi “DISC”, i cili e ndan personalitetin në katër kuadrate. Për të përcaktuar se çfarë kuadrati i përket personi duhet të bëjmë një intervistë me pyetje të cilat janë të studiuara për personalitetin që duam dhe, nga përgjigjet e pyetjeve kuptojmë se në cilin kuadrat futet kandidati. Se çfarë është përmbajtja e “DISC”, po e sqarojmë më poshtë:⁹

- “D” është për “dominues” dhe ka këto cilësi: dominues, rezultativ, i drejtpërdrejt dhe garues. Tek ky tip personaliteti mbizotëron ndjenja e lartë për detyrën dhe për arritjen e rezultateve.

- “I” është për “influencues” dhe ka këto cilësi: entuziast, shoqëror dhe optimist. Ky tip personaliteti është i gatshëm të bëjë kompromise dhe nuk e ka problem nëse nuk e mban fjalën e dhënë.

- “S” është “s qarues relatues” ka këto cilësi: i qetë, i sinqertë, i duruar, dhe modest. Ky tip personaliteti është i ndrojtur dhe i vetëpërmbajtur natyra e tyre është më shumë për ta mbajtur mirë me të gjithë dhe për të qenë jo shumë protagonist.

- “C” është “analizues e mendimtar” dhe ka këto cilësi: konformist, mendimtar, i përpiktë dhe i kujdesshëm.

Nëse do të shohim cilësitë e këtij klasifikimi të personaliteteve, na rezulton si më i përshtatshëm ai i pari, “dominuesi”, pasi ka këto tipare: shoqëror, i orientuar jashtëzakonisht ndaj detyrës, motivin kryesor ka arritjen e rezultateve¹⁰, kërkon ndaj vartësve rezultate përfundimtare dhe është për përkrahjen e drejtuesit të ardhshëm. Nisur nga këto tipare të këtij personaliteti, dalim në përfundimin se drejtues për organizatën, është i përshtatshëm një person i cili ka për tipare të personalitetit, të qenit “dominues”.

Nisur nga shembujt e praktikës, si dhe nga eksperiencia personale, mund të nënvizojmë disa nga cilësitë e drejtuesit me vlera në organizatë, si p.sh. integriteti personal, besimi, kuraja, përsosmëria, ndershmëria, përgjegjësia, llogaridhënia, të qenit i drejtë, modestia, maturia dhe trajtimi i njerëzve me dinjitet dhe respekt. Janë të gjitha këto cilësi, që bazohen në vlera, që e bëjnë një drejtues organizate të ketë sukses në menaxhimin e të gjitha burimeve njerëzore të organizatës. Të gjitha këto virtyte te personi që ka të mishëruar parimet e trajtuara më sipër si dhe personalitetin përkatës plotësojnë tiparet për një lider policor. Një lider i tillë do të jetë *Lider i efektshëm*.

Bibliografi

1. Adlam, R., dhe Villiers P. (2003) *Police Leadership in the Twenty-first Century*. Winchester: Waterside Press.
2. Memaj, B. (2016) *Lidershipi në Policinë e Shtetit*. Tiranë: Kristalina.
3. Bryn Caless dhe Steve Tong (2015) *European Police Science And Research Bulletin*, no. 12, University of Bristol's Policy Press.
4. Powell, C. (2012) *It worked for me: in life and leadership*. New York: Harper Collins.
5. Kasimati, M., Manxhari, M., (2010), *Sjellje organizative*, Tiranë.
6. Tracy, B. (2013) *Delegimi dhe Mbikëqyrja*. Tiranë.
7. Tracy, B. (2013) *Delegimi dhe Mbikëqyrja*. Tiranë: Damo.
8. Blake, R. R., dhe Mouton, J. S. (1994) *The Managerial Grid*. Houston: Gulf Publishing.

⁸ Tracy, B. (2013). *Delegimi dhe Mbikëqyrja*. Tiranë, f. 80.

⁹ Tracy, B. (2013) *Delegimi dhe Mbikëqyrja*. Tiranë: Damo, f. 80.

¹⁰ Blake, R. R., dhe Mouton, J. S. (1994) *The Managerial Grid*. Houston: Gulf Publishing.

Memaj, B.
« Zgjedhja
e liderit të
efektshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj



■ **Dr. Xhavit Shala**
Akademia e Sigurisë
xhavit.shala@asp.gov.al

Abstrakt

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim është trajtimi dhe analizimi i procesit të shtetndërtimit dhe të qeverisjes në Kosovë, përballë kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e shtetit të Kosovës. Procesin e shtetformimit dhe të shtetndërtimit të përgjegjshëm të Kosovës mund ta konsiderojmë si pjesë të misionit dhe përpjekjeve shekullore të shqiptarëve për të realizuar vizionin e tyre, për të pasur shtetin kombëtar përkrah botës së qytetëruar si finalizim i thelbit të programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Serbia dhe Rusia në vazhdimësi janë përpjekur, dhe jo vetëm, për ta paraqitur shtetformimin e Kosovës si një proces në shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Por, e drejta e shtetformimit të shqiptarëve të Kosovës tashmë është pranuar ndërkombëtarisht. Kjo pasqyrohet në njohjen e Kosovës nga rreth 116 shtete anëtare të OKB-së si dhe nga pranimi i saj në dhjetëra organizata ndërkombëtare. E drejta e shtetformimit mund të quhet një proces i përmbyllur edhe juridikisht. Kjo, sepse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë në kuadër të OKB-së, pas kërkesës së Serbisë për t'u shprehur për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, arriti në përfundimin se "shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare". Megjithatë, procesi i shtetformimit të Kosovës duhet të klasifikohet e të kategorizohet edhe për shumë kohë si "proces i kërcënuar" dhe, si i tillë, duhet mbajtur në vazhdimësi i sigurizuar. Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Gjetjet kryesore të këtij punimi nxjerrin në pah se kërcënim nga Serbia e Rusia ndaj procesit të shtetformimit të Kosovës do të fillojë të desigurizohet vetëm nëpërmjet një procesi të përgjegjshëm shtetndërtimi e qeverisje të mirë në Kosovë.

Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Fjalëkyçe:

Kosova, shtetformim, shtetndërtim, qeverisje e mirë, Rusia, Serbia, kompleksi ballkanik i sigurisë, Rilindja Kombëtare Shqiptare.

1. Koncepte mbi shtetformimin dhe shtetndërtimin e përgjegjshëm

Procesin e shtetformimit dhe të shtetndërtimit të përgjegjshëm të Kosovës mund ta konsiderojmë si pjesë të misionit dhe përpjekjeve shekullore të shqiptarëve për të realizuar vizionin e tyre, për të pasur shtetin kombëtar përkrah botës së qytetëruar si finalizim i thelbit të programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ndonëse shtetet kanë qenë dhe mbeten themelet e sistemit ndërkombëtar, akoma për shtetin nuk ka një definicion të pranuar ndërkombëtarisht¹. Kjo mungesë e definicionit nuk është e rastësishme, por është pasojë e vështirësive të hasura në negociata gjatë procesit të formimit, të pranimit dhe të njohjes së shteteve. Edhe vetë Organizata e Kombeve të Bashkuara, si organizmi më i madh ndërkombëtar i grupimit të shteteve dhe organizata më e madhe e sigurisë kolektive, nuk ka kritere formale për shtetësinë përveç njohjes nga shtetet e tjera².

Serbia dhe Rusia në vazhdimësi janë përpjekur dhe jo vetëm, për ta paraqitur shtetformimin e Kosovës si një proces në shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Por, e drejta e shtetformimit të shqiptarëve të Kosovës tashmë është pranuar ndërkombëtarisht. Kjo pasqyrohet në njohjen e Kosovës nga rreth 116 shtete anëtare të OKB-së si dhe nga pranimi i saj në dhjetëra organizata ndërkombëtare. E drejta e shtetformimit mund të quhet një proces i përmbyllur edhe juridikisht. Kjo sepse Gjykata Ndërkombëtare e

¹ Në Konventën e Montevideos të vitit 1933 më shumë se sa definimi i konceptit të shtetit, jepet sipas të drejtës ndërkombëtare koncepti i shtetformimit. Sipas kësaj konvente, shtetformimi kërkon një popullsi të përhershme, një territor të caktuar, një qeveri dhe kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.

Për më tepër shih: *Montevideo Convention on Rights and Duties of States*, December 26, 1933, article 1.

² *Concepts and Dilemmas of State Building in Fragile Situations*. OECD - Organisation for Economic Co-Operation and Development, Journal on Development 2008, Volume 9, No. 3, f.65.

Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Drejtësisë, e cila përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë në kuadër të OKB-së, pas kërkesës së Serbisë për t'u shprehur për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, konkludoi se "shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare"³.

Megjithatë, në kushtet kur në kushtetutë, Serbia, vazhdon ta vlerësojë Kosovën si pjesë të saj, për sa kohë që në strategjinë serbe të sigurisë kombëtare shteti i Kosovës vlerësohet si kërcënim për sigurinë e saj, në kushtet kur dy anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk e kanë njohur akoma pavarësinë e Kosovës, porsa kohë që Serbia nuk po divorcohet nga Rusia e nga angazhimet e tyre të drejtpërdrejta për ta sabotuar procesin e shtet-ndërtimit e për ta paraqitur Kosovën një shtet të dështuar dhe jo funksional, ashtu siç Rusia bëri dikur me nismën e çëqene për pavarësi apo siç po bën në vazhdim në Ukrainën Lindore, procesi i shtetformimit të Kosovës duhet të klasifikohet e të kategorizohet edhe për shumë kohë "proces i kërcënuar" dhe, si i tillë, duhet mbajtur në vazhdimësi i sigurizuar⁴.

Ky kërcënim ndaj procesit të shtetformimit të Kosovës do të fillojë të desigurizohet⁵ vetëm nëpërmjet një procesi të përgjegjshëm shtetndërtimi e qeverisje të mirë⁶ në Kosovë. Pavarësisht vështirësive që paraqet vetë procesi i shtetndërtimit si dhe përpjekjeve të shtuara serbo-ruse për ta dështuar shtetin e Kosovës, ky proces po zhvillohet me sukses. Suksesi i këtij procesi ndihmon sigurinë e Kosovës, të Serbisë si dhe të rajonit të Ballkanit e më gjerë. Shtetndërtimi apo ndërtimi i shtetit është procesi përmes të cilit shtetet rrisin aftësinë e tyre për të funksionuar⁷. Ndërtimi i shtetit nënkupton ndërtimin e një shteti funksional, duke iu referuar procesit të krijimit të institucioneve kyçe për funksionimin e shtetit⁸.

Shtetndërtimi është një proces që dallohet nga kombndërtimi, pavarësisht se jo rrallë ka tendenca për t'i barazuar ato. Kombndërtimi i referohet procesit të ndërtimit të një ndjenje identiteti dhe fati të përbashkët në përpjekje për t'iu kundër vënë burimeve alternative të identitetit dhe besnikërisë⁹. Për shqiptarët e Kosovës kombndërtimi është një proces relativisht i tejkaluar njëkohësisht me shqiptarët e Shqipërisë. Gjithsesi, historikisht, shtetet kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përpjekjet që të krijojnë shtetet kombëtare ose kombet që përputhen me kufijtë shtetërorë,¹⁰ shtetet komb apo

³ Gjykata Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë të OKB-së, më 22 korrik 2010 shpalli opinionin këshillëdhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

⁴ Sigurizimi si term i referohet klasifikimit të disa fenomeneve, personave ose entiteteve, etj., si kërcënime ekzistenciale që kërkojnë masa të jashtëzakonshme. Kur një çështje klasifikohet në kategorinë "çështje e sigurisë" bëhet sigurizimi i saj. Një çështje sigurizohet kur kërkon veprime urgjente përtej procedurave politike standarde të shtetit. Kjo i referohet një procesi në të cilin një komunitet politik vendos për të trajtuar diçka si një kërcënim ekzistencial dhe për të mundësuar një thirrje për masa urgjente dhe të jashtëzakonshme për t'u marrë me këtë kërcënim". Ky koncept është futur nga Shkolla e Kopenhagës. Për më tepër shih përfaqësuesit e kësaj shkolle Buzan, Waeber, de Wilde, 1998: 23.

⁵ De-sigurizimi i referohet një procesi të ri që paraqet një çështje të sigurizuar në arenën politike standarde dhe që fillon të menaxhohet brenda sistemit politik standard. Është procesi sipas të cilit një komunitet politik ul apo pushon për të trajtuar diçka si një kërcënim. Ky koncept është futur nga Shkolla e Kopenhagës.

⁶ Nocioni i "qeverisjes së mirë" është përhapur në vitet 1990 nga Banka Botërore si kusht i nevojshëm i politikave të zhvillimit. Për Bankën Botërore, qeverisja e mirë përfshin normat, traditat dhe institucionet përmes të cilave një vend ushtron autoritetin e tij mbi të mirën e përbashkët në optikën e zhvillimit. Qeverisja e mirë përfshin gjithashtu kapacitetin e qeverisë për të menaxhuar me efikasitet burimet e veta dhe për të zbatuar politika të përshtatshme, si dhe ekzistencën kontrollit demokratik.

⁷ Verena Fritz and Alina Rocha Menocal: Understanding Statebuilding from a Political Economy Perspective. Report for DFID's Effective and Fragile States Teams. Overseas Development Institute P. 13. September 2007.

⁸ Miruna Troncotă: "Balkanization of the Europeanization Process": How state-building was affected by axiological matters in the Western Balkans", WBSO, p 67, August 2011.

⁹ Verena Fritz and Alina Rocha Menocal: Understanding Statebuilding from a Political Economy Perspective. Report for DFID's Effective and Fragile States Teams. Overseas Development Institute P.15. September 2007.

Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Policimi dhe Siguria nr.11, 2018

kombet shtet. Në të ardhmen ky do të jetë një procesi i natyrshëm dhe i pandalshëm edhe për të dy shtetet shqiptarë në Ballkan.

Por, shtetndërtimi ndikohet dhe nga faktorët të tjerë, të tillë si prioritetet e qeverisë. Qëllimet kryesore të shtetndërtimit janë dhe objektiva për një qeverisje të përgjegjshme, duke bërë kështu që një qeverisje e mirë dhe e përgjegjshme të ndikojë pozitivisht në procesin e një shtetndërtimi të suksesshëm. Pra, shtetndërtimi dhe qeverisja janë të lidhura ngushtë mes tyre, sepse ndajnë një shqetësim të përbashkët, sidomos për mirëfunksionimin e institucioneve. Por, në thelb, shtetndërtimi është një term me vlera neutrale, pasi atë e duan të gjithë, ndonëse sipas mënyrës dhe standardeve të tyre. Gjithsesi, termi i shtetndërtimit ndryshon nga ai i qeverisjes. Shtetndërtimit është një përpjekje më gjithëpërfshirëse dhe më e shenjtë që nënkupton një vetëdije më të shprehur se sa natyra politike e ndërtimit të institucioneve.¹¹Në një farë mënyre shtetndërtimi ka të bëjë me ndërtimin e themeleve dhe të karabinasë së ndërtësës brenda së cilës do të operojë qeverisja dhe se, pa ndërtimin paraprak e me themele të forta të kësaj karabinaje, operimi i qeverisë do të jetë i vështirë dhe rezultati i kufizuar. Qeverisja e mirë dhe e përgjegjshme përfshin gjithashtu kapacitetin e qeverisë për të menaxhuar me efikasitet rreziqet e kërcënimeve për sigurinë e Kosovës, duke përfshirë këtu dhe mbrojtjen nga çdo cedim të aleancës së shenjtë me SHBA-në, BE-në dhe NATO-n, si mbështetësit më të mëdhenj të shtetformimit e të shtetndërtimit të suksesshëm e të përgjegjshëm të Kosovës.

2. Fazat e zhvillimit të shtetndërtimit të përgjegjshëm

Shtetndërtimi i përgjegjshëm përfshin domosdoshmërinë e progresit në tri fusha të domosdoshme të cilat janë: zgjidhja politike, funksionet e mbijetesës si dhe funksionet e pritura.

2.1 Arritja e një zgjidhje politike për shtetndërtimin e përgjegjshëm

Hapi i parë në shtetndërtimin e përgjegjshëm “...është arritja e një zgjidhje politike”¹². Zgjidhjet politike arrihen për shkak “...të interesit dhe shpresave për të përfutur nga një projekt i përbashkët për ndërtimin e shtetit..”¹³. Thelbësore këtu është krijimi i një ndjenje të një interesi të përbashkët publik. Zgjidhja politike është shprehje e një marrëveshjeje të detyrueshme për shtetin dhe shoqërinë për të siguruar legjitimitetin e nevojshëm për ata që qeverisin. Kjo është thelbësore për të krijuar, ndihmuar e mbështetur ndjenjën mbarëkombëtare të publikut dhe për krijimin e një shteti të përgjegjshëm. Shqiptarët e Kosovës e përcaktuan në rrugë paqësore zgjidhjen e tyre politike me referendumin e shtatorit të vitit 1991 ku 99% votuan për pavarësinë e Kosovës. Mospranimi i Beogradit dhe dështimi i rrugës paqësore për arritjen e kësaj zgjidhje politike, i detyroi shqiptarët e Kosovës t’i drejtohen luftës së armatosur, e cila u kurorëzua më sukses më çlirimin e Kosovës në qershor të vitit 1999. Zgjidhja politike u

Shala, XH.
« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

¹⁰ Shih Gellner 1983; Weber 1976.

¹¹ Po aty.

¹² Alan Whites, *States in Development: Understanding State-building*. Governance and Social Development Group Policy and Research Division, 2008, f. 6.

¹³ Verena Fritz, Alina R. Menocal. *Understanding Statebuilding from a Political Economy Perspective*. Report for DFID's Effective and Fragile States Teams, 2007, f. 26.

arrit përfundimisht më 17 Shkurt 2008, me miratimin nga deputetët e Kosovës të Deklaratës së Pavarësisë, ku Kosova shpallet shtet i pavarur dhe sovran¹⁴.

2.2 Përbushja e funksioneve thelbësore për mbijetesën e shtetit

Pas zgjidhjes politike, fusha e dytë e progresit për ndërtimin e shtetit të përgjegjshëm është përbushja e një grup funksionesh thelbësore për mbijetesën e tij dhe konkretisht në fushën e sigurisë¹⁵, sundimit të ligjit¹⁶, sigurimit të ardhurave¹⁷ si dhe prodhimi i legjitimitetit politik nëpërmjet ndërtimit të institucioneve që rrjedhin nga procese të rregullta zgjedhore. Por, cila është dinamika e përbushjes së këtij grupi funksionesh thelbësore për mbijetesën nga ana e shtetit të Kosovës? Nëse do t'i analizojmë një nga një do të gjejmë se:

1. Siguria e Kosovës është një proces i përbashkët i KFOR-it dhe institucioneve kosovare të sigurisë. KFOR-i ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë ta mbrojë Kosovën nga kërcënimet e jashtme, ndërsa garantimi i sigurisë së brendshme tashmë ka kaluar institucioneve kosovare. Fakti që kontingjenti i forcave të KFOR-it ka ardhur vazhdimisht duke u reduktuar tregon se stafeta e garantimit të sigurisë gradualisht do t'i kalojë plotësisht institucioneve kosovare. Kësaj do t'i shërbejë dhe transformimi i pritshëm i FSK-së në FAK dhe integrimi i Kosovës në strukturat euroatlantike.

2. Është evidente se institucionet kosovare të sundimit të ligjit si Sistemi gjyqësor (prokuroria dhe gjykatat), Policia e Kosovës, Doganat, etj, kanë bërë progres në përmirësimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë, duke treguar aftësi në rritje për të kapërcyer sfidat e sundimit të ligjit në mënyrë të pavarur¹⁸. Rol të rëndësishëm ndihmës në burimet e tyre njerëzore luan dhe sistemi arsimor në fushën e sigurisë, përkatësisht Akademia e Kosovës për Siguri. Mirëpo, ndërsa vazhdojnë të jenë të përkushtuara për axhendën e përbashkët të sundimit të ligjit, institucionet megjithatë duhet t'u përgjigjen në mënyrë efektive problemeve të vazhdueshme të ndërhyrjes politike dhe korrupsionit – ku natyra e gjerë e shtrirjes së tyre i lë notë negative sukseseve të arritura në fushat e tjera¹⁹. Institucionet kosovare të zbatimit të ligjit duhet të angazhohen më shumë për t'u përgjigjur në mënyrë të menjëhershme këtyre problemeve gjithë përfshirëse. Për këtë, në vazhdimësi, është i nevojshëm fuqizimi i mëtejshëm i policisë, doganës, institucioneve korrektuese dhe gjyqësore në mbarë territorin e Kosovës dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe e qëndrueshmërisë së këtyre institucioneve në trajtimin e përgjegjësive të tyre. Paralelisht me këtë është e nevojshme rritja e kapaciteteve të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit sidomos në trajtimin e krimeve ndëretnike, të krimit të organizuar dhe të korrupsionit përmes sistemit të drejtësisë penale.

Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Policimi dhe Siguria

nr.11, 2018

¹⁴ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 17 Shkurt 2008, pika 1.

¹⁵ Përbushja e funksioneve në fushën e sigurisë përfshin rikrijimin dhe konsolidimin e monopolit legjitim të forcës së shtetit për të mbështetur sundimin e ligjit.

¹⁶ Përbushja e funksioneve në fushën e sundimit të ligjit përfshin krijimin e një kuadri ligjor të njohur publikisht i cili rregullon ndërveprimin mes shtetit, shoqërisë dhe aktorëve politikë.

¹⁷ Përbushja e funksioneve në fushën e krijimi i të ardhurave përfshijnë aftësinë për të krijuar fonde të qëndrueshme, veçanërisht nëpërmjet taksimit dhe sundimit të ligjit.

¹⁸ Raport i Progres Kompaktit. Raport i Bordit të Përbashkët Bashkëndues për Sundimin e Ligjit. Vlerësimi i progresit për periudhën korrik 2016 – qershor 2017, f.3.

¹⁹ Po aty.

3. Institucionet kosovare të ngarkuara me ligj përmbushin me sukses funksionet e tyre në fushën e krijimit të së ardhurave duke krijuar fonde të qëndrueshme nga mbledhjet e pagesave të detyrueshme me ligj që personat fizikë e juridikë duhet të bëjnë në favor të buxhetit të shtetit, në bazë të të ardhurave ose të pasurisë që ata kanë, të konsumit të mallrave e të shërbimeve që përfitojnë.

4. Kosova ka krijuar institucionet themelore të një shteti të pavarur dhe Sovran²⁰. Institucionet kosovare janë të legjitimuara politikisht nëpërmjet një procesi zgjedhës të ndershme, të qeta, të lira dhe vërtet konkurruese²¹. Ndonëse shteti i ri, Kosova, ka qenë model edhe për vende të rajonit për realizimin e proceseve të besueshme zgjedhore dhe zgjedhjet kosovare kanë prodhuar vazhdimisht legjitimitet politik të institucioneve, domosdoshmëri dhe tipar ky i një shtetndërtimi të suksesshëm.

2.3 Pritshmëria për funksionalitetin e shtetit

Ndërsa fusha e tretë e progresit thelbësor në shtetndërtim është arritja e asaj që quhet "niveli i prituri" në funksionalitetin e shtetit. Qytetarët, por dhe partnerët strategjikë të Kosovës dhe aktorë të tjerë të jashtëm, përveç ruajtjes së stabilitetit, janë në pritje të shohin se si shteti do të kryejë detyra të rëndësishme. Këtu hyjnë: ofrimi i shërbimeve, në të cilën bëjnë pjesë arsimit, ndërtimi i infrastrukturës, shëndetësia dhe shërbimet e tjera publike; sistemi i drejtësisë përtej sundimit të ligjit, e cila përfshin administrimin e drejtësisë dhe krijimi i shtetit të së drejtës; qeverisja ekonomike e cila përfshin makro-menaxhimin; ekonominë e tregut, punësimin, menaxhimin e burimeve natyrore, etj. Edhe në këto fusha, Kosova, pavarësisht vështirësive që hasen, po bën përparime të dukshme.

3. Përfundime

Në përfundim të këtij punimi konkludojmë se:

- Procesi i shtetndërtimit në Kosovë, duke u bazuar në zgjidhjen politike të popullit të saj për shtet të pavarur dhe sovran, ka arritur të përmbushë funksionet thelbësore të mbijetesës në fushën e sigurisë, sundimit të ligjit, sigurimit të ardhurave, legjitimitetit politik të institucioneve nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe ka bërë përparime të dukshme në përmbushjen e "nivelet të prituri" të funksionalitetit të shtetit, karakteristika thelbësore këto të një procesi të përgjegjshëm shtetndërtimi.

- Pretendimet serbo-ruse për dështimin e shtetndërtimit në Kosovë janë pavërteta. Ato janë pjesë e strategjisë dhe angazhimeve të tyre të drejtpërdrejta për ta sabotuar procesin e shtetndërtimit në Kosovë.

- Procesi i shtetformimit dhe shtetndërtimit të Kosovës duhet të klasifikohen e të kategorizohet edhe për shumë kohë si të kërcënuara, e si i tillë, duhet mbajtur në vazhdimësi të sigurizuara.

- Procesi i shtetndërtimit të përgjegjshëm në Kosovë është pjesë e misionit dhe

Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Polici
dhe
Siguria

nr.11, 2018

përprojekte shekullore të shqiptarëve për të realizuar vizionin e tyre, për të pasur shtetin kombëtar përkrah botës së qytetëruar si finalizim i thelbit të programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

- Ky proces i suksesshëm është i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë e Kosovës, por përbën një investim serioz e me ndikime të mëdha në kompleksin ballkanik të sigurisë e me gjerë.

Referenca

1. Raport i Progres Kompaktit. *Raport i Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit. Vlerësimi i progresit për periudhën korrik 2016 – qershor 2017.*
2. *Montevideo Convention on Rights and Duties of States*, December 26, 1933.
3. Concepts and Dilemmas of State Building in Fragile Situations. *OECD - Organisation for Economic Co-Operation and Development, Journal on Development 2008*, Volume 9, No. 3.
4. Gjykata Ndërkombëtare të Drejtësisë. *Opinionin këshillëdhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.*
5. Buzan, Waever, de Wilde. *Koncepte të Shkollës së Kopenhagës për sigurinë*, 1998.
6. Verena Fritz dhe Alina Rocha Menocal, "Understanding Statebuilding from a Political Economy Perspective". *Report for DFID's Effective and Fragile States Teams*. Overseas Development Institute. September 2007.
7. Miruna Troncotă. "Balkanization of the Europeanization Process". *How state-building was affected by axiological matters in the Western Balkans*, WBSO, August 2011.
8. Alan Whites. *States in Development: Understanding State-building*. Governance and Social Development Group Policy and Research Division, 2008.
9. Daniel Server, Universiti John Hopkins në Uashington. *Intervistë për Radion Evropa e Lirë*, 10 shkurt 2018
10. Bashkimi Evropian. Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare – Kosovë 2017. *Deklaratë preliminare*, 13 qershor 2017.

Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018



Shala, XH.

« Kosova mes shtetndërtimit të përgjegjshëm dhe kërcënimeve serbo-ruse për dështimin e saj »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Buxhetimi dhe misioni i policisë



■ **MSc. Xhafer BARJAMI**
*Drejtor i Drejtorisë së Financave
Policia e Shtetit*
xhafer.barjami@asp.gov.al

Abstrakt

Në planin afatshkurtër, qëllimi fokusohet, në rritjen e ndjeshmërisë dhe interesit të strukturave operacionale dhe menaxheriale të policisë, në drejtim të aftësisë të kapaciteteve menaxheriale dhe përmirësimit, të njohurive mbi buxhetimin e Policisë së Shtetit. Në planin perspektiv, synohet "sfidat e matjes së rezultateve të punës së policisë", përmes aftësisë të strukturave të menaxhimit, në drejtim të ndërtimit të një buxheti real, të krahasuar, motivues, të plotë në mbulimin e kostos korente, koston prioritare dhe koston strategjike, të aktiviteteve (produktit) policore, me impakt të prekshëm në imazh dhe në performancë, të vlerësuar nga indikatorët e njohur ndërkombëtarisht në matjen e sigurisë së shtuar në vënd, rajon dhe me gjerë.

Fjalëkyçe:

buxheti, bilanci i policimit, vlera publike, financimi i investimeve.

1. Hyrje

Shumë studiues e specialistë të fushave të policisë e policimit e kanë trajtuar njohjen e vlerave në policim. Synimi i këtij studimi, ka në fokusin e vet këtë kërkesë, ndaj menaxhimi strategjik dhe operacional në Policinë e Shtetit, pra njohjen e vlerave në policim. Njohja e vlerave në policim, na vendos përpara këtyre sfidave:

- a) matjes së rezultateve të punës së policisë,
- b) përcaktimit të vlerave në policim,
- c) përgjegjshmërisë ndaj publikut,
- d) përdorimit të rezultateve të vlerësuara në përmirësimin e rezultateve të policisë.

Me rëndësi për studimin është që përmes bilancit të njohjes së vlerave dhe vlerësimit të performancës në sektorin e biznesit, të mundësohet e të ndërtohet bilanci i policimit. Kjo do të thotë se qytetarët, ashtu si dhe aksionerët duan informacion të përmbledhur në lidhje me performancën e organizatës, për të kuptuar nëse ia vlen të investohet në të. Drejtuesit e policisë, ashtu si presidentët e kompanive private, janë të interesuar të matin performancën e njësive të ndryshme brenda organizatës së tyre, me qëllim që të nxisin rritjen e fitimit, të shpërndajnë si duhet burimet e disponueshme si dhe të testojnë se çfarë funksionon për organizatën e tyre. Bilanci i policimit, është me interes të ndërtohet sipas konceptit të bilancit të biznesit privat, duke u fokusuar tek kënaqësia e klientit, që në rastin e policisë është edhe aksioner, edhe kreditor. Të ardhura neto të policisë (fitimi) do të konsiderohen: a) Reduktimi i kriminalitetit si fitim i policimit. b) Autoriteti i policisë - burim i veçantë. Në aspektin e rëndësishëm të kontabilitetit, duhet të pranojmë që autoriteti që u japim forcave policore është një burim apo aset i veçantë dhe në operacionet e policisë, ai llogaritet si kosto që krahasohet me përfitimin e uljes së kriminalitetit. c) drejtësia dhe transparenca, si objektiva të rëndësishme të policimit.

Kur flasim për burime financiare na intereson në radhë të parë një llogaritje e

raportit të mjetit kundrejt qëllimit, në rastin konkret, do të përktheheshin, efikasitet dhe efektivitet.

2. Buxheti dhe policimi

Çfarë është një buxhet?¹ Buxheti është quajtur shpesh një plan operativ. Përmes tij masim vlerën e fondeve që kemi shpenzuar jo vetëm nga përfitimet që marrim, por edhe nga ajo që duhet të heqim dorë. Buxhetim do të thotë të bësh zgjedhje.

Buxhet performance - është buxheti që i bazon shpenzimet kryesisht në performancën e matshme të aktiviteteve dhe programeve të punës.

Buxheti si një kontratë - është buxheti që mund të shihet si një kontratë ndërmjet qytetarëve dhe Policisë së Shtetit. Kjo do të thotë që qytetarët kanë rënë dakord për të paguar taksat, në mënyrë që ata të mund të marrin shërbime të caktuara nga policia.

Buxheti si mjet i menaxhimit - është buxheti që shërben si një deklaratë e vendimeve dhe përgjegjësive që përkthehen në programe specifike dhe aktivitete. Buxheti rrit përgjegjësinë e menaxhimit dhe llogaridhënien. Buxheti i motivon departamentet duke vendosur paraprakisht objektiva dhe duke shërbyer si një mekanizëm për arritjen e tyre, përfshirjen dhe angazhimin. Buxheti siguron një mjet për matjen e arritjeve kundrejt objektivave dhe për të krahasuar rezultatet aktuale me ato të planifikuara.

Buxheti si një mekanizëm kontrolli financiar - buxheti mund të shërbejë si një mjet për të përcaktuar dhe nominuar përgjegjësinë për kontrollin financiar. Një buxhet siguron kontroll të fortë mbi shpenzimet e departamentit dhe zvogëlon diskrecionin administrativ të përgjegjësve të departamentit.

Buxheti si një plan buxheti - është plan investimi për komunitetin tuaj. Ai koordinon zgjedhjet e bëra për të arritur qëllimet e dëshiruara. Buxheti është një instrument për të lidhur ngushtë veprimin ekzekutiv dhe atë legjislativ. Një buxhet duhet të përfshijë një specifikim të detajuar të asaj ç'ka janë objektiva për t'u arritur me shpenzimet e propozuara; si mjet planifikimi, buxheti mund të sugjerojnë metodat alternative për arritjen e këtyre objektivave.

Buxheti si mjet kryesor i politikës - pavarësisht nëse dëshironi ju apo jo, buxheti është një mjet i rëndësishëm politik. Mënyra se si ju vendosni të shpenzoni burimet e pakta të organizatës, është ndoshta vendimi më i rëndësishëm politik që ju do të bëni gjatë një viti fiskal. Burimet e qeverisë janë gjithmonë më pak se sa është e nevojshme për të përmbushur të gjitha objektivat e policimit.

Buxheti si një mekanizëm i komunikimit - dokumenti i buxhetit është mekanizmi me të cilin ju informoni qytetarët, zyrtarët, politikëbërësit, investitorët potencialë, punonjësit dhe të tjerët në lidhje me çështjet buxhetore të komunitetit, tendencat dhe zgjedhjet të adresuara në buxhetin tuaj. Dokumenti juaj i buxhetit duhet të komunikojë informacionin e rëndësishëm të buxhetit tek lexuesit. Përdorni tabelat dhe grafikët, aty ku është e përshtatshme, për të nxjerrë në pah informacione financiare, përveç kësaj, përdorni esetë për të përshkruar marrëdhëniet midis të ardhurave, shpenzimeve dhe programeve.

Buxheti si një udhërrëfyes operacional - kërkesat buxhetore përshkruajnë aktivitetet, shërbimet, apo funksionet e propozuara që njësitë vendore do të kryejnë. Në kërkesat

¹ Manual Trajnimi, "Menaxhim i shpenzimeve publike".

buxhetore ju duhet të identifikoni treguesit sasiorë dhe cilësorë, apo produktet, mbi bazën e të cilave do të vlerësohen rezultatet dhe performanca e programit. Ju duhet gjithashtu të identifikoni përfituesit e programit, të tillë si numri i qytetarëve të shërbyer dhe të përcaktoni numrin e punonjësve që kërkohen për të kryer çdo aktivitet. Kur ju ofroni këto lloje informacionesh, buxheti i hartuar bazuar në kërkesat buxhetore do të shërbejë si një udhërrëfyes operacional. Buxheti i secilit institucion jo vetëm që do të identifikojë koston e çdo aktiviteti, por edhe produktet që do të ofrohen, numrin e qytetarëve që do të përfitojnë dhe nivelin e personelit të kërkuar për të kryer aktivitetin.

Buxheti si një instrument i demokracisë - historikisht, një qëllim kryesor i buxhetit është që të promovojë demokracinë. Buxheti është një mjet për të ushtruar kontrollin popullor mbi paratë publike.

Për të hartuar një buxhet, sa më afër realitetit, pra, sa më afër mbulimit të plotë të koston së aktivitetit policor në aktualitet dhe në perspektivë, në zbatimin pa mëdyshje të rregullave, mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, duhet t'ju referohemi: 1) gjendjes aktuale të organizatës së policisë: këtu përfshihen, burimet njerëzore, burimet materiale dhe financiare, trendi i mbulimit dhe financimit të tyre, performanca e policimit, etj; 2) vizionit dhe misionit të Policisë së Shtetit; 3) objektit të punës së Policisë së Shtetit, mjedisit gjeografik, shoqëror dhe të integruar; 4) ndërtimit strukturor në të cilin zhvillohet dhe operon lënda policore; 5) kushteve të punës dhe të shërbimit; 6) prioriteteve të qeverisë; 7) nivelit ekonomik të shoqërisë, prej nga mund të shihen mundësitë e mbulimit të kostonit të policimit; 8) pritshmërive të qytetarëve, biznesit, etj., dhe kontributit të tyre në kostonin e kësaj pritshmërie; 9) nivelit të sigurisë në vend dhe më gjerë dhe pritshmërive; 10) prioriteteve dhe objektivave strategjike të Policisë së Shtetit; 11) të tjera vlerësime, të cilat plotësojnë ngrehinën e një programi buxhetor sa më cilësor.

2.1. Buxhetimi sipas natyrës. Raporti midis buxhetit të financuar dhe nevojave.

Natyrshëm, mund të lindin pyetjet: a) Pse është përfshirë një periudhë kaq e gjatë, për të thënë çfarë? b) Ç'është dashur të thuhet në trajtimin e kostonit të aktivitetit policor? c) Ku është Policia me kërkesat e materialit? Etj., etj. Përgjigjet, gjykoj se jepen në rekomandimet e dhëna në material, të cilat janë pjesë integrale e mendimit dhe e sfidës për ndryshim, megjithatë, për interesimin dhe rëndësinë që unë i jap këtij studimi, po qartësoj më tej idenë. Së pari, për informim të treguesit të buxhetimit, të lidhur me dy akte ligjore: ligjeve "Për Policinë e Shtetit" dhe fillimin dhe vijimin e procesit të hartimit të PBA-së. Së dyti, për të informuar mbi trendin e buxhetimit, përmes tij edhe për vëmendjen zyrtare ndaj kësaj organizate. Së treti, për të prezantuar aftësinë e trupës menaxheriale, në kostonin e produktit policor dhe më tej, në ballafaqimin e produktit me koston përkatëse. Së katërti, për të prezantuar aftësinë e trupës menaxheriale, në procesin e matjes së rezultateve të punës së policisë, të përcaktimit të vlerave në policim, të përgjegjshmërisë ndaj publikut, etj. Së pesti, për të vlerësuar interesin e strukturave të menaxhimit dhe jo vetëm; në njohjen e buxhetit dhe procesit të buxhetimit, përmes prezantimit linear të këtij procesi.

Në pamje të parë, paraqitja grafike tregon dy momente: a) shtrirjen kohore dhe b) pikën e kthesës, ose të ndryshimit, të *statuskuosë* (viti 2014). Informacioni, për thjeshtësi, është prezantuar në miliardë lekë. Buxhetimi i policisë për periudhën 2007-2013, varion nga 10.59 miliardë (mld.) lekë, në 11.96 mld. lekë, me një rritje mesatare vjetore prej + 1.85%. Buxhetimi i policisë për vitin 2014 ka qenë 14.31 mld. lekë ose + 19.65%,

Barjami, XH.
« Buxhetimi
dhe misioni
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

ndërsa kostimi i shërbimit policor është rritur me + 18.3%, krahasuar me vitin 2013. Buxhetimi i policisë për vitin 2017 është 15.71 mld. lekë, ose +9.8%, krahasuar me vitin 2014 ose +30% krahasuar me vitin 2013, ndërsa kostimi i shërbimit policor është rritur respektivisht me + 7.6% dhe + 27.25% krahasuar me të njëjtat periudha. Financimet për investimet nga buxheti i shtetit dhe të huaja, për periudhën 2014-2017, janë mesatarisht në nivelin, 9.85%, ose 1.27 mld. lekë. Niveli minimal i këtij treguesi është në vitin 2013, 7.3% ose 870 milion lekë dhe niveli maksimal në vitin 2009, 13.2% ose 1.57 mld. Natyrisht referencat janë në raport me buxhetimin nominal ushtritor.

Grafiku 1. Buxhetimi i policisë për periudhën 2007-2017 (në miliardë lekë) ²




Tabela 1. Buxhetimi i policisë (plani me ndryshime) në zërat kryesore për periudhën 2007-2017 (në miliardë lekë). Pjesëmarrjet dhe raportet (në përqindje).³


Nr.	Periudha	Paga & Kontribute		Shpenzime operative (mallra & shërbime)		Investime nga buxheti shtetit		Investime të huaja		Fin. të tjera nga buxheti		Total buxheti	Raport me v. Paraardh.
		leke	%	leke	%	leke	%	leke	%	leke	%		
1	Viti 2007	7.700	72.70%	1.800	17.00%	0.300	2.80%	0.770	7.30%	0.020	0.20%	10.590	100.00%
2	Viti 2008	7.980	74.00%	1.960	18.20%	0.370	3.40%	0.470	4.40%	0.010	0.10%	10.790	101.90%
3	Viti 2009	7.650	64.30%	2.050	17.20%	0.650	5.50%	0.920	7.70%	0.620	5.20%	11.890	110.20%
4	Viti 2010	8.280	68.90%	1.850	15.40%	0.820	6.80%	0.710	5.90%	0.350	2.90%	12.010	101.00%
5	Viti 2011	8.690	68.90%	2.000	15.80%	1.100	8.70%	0.550	4.40%	0.280	2.20%	12.620	105.10%
6	Viti 2012	8.700	72.40%	2.060	17.20%	0.420	3.50%	0.530	4.40%	0.300	2.50%	12.010	95.20%
7	Viti 2013	8.830	73.80%	1.960	16.40%	0.620	5.20%	0.250	2.10%	0.300	2.50%	11.960	99.60%
8	Viti 2014	10.030	70.20%	2.660	18.60%	1.030	7.20%	0.170	1.20%	0.400	2.80%	14.310	119.60%
9	Viti 2015	10.810	72.80%	2.250	15.20%	1.220	8.20%	0.170	1.20%	0.390	2.60%	14.840	103.70%
10	Viti 2016	11.050	75.50%	2.100	14.30%	0.940	6.40%	0.300	2.00%	0.330	2.20%	14.720	99.20%
11	Viti 2017	11.724	75.25%	2.052	13.17%	0.924	5.94%	0.540	3.46%	0.340	2.18%	15.580	105.84%
	Mesatare vjetore	9.214	71.58%	2.072	16.25%	0.746	5.67%	0.520	4.20%	0.307	2.33%	12.859	

² Raportimi vjetor mbi buxhetin e akorduar në Policinë e Shtetit.

³ Raportimi vjetor mbi buxhetin e akorduar në Policinë e Shtetit.

Për periudhën 2014-2017 investimet janë 5.45 mld. lekë ose 1.36 mld. mesatarisht në vit ose 9.1%, ndërsa për periudhën 2007-2013, ato janë 8.48 mld. lekë, ose 1.21 mld. mesatarisht në vit ose 10.36%. Krahasimi bëhet mbi vlerën absolute të financimeve vjetore respektive.

Grafiku 2. Buxheti i akorduar dhe i kërkuar për periudhën 2007-2017 (në miliardë lekë).⁴



Materiali i prezantuar më sipër, është rezultat i analizave të programeve buxhetore afatmesme dhe buxhetimeve ushtrimore. Për vitet 2009-2017 janë kërkuar fonde mbi limit, 28.336 mld. lekë (mbi 210 milion euro) ose 3.15 mld. lekë mesatarisht në vite (mbi 23 mln. euro në vit). Nga kjo shumë, 16.92 mld., ose 59.7%, janë për investime dhe 11.416 mld. Lekë ose 40.3%, janë për shpenzime korente “paga dhe kontribute” 3.372 mld. lekë dhe “shpenzime operative”, 8.044 mld. lekë. Për vitin 2016-2017 (pjesë e informacionit 2009-2017), janë kërkuar fonde mbi limit, respektivisht, + 4.266 mld. lekë dhe + 5.7 mld. lekë, ose 28.8% dhe 35.5% e buxhetit vjetor të akorduar. Për vitin 2018 janë kërkuar fonde mbi limit, 6.5 mld. lekë, ose mbi 40.5% e buxhetit limit (6.5 : 16), nga të cilat 3.7 mld. lekë për investime dhe 2.8 mld. për shpenzime korente, ku nga këto, 2.2 miliardë lekë, për “paga dhe kontribute”.

Në buxhetimin e policisë, për periudhën 2007-2017, pesha specifike është si me poshtë: a) zëri, “paga dhe kontribute”, në kufijtë minimale, është 64.5% (viti 2009) dhe maksimale, është 76.9% (viti 2016); b) zëri, “mallra dhe shërbime”, në kufijtë minimalë, është 12.6% (viti 2016) dhe maksimale, është 18.6% (viti 2014); c) zëri, “investime nga buxheti i shtetit”, në kufijtë minimal, është 2.8% (viti 2007) dhe maksimale, 8.75% (viti 2011); d) zëri, “investime të huaja”, në kufijtë minimal, është 1.14% (viti 2015) dhe maksimale, është 7.7% (viti 2009); e) zëri, “financime të tjera nga buxheti i shtetit”, në kufijtë minimale, është 0.1% (viti 2008) dhe maksimale 5.3% (viti 2009).

2.2. Buxhetimi i policisë sipas destinacionit - procesi i kostimit

Më herët pasqyruam dhe analizuam, buxhetimin e policisë sipas natyrës së

⁴ Nga informacioni i Balanceve të Policisë Shtetit 2007-2017.

shpenzimeve. Analiza e buxhetimit sipas destinacionit, na orienton, drejt procesit të matjes së kostos së aktiviteteve policore. Procesi i kostimit të aktivitetit policor, ka qenë për ne, një pikë e dobët, jo vetëm parë nga këndvështrimi i sasisë dhe cilësisë në procesin e përcaktimit të shpenzimeve të konceptuara në PBA, si pozicionim i buxhetit, por mbi të gjitha nga pamundësia për të ballafaquar (lidhur) kostimin me produktin, gjithmonë sipas çmuarjes së raportit *klient-kreditor*. Referuar periudhës 2007-2017, në totalin e shpenzimeve ushtrimore, *shpenzimet për paga* dhe kontribute zënë rreth 80%, ndërsa *shpenzime operative dhe të tjera*, rreth 20%. Për vitin 2017, ndarë sipas nënprogrameve, kostoja totale, për: a) departamentin e hetimit të krimit, është 3.66 mld., ose 24.6% e totalit; b) departamentin e sigurisë publike, 8.6 mld., ose 58% dhe c) departamenti për kufi-migracionin, 2.6 mld., ose 17.4%. Kostoja e aktiviteteve të nënprogramit të shërbimeve mbështetëse (përfshijë kostimin e investimeve), është integruar në kostimin e aktiviteteve të tre nënprogrameve të sipërshënuara, sipas raporteve të pjesëmarrjes.

3. Kostimi dhe prioritetet në Policinë e Shtetit

Prioritetet në aktivitetin policor janë një konstante e përhershme. Për shkak të kompleksitetit, e gjejmë me vend të trajtojmë këto raste:

Rasti i parë - kur pjesëmarrësit në kostim (b.nj.+b.f.+b.m.), mbeten konstante, ndërkohë, po nga këto burime, përveç ngarkesës normale realizohen edhe prioritetet. Në këtë rast jemi përballë opsioneve: a) neglizhencës ndaj shërbimeve të tjera (hiqen burime nga shërbimet normale dhe përqendrohen ato si burime shtesë në shërbimet apo aktivitetet prioritare dhe b) menaxhimit të suksesshëm. Në këtë rast, me të njëjtat burime mbulohet angazhimi në aktivitetet normale edhe në ato prioritare. Pra, gjendemi edhe në opsionin e “aftësisë” së planifikimit me rezerva.

Rasti i dytë - kur pjesëmarrësit në kostim, ndryshojnë; në sensin rritës sigurisht. Ky rast çmohet si rasti që për të mbuluar aktivitetet prioritare pa zbutur ato normale, është i nevojshëm një kostim shtesë në të tre pjesëmarrësit, ose në ndonjërin prej tyre. Ky është rasti më fatlum, pasi me të njëjtin nivel menaxhimi, ruhet e njëjta *statuskuo* policimi.

Rasti i tretë - është rasti i përdorimit të burimeve policore në shërbim të së tretëve. Shpesh, ky rast realizohet në neglizhencë të aktivitetit normal, sepse bëhet në zbatim të një urdhri, pa llogaritur më parë mundësitë.

Rasti i katërt - është rasti i përdorimit të burimeve policore në periudhë piku. Ky rast ngjan me rastin e tretë.

Në pasqyrën vijuese, prezantohen, për tre nënprogramet, aktivitetet më pikante, ose përfaqësuese të prioriteteve të policimit aktual. Aty tregohet procesi i vlerësimit dhe planifikimit të buxhetit të shtuar për veprimtaritë prioritare, por edhe ajo pjesë e cilësisë së dobët në procesin e hartimit të *pba*-së. Për shkak të prioritetit, lufta kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, aktiviteti policor është shënjuar. Referuar materialit (raportet), kosto e aktiviteteve policore të listuara ka peshë të ndjeshme në totalin e kostos së policimit ushtritor, e cila, sipas viteve, zë respektivisht: 52.25%, 56.98%, 57.15%, 60.79% dhe 62.11%.

Tabela 2. Aktivitetet kryesore në sasi dhe vlerë, sipas nënprogrameve policore, për periudhën 2013-2017.⁵

Nr	Nënprogramet dhe aktivitetet	viti 2013		viti 2014		viti 2015		viti 2016		viti 2017	
		sasi	vlerë	sasi	vlerë	sasi	vlerë	sasi	vlerë	sasi	vlerë
i	Hetimi i krimit										
1	Op.k.trafiqeve	20	176,040	23	202,445	32	281,664	31	272,854	36	316,863
2	Op.antidrogës	50	242,412	56	274,568	69	336,168	790	315,136	830	335,584
3	Op.k.a.terroriste	25	72,508	22	63,800	28	81,210	33	95,712	38	110,215
4	Hetime k.p.parave	15	56,600	19	82,232	29	125,504	37	160,126	45	194,747
5	Heti.k.kr.ekonom.	34	98,261	37	103,862	43	120,704	51	143,161	56	157,198
	Shuma/vlerë		645,821		726,907		945,250		986,989		1,114,607
	Rap. v.paraardhes		100%		112.6%		130.0%		104.4%		115.0%
ii	Sig. publike										
1	Sherb.p.përgjith.	4,023	1,517,658	4,271	1,928,737	4,122	1,861,391	4,615	2,083,797	4,761	2,149,842
2	Sherb.pol.r.rugore	5,224	1,306,816	6,421	2,118,095	5,952	1,964,239	6,444	2,120,259	6,347	2,088,353
3	Op.k.kult.b.nark.	159	896,896	162	913,818	192	1,083,043	196	1,105,606	2,011	1,263,443
	Shuma/vlerë		3,721,370		4,960,650		4,908,673		5,309,662		5,501,638
	Rap. v.paraardhes		100%		133.3%		99.0%		108.2%		103.6%
iii	Kufi-Migrac.										
1	Persona proç.pkk ajrore	2,311,557	243,733	2,460,887	305,150	2,500,000	310,000	2,600,000	322,400	2,669,145	330,974
2	Persona proç.pkk toksove	9,014,278	940,825	9,015,303	1,117,898	9,100,000	1,128,400	9,300,000	1,153,200	9,400,000	1,165,600
3	Persona proc.pkk detare	2,311,557	243,733	2,898,719	359,441	3,200,000	396,800	3,250,000	403,000	3,300,000	409,200
	Shuma/vlere		1,428,291		1,782,489		1,835,200		1,878,600		1,905,774
	Rap. v.paraardhes		100%		124.8%		103.0%		102.4%		101.4%
	shuma (i+ii+iii)		5,795,482		7,470,046		7,689,123		8,175,251		8,522,019
	Kosto e aktivitet. ne raport me shpenz. vjetor		52.25%		56.98%		57.15%		60.79%		62.11%

Më poshtë, (grafikisht) është prezantuar rasti kur buxhetimi ushtrimor i kombinuar me pjesëmarrjen e burimeve alternative mbulon në masë të plotë edhe kostime të aktiviteteve policore prioritare si në rastin e zbatimit të urdhrimit të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e strukturës drejtuese ndërinstitucionale në zbatim të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020”, përveç aktiviteteve rutinë.

Në këtë rast, jemi përpara dilemës: a mund të ketë aq rezerva të papërdorura, apo të paplanifikuara, apo të paçmuara, Policia e Shtetit, për të realizuar shërbimin, si procesin rutinë edhe prioritetet? Parë nga pikëpamja e buxhetimit, vlerësojmë se jemi larg ndërtimit të një: buxhet-performance, buxheti si mjet i menaxhimit, buxheti si një plan, buxheti si një udhërrëfyes operacional, etj., etj. Për të qartësuar idenë, i referohemi ndërtimit të buxhetit, *nënprogrami i sigurisë publike*.


Në pikën 3 të tabelës 2, aktivitetet për vitin 2017, në sasi, janë planifikuar të rriten 10.3 herë, ndërsa buxheti është planifikuar i rritur me +14.3%. Ç’tregon kjo? Çdo gjë, përveç, njohjes dhe zbatimit të rregullave në ndërtimin e buxhetit.

⁵ Informacioni nga PBA, 2013-2017.


Barjami, XH.
« Buxhetimi dhe misioni i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018


Grafiku 3. Siguria publike: operacione kundër kultivimit të bimëve narkotike, viti 2013-2017.⁶



Grafiku 4. Operacione antidrogë, për periudhën 2013-2017.⁷



Grafiku 5. Persona të procesuar në pikat e kontrolleve kufitare tokësore, për periudhën 2013-2017.⁸



Insistimi në procesin e kostimit të shërbimit/aktivitetit policor, referuar rasteve kur

⁶ Informacioni nga PBA, 2013-2017.

¹ Informacioni nga PBA, 2013-2017.

² Informacioni nga PBA, 2013-2017.

ndërmerren angazhime policore, pa mbështetje financiare, sigurisht në shkelje të ligjit, lidhet me rregullat që duhen njohur dhe zbatuar në procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, si mjeti kryesor për njohjen e vlerave në policim. Në vijim, në kostimin e matricës së policimit, (tërësia e aktiviteteve dhe shërbimeve policore) duhet të mbajmë në konsideratë disa referenca, të natyrës absolute dhe relative. Si tregues që i përmban të dyja këto gjendje, është ai i personelit. Treguesi i personelit ka në vetvete, masën absolute e cila përfshin: a) ngarkesën vjetore të punës për çdo punonjës policie = 1914 (174 x 11) ore dhe, b) ngarkesën (trajtimin) vjetore të punësimit për çdo punonjës policie = 2088 (174x12) orë dhe masën relative (performancën).

Procesi i kostimit, për çdo strukturë, çdo njësi, apo edhe për organizatën në tërësi, kërkon, të marrësh në konsideratë: a) numrin organik të personelit dhe masën e plotësimit. Raportet, sidomos me personelin e rolit zbatues; b) nivelin e shpenzimeve të planifikuara dhe masën e realizimit; c) orë pune në vite dhe orë punësimi, për personelin organik dhe fakt; d) raportet që zënë zërat e kostos në totalin e shpenzimeve të planifikuara apo shpenzimeve në fakt. Ky informacion përveç lehtësisë në vlerësimin e kostos, ndihmon edhe në vlerësimin e motivimit; e) raportin e shpenzimeve ushtrimore me buxhetimin, raporti mesatar vjetor, (shpenzime ushtrimore/buxhetimin), për periudhën 2007-2017, është 0.902. Pra, në totalin e buxhetimit mesatar ushtrimor fakt, 90.1 %, janë shpenzime korente dhe 9.9% janë investime. Ky raport ka minimumet dhe maksimumet e veta në vite të ndryshme ushtrimore. Peshat specifike në totalin e shpenzimeve korente (90.1% e buxhetimit ushtrimor), është: paga 69%, kontribute 11%, shpenzime operative 17% dhe shpenzime të tjera buxhetore 3%. Një tjetër referencë për procesin e kostimit është kosto mesatare orare e punësimit, pasi ajo lidhet, së pari, me shpërndarjen e shpenzimeve vjetore, sipas aktiviteteve të nënprogrameve policore dhe së dyti, me trajtimin e personelit, pra me motivimin.

Shembull

Referuar informacionit mbi, “gjendjen mesatare të realizuar për plotësimin organik të b.nj.”, që është 9 728.6 punonjës dhe “gjendjen e realizuar të shpenzimeve vjetore”, që janë 11 447 654 802 lekë, për periudhën 2007-2017, rezulton se:

Orë mesatare pune, janë 18 620 610 dhe kosto mesatare orare e punës, është 616.4 lekë. Orë mesatare punësimi, 20 313 317 dhe kosto mesatare orare e punësimit, është 565.03 lekë. Në koston mesatare orare, qoftë të punës, qoftë të punësimit, përmes raporteve përkatëse të krahasimit e gjejnë veten, kostot sipas niveleve të hierarkisë së b.nj., gjithashtu, në këto kosto, janë përfshirë të gjitha zërat e shpenzimeve, si ato të punës së gjallë edhe të punës së materializuar. Raportet, në procesin e kostimit janë shumë të rëndësishëm, pasi lehtësojnë punën e personelit menaxherial, për të realizuar kostimin e një aktiviteti. Ndihejnjë gjithashtu, edhe për të pasqyruar pjesëmarrjen sipas niveleve në hierarkinë policore.

Raporti 1: paga mesatare mujore e nivelit, *drejtues deri drejtues madhor*, me pagën mesatare mujore të Policisë së Shtetit, është 1.59 : 1, ose + 0.59% më e lartë.

Raporti 2: paga mesatare mujore e nivelit, *nënkomisar deri kryekomisar*, me pagën mesatare mujore të Policisë së Shtetit, është 1.21 : 1, ose + 0.21% më e lartë.

Raporti 3: paga mesatare mujore e nivelit *inspektor*, me pagën mesatare mujore të Policisë së Shtetit, është 0.93 : 1, ose -0.7% më e ulët.

Raporti 4: paga mesatare mujore e nivelit, *punonjës me statusin e nëpunësit civil*, me pagën mesatare mujore të punonjësit të policisë, është 0.91 : 1, ose -0.9% më e ulët.

Barjami, XH.
« Buxhetimi
dhe misioni
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Raporti 5: paga mesatare mujore e nivelit, *punonjësit administrativ*, me pagën mesatare mujore të punonjësit të Policisë së Shtetit, është 0.70 : 1, ose -0.30% më i ulët.


Raporti 6: paga mesatare mujore e punonjësve të grupit (1), me atë të grupit (3), është 1.7 : 1, ose +0.70% më i lartë.

Raporti 7: paga mesatare mujore e grupit (4), me atë të grupit (5), është 1.3 : 1, ose +30% me i lartë.

4. Buxhetime të specifikuara, pjesë e buxhetimeve ushtrimore

Për efekt të “ndjeshmërisë” dhe “peshës”, në zërin “të tjera trajtime dhe buxhetime” në Policinë e Shtetit, më kryesoret janë: a) kompensimi financiar i mbikohës së punës dhe i orëve të natës ; b) buxhetimi i vendimeve gjyqësore dhe c) trajtime të tjera.

Grafiku 6. Të tjera trajtime dhe buxhetime, zërat (1) dhe(2), për periudhën 2013-2016 (në lekë).⁹



Për periudhën 2013-2017 shuma e buxhetimit të tre zërave, është respektivisht, 0.8, 1.26, 1.41, 1.36 dhe 1.38 miliard lekë.

4.1. Trajtimi financiar i orëve suplementare dhe orëve të natës

Trajtimi financiar i mbingarkesës (o.s.) së punës, na shërben për të parë: a) peshën që ka ky tregues në fondin e pagave të Policisë së Shtetit; b) domosdoshmërinë e mbulimit të shërbimit me këtë formë menaxhimi dhe pamundësinë e mbulimit të shërbimit përmes shtesave organike c) mundësinë e krahasimit, midis *masës së mbuluar me buxhetim*, *masës së mbuluar me pushim* dhe *masës së pambuluar*. Vlerësimi i kësaj situatë, na mundëson të gjykojmë mbi nivelin e aftësisë menaxheriale në organizimin dhe mbulimin e shërbimit përmes kohës normale të punës dhe mundësisë që të jep personeli disponibël. Me pagesën e o.s., të evidentuara në tabelën e mësipërme, do të mbulohej kostoja vjetore respektivisht, për 50, 107, 237, 210 dhe 135 punonjës policie shtesë të rolit bazë. Sa i përket orëve të punës, të kryera në turne të dyta dhe të treta,

⁹ Raportimi vjetor mbi buxhetin e realizuar, në Policinë e Shtetit.

trajtimin me buxhet shtesë është në nivelin e 10% të fondit të pagave. Natyrisht, shërbimet policore janë të nevojshme, madje të domosdoshme të realizohen në kohën kur siguria dhe qetësia mund të cenohen më lehtë. Si alternativë për amortizimin e kësaj ngarkese mund të ishte vendosja e kamerave në territor.

4.2. Trajtimi financiar i vendimeve gjyqësore

Janë trajtuar, respektivisht vendimet gjyqësore të formës së prerë, respektivisht për 3, 157, 115, 98 dhe 263 raste, nga të cilat mbi 80% janë për punonjës policie, të liruar nga detyra, ose të drejta të tjera të mohuara. Mbi këtë tregues, komentet mund të jenë të shumta, ato mund të lidhen me: a) aftësinë apo paaftësinë e nivelit të lartë menaxherial në menaxhimin e trupës policore, që do të thotë se kemi probleme në raportet punëdhënës-punëmarrës, ndërsa në menaxhimin e burimeve njerëzore, nuk jemi udhëhequr nga parimi i *kosto-përfitueshmërisë*; b) mundësinë dhe seriozitetin e shtetit në trajtimin e detyrimeve, kjo shpjegohet me nivelin e buxhetimit të treguesit në vitet 2014-2017, krahasuar me vitin 2013.

4.3. Trajtime të tjera

Përveç buxhetimit të drejtpërdrejtë të veprimtarisë, çdo organizatë ekonomike ose jo, në procesin e ushtrimit të funksioneve, realizon edhe disa detyrime, së brendshmi dhe me të tretë, të cilat mund të konsiderohen kosto të nevojshme, natyrisht nëse sjellin performancë të shtuar dhe të panevojshme, por të detyrueshme nëse janë në kuadrin e një detyrimi ligjor. Këtu përfshihet edhe buxhetimi i vendimeve gjyqësore, i trajtuar më sipër. Kostot për të cilat po flasim janë evidentuar në grafikun nr. 7. Për lehtësi në të kuptuar, bazuar edhe në njëtrajshmërinë ndër vite, po sjellim në vëmendje koston ushtrimore të vitit 2016, e cila është në shumën 352.5 milion lekë, ose 2.2% e buxhetimit vjetor, ose 2.6 % e shpenzimeve vjetore të policisë.

Grafiku 7. Trajtime të tjera financiare, referuar informacionit të vitit 2016, në persona dhe lekë.¹⁰



Barjami, XH.
« Buxheti
dhe misioni
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

¹⁰ Raportimi vjetor mbi buxhetin e realizuar, në Policinë e Shtetit.

Në këtë material, nuk mund të mos trajtonim edhe një tregues të ftohtë statistikor, por të dhimbshëm nga pikëpamja humane (njerëzore). Prezantimi lidhet më shumë me statusin e punonjësit të policisë se sa me trajtimin financiar.


Në periudhën, 1990-2016, të rënë apo të plagosur, në krye apo për shkak të detyrës janë respektivisht, 260 dhe 259 punonjës policie, ose mesatarisht për secilin grup 9.6 punonjës policie në vite, që do të thotë se në çdo aksion me pasoja ekstreme, rezultati është 1 i vrarë dhe 1 i plagosur. Natyrisht, vitet e fundit për fat të mirë, por kryesisht për stabilitet të rendit dhe sigurisë në vend dhe mbi këtë bazë, funksionimit të shtetit ligjor, numri i punonjësve të policisë të rënë apo të plagosur në krye apo për shkak të detyrës, është reduktuar shumë, pothuaj është zero. Zëri, “nuk kemi nevojë për heronj”, është jo vetëm njerëzor, por edhe kambanë alarmi për të bërë shtet.

5. Buxheti dhe raporti me të ardhurat e realizuara

Për periudhën 2007-2016, “të ardhurat e realizuara”, “të drejtat e policisë mbi të ardhurat” dhe “masa e përfitimit në fakt”, janë prezantuar qartë dhe thjeshtë në grafikonin përkatës. Duhet theksuar se në institucionet publike (nuk bën përjashtim Policia e Shtetit) mbetet problem pjekja dhe mbledhja e të drejtave (çmuarja dhe realizimi i të drejtave mbi të tretët). Përmbledhtazi, po evidentojmë treguesin e të ardhurave në tre linja, realizimin, të drejtat e institucionit dhe përfitimin në fakt.

Realizimi: të ardhurat e realizuara kanë mbuluar buxhetimin vjetor në nivelin minimal, 5.7% (viti 2011) dhe në nivelin maksimal, 11.4% (viti 2015).

Grafiku 8. Të ardhurat e realizuara, kërkuara dhe përfituara, për periudhën 2007-2016 (në miliarda leke).¹¹



Barjami, XH.
« Buxheti dhe misioni i policisë »

Policimi dhe Siguria nr.11, 2018

E drejta e institucionit: nga të ardhurat e realizuara, policisë së shtetit i ka takuar të përfitojë mbi limitin buxhetor afërsisht 5 miliard lekë, ose afërsisht 500 milion lekë

¹¹ Raportimi vjetor mbi të ardhurat e realizuara dhe rakordura në Policinë e Shtetit.

mesatarisht në vite e përkthyer kjo në nivelin e 4% të buxhetit vjetor. Për vitin 2017, kjo e drejtë është 850 milion lekë, ose 5.5% e buxhetit vjetor përkatës.

Përfitimi fakt: në fakt, është përfituar rreth 60 milion lekë në vit, ose mesatarisht 12% $(60/500) \times 100$ e të drejtës së normuar, ose 0.5% e buxhetit vjetor. Është fjala për përfitime mbi limitin e buxhetimit vjetor.

6. Të ardhurat e masave administrative

Treguesi i m.a., është vlerësuar edhe për vitin ushtrimor 2017. Për periudhën 2007-2017, në totalin e të ardhurave, pesha specifike e m.a., në nivelin minimal, është 47.4% (viti 2007) dhe në nivelin maksimal, është 83.6 % (viti 2014).

Tabela 3. M.a., për periudhën 2013-2017 (në lekë). Raportet (në përqindje) ¹²

Nr	Përshkrimi	Periudha				
		V. 2013	V. 2014	V. 2015	V. 2016	V. 2017
1	Gjendja në fillim	501,746,445	584,436,194	513,240,736	346,407,763	341,165,593
2	Vendosur gjatë vitit	642,793,784	1,191,497,213	1,456,849,442	1,377,553,626	1,597,206,130
3	Shuma e maturuar	1,144,540,229	1,775,933,407	1,970,090,178	1,723,961,389	1,938,371,723
4	Arkëtuar Cash	342,217,544	925,620,590	1,180,996,917	1,058,288,605	1,242,944,899
5	Vlera e zbritur 20%			173,275,741	171,563,260	200,752,285
6	Shuma e vl.m.a.	342,217,544	925,620,590	1,354,272,658	1,229,851,865	1,443,697,184
7	Kamatvonesa	80,160,127	185,177,188	197,794,153	140,384,757	160,332,118
8	Parashkrimi	217,886,491	337,072,351	269,409,757	152,943,931	167,264,257
9	Gj.fund [3 - (6+8)]	584,436,194	513,240,736	346,407,763	341,165,593	327,410,282
	Raportet					
10	R. (6) : (2)	53%	78%	93%	89%	90%
10	R. (2) : v.paraardhes	100%	185%	122%	95%	120%
11	R. (6) : v.paraardhes	100%	2701%	146%	91%	117%
12	Rap. [(6)+(8)] : (3)	49%	71%	82%	80%	83%
13	R. (8) : (6)	64%	36%	20%	12%	12%
14	R. (9) me vitin 2013	100%	88%	59%	58%	56%

Çfarë konstatohet nga informacioni mbi m.a.: a) trendi rritës i m.a., të vendosura dhe të arkëtuara; b) trendi zbritës i shumave të parashkuara dhe gjendjeve në fund dhe fillim të periudhës; c) trendi zbritës i shumave të parashkuarave në raport me arkëtimin; d) rënie të peshës specifike të shumave të parashkuara në raportin *arkëtim + parashkrim*, me shumat e faturuara.


Evidenca dhe analiza mbi treguesin e m.a., ndonëse e përmirësuar ndjeshëm, gjithmonë ka vend të përmirësohet dhe të trajtohet në relacion me përfitimin; kjo, jo aq nga pikëpamja materiale se sa nga pikëpamja e sigurisë dhe jetëve të fituara, pra me çmimin e shërbimit.

Barjami, XH.
« Buxhetimi dhe misioni i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

¹² Raportimi vjetor mbi të ardhurat e realizuara dhe rakordura në Policinë e Shtetit.


Grafiku 9.M.a.,për periudhën 2013-2017,në mijë lekë.¹³



7. Buxheti dhe donacionet

Mbulimi i disa nevojave përmes donacioneve, është veprimtari e ligjshme. Përdorimi i kësaj forme është i nevojshëm, sidomos kur nevojat vijnë në rritje, ndërsa buxheti është i limituar.

Grafiku 10. Donacionet për periudhën 2007-2016 (në milion lekë).¹⁴



Donacionet si mundësi e “zbutjes” së nevojave:

a) Kjo formë duhet parë, në respektim të parimit të vullnetarizmit dhe barazisë së palëve. Sipas këtij parimi, është i papranueshëm, abuzimi nga pozitat e të pushtetshmit,

¹³ Raportimi vjetor mbi të ardhurat e realizuara dhe rakorduara në Policinë e Shtetit.

¹⁴ Raportimi vjetor mbi donacionet në Policinë e Shtetit.

që nuk është se mungon në pushtetin që ushtron Policia e Shtetit.

b) Kjo formë duhet parë, si një mundësi e plotësimit të nevojave prioritare. Ky kontekst, lidhet me nevojat, kryesisht, afatmesme dhe afatgjata. Kjo do të thotë se nuk duhet të shfrytëzohet si një mundësi e mbushjes së magazinave, aq më keq akoma si një mundësi përfitimi, ndihmuar edhe nga gjendja e evidencës kontabël, për këtë tregues.

c) Kjo formë duhet parë, si një mundësi partneriteti. Kjo mundësi, duhet parë dhe trajtuar si një formë e re bashkëpunimi, sidomos në procesin e policimit në komunitet. Natyrisht kjo kërkon edhe një kuadër ligjor dhe më tej, një kuadër rregullator.

d) Kjo formë duhet parë, në kontekstin e zbatimit të procedurës dhe atë të çmuarjes.


Nga prezantimi, kuptohet qartë problematika, por më shumë dalin në pah dy elementë: *serioziteti në vlerësim dhe përpjekjet për ta përdorur këtë mundësi*. Për vitin 2016, si viti më i suksesshëm në këtë drejtim, vlera e donacioneve ka arritur kuotën maksimale, në shumën 799 milionë lekë, nga të cilat, 3 milion euro janë aktive korente, ndërsa 2.9 milion euro, janë aktive afatgjata. Vlen të përmendet donacioni që lidhet me sponsorizimin e uniformës nga qeveria turke, në vlerën e 2.9 milion euro, një sponsorizim shumë i nevojshëm, parë në situatën aktuale.

8. Aktivet në Policinë e Shtetit

Referuar grafikut përkatës, aktivet me vlerën fillestare variojnë nga 13.83 miliard lekë (viti 2007) në 27.04 miliard lekë (viti 2016), ose + 13.21 mld. lekë, ose +95.5%, ndërsa amortizimi varion nga 5 miliardë lekë ose 36.15% në 7.9 miliard lekë, ose 29.2%, me një ndryshim prej + 58%.

Aktivitet me vlerën e mbetur (vlera e punës) variojnë nga 8.83 miliardë lekë, ose 63.85%, në 19.14 miliard lekë, ose 70.8%, ose +6.95% (36.2% - 29.2%). Siç shikohet, niveli i amortizimit është në zbritje, nga 36.2% (viti 2007), në 32.2% (viti 2013), në 29.2% (viti 2016).

Grafiku 11. Gjendja e aktiveve dhe niveli i amortizimit në p.sh. (në miliard lekë)¹⁵



Vlera e amortizueshme e aktiveve në datën 31.12.2016 është rreth 19 mld. lekë ose

¹⁵ Informacioni nga Pasqyrat Financiare të konsoliduara për periudhën 2007-2016 të Policisë së Shtetit.

70.4% e totalit të aktiveve. Niveli i amortizimit për vlerën e amortizueshme, është 41.6%, ndërsa vlera e mbetur ose “vlera e punës” është 58.4% ose 11.1 mld. lekë.

Aktivitet qarkulluese variojnë nga 2.9 mld. lekë ose 21% e totalit të aktiveve në 3.5 mld. lekë ose 13.1% e totalit të aktiveve, me një rritje në vlerë absolute prej rreth 600 mln. lekë (10 vjet) ose me një rritje absolute mesatare vjetore rreth 60 milion lekë. Kujtojmë se ky grupim është përfaqësues i “stokut”, rritja e të cilit është bllokuese për funksionimin normal të njësisë. Raporti fonde të veta/detyrime, varion nga 87% (viti 2007) në 88.3% (viti 2016). Kjo do të thotë se detyrimet zënë një peshë shumë të vogël në mbulimin e aktiveve. Pësha specifike që zënë në totalin e aktiveve, aktivitet afatgjata materiale; aktivitet afatgjata jomateriale dhe aktivitet qarkulluese në datën 31.12.2016 janë respektivisht, 86.3%; 0.6% dhe 13.1%. Informacioni mbi aktivitet i paraqitur grafikisht na mundëson dhe thjeshtëson njëkohësisht perceptimin dhe mundësinë për analiza më të thelluara. Metamorfoza e peshës specifike të grupimeve sipas natyrës të aktiveve ndaj totalit, për periudhën 2007-2016 (ref. ekstremeve) dhe amortizimit përkatës, në datën 31.12.2016, është si më poshtë:

a) “toka, troje dhe terrene”, nga 0.1 %, në 18.3%; aktiv që nuk amortizohet; b) “ndërtime dhe rikonstruksione”, nga 28.2% në 33.7%; amortizuar në masën 17%; c) “instalime, makineri e pajisje teknike” nga 11.8 %, në 16.9%; amortizuar në masën 37%; d) “mjetet transporti”, nga 43.4% në 21.1%; amortizimi në masën 84%; e) “inventar ekonomik dhe informat”, nga 14.5% në 6.4 %; amortizimi në masën 52%; ë) “të tjera aktive afatgjata”, nga 2.0% në 3.6%; amortizimi në masën 28%.

Aktivitet “armatimi”, në p.f. të vitit 2016 për shkak të procesit të administrimit është përfshirë në bilancin ushtrimor në mënyrë ekstrakontabël dhe përfaqëson 0.6% të totalit të aktiveve.

9. Burimet njerëzore në Policinë e Shtetit

Të gjithë biem dakord për veçorinë e këtij aseti dhe, kjo sepse: a) b.nj., janë aseti i çmuar, sa i përket vlerësimit financiar për kohën fizike në shërbim të policimit; b) b.nj., janë aseti i paçmuar, sa i përket performancës dhe rezultateve që përftohen prej saj dhe, c) b.nj., me kalimin e viteve, duke fituar eksperiencë, si edhe për shkak të investimeve (asistencë), rritin produktivitetin (përmirësojnë performancën), natyrisht duke rritur edhe koston e çmuarjes, por jo koston e amortizimit si në rastin e asetëve (aktiveve) të tjera. Kjo shpjegon vëmendjen e shtuar në trajtimin dhe pritshmëritë që kërkohen dhe mund të sigurohen nga aseti, “b.nj.”.

Përmbledhtazi po japim një informacion të reduktuar mbi b.nj., p.sh. menaxhimi i b.nj. nuk mund të realizohet pa një informacion sasior mbi treguesin, disa prej të cilave janë: shtimi i trupës policore; në vitin 2015 Policia e Shtetit është shtuar me 1083 punonjës ose +11%. Numri organik në 31.12.2017 është 10 958 punonjës plotësuar 97.2% (10 655). Në strategjinë e Policisë së shtetit, në fund të vitit 2017, numri total i policisë duhej të ishte 11 000 punonjës, objektiv strategjik i realizuar në nivelin 99.6%.

Orë pune të planifikuara, në vitin 2013 ishin 18 977 310 orë (9915 x 1914) ndërsa në vitin 2017 ishin 20 973 612 orë (10 958 x 1914) ose +1 996 302 ose +10.5% më shumë. Këndvështrimi mbi këtë tregues mund të jetë në dy linja:

a) *Referenca mbi ngarkesën fizike të normuar.* Kjo ngarkesë natyrisht përfaqëson “çmuarjen” e burimeve njerëzore. Ky çmim në buxhetin ushtrimor, në zërin “paga dhe kontribute”, është mesatarisht 72% e buxhetimit ushtrimor dhe kjo për periudhën

2007-2016. Natyrisht çmimi ka luhatjet e veta, të cilat variojnë nga minimumi prej 64.5% (viti 2009) në maksimumi prej 77.3% (viti 2016). Kjo referencë kushtëzon strukturat menaxheriale të cilat në ndërtimin/hartimin e planeve të shërbimit, planeve operacionale, planeve të veprimit dhe planeve vjetore duhet të marrin në konsideratë kohën fizike të normuar dhe trajtuar të personelit në dispozicion.

b) *Referenca mbi performancën e burimeve njerëzore.* Kjo referencë duhet marrë parasysh sidomos në procesin e ndërtimit strukturor, organizativ dhe të funksionimit të organizatës apo njësisë policore, duke iu referuar territorit gjeografik, gjeografisë së krimit, gjendjes dhe natyrës demografike, gjendjes dhe nivelit arsimor dhe kulturor, operatorëve ekonomik dhe fushave operuese, nivelit të punësimit, tendencave integruese dhe bashkëpunuese të rajoneve, etj. Plotësimin organik i trajtuar më sipër në rastin më të mirë është 98.7%, në vitin 2013 ndërsa në nivelin minimal 93.1% në vitin 2015.


Mosha mesatare. Nga informacioni i trajtuar në datën 31.10.2017, mosha mesatare e punonjësve të policisë me gradë policore, është 45.25 vjeç, ndërsa për inspektorët, është 44.6 vjeç. Në këtë grup punonjës me moshë 23-45 vjeç janë rreth 3 mijë punonjës ose 42.1% e totalit. Nga 46-55 vjeç janë 3,230 punonjës ose 45.5% e totalit dhe në moshën 56-65 vjeç janë afërsisht 900 punonjës ose 12.4% e totalit.

Vjetërsia mesatare në punë. Vjetërsia mesatare në punë për të gjithë punonjësit e policisë me gradë policore është 17 vjet, ndërsa për punonjësit e policisë me gradën “inspektor” është 16.6 vjet. Në këtë grup, punonjës me vjetërsi pune mbi 25 vjeç (26-44) janë 14% ose afërsisht një mijë punonjës.

Raportin e punës së gjallë me atë të materializuar. Për periudhën 2007-2017, raporti mesatar vjetor është 3.5 me 1, karakteristikë kjo për vendet në zhvillim apo të pazhvilluara.

Raporti i disponibilitetit. Në analizën disa vjeçare, në vlerësim të shumë faktorëve ndikues, efektiviteti disponibël policor është në nivelin 80-83%. Gjendja jo disponibël është me pushime vjetore, me raporte mjekësore, me raporte lindje, me shërbime ndaj të tretëve, me trajnime dhe shkollime dhe me mungesa organike.

Grafiku 12. B.nj. sipas organikës dhe realizimit në p.sh.¹⁶



¹⁶ Sistemi RMIS.

Barjami, XH.
« Buxhetimi dhe misioni i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

Sqarim: Pavarësisht se nuk është paraqitur në grafik, treguesi i burimeve njerëzore për vitin 2017, në vijim të materialit, është trajtuar duke mundësuar prezantimin aktual të këtij treguesi.

9.1 B.NJ. dhe disponibiliteti

Për shkak të rëndësisë që merr në procesin e planifikimit dhe të përmbushjes së misionit policor, disponibiliteti, bën të nevojshëm një trajtim me të hollësishëm. Për ta bërë më të qartë idenë po vijojmë me një shembull. Referuar organikës prej 10 958 punonjësish në vitin ushtrimor 2017 dhe niveleve minimale dhe maksimale të disponibilitetit, b.nj. disponibël do të jenë ose 8 766 punonjës (10 958 x 80%) ose 9 095 punonjës në rastin më të mirë (10 958 x 83%). Nisur nga kjo formulë, në hartimin e strategjisë së policisë, planeve të veprimit, planeve të masave, planeve të shërbimit apo planeve operacionale, çdo njësi e varësisë, departament apo Drejtoria e Përgjithshme, duhet t'i referohet mundësive fizike, të cilat shprehen në:

a) *Orët e punës vjetore.* Orët e punës për vitin 2017 (maksimal) janë në shumën 17 407 830 orë (9 095 x 1914). Lidhur me ngarkesën vjetore ligji ka krijuar edhe mundësinë e një ngarkese suplementare vjetore, 200 orë për punonjësit kryesisht të rolit bazë (7 500 x 200 = 1 500 000 orë). Në përfundim të analizës, Policia e Shtetit, në rastin më të mirë ka në dispozicion 18 907 830 orë (17 407 830 + 1 500 000).

b) *Kostimi mesatar orar.* Në këtë tregues është përfshirë kostimi i punës së gjallë dhe ai i materializuar. Në planin e radhës duhet zbritur ngarkesë fizike e amortizuar. Efekti i disponibilitetit është shumë përcaktues: çdo 1%, aktualisht, shoqërohet me një efektiv prej 110 punonjësish.

9.2 B.Nj. dhe motivimi


Ndërsa për kostimin e shërbimit policor merret për bazë “k.m.o.ps.”, për motivimin merret në konsideratë “k.m.o.m”. Kjo e fundit lidhet vetëm me pagën dhe pjesën e kontributit që paguan shoqëria për të punësuarin. Motivimi është i prekshëm, kur lidhet vetëm me pagën dhe mundësisht atë neto. “K.m.o.ps.”, dhe pesha e pagave për vitet 2007-2017 paraqiten në grafikun përkatës. Grafiku i peshës së pagave në përqindje, paraqet peshën e pagave në shpenzimet e vitit përkatës ushtrimor. Nëse “k.m.o.ps.” do të shumëzohet me përqindjen përkatëse, atëherë do të rezultojë vlera absolute e zërit *paga*.

Grafiku 13. “K.m.o.” në p.sh., për periudhën 2007-2017(në lekë).¹⁷



¹⁷ Informacioni bazohet në Raportimin ushtrimor të zbatimit të buxhetit.

Grafiku 13/1.k.m. orare në p.sh., për periudhën 2007-2017 (në përqindje).¹⁸



Grafiku 14. Peshë e pagave në "k.m.o" për periudhën 2007-2017 (në lekë)¹⁹



9.3 Burimet njerëzore dhe përfitimi mesatar mujor për periudhën 2007-2017

Në grafikun nr. 12 dhe tabelën nr. 4 është prezantuar niveli i pagës mesatare bruto ndër vite. Në kolonën (m) të tabelës paraqitet raporti i përfitimit mujor në vitin ushtrimor paraardhës.

¹⁸ Informacioni bazohet në Raportimin ushtrimor të zbatimit të buxhetit.

¹⁹ Informacioni bazohet në Raportimin ushtrimor të zbatimit të buxhetit

Barjami, XH.
« Buxhetimi dhe misioni i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

Grafiku 15. Personeli dhe motivimi në p.sh. për periudhën 2007-2017(në lekë)²⁰.



10. Përfitimi mesatar mujor dhe metamorfoza gjatë periudhës 2007-2017

Paga mesatare mujore e cila konsiderohet edhe elementi kryesor i motivimit për periudhën referuese ka këtë metamorfozë:

Nga viti 2007 deri në 2013, varion nga 62 mijë lekë, në 65 mijë ose nga 440 euro në 464 euro, me një rritje mesatare vjetore +0.6%. Në vitin 2014 ky tregues pësoi një hop duke u rritur me + 14.6 % (74.5/65) krahasuar me vitin 2013. Nga viti 2014 deri në vitin 2017, varion nga 74.5 mijë lekë në 77.7 mijë lekë ose nga 560 euro në 584 euro, me një rritje mesatare vjetore +1.4%. “Pg.m.m.”, në vitin 2017 krahasuar me atë të vitit 2013 është rritur me +19.6% (77 696: 64 969).

Paga mesatare mujore, është produkt që buron nga raporti i buxhetimit të pagave dhe organikës së b.nj. Në kushtet e një inflacioni të papërfillshëm, për periudhën 2014-2017, është treguar një kujdes i shtuar për trajtimin dhe motivimin e Policisë së Shtetit. Pavarësisht nga niveli relativisht më i lartë në raport me pjesën tjetër të pagave të administratës, krahasuar me vendet e rajonit (Kosovë, Maqedoni, Bosnjë-Hercegovinë, Serbi dhe Mali i Zi), “pg.m.m.” e Policisë Shqiptare është nga -4% deri -76% më e ulët.

11. Përfundime/rekomandime

Duke qenë se gjatë zhvillimit të materialit janë bërë komente, arsyetime, analiza, janë dhënë edhe disa rekomandime, pa pretenduar për një material të nivelit shterues, po fokusohemi në përfundimet që gjykojmë se përmbyllin materialin dhe e lënë njëkohësisht hapur, duke shprehur në këtë rast edhe qëllimin e këtij studimi. Mbi pyetjet që natyrshëm do t'i prodhojë vetë materiali, përgjigjet gjykoj dhe shpresoj se jepen në rekomandimet e dhëna në material, të cilat janë pjesë e mendimit dhe sfidës për ndryshim,

Barjami, XH.
« Buxhetimi
dhe misioni
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

²⁰ Informacioni bazohet në Raportimin ushtrimor të zbatimit të buxhetit.

por edhe në konkluzionin e nënvizuar. “Procesi i kostimit të aktivitetit policor”, - dhe kjo vlen edhe për kostimin e Strategjisë së Policisë së Shtetit, - vijon të jetë ende në fazën embrionale, pra anon më shumë nga tradita se sa nga bashkëkohorja. Informacioni i prezantuar në tërë shtjellimin dhe shtrirjen e tij, duke u udhëhequr nga *qëllimi*, ka synuar të tregojë se empirizmi, shabllonizmi dhe mosnjohja e kësaj pjese të rëndësishme të detyrës, nga nivelet e ndryshme menaxheriale, janë ende prezent në procesin e menaxhimit të policisë. Nisur nga ky konkluzion, është e kuptueshme edhe përgjigja, mbi *njohjen e vlerave në policim*. Pra, procesi nuk njihet sa duhet pasi ai kalon përmes rrugëve të “matjes” dhe “çmuarjes”, rrugë ende jo në përdorim të menaxhimit policor. Përmirësimi? Sugjerojmë një qasje sipas rekomandimeve të bëra në këtë studim, mbi këtë proces, pas të cilës do të vijë edhe ndryshimi edhe rezultati.

Bibliografia

1. Mark Moor, David Thacher, Andrea Dodge dhe Tobias Moor, *Njohja e vlerave në policim*.
2. Federata ndërkombëtare e kontabilistëve. *Manual i deklaratave të auditimit dhe dhënies së sigurisë dhe etikës*, 2006.
3. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, *Kuadri Ligjor dhe Standardet Kombëtare Kontabël*.
4. Bashkëpunim autorësh, *Kontabiliteti i koston së drejtimit dhe kontabiliteti financiar*.
5. Halit Xhafa dhe Beshir Ciceri, *Drejtimi financiar*.
6. Thanas Thimarko, *Kontabiliteti si sistem i regjistrimit, matjes dhe informimit*.
7. Ministria e Financave, *Manual, Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*.
8. Programet buxhetore afatmesme të Policisë së Shtetit, 2007-2020.
9. Pasqyrat financiare të konsoliduara (bilancet) të Policisë së Shtetit, 2007-2016.
10. Sistemi informatik, Rmis (Rims), mbi personelin.

Barjami, XH.
« Buxhetimi
dhe misioni
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë



■ **Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI**
Akademia e Sigurisë
Përgjegjës i Sektorit të Botimeve, QKSH
stavri.sinjari@asp.gov.al

Abstrakt

Figura më interesante në historinë e Policisë, ndoshta edhe më e dyzuara në përcaktimin e saktë të rolit dhe vlerave që solli, është pa dyshim Polici francez i shekullit 19, Eugen Fransua Vidok. Për çdo studiues, veçanërisht në hetimin e zbulimin e krimit, ai mbetet figura e parë, si detektiv i parë profesionist i policisë dhe më i shquari. Famën e tij si detektiv nuk e ka arritur askush tjetër deri më sot përveç personazheve të librave. Për artin e policisë zbulimit dhe hetimit të krimit, Vidok është themelues, krijues, pjesëmarrës, drejtues, i kudo ndodhur, i kurdoherë ndodhur, i cili del gjithmonë fitues. Për aq sa bëri, punoi e dha për policinë, i mjafton deri sot të jetë i pranishëm. Ai njihet përgjithësisht si një pionier i procedurës moderne të hetimit të krimit, mjekësisë ligjore dhe i një sistemi të tërë të investigimit e evidentimit të krimit e kriminelëve. Nga Vidoku mësuam policia Franceze, R. Peel në Angli, A. Uollmer dhe E. Huver në SHBA etj. Vidok është personi edhe polici më i famshëm mediatik, personazh tregimesh, romanesh, teatros, filmash, një superpolici me fytyrën e Zhan Valzhanit, apo Sherlock Holmsit, detektiv që ka frymëzuar jo vetëm shkrimtarë e artistë por shumë breza dedektivësh policie dhe nuk i përket vetëm Francës.

Fjalëkyçe:

detektiv policie, modus operandi, infiltrim, parandalimi i krimit, polici politike, agjent i fshehtë, detektiv privat, Surrete National.

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Hyrje

Në qytetin verior të Francës, Arras¹, në mbrëmjen e 24 korrikut të vitit 1775 në familjen Vidok erdhi në jetë fëmija i tretë, nga shtatë fëmijë që do bëheshin gjithsej. Ky ishte Eugeni. Si zakonisht, midis urimeve që iu bënë prindërve për djalin nga t' afërmit, më të shumtët u shprehën, të kishte jetë të gjatë, të bëhej një familjar i mirë, punëtor, i shkolluar, të trashëgonte, menaxhonte e të shtonte pasurinë e prindërve të tij. Por që në rininë e hershme Vidoku adoleshent i zhgënjeu të gjithë. I ati, Nikolas Vidok, njeri i arsimuar, tregtar misri e bukëpjekës, nuk kurseu për ta edukuar të birin, me një shkollim të plotë e të mirë, ta vinte në rrugën e mbarë të dijes e punës së ndershme. Por, ai nuk u shqua për shkollë, as si punëtor, ishte dembel. Madje asnjëherë nuk krijoi dot një familje të qëndrueshme e për më tepër, nuk la as pasardhës. Martesat e tij ishin të pafata, lidhjet joformale më pas ishin të shumta, sa për atë pak pasuri në të holla që i kishte mbetur pas vdekjes, u shfaqën në gjykatë rreth njëmbëdhjetë gra, që pretendonin se u takonte t'i trashëgonin. Ai pati të ardhura të mira nga paga² dhe fitime me agjencinë detektive private që themeloi për herë të parë në historinë e policisë. Paratë i shpenzonte shpejt, nuk jetoi në luks, bëri jetë të thjeshtë, aspak të qetë, gjë që natyra e punës si detektiv ia imponoi. Padashur jeta e tij në rini hyri në një rrugë pa krye. Rinia e hershme sidomos, e futi në një labirinth, prej nga do dilte me shumë mundime, pas një kohe kur do të bënte kthesën e madhe.

Shkurt, i riu Vidok i zhgënjeu të gjithë, veçanërisht të atin. Për Vidokun baba, më e

¹ Qendra historike e rajonit Artois, 182 km nga Parisi, qyteti mbrohet nga Unesco.

² Si shef i policisë sekrete paga shkonte deri 5000 fr. në vit. Në Francë përdorej edhe pagesa me privilegje, sidomos pas formimit të policisë së sigurisë nacionale, për agjentët e fshehtë (shih më poshtë f. 10)

Sinjari, S.
« Eugén
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

keqja do të vinte kur i biri do të provonte edhe burgun. Jo vetëm një herë, por aq herë sa do t'i ikte Eugenit rinia e pothuaj dy dekada me hyrje dalje nga burgu. Sa arrestime aq arratisje, kaq të shumta - saqë ato u kthyen në mit dhe ai në personazh. Edhe kur me të vërtetë ishte brenda qelive të burgut në Douai, Bastijë, Baudets, Lille etj., njerëzit nuk besonin që ai do qëndronte gjatë në to; prisnin lajmin në gazeta për arratisjen e radhës. Si një lojë, çdo burg për të riun Vidok pasohej nga një arratisje, e cila i shtohesh si dënim i ri dënimit të parë. Kështu vazhdimisht, njëri pas tjetrit, nuk mund të numërohen saktë dhjetëra dënimet e arratisjet e bëra nga i riu arrakat Vidok, deri ditën që u bë superpolic detektiv³. Pothuajse gjithë jetën, u ndoq nga padi të panumërta, nga dyshime, ndjekje, paragjykitime, nga zhvleftësimi, tortura e stresi. Me etiketën e “njeriut të dënuar” ndiqej njëllonj si Zhan Valzhani, figurë që do krijonte shkrimtari i madh V. Hygo, i frymëzuar prej tij, një personazh tipik, që ndiqej gjithë jetën si ish- i dënuar sepse kishte vjedhur dikur një bukë.

Këto rropatje të gjata për gjëra që mund të jenë sot të diskutueshme, në kufijtë e krimit ose çrregullimit, e lodhën, e munduan, e sfiduan dhe e ndërjegjësuuan në një moment vendimtar të jetës. Erdhi një ditë që jo vetëm do t'i hidhte pas, por u bënë shkak dhe e nxitën për një kthesë të fortë, të papritur, për fillimin e një jete të re, ndryshe. Vidoku polic, do t'i shfaqte publikut anën e mirë të personalitetit të tij, zotësitë e shumta, aftësitë e një polici tej të zakonshmes, të një agjenti policie legjendë, të detektivit për të cilin do të flisnin deri në shekujt e ardhshëm. Ky njeri i padiplomuar në shkollë të lartë, autodidakt, gjithmonë kundërshtar me policinë, i cili deri dje ishte personifikuar si kriminel i pandreqshëm, shumë shpejt do të bëhej i nevojshëm për të gjithë. Delinkuenti i pandreqshëm dhe detektiv i pazëvendësueshëm i policisë më pas, personazhi kontrovers, çuditërisht do rrokte shpejt simpatinë e përkrahjen e publikut, do e kishin zili të gjithë, do bëhej i njohur nga njerëzit e thjeshtë deri te shkrimtarët e mëdhenj, nga shefat e policisë deri te Mbreti Luigj e Perandori Napoleon.

Që në moshë shumë të re binin në sy disa tipare të veçanta. Adoleshenti ishte tip shpërthyes, dembel, trupmadh, i rrëmbyer, shumë i shpejtë dhe i shkathët. I vunë nofkën “*le vaultren*”⁴. Përshkruhet si sypatrembur, i drejtë, i butë, komunikues, shumë i zgjuar, praktik, mosbesues, dinak, me kujtesë fantastike, sidomos të fytyrave të njerëzve, që do ti jepte famë për kapjen e kriminelëve me një të parë. Eugeni kishte disa dhunti të fjetura, që do ti zgjoheshin më pas, kur të pranonte ofertën e policisë dhe t'i përvishesh punës, si zbulues e gjurmues i kriminelëve. Aty do dilte në pah natyra e tij krijuese e novatore për gjithçka, në gjurmimin e zbulimin e krimit, në përdorimin e metodave e mjeteve të reja. Ai do të shkëlqente si organizator e drejtues i talentuar, fantastik për t'ju përshtatur situatave të shumta e të papritura.

Këto dhunti ndoshta të lindura atij i kishin dhënë gjithmonë sukses ndaj policëve që e ndiqnin, të cilëve u fshihej me mjeshhtëri. Edhe kur e kapnin arratisje nga burgu. Madje, ndonjëherë kthehej vet, por pas një kohe dilte jashtë mureve të burgut me gjithfarë mënyrash e metodash, pa ose me ndihmë të organizuar nga jashtë. Herë dilte si “zotni” me “urdhër lirimi” nga autoritetet, me një shkresë “originale” të fabrikuar nga ai vet, herë i maskuar, i veshur si marinar, si roje, si polic apo murgeshë. Dilte nga

Sinjari, S.
« Eugeni
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

62

³ Detektiv-i vjen nga *detekt* i rrënjës *latine* që do të thotë *zbulim* ose *ekspozim*. Dedektiv - një anëtar i forcës së policisë ose një hetues privat, funksioni i të cilit është të sigurojë informacione dhe prova, si shkelje kundër ligjit. Një person, zakonisht një anëtar i një force policore, që heton krimet dhe merr dëshmi ose informacione.

⁴ “*Vaultren*”: *frëngji-vrapues (derr i egër)*. Polici Vautrin, përdoret nga Balzaku në romanet e veta, si kopje e Vidokut.

portat e burgut, që i hapte me çelësa fals të përgatitura po nga ai, me plot rrugë e mënyra të tjera që e bënë person *vip* të dëgjuar e të dëshiruar në publik, gjë që do t'i sillte edhe dëme në t' ardhmen. Këto ngjarje kanë ardhur e mbetur të freskëta deri në ditët tona, janë bërë subjekte tërheqëse romanesh, tregimesh policore, filma serial, komedi e triller, opera e videogame dhe, natyrisht në qendër të tyre, personazhi i mirënjohur e simpatik, Vidok.

Por, nuk ka vetëm një anë biografia e puna e Vidokut. Madje, të gjitha “të këqijat” e tij, çka duhet patjetër t'i përmendim, rezultojnë pa asnjë peshë në raport me ato të mira që ai solli për policinë, sidomos në luftën kundër kriminalitetit. Dhuntitë e jashtëzakonshme që trashëgoi e fitoi nga përvoja e tij si një “delikuent profesionist”, i vuri në dispozicion të policisë. Këto virtyte ishin aq shumë në numër e aq cilësore, sa që vazhdojnë të “peshojnë” në çdo veprim antikrim, që kryen policia deri sot. Është e vështirë për lexuesin e sotëm, pas njëqind e gjashtëdhjetë vjetësh nga ikja e këtij njeriu, të kuptojë e të gjykojë lirshëm, të peshojë e vlerësojë anët e mira dhe ato që mund të mbeten për diskutim, të këtij personazhi kontrovers e të papërsëritshëm në *historinë e mendimit policor*, sidomos për studentët e policisë, kur ta studiojnë atë në një lëndë mësimore të formimit policor.

Në maj të vitit 1857, në një shtëpi të thjeshtë të një rruge të dorës së dytë në Paris, Vidoku tetëdhjetenjëvjeçar u nda nga jeta. Njeriu që kaloi kaq aventura e rreziqe, që dha kaq shumë për policinë e vendin e vet, - i qetë dhe i natyrshëm, mbeti deri në momentin e fundit. Jeta e tij të vë në mendime, të mëson e të frymëzon për vepra të mira. Për skeptikët e pakët të veprës së Vidokut, le të përmendim fjalët e një politikani e shkrimtari të shquar të asaj kohe, Alfons de Lamartin, i cili ka thënë për të: “*Je l'aimais, je l'estimais ... Je ne l'oublierai jamais, et j'i dirai hautement que c'était un honnête homme!*”⁵.

Megjithëse i varfër në pasurinë që la, vepra e tij si drejtues i policisë së sigurisë kombëtare do të ishte pasuria e tij më e madhe. Vidoku vlerësohet jo vetëm si personazh i aventurave të shumta të rinisë së tij, por në radhë të parë sepse solli shumë gjëra të reja për policinë, që kanë vlerë edhe në ditët e sotme. Megjithatë vlerësimi i jetës dhe veprave të tij është disi i koklavitur, i vështirë. Policia i dha atij një emër, si detektiv i madh. Ai ishte krijuar dhe solli risi në krijimin e një policie të re në fushën e zbulimit dhe hetimit të krimit. Prej tij mësuan breza të shumtë specialistësh brenda Francës, por më tepër jashtë saj. Pavarësisht të kaluarës *gri* të rinisë, atij i munguan e nuk iu realizuan shumë gjëra në jetë. Por ngjarjet, faktet, veprimet e tij të mëvonshme, përpos të tjerave, zbuluan edhe një cilësi të veçantë të karakterit të tij, ishte njeri i mirë.

2. “Krimineli” Vidok?!

Franca e fund shekullit të XVIII-të, fillim XIX-të, - atëherë kur jetoi rininë e vet Eugen Fransua Vidok, - ishte duke shkruar librin e saj historik në kontinent e më tej. Brenda një kohe të shkurtër që nga rënia e Bastijes, në vitin 1789, rrodhën ngjarje historike të pashembullta në histori. Ngjarje kulmore ishin: Revolucioni Francez,⁶ që

⁵ Alphonse de Lamartine, (1790-1869), shkrimtar dhe politikan i qeverisë kalimtare në Francë, i Republikës së Dytë: “*E kam dashur atë, e vlerësova atë, nuk do ta harroj kurrë, dhe unë do të them me zë të lartë se ai ishte një njeri i ndershëm!*”

⁶ Revolucioni Francez (14 korrik 1789 - 1799) ishte një periudhë e përgjakshme që përfshiu të gjithë Francën për arsye kryesisht sociale dhe politike. Kjo shënoi fundin e monarkisë në Francë dhe ardhjen e një rendi që tronditi të gjithë Evropën. Megjithatë u deshën edhe disa revolucione të tjerë (1830,1848) që kapitalizmi të konsolidohej.

Sinjari, S.
« Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

arriti të përmbysë dinastinë shekullore të Burbonëve dhe ekzekutimi në gijotinë⁷ i mbretit, Luigjit të XVI-të, bashkë me mbretëreshën Maria Antuanetë. Vendosja e Republikës së Parë⁸ u pasua me një periudhë terrori, kaosi, varfërie e turbullirash sociale. Kudo, sidomos në Paris, lulëzonte vjedhja, grabitja e krimi i çfarëdolloj. Me ardhjen e Napolon Bonapartit si perandor, filloi një luftë e gjatë pushtuese, në gjithë kontinentin, që do të përfundonte me disfatë në Vaterló. Franca, ndryshe nga fqinji i vet ishullor Anglia, vendosjen e konsolidimin e kapitalizmit po e jetonte me ndryshime të thella sociale, me tronditje të mëdha e të stërgjata në kohë. Mund të themi, se Franca në ato njëqind vjet po shkruante jo vetëm historinë e saj, por historinë e gjithë Europës e më gjerë. Kjo klimë e shoqëroi Vidokun në adoleshencë dhe në rini. Si moshatarët e kohës, djem të rinj, edhe ai e kishte shpirtin plot aventura e plane, që kërkonin kohë, mund dhe shumë pará.

Mbas një edukimi në manastirin françeskan, si adoleshent i lindi dëshira për tu bërë shpatar dhe filloi stërvitje skërme. Ndoshta fantazonte të bëhej një tip kalorësi apo luftëtari trim, që mund ta ndante të drejtën me duel, sepse bëri shumë duela gjatë rinisë së tij. Eugeni trupmadh, fizikisht i fuqishëm e i guximshëm, ishte plot besim në vetvete. Si shumë të tjerë, bënte plane për të emigruar në Amerikë, por kishte edhe mendimin të merrej me biznes.

Me këto tundime në kokë për t'u pasuruar shpejt e pa shumë mundime, u zhyt lehtë në ujërat e turbullta të mjedisit të kohës. Mbasí ndoqi një kurs stërvitor skërme, në saje të fizikut e shkathtësisë u bë me të vërtetë shpatar i mirë dhe filloi t'i pëlqenin situatat e kaosit, e pse mos t'i shfrytëzonte ato. Me sfidat e duelit, me shpatë apo me armë zjarri, rrezikonte, por mund të nxirrte ndonjë fitim të vogël, kur kundërshtari tërhiqej nga frika; me ndonjë falsifikim, por jo me pasoja, bënte ca pará; pak fitime i bënte nëpërmjet ndonjë tregtie, ndonjë shërbimi, por asnjëherë nuk i menaxhonte mirë paratë; më shpejt i shpenzonte se i fitonte.

Fatkeqësisht kjo jetë adoleshente disi jashtë kontrollit, siç ishin të shturur rendi e shoqëria franceze, për Vidokun e ri i hapi shpejt dyert e burgut, dyer që do të qëndronin mjaft kohë krahëhapur për të e do t'i bëheshin si të shtëpisë. Kur ishte vetëm trembëdhjetë vjeç provoi dy javë burg, për vjedhjen e disa sendeve me vlerë në shtëpinë e vet (me ndërhyrjen e të atit për t'i dhënë një mësim). Një vit më vonë, mbasi vuri dorë përsëri në arkën e bukëpjekësit, u largua nga shtëpia me mendje të mbledhur të emigronte në Amerikë. Por të nesërmen, i mashtruar nga mjeshtër të tjerë më të zotë se ai, pa një dyshkë në xhep, u detyrua të kthehej në familje e të kërkonte të falur.

Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç regjistrohet në regjimentin Burbon dhe nisat në luftë⁹. Merr pjesë në disa beteja, edhe në betejën e famshme të Valmës⁹, por fati përsëri nuk ishte me të. Herë pas here, për gjëra të vogla, grindje, xhelozji, mosmarrëveshje, ngrinte krye uni i tij, për të vendosur drejtësi me forcë, siç gjykonte ai në shumicën e rasteve, karakteristike për këto grupmosha edhe në ditët e sotme. Në librin e vet me

⁷ Filozofi Zhak Derida ia atribuon shpikjen e gijotinės mjekut Zhozef Injac Gijotin, i cili vetë mezi shpëtoi nga kjo vegël, gjatë terrorit të 1794. Paisja u përdor për herë të parë gjatë revolucionit. Gijotini në fakt, kundërshtoi dënimin me vdekje, mbrojti ekzekutimin pa dhimbje me një makineri për prerjen e kokës, si hap i parë në rrugën drejt heqjes së plotë të dënimt me vdekje. Gijotina ishte më aktive gjatë "Mbretërimit të Terrorit", në verën e vitit 1794, kur në një muaj u ekzekutuan më se 1300 njerëz, në dy vjet-16000. Mbeti në përdorim në Francë, deri në vitin 1977.

⁸ Në Francë, Republika është shpallur pesë herë, në 1793, 1848, 1881, 1940, 1958.

⁹ Lufë midis Francës e Austrisë që u shpall prej Francës në 1792. Konsiderohet aventurë, thjesht për të treguar forcën e Francës në Europë pas Revolucionit, luftë e kotë. Beteja e Valmës shënoi kthesë për Francën, por pa fryte.

kujtime¹⁰ tregon mjaft ngjarje të kësaj periudhe. Për vetëm gjashtëmbëdhjetë muaj, sfidoi në duela mbi pesëmbëdhjetë njerëz, për sherre banale apo për reputacion siç shprehet në “*Memories*” e tij. Në një rast, me një oficer më të lartë, kur ky nuk ia pranoi duelin, Eugeni i prekur e ofendoi dhe e goditi atë. Kjo ngjarje në ushtri rrezikonte dënim me vdekje. Por, nga mosha e falën. Bëri dy javë burg dhe u arratis. Duke ikur mori me vete dhe shpëtoi edhe një të burgosur tjetër dhe u largua nga ushtria. Nga kjo ndodhi rrodhën të tjera ikje, deri sa iu ngjit akuza e dezertorit që mezi do t’i shqitej për shumë vjet.

Ndoshta dezertimi ishte “shkaku i parë”, ai shkak i shkaqeve, që do pasonte me akuza të shumta që s’do t’i ndaheshin për një kohë të gjatë. Filloi të ndiqej nga policia, të dënohej e ridënohej. Iu desh të fshihej për dekada, të maskohej, të përdorte emra të rremë, të arratisesh, të mashtronte për të jetuar, të merrte damkën e “kriminelit” të pandreqshëm. Kjo ishte “shkolla” e parë e Vidokut: maskimi nga ndjekjet e policisë, mashtrimi e falsifikimi, gjithmonë i dyshuar për vepra të këtij lloji, që klasifikohen si krime të lehta. Këto nuk iu ndanë edhe pas ikjes përfundimtare nga ushtria. Prandaj, thoshte shpesh se: *nuk i krijoi unë, problemet më gjejnë mua*¹⁰.

Deri nga fundi i shek. XVIII-të ai kishte një bilanc negativ në gjithçka. Duetet për shkaqe banale i shtuan edhe një tjetër vit burg. Edukimin e arsimimin e kishte ende të pjesshëm – më tepër autodidakt. Pasuri s’kishte vënë, familje s’kishte, bëri një martesë të dështuar, që u mbyll me divorc në 1805, e cila do pasohej me dy të tjera por të pafata¹¹. “Punë” për të u bënë aventurat e përditshme. Fama e tij ishte e madhe, por si aventurier, me sjellje negative e penalitete në polici, me kartelë për dezertim nga ushtria, sidomos për arratisjet nga burgu, që ishin bërë të shumta. Jetonte i fshehur, ndiqej, shpëtonte në saj të ndryshimeve të emrit e dokumenteve, maskimit fantastik që e bënte “të padukshëm”, aftësive të jashtëzakonshme për t’u arratisur nga burgu. Mediet e shkruara po e bënë personazh interesant, mjaft tërheqës, që u shtonte tirazhet e shitjeve të librave e gazetave.

Dalëngadalë e kaluara filloi të bëhej e keqja më e madhe për të. Zinxhiri i shkeljeve e dënimeve penale, kalvari i gjatë i vuajtjeve të mundimshme, të lindura e të ushqyera në shekuj edhe nga mentaliteti arkaik mesjetar i kohës, ishin si një hije që të ndiqte kudo. Ishte koha e sundimit të paragjyqimeve sipas motos: “Nëse ke qenë në burg, qoftë edhe disa ditë, qoftë edhe për asgjë, ishe fajtor sepse ke qenë i dënuar”. Për një grindje, do të shpalleshe ti fajtor, sepse je ish- i dënuar; për një krim, je ti i dyshuari i parë, sepse ke qenë i dënuar. Policia e “*Ancient Regime*”¹² i ndiqte, i persekutonte dhe i mundonte për çdo ngjarje, këtë kategori njerëzish. Ish i dënuari me burg, për të tjerët jetonte vetëm me të kaluarën e tij, ai nuk vlerësohej për të tashmen dhe nuk kishte as të ardhme. Ishte një ligj i pashkruar i kohës.

Në mënyrën më të arrirë artistike, shkrimtari i madh Viktor Hygo, bën sarkazëm me dënimin me burg, përmes një simboli të vetëm: “Vula” e Zhan Valzhanit¹³, figurë kjo, e frymëzuar nga Vidoku. Njeriu që do bëhej i famshëm në fushën e metodave e mënyrave të gjurmimit, zbulimit dhe hetimit të krimit, ishte krejtësisht pa mbrojtje në këtë situatë, e s’mund të merrte dot frymë. Kishte sfiduar me dhjetëra njerëz në duela,

¹⁰ Vidok botoi libra me kujtime, “*Memories*” të shkruar nga shkrimtarë anonim, me pagesë prej tij.

¹¹ Dy herë të tjera që u martua dhe i vdiqën gratë, pas 1836 mbante lidhje por nuk u martua më.

¹² “Regjimi i Vjetër”- kështu quhej monarkia në Francë.

¹³ Libri i famshëm “*Të Mjerët*”-1862, me personazhin kryesor Zhan Valzhanin, që u dënua se vodhi një bukë. Të dënuarve u vinin me djegie një vulë të veçantë në shpatull, që mbetej për gjithë jetën.

Sinjari, S.
« Eugén
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

madje kishte vrarë në to dy. Por, në gjykimin e kohës dueli ishte “*de-facto*” diçka e padënueshme, një akt që konsiderohej si gjest fisnik, kalorësiak, si zgjidhje e së drejtës, ku mund të vritej edhe ai vet.¹⁴ Eugeni kishte falsifikuar e mashtruar, por edhe atë e kishin rrjepur kur do ikte në mërgim me paratë e prindërve. Asnjëherë nuk rezultoi të kishte kryer krime përtej caktuar “të lehtë”. Në atë periudhë në Francë jeta e njeriut vlente më pak se kurrë. Epoka revolucionare me kaosin e vet do të përpinte rreth dyzet mijë jetë njerëzish, të ekzekutuar në sheshin e Revolucionit, në qendër të Parisit. Ai, “krimineli” Vidok, nuk vrau asnjë njeri për ndonjë qëllim kriminal. Nuk grabiti, as vodhi. Në një rast arratisje të tij nga burgu, Vidoku mori vesh se rojën e kishin dënuar, e për këtë u kthye dhe u dorëzua vullnetarisht në burg, vetëm për të dëshmuar se roja nuk kishte gisht dhe e shfajësoi atë. Arratisjet iu imponuan nga padrejtësitë, keqtrajtimi dhe egërsia prej torturave çnjerëzore që përdorshin nëpër burgje, pavarësisht se çfarë krimi kishte kryer ose jo i burgosuri¹⁵. Ai nuk mund të quhej kriminel, as në natyrën e tij si njeri. Ai kurrë nuk u mor me të varfrit e as nuk u ra në qafë njerëzve të thjeshtë. Edhe kur u bë shefi i Departamentit të Policisë Kriminale, ai kurrë nuk informoi për këdo që kishte vjedhur për nevoja reale. Mori pjesë në një luftë që edhe historia e ka quajtur aventurë të qeverisë, por vazhdoi të mbante mbi supë ende fajin e dezertorit dhe kërkohet nga policia, edhe pse kishte luftuar për Francën në disa betejat të mëdha. Do ta akuzonin pa të drejtë për bashkëpunim në falsifikim dhe përsëri do e dënonin... por, prej këtej do niste një faqe e re në jetën e Eugen Fransua Vidokut.

3. Polici detektiv Vidok

Kthesa e Vidokut nis në dekadën e parë të shekullit XIX-të, pas vitit 1809. Shkak u bë një nga dhjetëra ngjarjet e tij, të cilat janë bërë subjekte tërheqës në romanet policore. Ngjarja zë fill në vitin 1795, pas një shërri me një ushtar me të cilin e tradhtonte Francinë, e dashura e tij. U dënua me tre muaj në burgun *Tour Saint-Pierre* në Lille. Aty, një vjedhësi të njohur, Sebastian Boitel i dënuar me gjashtë vjet, papritur i vjen urdhri i mbarimit të dënimit. Mirëpo të nesërmen, drejtori i burgut konstatoi se shkresa e liritimit ishte fals. Dyshimet për falsifikimin e shkresës ranë mbi Vidokun. Ai njihej për këtë aftësi, por edhe dy të burgosur e akuzonin. Sipas Vidokut, i cili kurrë nuk e pranoi këtë akuzë¹⁶, këtë e kishin bërë dy të burgosurit, Grouard dhe Herbaux, të cilët kishin përdorur qelinë e tij për këtë punë, por ata ia hidhnin atij fajin, si autor e ideator i falsifikimit. Ai i kishte ata shokë burgu, asgjë tjetër. Sidomos Cesar Herbaux, një kriminel i rrezikshëm, po e akuzonte Vidokun më fort, pa të drejtë. Në përfundim, Vidokun nuk e liruan pas tre muajsh, kur i takonte. E lanë në pritje të gjatë deri në dënimin tjetër, deri kur të fillonte gjyqi ndaj tij për këtë akuzë, për falsifikim dokumentesh. Mbase kjo ngjarje e ky presion, mund të ishte i qëllimshëm nga policia, presion për të pranuar “ofertën”, një marrëveshje bashkëpunimi, por le të ndjekim rrjedhën e ngjarjeve më pas.

U dënua pa të drejtë tetë vjet, vetëm nga dëshmitë e dy të burgosurve. E çuan në burgun e Brestit. Por edhe nga Brestit u arratis i veshur si marinar dhe me identitetin August Duval filloi të merrej me punë, kryesisht me biznes të vogël. Lëvizte nëpër qytete si Paris, Arras, Bruksel, Ancer. U kap dhe prapë u arratis nga spitali, i veshur si

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

¹⁴ Në duel kanë humber jetën njerëz të shquar, si në 1837, A. Pushkin-poet i famshëm, për xhelozie me gruan; E. Galua - matematicien i madh, në1832, për pikëpamje politike, si republikan.

¹⁵ Këto i shkruan në “*Memories*”, si edhe një libër për burgjet e trajtimin e të burgosurve.

murgeshë. E kapën dhe e çuan në Douai ku e identifikuan si Vidok, dhe përsëri, në 1805 bëri arratisjen e radhës, nga dritarja e burgut të Luvrit. Aty mori vesh se rrezikonte dënim kapital, prandaj për katër vite bëri një jetë rutinë, krejtësisht të mbyllur, gjithmonë duke u maskuar dhe me emra të rremë.

Në vitin 1809 filloi kthesa e bashkëpunimit me policinë, që lidhej me akuzat ndaj kriminelit të rrezikshëm Herbaux. Dha indirekt dëshmi të shumta që ndihmuan në ekzekutimin e Herbaux. Kjo gjë e përmirësoi imazhin e tij në polici, por ende e rëndonin disa akuza. Pasi një ditë u njoh prej ish-gruas së divorcuar dhe u denoncua, e arrestuan përsëri. Si gjithmonë, u dënua për dezertim, arratisje nga burgu dhe falsifikim. Por, tashmë kishte vendosur të pranonte e të bashkëpunonte me policinë. Hapi i parë ishte hedhur që me dëshmitë e dhëna kundër Herbaux. Oferta e tij apo e policisë, u pranua e u nënshkrua nga shefi i policisë, Zhan Henri. Si hap i parë u dërgua në burgun “*La Force*” në Bisetre, si i burgosur. Aty u sajua një “arratisje”, në mënyrë që ta bënin më të besueshëm figurën e tij midis kriminelëve të dënuar. Tani Vidok filloi të punojë, u bë informator i fshehtë i policisë. Askush, jashtë apo në burg nuk e dinte misionin e tij. Informacionet ia dërgonte shef Henri, nëpërmjet një femre informatore, me emrin Anetë, të cilën Vidok e përmend vet në kujtimet e tij. Ai i la pas aventurat dhe iu përkushtua me zell punës së re në polici. Tashmë, Eugen Vidok ishte punonjës detektiv.

Menjëherë puna e tij filloi të jepte fryte. Ai ishte i adhuruar nga të gjithë. Nga kriminelët respektohej si i fortë dhe i zoti, por nderohej edhe nga policët e vërtetë, që e admironin këtë njeri për zotësitë e tij. Ai i përdori cilësitë personale për tu infiltruar në skutat më të errëta të krimit, në katakombet ku planifikoheshin krimet, vjedhjet, grabitjet e vrasjet më të mëdha të Parisit. Ai filloi të siguronte informacionet e nevojshme edhe për krimet e kryera prej kohësh, autorët e të cilëve nuk ishin zbuluar dot nga policia. Vidoku, për tu bërë i besueshëm, shumë herë “merrte pjesë” vet në teatrin e krimit. Dyshimet e mundshme i maskonte me mjeshtëri, sepse dinte të ndërronte pamjen, ecjen, sjelljen, zërin e gjithçka duhej.

Pas afër dy viteve pune, si agjent i Zhan Henri, ai fitoi shumë respekt e mirënjohje nga ata punonjës policie që e dinin se arritjet erdhën në sajë të punës së tij. Natyrisht do të kishte edhe zëra jomiqësorë¹⁷, kritikë e ziliqarë, që shihnin tek ai “delinkuentin e pandreqshëm”, njeriun me të shkuar të keqe të pashlyeshme, si i dënuar me burg. Numri i tyre do të binte në disa individë, kur ai do dilte nga “ilegaliteti” në vitin 1811, kur për herë të parë do të formonte e drejtonte vet një forcë krejt të re policore, “*Brigade de la Sureté*”¹⁸, në Paris. Pas një viti kjo forcë u njoh zyrtarisht më vete dhe u formalizua si njësi e veçantë nën Prefekturën e Policisë së Parisit. Vidoku ishte ai që kishte krijuar këtë forcë speciale policore të zbulimit dhe hetimit të krimit dhe e vendosën në krye të saj. Në vitin 1813, duke parë rezultatet e jashtëzakonshme, vet perandori, Napolon Bonaparti, nënshkroi dekretin e shndërrimit të saj në “*La Sûreté National*”¹². Pra, në këtë vit u shënua lindja e një force të re policore për sigurinë kombëtare; e veçantë, e destinuar për krimin, për gjithë Francën, pavarësisht se funksionoi realisht si mbarëkombëtare pas shumë kohe¹⁹.

¹⁶ Për këtë akuzë shkruajti në “*Memory*” e tij dhe në librat që botoi.

¹⁷ Kundërshtari më i madh i Vidok-ut mbeti deri në fund, një nga krerët i policisë së Parisit, Mark Duplè. Po ashtu, nuk iu nda për një kohë të gjatë ish drejtori i burgut të Doyait.

¹⁸ Sûreté (frëngjisht: [sy • te], “siguri”, por zakonisht si një term i përdorur në vendet franceze ose rajonet, në titullin organizativ të një forme të policisë civile “Brigada e Sigurisë”, një njësi e veçantë, civile e policisë sekrete në Francë, e barasvlershme me Departamentet e Policisë në Angli, SHBA. “Sûreté Nacional”, ishte baras me “Scotland Yard” ose me Policinë Metropolitane në Angli.

¹⁹ Prill 1941, Sûreté u emërtua “Policia Kombëtare” për qytetet e mëdha, përjashtuar Prefektura Policisë Parisit.

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Në krye të saj sigurisht udhëheqja iu besua atij që e krijoi, Eugen Fransua Vidok-ut. Për lexuesin rikujtojmë se në Francë, në kohën e Revolucionit, policia ishte një forcë e krijuar prej më se dy shekujsh. Madje, Franca ishte e avancuar në kontinent krahasuar edhe me Anglinë. Në kohën e fundit të monarkisë, policia franceze ishte e organizuar në dy forca kryesore kombëtare. E para ishte Policia Politike, forca më e madhe dhe më e rëndësishme në vend. Si “Polici Royale”, kishte pasur detyra të një organizate sigurie, me mision që të zbulonte intrigat politike, të mbronte mbretin nga rreziqet. Pra, ishte një polici me atributet e ruajtjes së monarkut dhe sistemit politik monarkist. Nga ana tjetër, policia normale dhe xhandarmëria, ishin forca të ngarkuara kryesisht për zgjidhjen e çështjeve civile, për ruajtjen e rendit e qetësisë, arrestimet e kriminelëve, zbulimin e vjedhjeve, vrasjeve etj²⁰.

Pra, *Sûreté* që krijoi dhe filloi ta drejtonte Vidoku, zinte vend të veçantë ndër forcat policore, ishte një forcë e re, e drejtuar të zbulonte, gjurmonte e godiste krimin e kriminelët e çdo lloji. Sigurisht që, si polici më vete, ajo kishte status e detyra të veçanta, mbahej me trajtim e rroga nga shteti, ishte e organizuar, pra, ishte një hap drejt policisë profesioniste. Risia që sillte krijimi i kësaj njësie policore të sigurisë, ishte se ajo tashmë vepronte si një degë e ndarë e policisë, e modeluar të punonte duke luftuar krimin në fshehtësi. Në fakt, pothuaj gjithë natyra e punës së policisë bazohet në punën e fshehtë, por kjo jo si në *suretë*-n e krijuar nga Vidok. Që prej fillimit, anëtarët e saj të hershëm punonin si agjentë të fshehtë të kësaj policie. Anëtarët e kësaj force nuk vishnin uniformë. Ata dhe puna e tyre mbaheshin krejtësisht të mbyllura nga sytë e publikut. Ishte krijuar bindja prej të gjithëve se metodat e zakonshme të punës së policisë nuk ishin efektive pa punën në fshehtësi.

Deri në kohën kur u dekretua *Sûreté*, gjithë informacionet që mblidhte Vidoku, shkonin tek shef Henri, kreu i Policisë në Paris. Kjo polici godiste bandat e kriminelët në saje të informacioneve që jepte Vidoku. Si agjent i fshehtë i infiltruar në bandat e kriminelëve, meritat e Vidokut nuk mund të dekonspiroheshin e të bëheshin publike. Edhe pse kthesa e policisë së Parisit u bë e dukshme, për Vidokun në hije nuk kishte merita e lëvdata, madje i mbetej ende njolla e dezertorit dhe e ish-të dënuarit. Çlirimi i plotë nga “robëria” i erdhi sapo filloi të punojë në krye të njësisë së pavarur, sidomos pas dekretimit dhe njohjes “*de jure*” të saj. Ajo u shndërrua nga një departament i policisë kriminale *Suretë* e Parisit, në polici të sigurisë kombëtare të Francës, që u quajt prej atëherë: “*Le Suretè National*”.

Pas këtij ndryshimi të strukturës së Policisë në Prefekturën e Parisit, departamenti i sigurisë kombëtare mori status ligjor të veçantë, detyrë funksionale si njësi policore e fshehtë që të mblidhte informacione, të gjurmonte, të hetonte, të çonte në arrest e në gjykatë kriminelët, për llogari të vet. Drejtuesi i saj, Eugen Vidok ishte vetë, në radhë të parë, një agjent i fshehtë. Nga të gjithë studiuesit e HMP²¹ është pranuar *Suretè National*, si organizatë pioniere midis gjithë organizatave që luftojnë krimin në botë. Kjo meritë i takon Vidokut. Prandaj detektivi i madh E. F. Vidok, meriton natyrshëm që të quhet *pionier i policisë moderne*.

²⁰ A. Heywood: Politika, 2nd edition, Tiranë 2008. F.416. Shumica e shteteve i kanë të kontrolluara forcat policore ku Franca është shëmbull klasik i këtij modeli. Policia Kombëtare nga MB dhe xhandarmëria nga MM.

²¹ Historia e Mendimit Policor - lëndë në shkollat e larta policore.

4. Vidok, shefi i *Sûretè National*

Shefi i forcës së sigurisë së Prefekturës së Policisë së Parisit tashmë drejtor i Policisë së Fshehtë Nacionale, që vazhdoi të quhej *Sûretè*, mori përsipër një përgjegjësi të madhe. Këtë post s'kishte kush ta bënte më mirë se ai. Ata që i besuan²², midis tyre edhe vet Napolon Bonaparti, ia dinin, i provuan vlerat e këtij njeriu, të cilin publiku e kishte njohur vetëm për bëmat e së kaluarës me policinë. Shpejt, Vidok do të bëhej i njohur jo vetëm për to. Do të konsiderohej si detektivi më i madh në histori, gjurmues i zoti, babai i kriminalistikës, mjeshër i maskimit, hetues profesionist, deri si mbret i policisë. Këtej e tutje ai do të vlerësohej e respektohej edhe jashtë Francës, në dy kontinentet. I meritoi me sukseset e veta në polici. Fillimisht, Vidoku iu përvesh punës për organizimin e kësaj force. Natyrisht me përzgjedhjen e njerëzve më të përshtatshëm që mund të punonin në *Sûretè National*. Krejt ndryshe nga tradita rutinë e këtij procesi, Vidoku ndoqi instinktin e tij. Ai mblodhi dhe zgjodhi kryesisht persona me të kaluar kriminale. Parimi "hajduti mund të kapë hajdutin" njihej në atë kohë dhe i përshtatej situatës kaotike, sidomos Francës së drobitur nga përmbysjet e njëpasnjëshme.

Duke zgjedhur agjentë prej ish- të dënuarve, ai përfitonte më shumë nga përvoja e tyre, nga mënyrat e metodat që përdornin e vepronin. Për më tepër, ai merrte informacione të sigurta për kriminelët e rrezikshëm. Kur kapte ndonjë autor krimi, ai përdorte teknika të veçanta në të pyeturin e të arrestuarit, sipas një plani të hartuar më parë, për mënyrat e formulimit të pyetjeve dhe objektivin që kërkonte të arrinte. Ai darkonte me ta, flisnin për ngjarjet dhe në përfundim arrinte të njihte secilin prej tyre. Prej kësaj mënyre të re të së pyeturit, mësohej për autorët e ngjarjeve të pazbuluara, për bashkëpunëtorët e kriminelëve dhe format e punës së tyre. Nga bisedat e afrimi me këta të arrestuar ose të dënuar, Vidoku zbulonte edhe njerëzit e aftë për punë në *Sûretè*, të cilët i rekrutonte dhe i bënte agjentë të fshehtë. Madje, ai filloi të rekrutojë dhe punësojë në përbërje të organizatës edhe gra.

Duhet pasur parasysh se prej lloj-lloj shkaqesh, kriminaliteti ishte mjaft i përhapur në shoqërinë franceze. Varfëria, luhatjet politike, luftërat e kota, shpenzimet qeveritare, korrupsioni, e mbanin ngrohtë krimin prej një periudhe kohe goxhà të gjatë. Ishte bërë e vështirë të dalloje njeriun e pastër nga ai kriminel. Kriminelë quheshin edhe ata që kishin luftuar përkrah mbretit, edhe republikanët që kishin përkrahur revolucionarin Robespier²³, i cili përfundoi vet në karamanjollë. Po ashtu edhe ata që luftuan me Napolonin ose kundër tij. Me mijëra vriteshin në duela edhe për konflikte banale politike. Zigzaget e historisë e ndoqën Francën për dyqind vjet, derisa u konsolidua republika, në të pestën herë.

Në këtë situatë, të cilën përkohësisht e kthjelloi regjimi i Napolonit²⁴, ishte e kotë të ndiqej modeli i vjetër i goditjes së krimit. Vidoku e kuptoi i pari, se infiltrimi i shpejtë në radhët e kriminelëve me agjentët e *Sûretè-s*, ishte mënyra më efikase për rezultate pozitive. Prandaj njerëzit më të përshtatshëm e të besueshëm, ishin pikërisht agjentët që rridhnin nga ky kontingjent i ish- të dënuarve, nga ku filloi rekrutimin Vidoku. Këtu

Sinjari, S.
« Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

²² Me siguri propozim i Ministrit të Brendshëm, Zhozef Fushë.

²³ M. Robespier (1758 -1894). Drejtoi "Regjimin e terrorit" nga qershor 1793 deri korrik 1794, kur e ekzekutuan.

²⁴ Regjimi i Napoleonit u vendos me forcë ushtarake por i dha Francës qetësi të përkohëshme, administrim të pushtetit në qarqe me prefekturat, organizim të policisë. Edhe pse regjim ushtarak, populli francez e përkrahu në luftë, se në plan të parë dilte uniteti i kombit.

qëndronte një tjetër çelës i sukseseve të para të tij. Ai vet, si ish- i dënuar apo agjent policie, prej kohësh maskohej si tjetër person. Tashmë filloi të bënte këtë trajnim edhe për agjentët të policisë së fshehtë. Ai filloi të jepte nga vetja atë çka dinte, gjithçka që e kishte mësuar nga jeta. Kjo lloj marrëdhënie e ky komunikim me vartësit, ia rriti respektin e reputacionin si drejtues policie dhe filloi ndryshimi pozitiv i perceptimit publik rreth figurës së tij dhe *Sûretë-s* që drejtonte.

Të gjitha këto iu kthyen në rezultate. Krimet u ulën në masën dyzet përqind. Me një ekip që në kohën e vet nuk i kaloi asnjëherë tridhjetë vetë, prej të cilëve vetëm tetë agjentë të fshehtë, nën varësinë e Prefekturës së Policisë së Parisit, ai u siguroi parisienëve një jetë më të qetë e më të sigurt. Ai i njihnte mirë njerëzit e botës së krimit. Dinte të dallonte edhe ata që mund të ndryshonin kurs e që mund t'u besohej. Nga ky kontingjent në përbërje të *Sûretë-s*, u stërvitën dhe u trajnuan prej tij agjentë të zotë, që lanë gjurmë si detektivë, ekspertë kriminalistë të njohur, u bënë nxënës e pasues të zotë të mësuesit të tyre, Vidok.

Edhe problemi i trajtimit të punonjësve dhe agjentëve të *Sûretë-s* u bë në rrugë mjaft origjinale nga drejtuesi i tyre. Punonjësit merrnin paga, kurse agjentëve të fshehtë nuk u jepej rrogë, por privilegje, si p.sh. licenca lojërash fati e lokalesh, punësim në pika që tërhiqnin shumë njerëz, aty ku mblidhej më tepër informacion mbi botën e krimit. Këta, pjesa më e madhe ish- të dënuar, u përkushtuan në punën e tyre, sepse jeta e tyre nuk vlerësohej një grosh nga ligji e shoqëria. Vidoku përmend në kujtime, se qindra nga ata ekzekutoheshin çdo ditë me një urdhër të një prifti me autoritet gjyqësor. Shpëtimi i jetës dhe puna, ishin shpërblimi më i madh që atyre u jepej. Ishin të kalitur me vuajtje, prandaj ishin më të angazhuar ndaj punës dhe sakrificave. Ish- të dënuarit e punësuar nga Vidoku, merrnin përsipër detyrat më të rrezikshme e punët më të vështira. Ata ndihmonin policinë në arrestimet e ruajtjen e kriminelëve më të regjur, kryenin përgjimet e ndjekjet e të dyshuarve, përballonin pa ngurrim punët në dimër e në turnet e natës, pranonin të infiltronin të maskuar në çerdhet e krimit etj. Ata, më mirë se cilido, kryenin këto punë me përkushtim e pa marrë parasysh rrezikun.

Orari i punës së anëtarëve të *sûretë-s* ishte pa kufi. Punonjësit dhe agjentët në çdo kohë duhej të ishin gati e në lëvizje. Vetë shefi i tyre nuk rrinte në zyrë, dilte për të kryer të njëjtat punë si vartësit e vet. Trajtimi nuk ishte për tu pasur zili. Paguesa ishte diçka normale, por kompensohej. Vidoku, megjithëse me pagë vjetore pesë mijë franga, merrte për zgjidhje edhe çështje private, ku punësonte edhe njerëzit e vet. Pas çdo hap krijimi e suksesi të *sûretë-s* të Vidokut, kishte rol dhe pjesë mbështetja e sinqertë, përkrahja e pakufishme e eprorëve të policisë të Prefekturës së Parisit, deri tek njerëzit e mëdhenj të politikës të çdo krahu. Kjo u vërtetua, kur ndërroheshin qeveritë e kahet politike. Vidoku me "*Sûretë-n*" vazhdoi normalisht për një kohë të gjatë punën e zakonshme. Në vitin 1833, ai hapi një agjenci private detektive²⁵, e para e këtij lloji në historinë e policisë. Kjo ishte një tjetër medalje për E. F. Vidok, i cili konsiderohet detektivi i parë privat në histori.

5. Detektivi më i suksesshëm në histori

Mënyra origjinale se si e organizoi Vidoku *Sûretë-n* e punën brenda saj ra në sy

²⁵ "Le Bureau des Renseignements Universales pour le commerce et l'industrie" - ("Zyra e Informacionit Universal të Tregtisë dhe Industrisë ")

menjëherë, sepse erdhën ndryshime të dukshme brenda një kohe të shkurtër. Ndryshe nga policia e vjetër, punonjësit e *Sûretè*-s dhe agjentët e saj të fshehtë ishin të shpërndarë dhe mbulonin pjesën më të madhe të lagjeve të Parisit. Komunikimi midis tyre, marrja e detyrave, mbartja e informacionit dhe urdhrave, u përcaktuan në mënyrë të re, krejt ndryshe nga rutina e punës së policisë së deriatëhershme. Secili e kishte të qartë detyrën e vet. Informacioni vinte prej ngado, ishte i sigurt, se vinte nga vendi ku “gatuheshin” planet e kimit, grumbullohej, përpunohej dhe mbi bazën e një plani të detajuar veprohej. Urdhrrat ishin të qarta e të prera. Gjithçka kryhej në fshehtësi, sipas një kodi, rregulli dhe me profesionalizëm.

Sûretè Nacional, funksiononte jo si një polici kobureje apo dajaku, ashtu siç konsiderohej prej kohe policia apo puna e policit. Ai e shndërroi atë në një profesion, që në plan të parë vinte fshehtësinë dhe punën inteligjente. Pra, punën e policit të *Sûretè*-s, nuk mund ta bënte kushdo, pa marrë e pa pasur disa aftësi, shprehë dhe trajnim paraprak. Më sipër theksuam se, puna e policisë ka natyrë të fshehtë, sidomos kur kryen operacionet e veta, të paktën deri në përfundim. Por, *Sûretè Nacional* e Vidokut kishte edhe diçka tjetër: jo vetëm që mbështetej tërësisht në informacionet e fshehta për zbulimin e kimit, por ishte së pari një punë inteligjente, ku forca dhe armët dilnin në plan të dytë.

Që në krijim ky shërbim i ri, gjeti vendin e veçantë në strukturën e policisë franceze. Kjo polici e re u duk sikur i kishte munguar deri atëherë policisë së Parisit dhe Francës. *Sûretè* zuri vendin e vet si njësi policore, krejt në harmoni me policinë e tjera. Kryesisht, Vidokut i përkiste merita e këtyre ndryshimeve dhe risive që solli. Edhe më skeptikët e ndryshimeve e kuptuan dhe u detyruan të pranonin nevojën e një policie të tillë, të krijuar posaçërisht për mposhtjen e kimit, gjë që u vërtetua nga sukseset mbresëlënëse të saj dhe rolin vendimtar të Vidokut në të. U thye një mentalitet i vjetër për punën e misionin e policisë. Është e pranueshme e vërteta se profesioni i policisë, kudo e kurdoherë, ka qenë një profesion me status të ulët e me paga të ulëta²⁶. Lexuesi duhet të dijë se, në mentalitetin e përgjithshëm, ka sunduar për kohë të gjatë mendimi se nuk duhet ndonjë shkollë a trajnim për të përdorur një shkop. Prandaj, rekrutët e policisë, në Francë, Angli e kudo, zgjidheshin nga ish-ushtarakë ose ish- të dënuar²⁷. Ky rregull vazhdoi deri në vitin 1829 në Angli, kur filloi të thyhej ky zakon nga “bobbies”²⁷. Po ashtu në Francë, vetëm pas vdekjes së Vidokut, u vendos kriter që rekrutët e rinj të zgjidheshin nga ata që nuk kishin pasur ndonjëherë problem penal me policinë.

Mënyra e përzgjedhjeve të policëve të mëparshëm buronte prej shekujsh nga shkaku e qëllimet që nxitën krijimin e forcave policore. Krijimi i forcave të para policore u ndikua prej trazirave të turmave, që u bënë të shpeshta e më të egra, me qëllimin e shpërndarjes së protestuesve, ruajtjen e rendit e pushtetit monarkik. Prandaj, ndërhyrjet e policisë ndaj turmave u bënë gjithmonë e më të dhunshme e më brutale,²⁸ por nuk mund të vazhdohej më me të tilla metoda. Ishin këto protesta që nxitën qeverinë britanike të krijonte e riorganizonte Policinë Metropolitane të Londrës, po kështu në Francë me Vidokun dhe më pas në vende të tjera, mbi bazën e një misioni e vizioni të ri. Në Angli, Francë e kudo në kontinent e përtej oqeanit, nisi për policinë një erë e re, një koncept i ri mbi detyrat e saj, mbi bazën e parimeve të reja të ndërtimit e funksionimit

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

²⁶ Sipas “Britanica”. <https://www.britannica.com/topic/police/The-history-of-policing-in-the-West>

²⁷ Krijimi i Policisë Metropolitane nga R.Peel (shih “*Policimi dhe Siguria*” Nr.7 f.100)

²⁸ Masakra e Peterlo e vitit 1819, ku kalorësia vrau 11 protestues e plagosi me qindra, po kështu në Francë në1666 e më pas. Franca deri në 1829 qëndronte para fqinjit ishullor, Anglisë për organizimin e policisë.

të kësaj organizate, duke vënë në themel profesionalizmin. Kjo do finalizohet me modernizimin e saj, në parimet bazë të policimit, të cilat do të modeloheshin në Angli, nga Robert Peel, kurse në Francë, sapo po hidhej hapi i parë.

Parimet që u shtruan për herë të parë në Angli, nga Robert Peel, në shek. XIX-të, u pranuan dhe u përfshinë shpejt në të gjitha organizatat e policisë, në kontinent e përtej oqeanit: në SHBA, Kanada, Australi e kudo. Në Francë, policia edhe pse dikur një hap para Anglisë e vendeve të tjera, kishte qëndruar gjatë në vend, në pozicion klasik, e pareformuar dhe e ndarë. Policia politike - elitare nga rëndësia, si polici shteti; dhe tjetra, të themi policia normale, - me detyra për rendin, krimet, çështjet civile, shpërndarjen e turmave, ku bënte pjesë edhe xhandarmëria. Pra, policia franceze nuk ishte parapërgatitur për situatën që përfshiu Francën e fundshekullit XVIII-XIX, nuk mundi të përballlej me atë situatë kaosi e krimi, siç ishte periudha e gjatë me "vice-versa"-t e Revolucionit Francez, i cili zgjati pothuaj një shekull. Asaj i ra një barrë e rëndë dhe i përballoi me shumë vështirësi dhe sakrificë ngjarjet që rrodhën. Njëkohësisht u kuptua nevoja e domosdoshme, që në ato kushte të jashtëzakonshme duhej të merreshin masa të jashtëzakonshme. Kjo përligji ardhjen e Vidokut dhe ndryshimet që solli ai.

Është një meritë e madhe e E. Vidokut, si i pari drejtues policie në Francë, që theu mendimin e vjetër të punës së policisë dhe e çoi atë drejt modernizimit. *Sûreté National* apo më pas, "Agjencia Private e Informacionit" që ai krijoi, ishin polici të reja, të cilat tronditën e ndryshuan statusin e policisë franceze. Kjo mundësoi vet policinë të riorganizohet, të rishikonte misionin e vet, të ishte aktive, e aftë të depërtonte në mjediset e fshehta të krimit, të gdiste e arrestonte kriminelë të njohur.

Në kaosin e krijuar, sidomos pas rënies së Napolonit, Vidoku me brigadën e tij arrestoi mbi tetëqind e njëmbëdhjetë vetë, midis tyre pesëmbëdhjetë vrasës të njohur, treqind e dyzet e një hajdutë dhe tridhjetë e tetë pranues të pasurisë të tjetërsuar; u kapën katërmëdhjetë të arratisur ish të burgosur; dyzet e tre burra që kishin thyer lirin e tyre u risollën në burg dhe dyqind e njëzet e nëntë personazhe të keq u arrestuan dhe u dëbuan nga Parisi. U kryen tridhjetë e nëntë kërkime dhe konfiskime të mallrave të vjedhura, ku u kapën gjashtëdhjetë e gjashtë mashtrues, bile edhe mashtrues si njerëz besimesh"²⁹.

Natyrisht, Vidoku kryente edhe detyra të rendit. Sidomos, roli i tij u shfaq dukshëm në momentet e ndryshimeve të pushteteve, si gjatë ardhjes e pas rënies së perandorit Napolon, dhe pas revolucioneve të viteve 1830, 1848, etj. Policia e Vidokut arriti të shpartallojë banda të tëra vjedhësish e grabitësish të rrezikshëm. Pavarësisht se të gjitha të dhënat flasin për shpirtmadhësi të Vidokut, në trajtimin e autorëve të krimeve të lehta, që bënin ndonjë vjedhje për të jetuar, kishte përsëri zëra kundër tij. Disa kundërshtarë të tij, sidomos brenda policisë, filluan të kritikonin metodat e tij, gjoja më të ashpra se duhet, me gjithë rolin tepër të rëndësishëm të tij e *Sûreté*-s në qetësimin e situatave. Po japim një rast. Në vitin 1814, kur erdhi Napoloni nga Elba e rimori pushtetin dhe shumë fisnikë të "Regjimit të Vjetër" me gjithë familjet u burgosën. Disa ushtarë gardianë të burgut, nisën të hakmerren e të përdhunojnë vajzat e gratë e fisnikëve në ambientet e burgut. Në këtë skenë kaq mizore, Vidoku u detyrua të vriste ushtarët që po përdhunonin dhe jo vetëm kaq, por i liroi edhe të burgosurit me familjet e tyre, duke i çuar në shtëpi. Publiku e vlerësoi të drejtë veprën e tij, madje edhe policia, por nuk mbeti pa u kritikuar nga formalistët e tipit Dyplë.

²⁹ Sipas Philip John Stead (shih më poshtë në këtë shkrim).

Këto qëndrime kritike vinin prej xhelozisë e ngushtësisë profesionale, prej zilisë së kolegëve të vet. Dalëngadalë, ato po vinin në dyshim ndershmërinë e përkushtimin e Vidokut në polici, po gërryenin e deformonin figurën e tij sa madhore kaq edhe kontradiktore, duke e bërë Vidokun pa të drejtë, objekt sulmesh, shpifjesh e denoncimesh. Vidoku, në krye të departamentit, vazhdoi ta përqendrojë vëmendjen në zonat më të nxehta të krimit në Paris. Skanimi i terrenit ishte i qartë në mendjen e tij pasi ai e kishte shkelur dhe projektuar prej kohësh atë, me përvojën e vet. Kishte gjithsej tetë agjentë të fshehtë në *Sûreté*, të cilët me gjithë punonjësit, duhej të mbulonin gjithë zonat kryesore të kryeqytetit, Parisit. Punonjëseve u mësonte që të dokumentonin ngjarjet kriminale; se si të vlerësonin e mblidhnin faktet, gjurmët, gjithë të dhënat në vendngjarjen e krimit; të analizonin edhe detajet në dukje të parëndësishme, por që mund të ishin përcaktuese në gjetjen e autorit. Porosia në punën e ekspertëve të ardhshëm përmblidhej më së miri në parimin e njohur: *Kur të keni eliminuar të pamundurën, çdo gjë që mbetet, sado e pamundur, duhet të jetë e vërteta.*

Zgjuarsisë, arsytimit logjik, me të cilat duhet të përzgjidheshin gjurmët e të dhënat në vendngjarje, renditjes së provave, pyetjeve, metodave shkencore, kryerjes së plotë të hetimit, këtyre u jepte rëndësi parësore në gjetjen e konkluzioneve të sakta. Kjo vinte natyrshëm kur merreshin parasysht të gjitha të dhënat e ngjarjeve, hallka të lidhura midis tyre, që formonin zinxhirin e gjatë shkak-pasojë. Çdo situatë e ngjarjeve kriminale, vlerësohej si të ishte një problem i veçantë që duhej zgjidhur. Kishte një e vetëm një të vërtetë, e cila duhej gjetur nëpërmjet hetimit të mbështetur në prova. Agjentëve të fshehtë, Vidoku u mësonte mënyrat e maskimit, të përgjimit, mbledhjen e informacionit nga çdo burim, seleksionimin e të dhënave: analiza, përgjithësimi, faktet e dokumentimi, mënyrat e të pyeturit së të dyshuarit, të dëshmitarit apo të dëmtuarit, lidhja logjike e gjithë përgjigjeve dhe analiza e tyre me një mendje të ftohtë, të çojnë tek e vërteta. Vetëm atëherë autori i krimit, nuk do mund të mbrohej dot, – porosiste Vidoku.

Ai përdorte një ambient të veçantë ku mblidhte e klasifikonte provat, mbante mjetet e punës, bënte analiza laboratorike, eksperimentonte teknikat e reja. Ky mund të quhet laborator i kriminalistikës së Vidokut, i pari i këtij lloji në Francë, ku zë fill edhe kriminalistika moderne. I detë, si dhe mjetet që po përdorte, në atë kohë ishin krejt të reja. Ato po hidhnin bazat e shkencave kriminalistike, të ekspertimit mjekësor modern, teknikat e taktikat e të pyeturit, të hetimit shkencor, duke i dhënë Vidokut edhe një tjetër emër të ri, si “babai i kriminalistikës moderne”, – i quajtur edhe kështu prej historianëve e jetëshkruesve të tij. I detë e tij Vidoku i konkretizoi gjatë punës. Ngjarjet e ndryshme kriminale, me të cilat ndeshje çdo ditë, pasuronin hap pas hapi metodat e gjurmimit të krimit. Kështu, para se balistika të vendosej zyrtarisht, si metodë identifikimi të armës³⁰, Vidoku e njihte e dinte ta përdorte atë në rastet e vrasjeve me armë zjarri. Në një ngjarje të vitit 1822, shkrimtari i madh A. Dyma³¹ tregon:

“U njoftua policia se ishte vrarë me armë zjarri një grua fisniku, kontesha Isabelle d’Arcy. Policia e bindur se autor ishte burri i saj, sepse iu gjet një armë zjarri në shtëpi, kërkoi arrestimin e tij. Megjithatë, duhej të vinte Vidoku, i cili kishte detyrë të shqyrtonte provat e të jepte vendimin përfundimtar. Mbas një këqyrje të kujdesshme, Vidoku thirri mjekun. Në konfidencë i kërkoi atij jashtë raportit zyrtar, t’ia hiqte viktimës nga

Sinjari, S.
« Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë »

³⁰ Krahاسimi i parë i vërtetë midis një arme dhe një plumbi u bë në vitin 1835 nga Runner Bow Street Henry Goddard. Më 21 dhjetor 1860, The Times raportoi për një vendim gjyqësor në të cilin një vrasës në Linkoln i quajtur Th. Richardson ishte dënuar me vdekje me ndihmën e balistikës për herë të parë.

³¹ Aleksandër Dyma (1802-1870-shkrimtari i madh francez.

koka plumbin që i kishte shkaktuar vdekjen. Atë kohë ndërhyrja në kufomë nuk njihej në procedurën hetimore. Në fshehtësi, Vidok bëri krahasimin e armës me plumbin dhe arriti në përfundimin se ai plumb nuk kishte dalë nga ajo armë. Iu desh pak kohë, që të informohej e të zbulonte lidhjet jashtëmartesore të konteshës. Pas kontrollit, tek shtëpia e të dashurit të saj, u gjet arma e krimit, që përshtatej me plumbin e gjetur tek viktimja. Veç kësaj, u gjetën në banesë të fshehura edhe një numër bizhuterish të gruas së vvarë, madje edhe disa prej tyre të shitura në një dyqan bizhuterie. Këto prova vërtetuan katërçipërisht autorin, që ishte i dashuri i saj, i cili e pranoi vrasjen e kryer prej tij pa asnjë kundërshtim.”

Ndër provat e mbledhura në vendngjarje, regjistroheshin edhe gjurmët e këpucëve të personit të dyshuar. Kjo e dhënë ndihmonte në gjetjen e autorit apo grup-autorëve të mundshëm të krimit. Identifikimi i autorit arrihej kur të gjendej prova, këpucët e veshura në vendin e krimit. E reja që solli Vidoku ishte mundësia që kjo gjurmë të analizohet veçmas, në laborator, larg vendit të krimit dhe të paraqitej në gjykatë si provë. Këtë, Vidoku e bëri për herë të parë, duke hedhur suvë mbi gjurmët, e cila ngurtësohej e merrej me vete. Mbase kjo merrete formën e këpucës, analizohet, krahasohet me të dyshuarin dhe ruhej, që të shërbente si provë e autorësisë apo bashkautorësisë së krimit.

Në shumë aspekte, detektivi Vidok ngjason me personazhin e romanit policor, detektivin imagjinar Sherlock Holms³². Më saktë, duhet thënë se është Holmsi që e kopjon atë, sepse Vidoku është real, më i hershëm dhe jo krijim artistik. Me të vërtetë, Vidoku asnjëherë nuk gabonte. Mbas një këqyrje të vendngjarjes, pa i shpëtuar asnjë gjë në dukje e parëndësishme, analizonte, arsyetonte, kërkonte, pyeste për ndonjë të dhënë shtesë dhe nxirrte përfundimin e saktë në mënyrë origjinale e shpejtësi të mahnitshme. Me një kujtesë dhe imagjinatë fantastike, sidomos për mënyrat e metodat e të vepruarit të kriminelëve të veçantë, në mbajtjen mend të fytyrave, të ngjarjeve dhe lidhjes së fakteve, që vetëm ai dinte t'i bënte, të linte të habitur e të krijonte përshtypjen se ai kishte lindur detektiv krimesh. Me kalimin e kohës, filloi që të skedonte në një tjetër mënyrë e formë karakteristikat kryesore të kriminelëve e të dyshuarve; edhe të delinkuentët e krimeve të lehta. Risia e tij në skedim ishte përzgjedhja e atyre karakteristikave më thelbësore individuale të çdo kriminelit, që ndihmonin hetimin e zbulimin e një krimi, në rast përsëritje nga i njëjti autor. Ky lloj skedimi, i përzgjedhur nga Vidoku, bëri që të krijohet një kartotekë e veçantë shumë efikase, e lehtë dhe e thjeshtë në përdorim. Për çdo person të arrestuar krijoi një indeks kartelash, ku gjendej përshkrimi personal, identiteti që përdorte, sjellja, reagimet, dobësitë, aftësitë, bindjet, një mostër të shkrimit të dorës etj. Sistemi i kartave të indeksit të Vidokut, u përhap në policinë franceze dhe u mbart në gjithë policitë në vende të tjera³³. Natyrisht, një tjetër kontribut, - meritë e Vidokut. Sot, kudo, këtë proces e kanë zëvendësuar programet kompjuterike.

Vidoku zbuloi gjërat më karakteristike që duheshin për të identifikuar një person: retina dhe ngjyra e syve, ndonjë shenjë e veçantë në trup, gjatësia, nishane, flokët, zëri e të folurit, forma e jashtme, mënyra e të ecurit, etj., që shërbenin për të dalluar përsëritësit në krime, recidivistët. Kjo ndihmonte edhe në identifikimin e autorëve, nisur nga gjurmët

Sinjari, S.

« Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

³² “Sherlock Holmes” dedektiv, personazh imagjinar, shkruar nga autori britanik, Sir Arthur Conan Doyle. Arsëne Lupin (Arsen Lupen), një hajdut imagjinar, mjeshtër i maskimit, i krijuar nga shkrimtari francez Maurice Leblanc.

³³ Në SHBA, nga Alen Pinkerton që shtoi edhe fotografinë. Sistemi bazik i të dhënave përfshirë MO u vendos në 1906 nga A.Wollmer. Ndërsa hetimi shkencor, analizat e gjakut, fibrave, tokës etj. filloi në 1907.

e lëna në vendngjarje. Prej këtej me të drejtë thuhet se, Vidoku është një nga autorët e parë të përdorimit të sistemit MO, *modus operandi*³⁴, metodë e njohur dhe e përdorur sot në zbulimin e identifikimin e autorëve të krimit. Kjo bazohet në postulatit se, një veprim i njëjtë nga një njeri bëhet gjithmonë në mënyrë të njëjtë. Mënyra e bërjes së një diçkaje, është karakteristike të çdo individ dhe e ndryshme në individë të ndryshëm. Pra, e njëjta gjë ndodh edhe kur një person kryen me përsëritje, të njëjtën lloj veprë kriminale. Për shembull: vjedhjen e një banese, grabitjen, vrasjen, - secili njeri e bën në mënyrën e vet karakteristike, me shenja që dallohen. Nëse e përsërit vjedhjen diku, në ndonjë banesë tjetër, vëmë re se mënyra do të jetë pothuajse njëlloj, si e ka bërë po ky person diku më parë. Kjo ndodh kurdoherë sepse autori familjarizohet, ia merr dorën një metode dhe i duket më e lehtë. Kështu ndodh për mënyrën e hapjes ose thyerjes së dyerve, në mënyrën e kryerjes së vrasjeve nga një vrasës serial etj. Pra, mënyrat e njëjta të zbuluara në vendngjarje të çojnë tek i njëjti person, ndërsa të ndryshmet tek disa. Këto konkluzione i kishte nxjerrë vet Vidoku, kur shkencat përkatëse mbi metodat e njohjes ende nuk kishin dalë³⁵, as metoda MO-ja nuk njihet. Ja për ilustrim një rast vjedhjeje i vitit 1831, ku zbulimi mbështetet në MO. Ngjarja, e përshkruar nga një ish-drejtues policie³⁶, prezent në këtë ngjarje është si vijon:

“E thirrën Vidokun në Bibliotekën Kombëtare të Parisit, sepse ishin vjedhur disa libra të rrallë e me vlerë. Vidoku gjykoi se kjo vepër nuk mund të ishte kryer nga ndonjë intelektual frekuentues apo ndonjë punonjës i brendshëm i bibliotekës, sepse hapja e derës dhe vjedhja ishte kryer me profesionalizëm, me mjete të posaçme. Duke këqyru me vëmendje derën në vendngjarje, ai zbuloi një dëmtim të një paneli të saj, disa shenja karakteristike që kishin mbetur nga hapja. Pasi bëri disa matje ai u tha hetuesve të pranishëm se, kjo mënyrë e hapjes së derës përdoret vetëm nga një person: nga Fossard, - një vjedhës profesionist i njohur, i cili duhet të jetë autori. Në fillim u dyshua për këmbënguljen e Vidokut, sepse dihej që Fossard-i ishte i burgosur. Por, përgjigja erdhi aty për aty. Ky hajdut kishte dalë nga burgu tetë ditë më parë. Nga verifikimi u vërtetua dyshimi i Vidokut. Kur e arrestoi Fossard-in, ai e pranoi vjedhjen e kryer prej tij pa kundërshtim.” Ky rast dëshmon se Vidoku përdorte metodën MO që atëherë. Krahasonte të dhënat e nxjerra nga vendi i krimit, bazohej në kujtesën e njohuritë e tij për kriminelë të veçantë dhe në mënyrën e tyre të veprimit, prej nga ngjashmëria apo ndryshimi me ndonjë autor, përcaktonte dhunuesin, zbulonte autorin e krimit. Kur të dhënat filluan të skedoheshin, natyrisht u shërbenin të gjithëve për hetimet e ardhshme.

Përdorimi i sistemit *modus operandi* sot njihet e përdoret nga ekspertët e krimit kudo. Boja e padukshme që Vidoku krijoi me ndihmën e dy kimistëve, në fillim u përdor shumë për komunikimin me agentët e fshehtë, për të përçarur mesazhe të fshehtë. Ai prodhoi dhe u pajis me licencë edhe për letrën e pafalsifikueshme. Kjo letër hyri shumë në përdorim për një kohë në Francë, deri për shtypjen e kartëmonedhave dhe u shërbeu bankave për prodhimin e letrave me vlerë, çeqeve të pakopjueshëm, etj. Shumë nga mjetet e metodat e krijuara dhe të përdorura nga Vidoku dy shekuj më parë, përdoren ende në punën e ekspertëve kriminalistë në mbarë botën sot, pavarësisht teknologjisë së kohës që ka zëvendësuar ose rinovuar shumë gjëra prej tyre.

³⁴ latin. "modus operandi" - mënyrë të vepruarit.

³⁵ Në fillim të shek.XIX, francezi Auguste Komty sa po hidhte bazat e shkencës së Sociologjisë, kurse për Psikologjinë Eksperimentale do të flitej pas vitit 1860. XH.S.Mill në Angli përpunoi metodat logjike të njohjes.

³⁶ Sipas kujtimeve të ish Drejtorit bashkëkohor të burgjeve, Louis Moreau, i pranishëm në rastin e dhënë.

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

6. Deri në fund, detektiv i madh

Lartësia e karrierës dhe reputacioni i Vidokut kur arriti kulmin, përsëri nuk mundi t'ia zhdukë hijen e së kaluarës tek të gjithë njerëzit. U deshën shumë vite për të hequr akuzën e dezertorit. Herë pas here vinin kërkesa nga ish-drejtori i burgut të Douait, që të paraqitej në gjykatë Shefi i *Sûreté National*. Kjo akuzë absurde më në fund iu hoq pas tre dekadash, falë faljes zyrtare që mori në 1817 nga Mbret Luigj i XVIII-të, i vetmi që e kishte të drejtën e faljes, si sovran. Për këtë pati edhe ndihmën e eprorëve e miqve të tij në polici, të prefektit të policisë së Parisit, Anglès dhe mikut të përhershëm, shef Henrit. Por, damka e ish- të burgosurit, si edhe ankesat, denoncimet për punësimet e ish- të burgosurve në *Sûreté*, deri dhe shpifjet, vazhdonin ta ndiqnin përsëri pas ngjarjeve që rrodhën.

Vdekja e Luigjit të XVIII-të, ardhja e mbretit ekstremist reaksionar, Karlit të X-të, solli shumë pasoja negative në qeverisje e çoi në ndryshime në polici. Pas heqjes së prefektit të policisë, Comte Jules Anglès dhe zëvendësimit të shefit, Henri me Mark Dypplë, filluan të vërshonin ndaj tij kritika e denoncime boshe. Antipatia midis tij e shefit të ri ishte plagë e vjetër. Në vend të vlerësimit të rezultateve të punës, Vidoku i madh kritikohet nga eprori Dypplë, për punonjësit e vet: se duhej të hiqeshin nga puna sepse ishin të dënuar, se diku pas pune dikush kishte prishur qetësinë, se ishte dehur ndonjë punonjës, se kishin ulur reputacionin duke shkuar në bare e bordello, e për vogëloma të tjera. Shpjegimet e Vidokut, se ata punonjës e ato sjellje ishin jashtë kohës së punës ose, se ato shpesh i shërbenin punës për kontakte dhe informacione të vlefshme, nuk përfillehin nga eprori i tij konservator. Ishin dy botëkuptime që ndesheshin e s'mund të pajtoheshin dot. Si njeri e drejtues me dinjitet, Vidoku, më 1827 i dorëzoi Dyples dorëheqjen nga policia. Ai shkruan në dokumentin e dorëheqjes së tij, që i dorëzoi Dypplës: *“Për tetëmbëdhjetë vjet i kam shërbyer policisë si i dalluar. Nuk kam marrë kurrë ndonjë kritikë nga paraardhësit tuaj... Që prej ardhjes tuaj... kjo është hera e dytë që më drejtoheni mua... duke u ankuar për agjentët e mi. A jam unë zotëria i tyre në kohën që ata janë jashtë detyrës? Jo! Për t'ju shpëtuar, zotëri, - nga dërgimi i ankesave të tjera të ngjashme në të ardhmen, - dhe veten time nga shqetësimi i marrjes me ta, kam nderin t'ju kërkoj pranimin e dorëheqjes time.”*³⁷

Por, ky nuk do të ishte “divorci” i tij i fundit me policinë shtetërore. Ulje-ngritjet, bashkë me ngacmimet, do të vazhdonin paralelisht me zigzaget politike. Situata u përkeqësua, sidomos pas përmbysjes së Karlit të X-të me revolucionin e korrikut 1830. Policia joeficiente, e mbingarkuar, e pazonja në menaxhimin e situatës së ngarkuar, thirri përsëri në ndihmë Vidokun. Këshillat e tij të dobishme ndihmonin në zgjidhjen e shumë problemeve. Në një rast vjedhje, që çoi në arrestimin e tetë njerëzve, prefekti i ri i policisë, Henri Gisquet, përsëri e emëroi Vidokun në krye të *La Sûreté National* dhe ai vazhdoi punën e lënë në mes, njëlloj si më parë. Por përsëri, opinionet për të kaluarën dhe mosaprovimi i metodave të tij në shpërndarjen e protestave, ia vështirësuan punën. Kur këto ankesa arritën kulmin me denoncime ndaj tij dhe bashkëpunëtorëve të vet, ai në 1832 dha përsëri dorëheqjen.

Prej këtej filloi përsëri të shquhej e shkëlqejë me ngritjen e një lloj policie të re, të

³⁷ Louis François L'Héritier, *Supplément aux Mémoires de Vidocq, ou dernières révélations sans réticence; par le rédacteur des 2e, 3e, 4e volume des Mémoires, Volume 1*, Paris: La Librairie Centrale de Boulland, 1830, f. 25

panjohur deri atëherë: të policisë private. Krijoi një agjenci private, një lloj policie të përzier, me detektivë për gjurmim dhe që siguronte informacion. Gjithkush mund t'i drejtohej kësaj agjencie për zgjidhje çështjesh private, mund të thirrreshin punonjësit e saj si këshilltar ose ekspert. Edhe nga policia zyrtare mund të thirrreshin për shërbime të ndryshme, sigurisht me pagesë. Agjencia Vidok, ishte agjencia e parë private në historinë e policisë. Në të, natyrisht të punësuarit ishin edhe ish- të dënuar, kryesisht nga ish-punonjësit e tij në *Suretë*.

Dhe ndërsa të ardhurat e fama iu dyfishuan, bashkë me të filluan të shumëfishohen nga zilia shpifjet, ankesat e denoncimet, për akuza që e kishin shoqëruar gjithë jetën. Goditjen kryesore do ta merrte nga vet policia, xhelozia e lidhshimit të paaftë të së cilës, do sajonte rreth tij akuza e reprezalje, sidomos për të penguar funksionimin normal të agjencisë. E akuzuan për tejkalim të ligjit nga agjentët e tij, për vjedhje në kohë trazirash, për arrestim të paligjshëm, për mashtrime të klientëve, për përvetësim parash të paligjshme, shumë denoncime e akuza. Të gjitha u rrëzuan në gjykatë një nga një, por megjithatë ia vështirësuan punën agjencisë. I bënin kontrolle, bastisje dokumentacioni, presione, deri sa i dhanë goditjen fatale, filluan të mos ia pranonin dëshmitë e agjentëve nga kontingjenti i ish- të dënuarve të punësuar. Kjo e bëri krejt të pamundur zhvillimin normal të punës së agjencisë. Dëmet e shkaktuara ishin të pariparueshme, sidomos në reputacion, në financë dhe sigurisht si polici.

U detyrua të tërhiqet e të merrej me ndonjë tregti e biznes të vogël. Pas Revolucionit të shkurtit 1848, shpalljes së Republikës së Dytë, Vidokut iu ofrua shërbim prej qeverisë kalimtare të kryesuar nga L. De Lamartin, madje shërbeu edhe si këshilltar dhe ndërlidhës i kësaj qeverie me L. Bonapartin, nipin e Napolonit. Ngjarjet rrodhën në favor të Napolonit të dytë dhe për Vidokun nuk pati më oferta shtetërore. Gjatë dekadës së fundit të jetës, u tërhoq gradualisht nga jeta aktive. U mbyll në vetminë e tij duke u marrë me punë të vogla. Pasuria e tij me gjithçka, çmohej sa ish-paga e tij vjetore: gjithsej rreth pesë mijë franga³⁸ dhe një pension vjetor tetëqind e dyzet e shtatë franga.

Agjencia e tij private nuk funksiononte më, e thërrisnin për këshilla ose ndonjë çështje private. Ndërkaq ishte bërë një person publik në rrethet intelektuale, sidomos midis shkrimtarëve e artistëve. Shoqërohej me Balzakun, me Hygoin, Dyman, Dikensin, Edgar Allèn Poe, Arthur Konan Dylë dhe me shumë të tjerë. Ishte bërë personazh romanesh, tregimesh policore që sapo po lindnin si zhanër më vete, teatroshe e operash, më vonë në filma serial mjaft të suksesshëm, sidomos në Francë, të cilat ia shumëfishuan famën qindra herë, në gjithë botën, deri në ditët tona. Në vitet e fundit të jetës, i shpërfillur, i lodhur, i sëmurë, filloi të shkruajë kujtimet e veta, me ndihmën e shkrimtarëve anonim, për të sqaruar figurën e vet. Botoi mjaft libra, kujtime, esë, rreth të dënuarve, dënimit me vdekje, burgjeve etj. Çuditërisht, ky njeri i zhurmshëm, energjik, e kaq frutdhënës në polici, sidomos në luftën kundër krimit, po shuhej ngadalë i harruar prej të gjithëve. Sipas Filip John Stead³⁹: *“Ai preferoi jetën e trazuar të rrezikut për kënaqësinë e sigurisë. Historia e tij është një aventurë e gjatë e ndeshjeve, pasi ai shpërthen nga burgjet, ndjek autorët, bën duele me vdekje, bastis ferrat e kriminelëve dhe ecën*

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

³⁸ Një frang ari përmban 290.034 mg. ari të kulluar. Në gusht të vitit 1795, Ligji Monetar zëvendësoi livre ("kile") me franga , e cila u nda në 10 décime ("dhjetë") dhe 100 centime ("qindra"). Në 1873, Latin Monetar Union kaloi në një standard të pastër ari prej 1 fr = 0.290322581 gr.ari.

³⁹ Philip John Stead, anglez, (1915-2005) ishte një kriminolog, autor, kritik letrar, përkthyes dhe poet në Nju Jork dhe pastaj në Masaçuset. Dekan dhe profesor i shquar i studimeve policore, botues i shumë librave për policinë. Në 1953 botoi librin biografik, "Vidok".

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

natën në rrugët e Parisit me një mijë maskime". Të ishin lodhur vallë njerëzit me të?!

Vidoku iku në qetësi, pa bujë, i harruar nga miqtë, policia e publiku. Prej andej ku shkoi, përsëri nuk do ta linin "rehat" të gjallët. Vitet e shekujt që do vinin përkundrazi do t'ia rrisnin më shumë famën, respektin e merituar të brezave të policisë, të kriminalistëve e kriminologëve, të publikut, jo vetëm në Francë, por në mbarë botën. Fama e tij, për veprat që la trashëgim për policinë, sot është e padiskutueshme. Ai, njeriu kontrovers Eugen Fransua Vidok, kujtohet gjithmonë si detektiv madh i policisë moderne.

7. Përfundime

Eugen Fransua Vidok, është ndoshta polici më i madh dhe figura më kontradiktore në historinë e policisë. Figura e tij është njëlloj si një kopje e një letre bixhozi, me dy gjysma figurash, lartë e poshtë. Ai është kriminel dhe polici, aktori dhe regjisori, i pandehuri dhe gjykatësi. Vidoku është Zhan Valzhani i dënuar dhe polici i hekurt Zhaver⁴⁰.

Personazhe të tillë janë më famëgjatë e tërheqës, jo vetëm si më interesantë, por edhe më të vështirët për tu vlerësuar. Për jetëshkruesit, njerëzit e thjeshtë, për vetë shoqërinë, u desh kohë që Vidokun ta çmonin e ta vendosnin në piedestalin e policisë, vendin që i takon, aty ku është sot. Përgjithësisht, diskutohet për dy gjëra:

Së pari, për të kaluarën e tij delikuate deri në moshën e rinisë.

Së dyti, se punësoi në polici njerëz me të kaluar kriminale, që përdornin metoda të rrepta.

Për të kaluarën e tij, përgjigje dhe apologji më e mirë është, emërimi i tij në krye të *Sûretë National*, njësisë policore kombëtare. Kjo u bë nga vet drejtuesit largpamës të policisë, e dekretimi i tij nga vet perandori Napolon Bonapart. Sukseset e jashtëzakonshme të forcës së krijuar e drejtuar nga Vidoku, besojmë se janë përgjigjet më të sakta për figurën e tij. Ai e hodhi pas të kaluarën e tij që kur ishte njëzet e katër vjeç, e në vazhdim, kur filloi të bashkëpunojë me policinë e të kapte kriminelët e rrezikshëm.

Për të dytën kritikë, punësimin si agjentë të ish- të dënuarve, le të gjykojmë sipas arsyes që na e thotë vet Vidoku në *Memories*: "*Për të parandaluar krimet, për të zbuluar keqbërësit dhe për t'i dhënë mundësi atyre që të mos braktisen për drejtësi*". Pra, për këtë qëllim punësoi ish- të dënuar, për t'i kthyer në rrugën e drejtë, duke i shërbyer publikut si kompensim. Punësimi në polici si agjentë të *Sûretës* ishte njëkohësisht certifikatë pendimi nga ana e tyre. Edhe metodat e rrepta, që në ndonjë situatë u përdorën, u bënë në rastet ekstreme të egërsisë së krimit, pjellë e kaosit e çekuilibrit shoqëror. Mendimi se, sa më i rreptë ndëshkimi kaq më i ulët krimi, ishte botëkuptim sundues në atë epokë. Por, për krime të lehta të njerëzve të thjeshtë, ai asnjëherë nuk u tregua i ashpër, madje prej kësaj gëzonte simpatinë e përkrahjen e tyre. Sot, nuk del e nevojshme të bëjmë avokatin për Vidokun e të punësuarit e tij, sepse e bëri historia. Le të gjykojmë me këndin e koncepteve të reja, mbi të drejtat dhe policimin. Qëllimi i dënimit është rehabilitimi i plotë i individit, jo thjesht ndëshkim, por një kompensim që i dënuari të ketë mundësi të rehabilitohet e të kthehet në shoqëri. Po kështu, policimi sot, si masë të parë e kryesore për policinë thekson parandalimin e krimit, përdorimin

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

⁴¹ Latin. "E vërteta gjeneron të vërtetën".

e mjeteve edukuese dhe dhunën si gjënë e fundit, kur janë shterur metodat e tjera. Prandaj skeptikëve mund tu bëjmë pyetjen: Nëse parimet e policimit do ishin krijuar e njohur që atëherë, si platformë e punës së policisë, Vidoku a do t'i meritonte e vuante ndëshkimet e rënda, mënyrat ç'njerëzore të vuajtjes së dënimit në burg? Kur hodhi pas të kaluarën me vepra, atëherë, a i meritonte ai paragjykimet e kolegëve?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje, mendoj se më shpejtë e më drejtë e dhanë që në atë kohë shkrimtarët e mëdhenj, Balzak e Hygo, e më vonë e kuptoi edhe policia franceze. Pa i bërë analizë e alibi këtyre kritikave prej xhelozisë së kolegëve të tij, po japim edhe dy momente që e bëjnë më të qartë rrugëtimin në kohë të rivlerësimit të Eugen Fransua Vidokut.

Në vitin 1905, në Paris u hap një ekspozitë kushtuar *Sûretë National*. Në një vend të dukshëm u vendosën edhe figurat e ish-drejtuesve të kësaj force policore, që prej themelimit të saj. Mungonte fotografia e Vidokut! Themeluesin e drejtuesin e parë të *Sûretë-s* e kishin "harruar". Një gazetë e kohës që u interesua, mbi arsyt se përse mungonte emri dhe figura e themeluesit dhe drejtuesit të kësaj organizate, Vidokut, nuk mori përgjigje. "Pse"-ja sigurisht që dihej. Vidoku vuante ende, *post-mortum*, padrejtsitë e kohës. Ky fakt është mjaft kuptimplotë. Prej vitit 1990, është themeluar në Filadelfia, *Shoqëria Vidok*. Anëtarë të saj sipas statutit, duhet të jenë ekspertë mjekoligjorë, ish-punonjës me profil të FBI-së, hetues të vrasjeve, shkencëtarë, psikologë, mjekë, etj. Në takimet mujore, përpiqen të zgjidhin çështje nga gjithë bota. Shërbimi bëhet pa pagesë dhe në përputhje me moton *Veritas veritatum*⁴¹. Anëtarësimi është i mbyllur. Numri i anëtarëve është i ulët, pasi formalisht nuk duhet të tejkalojë numrin e viteve të jetës së Vidok, pra tetëdhjetë e një. Pra, edhe ky fakt flet shumë për Vidokun.

E në mënyrë të përmbledhur, një prej thënieve të Josef de Maistre⁴² është se: *çdo vend nxjerr policinë që meriton*. Ky deduksion vjen nga analiza që i bëhet një regjimi. Historia tregon se Franca në atë kohë ndërtoi një polici me të vërtetë të përparuar. Nga regjimi i mëparshëm trashëgoi dy njësi të ndara në detyra, për sigurinë politike dhe atë civile. Por kur ngjarjet rrodhën, duke lënë pas "Regjimin e Terrorit"⁴³, për një kohë filloi të sundojë në Paris, kaosi dhe krimi. Policia e vjetër duhej reformuar si në organizim edhe në mentalitet. Këtu del ajo lidhje e pandashme, që ekziston midis kushteve të një vendi dhe policisë që i takon. Ardhja e Napolonit bëri të mundur një sërë reformash në shtet. Policia e vjetër franceze u shkund nga paaftësia e plogështia e saj. Ajo iu përshtat situatës, duke u modeluar në një formë e mënyrë pune të re, si polici profesioniste. Për këtë ka meritën e vet E. F. Vidok. Ngritja e *Sûretë-s* e më pas, shndërrimi i saj si njësi policore për gjithë kombin, *Sûretë National*, e çoi akoma më përpara cilësinë e modernizimin e Policisë Franceze.

Gjithë bota e asaj kohe përfitoi nga përvoja franceze. Nga Anglia, Robert Peel dërgoi disa herë delegacione të Policisë Metropolitane. Kur u takuan, nuk iu shqitën një javë rresht, duke marrë pjesë deri në aksione me Vidokun. Mësuan shumë nga metodat e gjurmimit dhe hetimit të krimit prej tij, madje R. Peel e bëri këshilltar për krijimin e Policisë Metropolitane. *Surete* u bë frymëzim për "Scotland Yard", për agjencinë detektive të legjendarit A. Pinkerton në SHBA, për modernizimin e policisë amerikane nga A. Uollmer, FBI-në e E. Huverit dhe për departamente të tjerë të hetimit në të

Sinjari, S.
« Eugen Fransua Vidok, detektiv i madh i policisë »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

⁴² Joseph de Maistre (1753 -1821) filozof, shkrimtar, avokat dhe diplomat francez. një nga themeluesit e konservatorizmit evropian.

⁴³ "Regjimin e terrorit" nga qershor 1793 deri korrik 1794.

gjithë botën. Në një anketë të bërë për vlerësimin e Vidokut, shumica e të anketuarve e vlerësuan atë së paku, “Babai i hetimit penal modern”.

Sot mjaft turistëve që vizitojnë Parisin, u tregohet ndërtesa e Policisë Kombëtare, duke e shoqëruar me tregime zbavitëse për Vidokun, shefin e parë të zyrës së zbulimit të policisë dhe policisë së parë private. Dëgjuesit habiten, përse e njohin fare pak ose aspak Vidokun. Ky njeri i famshëm paska qenë i dënuar?! Atëherë vazhdon monologu i çdo vizitori: A duhet vlerësuar si polic e detektiv i madh?! Përgjigja “Po!”, natyrshëm sjell pyetjen tjetër: Po policia sot, a mund të marrë individë të tillë në radhët e saja? Vallë, duhet konsideruar e padiskutueshme përgjigja se, Ai, Vidoku, ishte njeri i jashtëzakonshëm që erdhi në polici në situata të jashtëzakonshme?! Mosdënimi penal, në përzgjedhjen e oficerëve të Policisë sot, është kriter pothuajse në gjithë policitë e botës. Dikur, A. Wollmeri shkruante për ardhjen në polici: *“Puna e policit është thirrja më e lartë në botë. Njerëzit të cilët e kryejnë këtë punë duhet të jenë të shkëlqyeshëm...”*⁴⁴

Për policinë ai do të mbetet një nga reformatorët e policisë moderne.

Sinjari, S.

« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

⁴⁴ S. Sinjari, S. Duka. “A. Wollmer- Babai i Policisë moderne amerikane”. *Policimi dhe Siguria*, nr. 2 Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016

Bibliografi

1. J. S. Dempsey, L. S. Forst, *An Introduction Policing*, Boston 2016.
2. S. Cvajg, *Zhozef Fushe*, Tiranë, 1992.
3. M. Foucault, *Anthropologies of Modernity, Governmentality, and Life Politics*, red. Jonathan Xavier Inda, Blackwell Publishing, 2005.
4. McHoul, W. Grace, *A Foucault Primer Discourse, Power and the Subject*, London and New York, Routledge 2002.
5. Heywood, *Politika*, 2nd edition, Tiranë 2008.
6. SIPU, *Manual për Policimin në Komunitet*, 2015.
7. N. Gash, *Sir Robert Peel: The Life of Sir Robert Peel after 1830*, Faber & Faber, 2011.
8. Louis François L'Héritier, *Supplément aux Mémoires de Vidocq, ou dernières révélations sans réticence; par le rédacteur des 2e, 3e, 4e volume des Mémoires, Volume 1*, Paris: La Librairie Centrale de Boulland, 1830.
9. S. Sinjari, S. Duka. "A. Wollmer - babai i Policisë moderne amerikane". *Policimi dhe Siguria*, nr. 2 Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016

Burime elektronike:

10. Ncwc, *A Brief Guide To Police History*, në:
[faculty.ncwc.edu/toconnor/205/205lect04.htm/Police History/ A Brief Guide To Police History/](http://faculty.ncwc.edu/toconnor/205/205lect04.htm/Police%20History/A%20Brief%20Guide%20To%20Police%20History/)
11. Botasot, *227 vjetori i revolucionit borgjez francez*, në:
<http://www.botasot.info/dokumentare-lajme/554637/227-vjetori-i-revolucionit-borgjez-francez/>
12. Bota.al, *Pesë mite mbi revolucionin francez*, në:
<http://www.bota.al/2017/03/pervjetori-pese-mite-mbi-revolucionin-francez>
13. Vocabulary, *Zëri "Detective"*, në:
<https://www.vocabulary.com/dictionary/detective> (mars 2018)
14. Britannica, *The history of policing in the West*, në:
<https://www.britannica.com/topic/police/The-history-of-policing-in-the-West>
15. Police.uk, *The Metropolitan Police how it all began*, në:
<http://content.met.police.uk/Article/The-Metropolitan-Police-how-it-all-began/1400015336362/1400015336362> (dhjetor 2017)
16. Britannica, *Thomas Whetstone*, në:
<https://www.britannica.com/contributor/Thomas-Whetstone/5819>
17. Owcation, *Eugne F. Vidocq The Convict Who Became the Father of Modern Criminal Investigation*, në:
<https://owcation.com/social-sciences/Eugne-Francois-Vidocq-The-Convict-Who-Became-the-Father-of-Modern-Criminal-Investigation> (nëntor 2017) (mars 2018)
16. Britannica, *Joseph de Maistre*, në:
<https://www.britannica.com/biography/Joseph-de-Maistre> (mars 2018)

Sinjari, S.
« Eugen
Fransua Vidok,
detektiv i madh
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Trajnimi i punonjësve së Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike



■ **MSc. Besnik SHEHAJ**
Akademia e Sigurisë
besnik.shehaj@asp.gov.al

Abstrakt

Shërbimi Privat i Sigurisë (SHPS) është një veprimtari biznesi që ka për mision ruajtjen e pronës private e publike, jetën, shëndetin dhe integritetin e personave, i cili nuk ka një traditë të konsoliduar në vendin tonë, pasi për gati gjysmën e dytë të shek. XX nuk ka ekzistuar. Vetëm pas ndryshimeve demokratike në vendin tonë, kur u lejua ekonomia e tregut, lindi nevoja për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, për shkak se Policia e Shtetit e kishte të pamundur ruajtjen e të gjitha objekteve të rëndësishme publike e private. Si çdo aktivitet i ri, pa një traditë dhe eksperiencë profesionale dhe i ngritur në ngut e sipër, ky shërbim nuk funksionoi siç duhet. Disa ngjarje të rënda të ndodhura në objektet e ruajtura prej SHPS në këto 20 vitet e fundit tregojnë se ky shërbim nuk ka arritur të maturohet për të qenë efektiv në misionin e tij. Edhe në fushën e studimeve me fokus këtë veprimtari është e vështirë të gjejmë referenca të një pune të mirëfilltë kërkimore e studimore në vendin tonë, prandaj ndërmarrja e një artikulli të tillë mund mos të plotësojë gjithë pritshmërinë. Por le të shpresojmë se ai do të shërbejë sa do pak si nxitje për studime të tjera më të thelluara, sidomos në drejtim të aftësimit profesional të SHPSF dhe eficientës së këtij shërbimi. Brenda hapësirave që lejon një punim i tillë, jemi përpjekur të trajtojmë disa aspekte që lidhen me: kuptimin, rëndësinë, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e SHPS në tërësi, si dhe veçanërisht: trajnimin e personelit të këtij shërbimi.

Fjalëkyçe:

Kodi i Sjelljes, Dokument i Montro-së, licencim, certifikim, trajnim, shërbim privat i siguri fizike, punonjës i SHPSF, drejtues teknik, trajner, qendrat e trajnimit privat, menaxhim operacional.


Shehaj, B.
« Trajnimi
i punonjësve
të SHPSF »

Polici
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Hyrje

Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike (SHPSF) është një veprimtari biznesi që ka për mision ruajtjen e pronës private e publike, jetën, shëndetin dhe integritetin e personave, i cili nuk ka një traditë të konsoliduar në vendin tonë, pasi për gati gjysmën e dytë të shek. XX nuk ka ekzistuar, kur në vendet e zhvilluara perëndimore ai daton nga mesjeta e hershme e deri në ditët e sotme, duke evoluar me shpejtësi në fund të shekullit të kaluar deri në nivele konkurruese me shërbimet e policore institucionale. Vetëm pas ndryshimeve demokratike në vendin tonë, kur u lejua ekonomia e tregut, lindi nevoja për organizimin dhe funksionimin e SHPSF, nëpërmjet rregullimit ligjor¹ të tij, duke i dhënë mundësi krijimit dhe veprimtarisë së subjekteve private në këtë fushë. Pamundësia e Policisë së Shtetit për të marrë në ruajtje të gjitha objektet e rëndësishme publike e private, për shkak të angazhimit të saj të plotë në ruajtjen e rendit publike dhe parandalimin e krimit në situatën e trazuar të ndërrimit të sistemeve, diktoi nevojën urgjente të licencimit të firmave të para të SHPSF sipas modelit perëndimor, të cilat brenda një kohe të shkurtër pushtuan të gjithë tregun në këtë fushë të sigurisë. (shih Fig. 1)²

Figura 1



¹ Ligji Nr. 7696, datë 07.04.1993 "Për shërbimin e rojeve civile" (Kuvendi 1993).

² Statistika zyrtare të Departamentit të Sigurisë Publike. (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit 2018)

Por si çdo aktivitet i ri, pa një traditë, pa eksperiencë profesionale dhe i ngritur në ngut e sipër, shpejt ai cedo i shumë drejtime, që nga baza ligjore, organizimi e funksionimi, përzgjedhja e përgatitja e personelit, korrupsioni dhe politizimi.³ Rregullimet e shumta ligjore e nënligjore që janë bërë në këtë fushë dhe ngjarjet e rënda të ndodhura në objektet e ruajtura prej tyre në këto 20 vjetët e fundit tregojnë se SHPSF nuk kanë arritur të maturohet plotësisht për të qenë efikas në misionin e tij.

Edhe në fushën e studimeve me fokusin në këtë veprimtari, është e vështirë të gesh referenca të një pune të mirëfilltë kërkimore e studimore në vendin tonë, përjashtoj studimin me vlerë të z. Arjan Dyrmishi dhe znj. Gentiola Madhi të titulluar “Sektori Privat i Sigurisë në Shqipëri”.⁴ Prandaj, trajtimi i subjektit në këtë artikull mund të mos plotësojë gjithë pritshmërinë, por le të shpresojmë se do të shërbejë sadopak si nxitje për studime të tjera më të thelluara, sidomos në drejtim të aftësimin profesional të SHPSF-së dhe efikasitetit të këtij shërbimi. Brenda hapësirave që lejon një punim i tillë, jemi përpjekur të trajtojmë disa aspekte që lidhen me: *kuptimin, rëndësinë, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e SHPSF në tërësi, si dhe veçanërisht: trajnimin e personelit të këtij shërbimi.*

2. Kuptimi për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike

2.1. Pak histori

Shërbimi i rojeve private në botë është i dokumentuar të paktën që nga mesjeta e hershme, kur filloi grupimi i zejeve dhe tregtisë në qendra të përbashkëta, si zanafilla të qyteteve të periudhës feudale. Prania e shumë shitësve dhe blerësve të grumbulluar në hapësira relativisht të vogla, sidomos në ditët e panairëve dhe festave, krijonte premisa për vjedhje, mashtrime, dehje dhe grindje që shpesh kërcënonin seriozisht pasurinë dhe jetën e të pranishmëve. Në këto kushte, veçanërisht për të ruajtur punishtet e tregjet gjatë natës, kolektivat e zejtarëve dhe tregtarëve përzgjidhnin dhe paguanin individë të caktuar për të kryer këtë detyrë. Zakonisht këta ishin njerëz të besuar të feudalit që zotëronin territorin ose individë të besuar me një farë autoriteti. Duke vepruar si individë apo në njësi të vogla fuqitë e tyre ekzekutive ishin të limituara, kryesisht në kontrollin e territorit, gjetjen dhe kthimin e sendeve të vjedhura, kapjen e elementëve keqbërës dhe çuarjen e tyre para një gjykatësi, i cili shpesh ishte feudali ose një person i ngarkuar prej tij. Emërtimet e tyre ndryshonin sipas traditës të vendeve përkatëse ose përcaktimeve nga kontraktuesit e tyre, ku mund të përmendim si të tilla: “Constable”, “Watchmen”, “Thief-taker”⁵, “Night-Watchmen”, “Charlies”, etj. Të tillë individë apo njësi ka pasur edhe në vendin tonë, të dokumentuara nga mesjeta deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, kur sistemi socialist që u aplikua, bashkë me eliminimin e pronës private, ndaloi gjithashtu përfundimisht ekzistencën e tyre. Në Kanunet e Lek Dukagjinit dhe Skënderbeut, janë të institucionalizuara emërtimi dhe funksionet e këtyre personave, si “Kapucari”⁶ e “Parota”⁷, ose shpesh me emërtimin popullor “Gjurmatar”, pasi në të

Shehaj, B.
« Trajnimi
i punonjësve
të SHPSF »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

84

³ Dyrmishi, A. & Madhi, G. *Sektori Privat i Sigurisë në Shqipëri*, f. 1.

⁴ Po aty.

⁵ Sinjari, S. “*Sër Robert Pili, krijues i policisë moderne*”, Policia dhe Siguria Nr. 7, Akademia e Sigurisë, Shtator 2017, faqe 100.

⁶ Kanuni i Lek Dukagjinit, f. 93. (Gjeçovi 2009)

⁷ Ilija, F. *Kanuni i Skënderbeut*, faqe 168-170, 172-173.

shumtën e rasteve ata vepronin duke ndjekur gjurmët e këmbëve të lëna nga kafshët e vjedhura apo nga autori. Po ashtu në Statutet e Shkodrës, në Kreun 81 parashikohen detyrat e të ashtuquajturve “Rojeve”⁸, “...të cilat ishin ngarkuar për ruajtjen e qytetit dhe urdhërohen të qëndrojnë në detyrë gjithë natën deri në mëngjes...” Gjatë periudhës së pushtimit otoman, për të garantuar aktivitetin normal të tregtisë apo transportit të mallrave në zona të ndryshme të vendit, tregtarët e trevave shqiptare e më gjerë pajtonin “ruajtësit e karvanëve tregtare”, të ashtuquajturit Dervenxhinj,⁹ prej të cilëve mund të themi se e kanë origjinën eskortat e sotme të shoqërimit të vlerave monetare e të çmuara.

Historia moderne e SHPSF në Amerikë dhe në vendet e Evropës Perëndimore, pak a shumë në format që njohim edhe sot, si persona fizik apo juridik të licencuar, fillon në dekadat e para të shek. XX, prej nga u përhap me shpejtësi në gjithë botën. Nga ana tjetër, duke qenë se ky lloj shërbimi e ushtron veprimtarinë e tij në një fushë të ndjeshme në lidhje me respektimin e lirive dhe të drejtave universale të njeriut, siç është siguria publike, lindi si domosdoshmëri nevoja e përcaktimit të disa “*principeve*” bazë në respektim të këtyre të drejtave dhe ligjit ndërkombëtar gjatë ushtrimit të përgjegjësive nga SHPSF. Kjo gjë u finalizua në shtator të vitit 2013 me miratimin e “*Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Shoqëritë e Shërbimeve Private të Sigurisë*”¹⁰, i bazuar në rekomandimet e të ashtuquajturit “*Dokumenti i Montro-së (Montreux)*”¹¹.

2.2. Kuptimi për Shërbimin Privat të Sigurisë fizike

Kuptimi për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike jepet në pikën 23, të nenit 3, i ligjit përkatës, ku thuhet: “*SHPSF (shërbimi privat i sigurisë fizike) është shërbimi që ofrohet nga subjekti privat i licencuar për sigurimin e objekteve shtetërore, private, personave, si dhe të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare, të vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, në bazë të detyrimeve kontraktuale...*”¹²

Nisur nga sa sipër kuptohet se SHPSF organizohen si subjekte private juridik¹³ me objekt të veprimtarisë së tyre: *sigurimin e objekteve shtetërore, private, personave, si dhe të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare, të vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit*. Me këtë status ligjor, ato ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik njësoj si të gjithë operatorët e tjerë tregtarë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare¹⁴, Kodin Civil dhe legjislacionit tatimor, pra jashtë juridiksionit të Policisë së Shtetit.

Duke qenë se shërbimi që subjektet e SHPSF ofrojnë i përket një fushe delikate, siç është ajo e sigurisë publike, kuptohet se ato duhet të jenë edhe të *licencuara*¹⁵ për fushën e veprimtarisë ku operojnë. Pra nuk mund të ushtrojnë aktivitetet në liri të plotë, por duhet të plotësojnë disa kushte e kritere specifike të përcaktuara në aktet ligjore e

⁸ Shkëmbi, H. *Policia Shqiptare*, f. 21.

⁹ Po aty, f. 26.

¹⁰ International Code Of Conduct For Private Security Service Providers. (ICoCA 2010).

¹¹ Emërtimi sipas qytetit, ku u zhvillua samiti i thirrur nga qeveria Zvicerane dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, më 17 Shtator 2008, me pjesëmarrje të ekspertëve nga disa vende euroatlantike, ku u miratua ky dokument. (Federal Department of Foreign Affairs (FDFA) 2008)

¹² Ligji 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. (Kuvendi 2014)

¹³ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nenet 24-34. (Kuvendi 2017)

¹⁴ Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Kuvendi 2008)

¹⁵ Ligji Nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. (Kuvendi 2009)

nënligjore përkatëse. Ndërsa në raport me llojin e shërbimit që ofrojnë subjektet e SHPSF ndahen në *nënkategoritë* 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C,¹⁶ për të cilat do të flitet më hollësisht në vijim. Në këtë kuptim ato janë subjekte që lejohen të ushtrorjnë aktivitetin e tyre dhe kontrollohen në vazhdimësi nga Policia e Shtetit.

3. Rëndësia e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike

3.1. Pse është i nevojshëm SHPSF

Në një studim të “Research Triangle Institute”, organizatë jo qeveritare me reputacion të lartë në Karolinën e Veriut të SHBA-së, thuhet: “*Industria e sigurisë private është një komponent i rëndësishëm i ruajtjes dhe sigurisë në Shtetet e Bashkuara dhe jashtë vendit. Sot, siguria private është përgjegjëse jo vetëm për mbrojtjen e shumë prej institucioneve kombëtare dhe sistemeve të infrastrukturës kritike, por edhe për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe informacionit sensitiv të korporatave. Kompanitë amerikane gjithashtu mbështeten shumë në shërbimet private të sigurisë për një gamë të gjerë funksionesh, duke përfshirë mbrojtjen e punonjësve dhe pronës, kryerjen e hetimeve, kryerjen e verifikimeve para punësimit, ruajtjen e informacionit dhe sigurinë e teknologjisë së informacionit, si dhe shumë funksione të tjera*”.¹⁷

E njëjta gjë mund të thuhet për SHPSF në vendin tonë. Por dikush mund të thotë se ruajtja e jetës, shëndetit dhe pronës së shtetasve është përgjegjësi institucionale dhe ligjore e Policisë së Shtetit, pra mos vallë SHPSF “futer” në kompetencat e Policisë ose e konkurron atë!? Pikërisht për këtë fakt ne mendojmë të kundërtën, se përmbushja e këtij mision të rëndësishëm për Policinë është i pamundur në kushtet e ekonomisë së tregut duke qenë e vetme, prandaj ekzistenca dhe funksionimin e këtij shërbimi privat, jo vetëm nuk e sfidon Policinë e Shtetit në këtë fushë të sigurisë, por përkundrazi kthehet në aleat i domosdoshëm i saj.

Në të shkuarën e afërt të shtetit Shqiptar, në kushtet kur ishte e ndaluar ekonomia e tregut dhe aktiviteti ekonomik privat, Policia e Shtetit ishte përgjegjëse e vetme për ruajtjen e jetës, shëndetit dhe pronës publike e private, ku prioritet kishte ajo publike.¹⁸ Mbas ndryshimeve demokratike në vitet '90, kërkesat e institucioneve shtetërore e private për ruajtje fizike të pronës u rritën në përmasa të papërbalueshme nga Policia. Kjo situatë i detyroi drejtuesit e lartë të këtij institucioni të kërkonin forma të tjera organizimi për ruajtjen e objekteve jashtë Policisë, duke huazuar eksperiencën nga vendet e zhvilluara demokratike,¹⁹ ku prej kohësh funksiononte me sukses *shërbimi privat e sigurisë fizike*. Ky realitet i ri shtroi nevojën e organizimit dhe funksionimit të SHPSF-ve edhe në vendin tonë.

Krahas kësaj, nevoja për SHPSF ishte e lidhur me faktin tjetër, se Policia do të lehtësohej nga ngarkesa me forca e mjete për sigurimin e pronës, duke u fokusuar

Shehaj, B.
« Trajnimi
i punonjësve
të SHPSF »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

¹⁶ VKM Nr. 358, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Aneksi 1, Fusha I, Kategoria 1.3. (Këshilli i Ministrave 2009)

¹⁷ RTI International. “The Private Security Industry: A Review of the Definitions, Available Data Sources, and Paths Moving Forward.” December 2010.

<https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/bjs/grants/232781.pdf> (accessed Maj 8, 2018).

¹⁸ Ligji nr. 7550, datë 20.01.1992, “Për Policinë e Objekteve”. (Kuvendi 1992)

¹⁹ Calesini, G. “Leggi di pubblica sicurezza e illeciti amministrativi”, faqe 292 – 293. (Calesini 2000)

kryesisht në përgjegjësitë primare të saj si: ruajtja e sigurisë publike dhe mbajtja nën kontroll e kriminalitetit. Ky i fundit, pas hapjes së kufijve dhe etjes së individëve për pasurim të menjëhershëm, u rrit me përmasa të frikshme në numër, në forma e metoda të pandeshura më parë dhe shkallë agresiviteti të lartë, si grabitje, përdhunime, vrasje e trafiqe, deri në krijimin e bandave të armatosura e grupeve të strukturuar kriminale. Pra nëpërmjet krijimit të SHPSF u krijua mundësia që forcat e mjete e Policisë të angazhuara më parë në ruajtje të objekteve, të aktivizoheshin tashmë në detyrat e tjera primare të saj. Nga ana tjetër *nevoja* për krijimin dhe funksionimin e subjekteve të SHPSF qëndronte edhe në faktin se me marrjen nga ana e tyre e detyrimeve për ruajtjen fizike të pronës u lehtësuan shpenzimet buxhetore të Policisë në funksion të ruajtjes së objekteve, ndërsa vetë SHPSF-t, nën presionin e konkurrencës së ekonomisë së tregut, u detyruan të ofrojnë shërbime më profesionale dhe pajisen me mjete bashkëkohore për t'i mbijetuar kësaj konkurrence.

3.2. Garantimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut

Dihet se e drejta e jetës dhe pronës konsiderohen si të drejta themelore të individit në një shtet demokratik të garantuara me akte ndërkombëtare dhe nga kushtetuta. Bazuar në këto parime, shteti ka detyrimin që të garantojë jo vetëm njohjen juridike, por dhe krijimin e kushteve për gëzimin e plotë të tyre nga të gjithë shtetasit. Në ligjin Shqiptar për SHPSF, në nenin 4, me titullin “Parime të përgjithshme”, theksohet: “*Subjektet e SHPSF-së, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre u nënshtrohen parimeve të përgjithshme, si parimi respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, ...*”²⁰

Siç u përmend më sipër, në të kaluarën, shteti ndonëse e kishte përgjegjësinë për ruajtjen e pronës private, prioritet kishte prona shtetërore. Akoma më e përkeqësuar ishte situata për garantimin e jetës dhe shëndetit të shtetasve, në raport me zyrtarët e lartë, ku këta të fundit kishin përparësi, por nga ana tjetër ishte edhe pamundësia objektive që çdo individ të ruhej nga Policia, qoftë kur ai ishte kërcënuar më parë. Atëherë shteti, duke licencuar në radhë të parë subjektet e SHPSF, por edhe duke i kontrolluar që të jenë të afta profesionalisht për përmbushjen e kësaj përgjegjësie (misioni), siguron kushtet që individët të marrin masa vetë për garantimin e jetës, pronës dhe integritetit të tyre nëpërmjet këtyre subjekteve. Edhe në vendet më të zhvilluara demokratike Policia nuk është në gjendje të ofroj shërbime sigurie për të gjithë shtetasit sipas kërkesave apo interesave të këtyre të fundit, sa për pamundësi objektive, por edhe për shkak të mentalitetit etatist që trashëgojnë, ku më shumë e ku më pak, të gjitha shërbimet policore. Në këto rrethana, ekzistenca e SHPSF merr *rëndësi* të veçantë që çdo shtetasi t'i jepet mundësia për të *garantuar të drejtat e tij themelore* edhe në rrugë alternative. Sot, kudo në botë, por edhe në vendin tonë, shërbimet private të sigurisë janë zhvilluar aq shumë sa të ofrojnë shërbime të ruajtjes personale, vlerave monetare e të çmuara apo mbrojtjen me mjete elektronike, etj. me profesionalizëm të admirueshëm, por edhe të pëlqyeshëm për klientët e tyre, ku prioritet kanë kërkesat e këtyre të fundit.


3.3. Punësim dhe gjenerim të ardhurash

Duke qenë se kërkesat për siguri të jetës, pronës dhe integritetit nga individë apo

²⁰ Ligji nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 4.

subjekte tregtare në një ekonomi tregu sa vinë e shtohen, kuptohet që dhe numri i shoqërive të SHPSF-ve sa vjen e rritet, duke punësuar kështu gjithnjë e më shumë punonjës të niveleve të ndryshme në këto shoqëri, si roje, grupe të gatshme, drejtues mjetes, operatorë të qendrave të komandimit, përgjegjës turni, trajnerë, drejtues teknik, etj. Në një publikim në faqen zyrtare të cituar thuhet se nga një studim i ASIS International (American Society for Industrial Security) rezulton që: “...Shtetet e Bashkuara janë konsumatori më i madh në botë... i sigurisë private... që filloi të shihet një rritje të madhe të popullaritetit në vitin 2010. Aktualisht ka 2 milionë punonjës sigurie me orar të plotë në Shtetet e Bashkuara dhe ky numër pritet të rritet me 21% deri në vitin 2020”²¹. Ndërsa në vendin tonë, gjatë dekadës 2008 - 2017, numri i punonjësve të sektorit privat të sigurisë është rritur konsiderueshëm, nga 7105 në 9399 persona, të punësuar në 460 kompani të licencuara²². (shih Tabela 1)

Figura 2



Nga ana tjetër shtimi i objekteve në ruajtje dhe masat e shtuara të sigurisë bëjnë që në këtë fushë të ekonomisë të gjenerohen të ardhura të konsiderueshme, një pjesë e mirë e të cilave rialokohet për investime të reja në teknologji e pajisje sigurie, të cilat gjithashtu evoluojnë me shpejtësi në kuadër të zhvillimeve tekniko-shkencore. Në një studim, - dhe i vetmi i bërë në vendin tonë për SHPSF, - rezulton se: “Shuma e fondeve publike për shërbime të tilla në periudhën midis viteve 2012 dhe 2014 është rritur nga 9 në 11 milionë euro. Kjo shumë është e barabartë me rreth 9% të buxhetit vjetor të Ministrisë së Brendshme...”²³. (shih Tabela 2)

Tabela 1

SHPSF-të dhe kontrata nga fondet publike (2012, 2013 dhe 2014)

Viti	Shoqëritë që kanë fituar të paktën një tender publik	Fondet publike të caktuara për të blerë shërbime të sigurisë (EUR)	Shuma totale e të ardhurave të deklaruar të shoqërive që kanë fituar një tender publik (EUR)	Buxheti vjetor i Ministrisë së Brendshme
2012	115	9.2 milion	22 milion	117.3 milion
2013	119	10.4 milion	23 milion	116.2 milion
2014	114	11 milion	-----	121.6 milion

Shehaj, B.
« Trajnimi i punonjësve të SHPSF »

Policimi dhe Siguria nr.11, 2018

²¹ The Growth & Development of the Private Security Industry.

²² Statistika zyrtare të Departamentit të Sigurisë Publike.

4. Organizimi dhe funksionimi i SHPSF-ve

4.1. Licencimi i SHPSF

Siç është theksuar në seksionin 2 të këtij shkrimi, për vetë specifikën e aktivitetit që kryejnë subjektet e SHPSF-ve, kërkohet *licencimi* i tyre nga organet shtetërore, e sanksionuar kjo në nenin 6 të ligjit bazë.²⁴ Kjo gjë është e nevojshme jo vetëm në aspektin formalo-juridik si kusht për ushtrimin e aktivitetit të biznesit në këtë fushë, por ajo që ka shumë rëndësi për vetë organin e Policisë është fakti se, nëpërmjet procedurës së licencimit, i krijohet mundësia dhe detyrimi për të verifikuar paraprakisht e në vijim sa i plotëson subjekti që do të licencohet kushtet tekniko-profesionale për të ofruar e kryer shërbime të sigurisë fizike ndaj të tretëve. Në bazë të ligjit për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë, licencimi i SHPSF-ve bëhet për *kategorinë I.3 "Fusha I...siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile"*,²⁵ e ndarë në tre *nënkategori*, përkatësisht me kodet: I.3.A "*Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike*"; I.3.B "*Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare dhe sendeve të çmuara gjatë transportit*", sipas Ligjit Nr. 75/2014,²⁶ si dhe me kodin I.3.C "*Qendra të trajnimit privat të punonjësve të SHPSF*", sipas VKM Nr. 358, datë 26.05.2009, i ndryshuar.²⁷ Kjo ndarje është e nevojshme për vetë natyrën e veçantë të secilit nga llojet e aktiviteteve në nënkategorinë përkatëse, por dhe të masave specifike teknike e profesionale që duhen marrë në kryerjen e shërbimeve të sigurisë nga subjektet e licencuara. Nga ana tjetër procedurat e licencimit janë të përcaktuara qartë në ligjin e SHPSF dhe në mënyrë të detajuar në udhëzimin përkatës të ministrit të Brendshëm,²⁸ duke filluar nga paraqitja e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, verifikimin e besueshmërisë, verifikimin e kushteve teknike e profesionale në mjediset ku do të zhvillohet aktiviteti dhe të pajisjeve e mjeteve të shërbimit, trajnimin dhe pajisjen me dëshmi të personelit si dhe certifikatën përkatëse, etj.

4.2. Funksionimi i SHPSF-së

Mbas licencimit, subjektit për SHPSF ose Qendër e Trajnimit Privat (QTP) i lind e drejta e funksionimit në fushën përkatëse të sigurisë, sipas llojit të licencës. Ligji i njeh gjithashtu të drejtën një subjekti që të aplikojë dhe fitojë të tre llojet e licencave, por me kushtin që për secilin aktivitet të licencuar të ketë të punësuar *drejtues teknik* më vete. Ky kusht është i lidhur me kërkesat e veçanta që ka secili nga llojet e shërbimit në detyrimet ligjore, për standardet profesionale, për trajnimin dhe pajisjen me mjetet e

²³ Arjan Dyrmishi, Gentiola Madhi. Sektori Privat i Sigurisë në Shqipëri, faqe 7. (Dyrmishi and Madhi 2015)

²⁴ Ligji Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

²⁵ Ligji Nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shtojcë.

²⁶ Ligji Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", neni 7.

²⁷ VKM Nr. 358, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar, Aneksi 4, Fusha I, Kategoria I.3.

²⁸ Udhëzim i ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 "PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE", Kreu I, Parag. A, pikat 1-23. (Ministri i Brendshëm 2018)

nevojshme të shërbimit e punonjësve të punësuar; p.sh. të tjera kërkesa ka për ruajtjen fizike të një objekti, në raport me shoqërimin e vlerave monetare e sendeve të çmuara apo për funksionimin e QTP, etj. Nga ana tjetër, ndërkohë që titullari i subjektit të SHPSF kryesisht merret me drejtimin ekonomik-administrativ të biznesit, si shpenzimet, investimet, fitimet, lidhje e kontratash, marrëdhëniet me organet e fiskut, etj., është pikërisht drejtuesi teknik që merret me planifikimin, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e shërbimeve të ruajtjes fizike që ofron subjekti i licencuar, pra me atë që mund ta quajmë “menaxhim operacional”. Kjo kuptohet më mirë po të rendisim disa nga detyrat kryesore e parashikuara në aktet normative²⁹ për drejtuesin teknik, si:

- asiston, për aspekte teknike, titullarin e SHPSF-së në nënshkrimin e marrëveshjes apo kontratës me palën kontraktuese për objektin që merr në ruajtje shoqëria;
- harton rregullat e funksionimit të SHPSF-së, në lidhje me ruajtjen e objektit;
- është përgjegjës për njohjen e punonjësve vartës me legjislacionin përkatës dhe për organizimin e trajnimit të tyre;
- përpilon plandislokimet me skemat e ruajtjes për çdo objekt në ruajtje dhe, për situata;
- emergjente, parashikon plane të veçanta;
- është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje;
- është përgjegjës për planifikimin, organizimin, menaxhimin, kontrollin, inspektimin, përpilimin e dokumentacionit, sigurimin e armatimit dhe të pajisjeve përkatëse të shërbimit të sigurisë fizike;
- ka përgjegjësinë të konstatojë dhe të analizojë të metat e dobësitë e punonjësit të shërbimit, si dhe të marrë masa për shmangien dhe përmirësimin e tyre;
- jep masa disiplinore ndaj punonjësit të shërbimit;
- kryen, sipas programit, edukimin profesional të punonjësve të shërbimit me akte normative;
- nuk lejon marrjen e detyrës nga punonjësit pa uniformë, armatim apo pajisje e mjetet e shërbimit;
- merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes në territorin e objektit që ka në ruajtje dhe njofton Policinë e Shtetit.

Disa nga llojet e shërbimeve të ligjëruara³⁰ me të cilat operojnë SHPSF janë:

- roje objekti për ruajtjen fizike;
- punonjës shërbimi për shoqërimin e vlerave monetare dhe sendeve të çmuara;
- truproje për ruajtjen e personave;
- sisteme sinjalizuese elektronike për ruajtjen e objekteve;
- punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;
- punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;
- punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit, si dhe atyre të blinduara;
- shoqërues i qenit të shërbimit;
- përgjegjës shërbimi.

²⁹ Ligji Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 26.

³⁰ Udhëzimi i ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018, “PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE”, Kreu V, Parag. A, pika 11.

Ndërsa fuqitë ekzekutive që ligji përkatës³¹ ju njuh punonjësve të SHPSF janë:

- punonjësi i shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj;
- punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës;
- punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj;
- punonjësi i shërbimit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës të SHPSF-së, e përdor armën e zjarrit në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme;
- të dëmtuarit nga përdorimi i forcës i jepet ndihma e parë mjekësore, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundshme;
- struktura e policisë vendore duhet të vihet në dijeni për çdo rast të përdorimit të forcës.

Është pikërisht kjo ndarje e përgjegjësive, detyrave dhe roleve ndërmjet punonjësve të SHPSF-ve që dikton nevojën e trajnimit të tyre para dhe gjatë shërbimit, jo vetëm si kusht për marrjen e certifikatës përkatëse, por mbi të gjitha për të marrë masat dhe kryer me profesionalizëm e përkushtim detyrat për ruajtjen fizike të objekteve, aktiviteteve e personave; parandalimin e ngjarjeve kriminale apo aksidentale, si dhe minimizimin e pasojave në rastet e fatkeqësive natyrore.

5. Trajnimi i personelit të SHPSF

5.1. Trajnimet bazë

Sipas udhëzimit të ministrit të Brendshëm, Kreu III “Procedurat për trajnimin e personelit të SHPSF-së”³², *trajnimet bazë* që zhvillohen për personelin e SHPSF-ve janë:

- kurs trajnimi për pajisjen me *dëshmi aftësie të drejtuesit teknik* të SHPSF-së, me kohë zgjatje jo më shumë se tri ditë;
- kurs trajnimi për pajisjen me *certifikatë për trajnerë* në QTP të punonjësve të SHPSF-së, jo më pak se 5 ditë;
- kurs trajnimi për pajisjen me *dëshmi aftësie e punonjësit të shërbimit*, me kohëzgjatje jo më pak se 10 ditë.

Pra siç shihet, trajnimet bazë janë të detyrueshme për tre pozicione të personelit në SHPSF, si *drejtuesit teknik, trajnerët në QTP dhe punonjësit e shërbimit*. Kjo është e kuptueshme dhe e domosdoshme pasi këto janë pozicionet, ose në terma profesional funksionet kryesore, që mbulojnë detyrat dhe përgjegjësitë primare gjatë shërbimit të ruajtjes fizike nga shoqëritë privatët. Në ndryshim nga udhëzimi i mëparshëm, në udhëzimin e ri nuk është toleruar trajnimi këtyre funksioneve nga QTP, por vetëm nga Akademia e Sigurisë, gjë që tregon se autoriteti vendimmarrës, në këtë rast ministri i Brendshëm, ka vlerësuar se këta persona duhet t’i nënshtrohen trajnimeve sa më profesionale dhe nga institucione të specializuara shtetërore, siç është Akademia e

³¹ Ligji Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, nenet 33 dhe 35.

³² Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018, “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, Kreu III, Parag. A, pika 1.

Sigurisë. Kjo duke marrë shkas edhe nga disa ngjarje të rënda të ndodhura gjatë vitit 2016, siç ishin vjedhjet e përsëritura gjatë transportit vlerave monetare të disa bankave apo disa dyqaneve të shitjes së sendeve të çmuara.

Duke qenë se ky përcaktim i udhëzimit është kontestuar nga disa drejtues të SHPSF-ve, kryesisht ato shoqëri që kanë fituar edhe licencën për nënkategorinë I.3.C, (funksionimin edhe si QTP), është me interes të sjellim disa eksperiencë në vende me demokraci të zhvilluar se si procedohet atje për trajnimin e punonjësve të shërbimeve private të sigurisë.

Në SHBA, ndonëse ka ndryshime nga një shtet i federatës tek tjetri, përgjithësisht mbisundon e drejta e trajnimit nga shoqëri private të licencuara, bile në ndonjë shtet edhe me të drejta që të trajnojnë punonjës të agjencive publike, deri ato ushtarake. Kjo është e kuptueshme për një vend si SHBA, ku liria ekonomike është e pakufishme. Por kjo liri është shumë e disiplinuar nga fakti se ky lloj aktiviteti ekonomik, pra trajnimi i forcave private të sigurisë, duhet të jetë i licencuar, ku hynë në veprim mekanizmat e kontrollit shtetëror apo komunitar. Aplikimi i këtij lloj mekanizmi “check and balance” përbënë garanci se trajnimi i forcave private të sigurisë nuk do të degjeneroj si pasojë e qëllimit të fitimit apo konkurrencës së pandershme.

Në vendet e hershme të BE-së, gjithashtu gjejmë eksperiencë të ndryshme, që varen nga tradita historike e krijimit dhe funksionimit të shërbimeve private të sigurisë, ku përgjithësisht dallimi është i lidhur me ndikimin e dy shkollave kryesore socio-politike, që janë ajo anglosaksone apo romake.³³ Ndërsa me zgjerimin e BE-së edhe me shtete që vinë nga ish-vendet e Lindjes, konstatohet se në këto shtete ka tendenca që trajnimi i forcave të sigurisë të jetë e mbetet monopol i institucioneve shtetërore, sa për shkak të traditës nga ish-shtetet komuniste, aq edhe për mungesë besueshmërie tek institucionet private të sigurisë akoma të brishta.

Nga ana tjetër, grupimi i pothuajse të gjitha trajnimeve të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë në Akademinë e Sigurisë, kërkon pa tjetër shtim të kapaciteteve të sektorit apo njësisë mësimore që do të kryejë këto trajnime, sepse parashikohet që do t'i nënshtrohen kësaj procedure rreth 9000 persona për trajnimin bazë, pastaj një pjesë e tyre do të kalojnë në trajnime të specializuara, ndërsa të gjithë do të kryejnë trajnime të vazhdueshme gjatë vitit. Brenda një viti Akademik sektori përkatës mund të zhvillojë maksimalisht trajnim për 100 persona në muaj, ndërkohë që i duhet të përgatis apo rishikojë herë pas here kurrikulat për çdo program trajnimi, si dhe të monitorojë trajnimet që do të zhvillohen nga QTP-ët. Në një përlllogaritje paraprake, që i është bërë prezent edhe drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit, rezulton se me stafin dhe mjediset e trajnimit që disponon aktualisht Akademia e Sigurisë për trajnimin e shërbimeve private të sigurisë do të duhen afërsisht 10 vjet për të përfunduar trajnimin fillestar për të gjithë personelin e SHPSF-ve në vendin tonë. Në tabelën 3 pasqyrohen treguesit e trajnimeve të bëra nga Akademia e Sigurisë nga viti 2015 deri tani.

Tabela 2

KURSE	REGJISTRUAR	PJESMARRES	PAJISUR ME DESHMI
22	1321	1129	1129

³³ Di Raimondo, M. “Testo unico delle Leggi di Pubblica sicurezza”, faqe 247 – 262. (Raimondo 2000).

Gjithsesi, duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi në vendin tonë, mund të themi se trajnimi bazë i punonjësve të shërbimeve private të ruajtjes fizike konsiston së këto drejtime kryesore:

Së pari: Njohja me legjislacionin në fushën e sigurisë fizike, si dhe akteve nënligjore në funksion të zbatimit të këtij legjislacioni. Kjo fazë e trajnimit është e rëndësishme pasi jo të gjithë kandidatët që do të pranohen në SHPSF janë të informuar apo vinë nga radhët e personave që kanë njohuri të mëparshme për këtë lloj legjislacioni. Shumica e tyre vinë nga jeta civile ose me eksperiencë që nuk kanë pasur asnjë lidhje me konceptet apo nocionet e sigurisë publike në tërësi apo asaj të ruajtjes fizike të objekteve, personave e aktiviteteve në veçanti. Nga ana tjetër njohja e legjislacionit ka për qëllim ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e misionit që do të kryejnë gjatë shërbimit, për të drejtat e detyrimit, për procedurat e standardet e punës, për kodin e etikës së shërbimit, etj.

Së dyti: Trajnimi bazë ka për qëllim krijimin e shprehive të punës ose siç mund të thuhet ndryshe shndërrimin e tyre në profesionist të shërbimeve të ruajtjes fizike. Në këtë fazë të trajnimit ata marrin njohuri për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të ruajtjes fizike, veprimet taktike e teknike që duhet të kryejnë gjatë shërbimit, sjelljet dhe qëndrimet në shërbim, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve të shërbimit, etj.

Së treti: Trajnimi bazë ka për qëllim gjithashtu unifikimin dhe standardizimin e veprimeve të gjithë punonjësve të SHPSF-ve, kryesisht sa i përket respektimit të lirive e të drejtave të njeriut, zbatimit të standardeve profesionale dhe të përdorimit të mjeteve e pajisjeve të shërbimit. Ndonëse SHPSF-ët janë subjekte private nga pikëpamja e zhvillimit të aktivitetit të tyre ekonomik, fusha e veprimit të tyre, siç është ajo e sigurisë fizike, i detyron të respektojnë disa parime themelore në fushën e te drejtave e lirive të njeriut, të theksuara këto edhe në Kodin e Sjelljes³⁴ së këtyre shoqërive. Kështu kontrolli i personave, përdorimi i forcës apo dhënia e ndihmës së parë, etj., janë veprime ekzekutive që janë të lidhura fort me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Së katërti: Trajnimi bazë ka për qëllim dhënien e informacionit dhe njohurive të nevojshme dhe të mjaftueshme për secilën kategori të licencuar, në përputhje me përgjegjësitë që mbulon, sipas parimit “know-how”. Ky lloj trajnimi është e limituar sa për efekt të kohës së kufizuar të përcaktuar në udhëzimin përkatës, si në pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit 4.1 të këtij nëntitulli, por edhe për faktin se çdo niveli të shërbimit i duhen dhënë njohurit bazike, ose e thënë ndryshe të domosdoshme, për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara, prandaj dhe quhet *trajnim bazë*.

5.2. Trajnimet e specializuara

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit përkatës³⁵, trajnimet e specializuara janë:

- kurs trajnimi për përgjegjës shërbimi për SHPSF-t;
- kurs trajnimi për operator për Qendrën e Kontrollit;
- kurs trajnimi për truporj për sigurimin fizik të personave;
- kurs trajnimi për punonjës për shoqërimin e vlerave monetare gjatë transportit;
- kurs trajnimi për punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve të alarmit;
- kurs trajnimi për shoferë për drejtimin e mjeteve të blinduara për shoqërimin

³⁴ International Code Of Conduct For Private Security Service Providers, faqe 8–9.

³⁵ Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018, “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, Kreu III, parag. A, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “e”.

e vlerave monetare.

Këto kurse “...zhvillohen në Akademinë e Sigurisë ose Qendrën e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së, sipas përzgjedhjes së secilit kandidat”.³⁶

Siç kuptohet nga këto përcaktime të udhëzimit, trajnimet e specializuara kanë për qëllim:

Së pari: Të aftësojnë punonjësit e shërbimit të SHPSF-ve për kryerjen e disa prej detyrave specifike, në kuadër të shërbimeve që ata mbulojnë, të cilat dallohen për nga lloji i veçantë i përgjegjësive ligjore e profesionale. Kështu p.sh. operatori i Qendrës së Kontrollit ka përgjegjësi shumë specifike që lidhen kryesisht me monitorimin e sistemeve të ruajtjes elektronike, mënyrën e njoftimit dhe operimit në rast alarmi, përdorimin e shpejtë e të saktë të mjeteve të komunikimit, etj.

Së dyti: Realizimi i këtyre përgjegjësive të veçanta është i lidhur me disa *njohuri dhe shprehje* teknike pune që duhet të fitoj punonjësi i shërbimit gjatë trajnimit të specializuar për pajisjet e veçanta të shërbimit që përdoren në detyrat specifike, si p.sh. ndërtimin e funksionimin e pajisjeve të komunikimit, atyre të ruajtjes elektronike, atyre të sinjaleve të alarmit në rastin e operatorëve të Qendrave të Kontrollit apo mënyra e drejtimit të mjeteve të blinduara për drejtuesit e këtyre mjeteve gjatë shoqërimit të vlerave monetare e të çmuara, etj.

Së treti: Këto lloj trajnimesh mund të kryhen edhe nga qendrat e trajnimit privat, por në kushte kur programet e tyre duhet të jenë përgatitur e miratuar nga Akademia e Policisë; testimi duhet bërë nën monitorimin e përfaqësuesve të saj, të cilët përgatisin dhe pyetësorin e testeve. Gjithashtu Akademia e Policisë ushtron kontroll gjatë gjithë procesit të zhvillimit të kurseve në këto QTP.

5.3. Trajnimet në vazhdimësi

Edhe për këto lloje trajnimesh udhëzimi përkatës i ministrit të Brendshëm³⁷ është i qartë dhe pa asnjë mëdyshje, kur përcakton si të tilla:

- kurs trajnimi të vazhdueshëm për drejtues teknik të SHPSF-së, me kohëzgjatje një ditë në vit;

- kurse të vazhdueshme për punonjës shërbimi, me kohëzgjatje jo më pak se tri ditë në vit.

Siç mund të kuptohet edhe nga emërtimi i këtyre kurseve, ato kanë për qëllim:

Së pari: Të mbajnë të freskëta njohuritë ligjore dhe profesionale të punonjësve të SHPSF-ve gjatë gjithë kohës së tyre të punësimit.

Së dyti: Të informojnë punonjësit e SHPSF-ve me ndryshimet ligjore apo të reja në fushën e standardeve profesionale apo të teknologjisë në përdorim.

6. Përfundime dhe rekomandime

Nisur nga sa shtjelluam më sipër, mund të dalim në disa përfundime dhe të sugjerojmë disa rekomandime:

- trajnimet e punonjësve të SHPSF-ve janë *veprimtari të rëndësishme dhe të detyrueshme*³⁸ për të krijuar një trup profesionistësh në shërbimet private të sigurisë, të

³⁶ Po aty, Kreu III, parag. A, pika 4, germa “f”.

³⁷ Po aty, Kreu III, parag. A, pika 1, gërmat “c” dhe “f”.

³⁸ The Sarajevo Code of Conduct for Private Security Companies, faqe 2. (SEESAC 2006)

aftë të kryejnë më ndërgjegje, vetëbesim, disiplinë, kompetencë, profesionalizëm dhe përkushtim misionin për ruajtjen e personave, aktiviteteve dhe objekteve publike e private;

- trajnimet duhet të jenë të bazuara në aktet ligjore e normative që rregullojnë aktivitetin e subjekteve të SHPSF-së, pasi në të kundërt ato konsiderohen të pavlefshme ose rrezikohen të dalin jashtë misionit të përcaktuar;

- trajnimi i punonjësve të SHPSF-ve nga institucione shtetërore, si Akademia e Sigurisë, kërkon pa tjetër shtimin me kapacitete njerëzore të strukturave që merren direkt me këto lloje trajnimesh, pasi stafi mësimdhënës ekzistues është shumë i reduktuar në raport me numrin e përgjithshëm të personave që duhen trajnuar;

- në të gjitha programet e trajnimeve duhet të gërshetohet më mirë raporti midis moduleve teorike dhe atyre praktike, sipas niveleve, ku për punonjësit e thjeshtë të shërbimit raporti duhet të anojë nga moduli i veprimeve praktike, ndërsa për nivelet e tjera nga moduli teorik.

Bibliography

1. Calesini, Giovanni. *Leggi di pubblica sicurezza e illeciti amministrativi*. Roma: Laurus Robuffo, 2000.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. *Dërgohen të dhëna statistikore për SHPSF-ët*. Shkresë nr. 2561, datë 11.04.2018, Tiranë: Departamenti i Sigurisë Publike, 2018.
3. Dyrmishi, Arjan and Gentiola Madhi. "Sektori Privat i Sigurisë në Shqipëri." 2015. <http://www.ppps.dcaf.ch/sites/default/files/uploads/A%20force%20for%20good%20Albania%20-%20web.pdf> (accessed Maj 8, 2018).
4. Federal Department of Foreign Affairs (FDFA). *The Montreux Document*. September 17, 2008. <https://www.eda.admin.ch/eda/en/home/foreign-policy/international-law/international-humanitarian-law/private-military-security-companies/montreux-document.html> (accessed Maj 2, 2018).
5. First Security. *The Growth & Development of the Private Security Industry*. Decembre 25, 2013. <https://www.firstsecurityservices.com/the-growth-development-of-the-private-security-industry/> (accessed February 13, 2018).
6. Gjeçovi, At Shtjefën. "Kanuni i Lek Dukagjinit." Maj 26, 2009. <https://www.slideshare.net/keti/kanuni-i-lek-dukagjinit> (accessed Maj 9, 2018).
7. ICoCA. "The International Code of Conduct for Private Security Service Providers (ICoC)." November 2010, 2010. https://www.icoca.ch/sites/all/themes/icoca/assets/icoc_english3.pdf (accessed Maj 2, 2018).
8. Ilija, Frano. *Kanuni i Skanderbegut*. Milot: Rosa, 1993.
9. Këshilli i Ministrave. *VKM Nr. 358, datë 26.5.2009, Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta, i ndryshuar*. Tiranë: QTB, 2009.
10. Kuvendi. "Ligji Nr. 7550, datë 20.01.1992, Për Policinë e Objekteve." *Fletore Zyrtare Nr. 1*, Maj 10, 1992.
11. —. "Ligji Nr. 75/2014, Për shërbimin privat të sigurisë fizike." *Fletore Zyrtare Nr. 124*, Gusht 8, 2014.
12. —. "Ligji Nr. 7696, datë 07.04.1993, Për shërbimin e rojeve civile." *Fletore Zyrtare Nr. 5*, Maj 18, 1993.
13. —. "Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008, Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare." *Fletore Zyrtare Nr. 60*, Maj 6, 2008.
14. —. *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar*. Tiranë: QBT, 2017.
15. —. "Ligji Nr. 10081, datë 23.2.2009, Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë." Shkurt 23, 2009. http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/licenca/Ligj%20Nr_10%20081_%202322009.pdf (accessed Maj 11, 2018).
16. Ministri i Brendshëm. *Udhëzimi nr. 130, datë 05.03.2018, "Për funksionimin e SHPSF"*. Fletore Zyrtare Nr. 31, Tiranë: QZB, 2018.
17. Di Raimondo, Marco. *Testo unico delle Leggi di Pubblica sicurezza*. Roma: Laurus Robuffo, 2000.
18. RTI International. "The Private Security Industry: A Review of the Definitions, Available Data Sources, and Paths Moving Forward." December 2010. <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/bjs/grants/232781.pdf> (accessed Maj 8, 2018).
19. SEESAC. "The Sarajevo Code of Conduct for Private Security Companies." July 30, 2006. <http://www.seesac.org/f/docs/Private-Security-Companies/The-Sarajevo-Code-of-Conduct-for-Private-Security-Companies-EN.pdf> (accessed Maj 11, 2018).
20. Shkëmbi, Hasan. *Policia Shqiptare*. Tiranë: Mirgeeralb, 2014.
21. Sinjari, Stavri. "Sër Robert Pil, krijues i policisë moderne." *Policia dhe Siguria Nr. 7*, Shtator 2017.

Shehaj, B.
◀ Trajnimi
i punonjësve
të SHPSF ▶

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Riorganizimi i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, kërkesë e kohës



■ MSc. Adriatik AGO

adriatik.ago@asp.gov.al

Abstrakt

Miratimi si përfundim i paketës kryesore të ligjeve për reformën në drejtësi, me standarde të vendeve të BE-së, ka krijuar një taban të fuqishëm për thellimin e saj edhe në drejtim të reformimit të strukturës së policisë gjyqësore. Kjo paketë, ka hapur horizont për të përzgjedhur për kushtet e vendit tone, modelin më të mirë të mundshëm të policisë gjyqësore, si struktura që merret me hetimet paraprake të veprave penale, por të evidentuar tashmë si ndër hallkat më të dobëta në tërë organigramën strukturore, si në Policinë e Shtetit ashtu edhe në institucione të tjera që ligji ju jep të drejtën të kenë një strukturë të tillë. Evidentimi i nivelit të ulët të efikasitetit të saj, është bërë jo vetëm nga auditet e brendshme të institucioneve si, prokuroria, Policia e Shtetit, gjykatat, por edhe të aktorëve të tjerë të jashtëm. Janë të shumta dokumentet e nivelit strategjik apo dhe të studimeve të kryera nga këta aktorë, që në analizën e vlerësimit të performancës së sigurisë, kanë arritur në këto konkluzione. Domsdoshmërinë e ristrukturimit të saj e bën dhe fakti se paketa e reformës në drejtësi, kryesisht në institucionin e Prokurorisë ka krijuar dhe struktura të tjera me kompetenca hetimore si BKH-it, etj., të cilat duhen të merren në konsideratë dhe të vlerësohen seriozisht në procesin e ristrukturimit të policisë gjyqësore, sidomos të asaj që vepron sot në Policinë e Shtetit.

Fjalëkyçe:

polici gjyqësore, Polici e Shtetit, Byroja Kombëtare e Hetimit, procesi i të provuarit, shërbimet e policisë gjyqësore, kapacitetet hetimore, atribut i policisë gjyqësore.

« Ago, A.
Riorganizimi
i policisë
gjyqësore
në Policinë e
Shtetit, kërkesë
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11 2018

1. Hyrje

Ekspierienca e fituar deri më sot, dallimet dhe ndryshimet që janë përcaktuar në ligjin aktual apo në akte të tjera nënligjore, për sa i përket shërbimeve të policisë gjyqësore, me seksionet e policisë gjyqësore pranë prokurorisë, dashur pa dashur kanë krijuar profile dhe vendosur kritere të ndryshme, si në drejtim të rekrutimeve, të arsimimeve, trajtimeve financiare e administrative. Gjithashtu, mos vënia në eficence e kësaj strukture në hetimin e kriminalitetit apo të çdo shkelje ligjore që konsumon figurë krimi, ka sjellë që edhe drejtime të tjera si, respektimi i kërkesave, për burimet njerëzore, për çështjet disiplinore, për lëvizjet, transferimet, emërimet, trajnimet të personelit, të mos jenë në lartësinë e duhur. E theksojmë edhe një herë, që më shumë rëndësi paraqet riorganizimi i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, si e vetmja strukturë e specializuar dhe përgjegjëse për dokumentimin e veprimtarisë kriminale, në çdo formë që ai shfaqet. Të rejat e ligjit për Policinë e Shtetit, reforma territoriale administrative dhe shumë probleme të evidentuara për këtë strukturë, kërkojnë medoemos reformimin e këtij shërbimi, dhe në kushtet aktuale, t'i bashkëlidhet reformës në drejtësi, si një nga reformat që lidhet me ekzistencën e shtetit demokratik, me respektimin e parimeve bazë të funksionimit të tij, por edhe me luftën ndaj fenomeneve të tilla si korrupsioni, krimi i organizuar, terrorizmi etj.

2. Sjelljet e reja të ligjeve reformatore për policinë gjyqësore

Në përbërje të paketës reformatore në drejtësi, janë disa ligje që interferojnë në reformimin e policisë gjyqësore. Ato në vetvete kanë kompozuar institucionet hetimore me objekte konkrete. Në mënyrë të veçantë, sjellje të reja ka bërë ligji nr. 35/2017 “Për

Ago, A.
« Riorganizimi
i policisë
gjyqësore
në Policinë e
Shtetit, kërkesë
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

disa ndryshime në K. Pr. Penale”, ku kemi një shtesë të nenit 30, pika 3, të K. Pr. Penale, me këtë përmbajtje: “. . . *Funksionet e parashikuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, kryhen nga oficerët e policisë gjyqësore. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, kanë statusin e oficerit të policisë gjyqësore*”, në nenin 33, bëhen ndryshime që në titull, ku theksohet: “*Varësia funksionale e policisë gjyqësore*”, dhe me përmbajtje krejt të re ndryshojnë pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, ndërkohë që shfuqizohet pika 4 e nenit 33.¹

Tepër të veçanta janë sjelljet e ligjit 95/2016, “*Për krijimin e institucioneve për luftën ndaj krimit të organizuar e korrupsionit*”, ku për herë të parë në vendin tonë pas viteve '90, sanksionohet krijimi i strukturës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, (SPAK), ku nënkuptohen prokuroria e posaçme dhe BKH.

Vet Byroja Kombëtare e Hetimit, na paraqitet si një strukturë e specializuar, e cila ka në përbërje të saj hetuesit dhe shërbimet e policisë gjyqësore. Të rejat e ligjeve, në mënyra të ndryshme sjellin efekte juridike dhe për institucionin e tjera, por sidomos për Policinë e shtetit, p.sh., neni 31 i ligjit 95/2016 përcakton se: “*Çdo punonjës i Policisë së Shtetit, kur vjen në dijeni për kryerjen e një veprë penale të parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, njofton menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit nxjerr një rregullore mbi metodologjinë e informimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit*”.

Në vazhdim, . . . pika 3 e po këtij neni, përcakton se: “*Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj . . . hetuesit dhe punonjësit e administratës. Ajo ka gjithashtu në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore, të përbëra nga oficerët të Policisë Gjyqësore, nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilët janë nën drejtimin administrativ të . . . dhe nën varësi procedurale hetimore të Prokurorisë së Posaçme*”. Neni 29, pika 4 përcakton se: “*Çdo oficer i Policisë së Shtetit, agjent apo oficer i Policisë Gjyqësore ekzekuton urdhrat e prokurorit të Prokurorisë së Posaçme ose vendimet e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për kontrolle ose arrestime*” . . . në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, kur urdhri parashikon se ekzekutimi duhet të kryhet prej tij. “. . . *Ata përbushin edhe çdo detyrë apo kërkesë tjetër ligjore të urdhëruar nga një prokuror i posaçëm ose nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*”. Neni 31, pika 4, thuhet: “*Organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit rregullohet në përputhje me këtë ligj dhe urdhrat e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme*”. I rëndësishëm është përcaktimi i nenit 39, me titull “*Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit*”, ku pika 1, saktëson se: “*Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore. Qëllimi i tyre është të rrisin bashkëpunimin dhe komunikimin midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe institucioneve të tjera, si dhe të ndihmojnë në hetimet e Prokurorisë së Posaçme, që kryhen nga institucione të tjera*”²

Pra, është më se e qartë se këto ligje, por edhe të tjera që mund të hartohen për shkak të nevojave, në përfundim të qëllimit të tyre, e kanë skicuar kompozimin e institucioneve të reja që do të merren me hetimet e krimeve të kompetencës tyre, njëkohësisht është skicuar dhe policia gjyqësore e këtij niveli. Do të jenë aktet e brendshme të titullarëve që do të bëjnë kompozimin real faktik të misionit, strukturat, funksionet, përshkrimet e detyrave, deri tek detajimet e shumë marrëdhënieve të tjera juridike

Agó, A.
« Riorganizimi
i policisë
gjyqësore
në Policinë e
Shtetit, kërkesë
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11 2018

¹ Ligji nr 35/2017 “Për disa ndryshime në K. P. Penale” i ndryshuar, nenet 22, 26.

² Ligji 95/2016, “Për krijimin e Institucioneve për Luftën ndaj Krimit të Organizuar e Korrupsionit”, nenet 29-39, etj.

profesionale që në këto raste lindin normal. Ajo, patjetër që do të jetë një veprimtari e studiuar, serioze dhe do kërkojë kohën e vet, pasi miratimi i ligjeve është fillimi i një pune dhe jo mbarimi i saj, që rëndonte në praktikat e administratës, ka shumë raste që ligjet “ndryshken” në sirtarë dhe nuk gjejnë dritën e zbatimit të tyre. Gjykoj se kësaj radhe do të jetë ndryshe...

3. Problemet e mbartura të policisë gjyqësore

Duke përkrahur dhe duke i uruar suksese reformës në drejtësi në krijimin e institucioneve të reja të hetimit, shqetësimi që dua të ndaj me opinion është tërësisht tjetër. Çfarë do të bëhet me policinë gjyqësore që funksionon sot sipas ligjit organik, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, ashtu si dhe në Policinë e Shtetit, në nivelin vendor të saj? Ka vite që ky problem është hedhur për diskutim, mendoj se në heshtje, shumica e njerëzve që e njohim mirë dhe punojnë në këto struktura, pranojnë shqetësimin se mënyra aktuale e kompozimit nuk funksionoi. Në shumë dokumente të Policisë së Shtetit ka qenë vendosur objektivi i riorganizimit të këtij shërbimi. Përmendim këtu dokumente si “Strategjia e Rendit Publik 2015-2020”, miratuar me V.K.M. nr 702, datë, 26.08.2015, Planin e Veprimit 2015-2017, bashkëlidhur saj,³ Programi Vjetor 2017⁴ e në vazhdim, etj., janë të parashikuar dhe vendosur si objektiv çështja e ristrukturimit të policisë gjyqësore. Por me sa duket ende nuk është marrë iniciativa as nga Policia e Shtetit as nga Prokuroria e Përgjithshme. Polica e Shtetit edhe në këto momente, nuk mund të bëhet lider në këto reforma, por vetëm bashkëpunuese me institucionet kryesore që kanë këtë përgjegjësi.

Sot çdokush, person i fushës ose jo, mund të shtrojë pyetjen se: a duhen reformuar strukturat hetimore të Policisë së Shtetit? A është efikas modeli aktual i policisë gjyqësore që është instaluar? A është ai në harmoni me paketën e reformës në drejtësi? A i përgjigjet ai profesionalisht hetimit të volumit të veprave penale të nivelit vendor që kanë impakt dhe ndjeshmëri për sigurinë e qytetarëve? A janë të trajnuar burimet njerëzore që punojnë në këto struktura? E të tjera shqetësime që mund të ngrihen.

Përpos këtyre, në raportet e Komisionit Evropian 2014, për strukturat e sigurisë, kryesisht për Policinë e Shtetit, konstatohet se: “Përfshirja e policisë në korrupsion ka ndikuar në pengimin e hetimeve të thelluara të krimit të organizuar. Korrupsioni vazhdon të mbetet problem serioz, lufta ndaj të cilit në të gjitha nivelet, është një nga prioritetet e përcaktuara për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE”⁵. Pra, shqetësimi aktual është, se sa janë kapacitetet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, të përballojnë cilësisht këtë përgjegjësi ligjore, për të cilën duhet pranuar se: problematikat janë të shumta, ngjarjet e rënda të pazbuluara kanë zënë rrënjë dhe ende nuk po shikojnë dritën e zbardhjes, vjedhjet e banesave, të automjete, të kompanive e bizneseve ekonomike, dëmtimet e pronës, krimet kundër mjedisit, përdorimi i drogave nëpër shkolla, armëmbajtja pa leje, të cilat janë tepër shqetësuese për komunitetin. Realizohen arrestime në flagrancë ose nga rastësia apo dhe nga kryerja e operacioneve të parashikuara, ngrihen akuzat e para, bëhet zhurmë mediatike dhe mbas njëfarë kohe katandiset procedimi penal në mënyrën më të keqe të mundshme, akuzat firojnë,

Ago, A.
« Riorganizimi i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, kërkesë e kohës »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

³ Dokumenti i Strategjisë së Rendit Publik dhe Plani Veprimit 2015-2020, miratuar me VKM nr 702, datë 26.8.2015.

⁴ Plani Vjetor i Policisë së Shtetit/2017.

⁵ Progres Raportet e Komisionit Evropian për Sigurinë /2015.

provat zbehen, masat e sigurimit ndryshojnë dhe strukturat e hetimit ose nuk ndjekin procedimin deri në fund ose mendojnë se dorëzimi i materialeve të para konsiderohet përfundimi i detyrës. Sot, në modelet e punës së institucioneve të akuzës, ku bashkautor është dhe policia gjyqësore e Policisë së Shtetit, është hequr dorë nga analizat dhe nxjerrjet e përgjegjësi, kur deklarohet një pafajësi, kur ndryshon një akuzë, një masë sigurie, kur shkelen rregullat e sekretit apo afatet e hetimeve, etj., dhe këto konstatohen në seancë gjyqësore nga mbrojtja ose media etj. Nuk kemi parë që në raste të tilla, të jetë mbajtur qëndrim, rasti të jetë analizuar, personat përgjegjës të jenë identifikuar, ndëshkuar apo të jenë marrë masa të mospërsëritjes nga të tjerët të një gjëje të tillë. Nëpër ligje, kode, e deri të shumë akteve të përbashkëta të organit të akuzës me Policinë e Shtetit, të duket se gjërat janë të rregulluara, çdo gjë “shkon vaj”, por në praktikë as që bëhet fjalë për respektimin, pse jo dhe për njohjen e tyre.

Është krijuar praktike joracionale që policia gjyqësore mjafton të shkojë në vendngjarje, të kryejë ato veprime të detyrueshme, të bëjë ndonjë shoqërim, ndalim, arrestim apo ndonjë kontroll dhe brenda afatit të përcjellë materialet në prokuroi. Por, pak shqetësohemi për cilësinë e veprimeve. Ndoshta edhe për shkelje të normave të procedurës penale, askush nuk ve re respektimin e metodikave kriminalistike mbi fiksimin, marrjen e transportin e provës, mënyrat e pyetjes dhe intervistat me të shoqëruarit, të ndaluarit apo të arrestuarit. Procesverbalet e pyetjeve, edhe për ngjarje të rënda katandisen në një faqe me disa pyetje të rëndomta që nuk bie “erë pune” e mirëfilltë policore e juridiko-procedurale penale. Është hequr dorë nga praktikat motivuese për bashkëpunimin e strukturave të informacionit me ato të policisë gjyqësore, siç janë, “. . . analizat e përbashkëta të rezultateve të hetimit ose të informacionit të grumbulluar, të vlerësimit të informacioneve që mund të vinë nga burimet apo dhe nga shërbimet me uniforme”⁶.

Nuk vlerësohet sa duhet roli i policisë shkencore, grumbullohen me dhjetëra e qindra objekte, pa u kujdesur më parë për njohjen e mekanizmit të ngjarjes, metodë shkencore që orienton në selektimin dhe fiksimin e objekteve gjurmëmbajtës, etj. Policia gjyqësore nuk e ndjek në dinamikë dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të një autori, pasi dorëzimi i materialeve dhe mosdelegimi në kthim, ka bërë shkëputjen e kësaj faze. Një o.p.gj., nuk e di se çfarë ndodh me çështjet penale, ku ai ka kryer veprimet e para, nuk e di se kanë ndryshuar masat e sigurimit, akuzat, se provat mund të jenë shtuar ose pakësuar; ai nuk merr pjesë në seancat gjyqësore për të shoqëruar ose ndihmuar prokurorin në përfaqësimin e mbrojtjes e akuzës, pasi një gjë e tillë nuk parashikohet as në ligje dhe akte nënligjore, etj.

Mjafton të vlerësojmë vetëm njërin nga dokumentet analitike të kohës, siç është Raporti i Misionit të Bashkimit Evropian, “PAMECA IV” 2015, për mangësitë/ problematikat kryesisht të strukturave policore, ku përmenden se ka “. . . Mungesë profesionalizmi dhe kapacitete të dobëta të personelit të policisë gjyqësore, që nënkupton një qëndrim të dobët dhe mos fillim të hetimeve proaktive mbi organizatën kriminale, për të pikasur dhe hetuar fenomene, komplekse për rrjedhojë, duke e kufizuar veten e tyre vetëm në zbatimin e hetimeve të cilat përfundojnë me arrestime në flagrante ‘delicto’, pa e zhvilluar më tej informacionin e mbledhur nëpërmjet hetimeve të veçanta në mënyrë ngritjen e një hetimi të vërtetë mbi rrjetet komplekse kriminale”, ose “Aftësi të dobëta për të kryer hetim, përveçse nëpërmjet përgjimit telefonik (si për shembull

Agjo, A.
 Riorganizimi
 i policisë
 gjyqësore
 në Policinë e
 Shtetit, kërkesë
 e kohës

Policimi
 dhe
 Siguria
 nr.11 2018

⁶ Studim Studimi/2015 Drejtues Xh. Shala, “Rrjeti Informativ në Policinë e Shtetit / 2005-2010”.

përgjim ambiental në banesa, të cilat nuk kryhen fare)⁷, dhe të mbajmë frymën se emergjenca e riorganizimit të policisë gjyqësore e ka kaluar vijën e kuqe.

4. Modeli i policisë gjyqësore, lidhje organike e organizimit të Policisë së Shtetit në nivelin vendor?

E para, duhet të kuptohet se flasim për organizimin e policisë gjyqësore të nivelit vendor dhe që do të hetojë veprat penale në volum. Kjo, pasi krimi i organizuar, korrupsioni e krimet e rënda lidhur me to, e kanë bazën e tyre ligjore, si e shpjeguam më lart. Policia e Shtetit në nivelin vendor ka të dislokuara rreth 70% të numrit të përgjithshëm të saj, ku në mënyrë të përmbledhur misioni kryesor, është kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjit në raste të cenimit të tij. Po kështu, në nivelin vendor konsumohen rreth 80% e figurave të krimit me vend ngjarje, që në gjuhën e specialistëve thuhet i “*krimit të hapur*”, vjedhje, krime kundër personit, dëmtime të pronës, krime në fushën e mjedisit, aksidente, etj. Për pasojë edhe numri më i madh i policisë gjyqësore duhet të operojë në këtë nivel. Patjetër, i dislokuar nëpër strukturat si drejtori/komisariat, stacione e postë policie. Në studimin me objekt, “Organizimi i Policisë së Shtetit në Nivelin Vendor” i vitit 2015, studim i kryer në bashkëpunim me asistencën e ndërkombëtareve, të cilin fatkeqësisht, vendimmarrja e asaj kohe nuk e zbatoi, është argumentuar modeli i organizimit të Policisë së Shtetit, për rrjedhojë edhe ai i policisë gjyqësore. Ky studim që u mbështet në shifra, argumente të administruara nga një observim i detajuar i skemës së funksionimit të saj deri në atë kohë, ka nxjerrë disa indikatorë që janë ende prezentë edhe sot.

Dhe, konkluzioni, ishte se: “*Ka keqimplementim të shërbimit të policisë gjyqësore, ku diku ky atribut ushtrohet nga funksione që kanë edhe një përgjegjësi tjetër, dhe diku tjetër kryhet nga punonjës të lirë, pa detyrë të dytë, (Komisariatet e policisë gjyqësore)*”⁸. Në tërësinë e tyre, evidentimi i mangësive të mësipërme e kishte bazën tek moskuptimi i misionit të policisë gjyqësore; moskuptimi i “*atributit të policisë gjyqësore*”, që ligji i Policisë së Shtetit ia njeht personelit të saj, dhe për pasojë diku kishte struktura normale, diku jo. Në kompozimin e modelit, mendoj se duhet të udhëhiqemi nga filozofia se krimet në volum, sjellin shqetësime me të ndjeshme për komunitetin; cenojnë sigurinë në veprimet e përditshme të tyre, paçka se efekti pasojë kriminale në kuptimin klasik të këtij nocioni juridik, mund të jetë më i pakët në raport me krimin e organizuar ose format e ndryshme të tij.

Kësaj filozofie duhet t’i përgjigjemi me organizimin e shërbimit policor në nivelin vendor, në radhë të parë *me filozofinë e policimit në komunitet dhe veprimet proaktiv*, ku realizimi i saj të bëhet duke kaluar nga “*sistemi i mbyllur e i pandryshueshëm që ruan status-quo-në, e nuk i përgjigjet mjedisit, në atë të hapur, dinamik dhe elastik që mund t’i përshtatet mjedisit dhe të angazhohet në sjelljen e vetorganizimit*”⁹. Pikërisht, në bazë të kësaj doktrine, organizimi i policisë gjyqësore duhet të përshtatet me dy ndarje të mëdha organizative që duhet të jenë: *Shërbimi i Policimit Parësor*, dhe *Shërbimi i Policimit të Specializuar*¹⁰.

⁷ Raporti i Misionit të Bashkimit Evropian, “PAMECA IV” 2015.

⁸ Studimi, A. Ago/Grupi Punës, “Organizimi i Policisë së Shtetit në Nivelin Vendor”/2015.

⁹ Strategjia e Rendit Publik 2015-2020, miratuar me vkm 702, datë, 26. 08. 2015

¹⁰ Po aty.

Ago, A.
« Riorganizimi i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, kërkesë e kohës »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

Në raport me këto organizime, duhet të orientohet dhe ristrukturimi i policisë gjyqësore. Por, organizimet e mësipërme, të sugjeruara dhe të argumentuara shkencërisht në studimin e lartpërmendur, nuk u kryen. Përshtatshmëria e Policisë së Shtetit mbas reformës administrative u bë jo efikase dhe për pasojë policia gjyqësore as nuk u prek fare, çka ka sjellë gjendjen që trashëgojmë. Ligji organik vazhdon të rrjedhë anët negative të tij me kompozimin e “dy llojeve” të policisë gjyqësore, që pranon se policia gjyqësore në shtetin shqiptar është e kompozuar nga dy pushtete: a) pushteti ekzekutiv, dhe b) vartësia e organit të prokurorisë, që tek në është konceptuar si një organ i një lloji të veçantë “*sui generis*”, duke mos qenë as në gjyqësor, as në ekzekutiv, ndërkohë që modelet e shumta të vendeve të BE-së e kanë të pushtetit ekzekutiv.

Por, po të shtojmë këtu dhe ligjin 95/2016 për krijimin e SPAK-ut, ku BKH-ja, ka policinë gjyqësore të saj, modeli aktual në shtetin shqiptar na del në 3D. Për pasojë, do të jetë i vështirë funksionimi i skemës, po qe se nuk vëmë dorë në ligjin në fuqi të policisë gjyqësore dhe te rikonceptimin i tij me frymën e ligjit të SPAK-ut. Pika më e dobët e këtyre strukturave janë burimet njerëzore. Në Policinë e Shtetit, për vite me radhë, nuk ka funksionuar arsimi policor tradicional për të nxjerrë specialistë hetimi, ndërkohë që janë trashëguar dëme të mëdha në drejtim të rekrutimit të personave me arsim të cunuar, - duke i plotësuar këta me kurse trajnuese për grade policore. Çelja e funksionimi i Akademisë së Sigurisë, është një shpresë për prodhimin e specialistëve të mirëfilltë të hetimit.

5. Njohja e doktrinës mbi funksionet e policisë gjyqësore

Te kuptuarit e doktrinës për policinë gjyqësore lehtëson punën për skicimin e modelit. Kjo doktrinë duhet të kuptohet sa më vete, aq edhe në raportin që ajo ka me Policinë e Shtetit. Nga veprimtaria e këtij institucioni, dalin në pah dy lloj aktivitete, e konkretisht: a) aktivitete administrative, para hetimore gjurmuese (hetimet proaktive) dhe b) aktivitete paragjyqësore, që lidhen me kryerjen e veprimtarisë procedurale (hetimi paraprak). Të parat, d.m.th, aktivitetet administrative kryhen, pasi Policia e Shtetit si pjesë e pushtetit ekzekutiv, ka për mision realizimin e parandalimit dhe të shtrëngimit administrative, për shkeljet e konstatuara. Por, e veçanta në Policinë e Shtetit është se, veprimtaria administrative shtrihet dhe në disa drejtime të tjera që vet ligj organik ja njeh si tagra dhe që janë: a) veprimtaria informative, b) mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale, apo mbledhja, administrimi dhe ruajtja e informacionit policor dhe c) procedimi policor, (hetimi proaktiv). Këto tagra që ushtrohen kryhen nga strukturat e policisë së shtetit me uniforme, të cilat automatikisht gëzojnë dhe atributin e policisë gjyqësore dhe dallojnë nga veprimtaria procedurale penale. Kjo duhet të kuptohet mirë dhe qartë.

Të dytat, dallohen nga këto veçori: a) nga aktivitete detyruese, b) nga aktiviteti urdhërues ose i deleguar, dhe nga c) aktiviteti ndihmës ose të deleguara nga gjykata nëpërmjet prokurorit. Është shumë e rëndësishme të kuptohet se, aktiviteti detyrues është pothuajse i njëjtë me atë administrativ të Policisë së Shtetit, kur bëhet fjalë për veprimtari parandaluese kriminale. Pikërisht këtu është edhe thelbi i kësaj reforme, që të bëhet ndarja e punës midis njerëzve të së njëjtës strukturë, por që dikush të marrë përsipër aktivitetin detyrues/administrativ (parandalimin) dhe dikush tjetër të marrë përsipër aktivitetin urdhërues apo delegues procedural. Hetimi ose veprimtaria

procedurale kryhet nga ato struktura të administratës shtetërore, të cilave ligji organik i saj ua njeh këtë atribut, por për shkak të mosqartësisë të dallimeve midis veprimtarive të mësipërme, (parandalimi) dhe veprimtarisë procedurale (gjqësore), apo të mospërcaktimit të strukturave dhe njerëzve konkretë, - për të kuptuar secili, se çfarë do të kryejë, - e bën të vështirë të kuptuarin e doktrinës mbi policinë gjyqësore, si në teori ashtu edhe në zbatimin e saj praktik. E meta e madhe, - e trashëguar kjo në Policinë e Shtetit, - është mosnjohja në detaje e aktiviteteve/roleve të Policisë Gjyqësore; moslistimi dhe ndjekja nga afër e problemeve që nxori praktika në zbatimin e modelit aktual, deri në mosmarrjen e masave konkrete për përballimin e tyre. Ne jemi tunduar nga interesat e çastit dhe nuk jemi ndalur për të analizuar se përse u bë ky ose ai ndryshim; çfarë produkti sollti, kush është përgjegjës i kësaj pune, për të mirë apo për të keq qoftë. Në këtë mënyrë, ka kaluar koha, të metat kanë zënë rrënjë, përgjegjësia asnjëherë nuk është ndarë, kostot e tyre nuk janë administruar dhe pasojat i vuan shoqëria apo organizata e Policisë së Shtetit. Detyra jonë është, që në tërë organigramën strukturore të Policisë së Shtetit, të nivelit vendor, të bëjmë *implementimin e integruar të aktiviteteve të Policisë Gjyqësore*, ose e kundërta, *aktiviteteve të Policisë Gjyqësore, tu gjejmë strukturën e përshtatshme*, duke caktuar se çfarë roli i takon secilit të kryejë, pa konflikt kompetencash.

Ndreqja e gabimit nga Gjykata Kushtetuese me rastin e konceptimit të BKH në ligjin organik të Policisë së Shtetit, duhet të na nxisë për këtë reformë jetike dhe të hiqet dorë nga megalomania dhe të moskuptuarit e vendit apo rolit që kanë institucionet në një shtet demokratik. Reformat e ndërmarra deri më sot nuk arritën që të iniciojnë një nisëm të tillë, ndoshta edhe për arsye të tjera objektive a subjektive. Por sot, që është shpallur platforma reformatore në Policinë e shtetit, me indikatorët e vetingut, në Ministrinë e Brendshme, që është plotësuar vakuumi ligjor dhe që fatmirësisht ka edhe një mbështetje pozitive të vullnetit politik, do të jetë e pafalshme për historinë që kjo reformë të mos kryhet me cilësinë e standardet e kohës.

6. Rekomandimet e ndërkombëtarëve

Për të disatën herë organizmat ndërkombëtare që asistojnë pranë MB ose Policisë së Shtetit si: PAMEKA IV, ICITAP OSBE, kanë shtruar rekomandimet e tyre, për reformën në strukturat hetimore, për trajnime, investime, etj., me qëllim fuqizimin, rritjen e profesionalizmit, mbajtjen pastër të figurave për personelin, vendosjen e standardeve, kushteve e kritereve në rekrutime, e deri në mënyrat e trajtimet e tyre morale e materiale. Është momenti i duhur për një reformë të tillë, sidomos kur gjen përkrahje edhe nga partnerët tanë strategjikë, si SHBA-ja. Në dokumentet e tyre si Progres Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2016, theksohet se prioritet mbetet, “*Rritja e numrit të hetimeve të bazuar në informacionin sekret dhe hetimet financiare për pastrimin e parave dhe trafikimin e drogës si dhe rritja e konfiskimit të pasurisë së fituar në rrugë kriminale*”.¹¹ Prioritetet kryesore për kapitullin 24 të bazuara mbi dokumentet strategjikë dhe progres-raportet, sqarojnë se; “*Niveli dhe efica e hetimeve duhet të rritet dhe duhet të çojë në krijimin e një trackrecord-i solid dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë*”, apo sugjerimi se: “*Në rritjen e rezultateve në goditjen e krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike, për shkak të*

Ago, A.
« Riorganizimi i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, kërkesë e kohës »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

¹¹ Progres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2016.

natyrës së tyre, veprimet hetimore duhet të kryhen vetëm nga njësi të specializuara të policisë, të cilat të jenë në gjendje të kryejnë veprime hetimore njëkohësisht në disa pjesë të territorit, të koordinojnë me agjenci të huaja të zbatimit të ligjit, të përdorin metodat speciale të hetimit si dhe të disponojnë kapacitetet e duhura njerëzore dhe teknike për shkak të kompleksitetit që shfaq hetimi i krimit të organizuar.

I veçantë dhe konkret është sugjerimi i ndërkombëtareve për burimet njerëzore kur rekomandojnë: “*Ndjekja e një politike efektive për burimet njerëzore bazuar në merita dhe kjo të aplikohet në radhët e Policisë së Shtetit si dhe alokimin e mjaftueshëm të këtyre burimeve në polici dhe prokurori.*”¹²

7. Konkluzione

Siç e trajtuam dhe në këtë shkrim, krijimi i institucione të veçanta për luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar si SPAK-u, Prokuroria e Posaçme, BKH hetuesit e saj dhe policie gjyqësore, pasqyruar këto në paketën reformatore në drejtësi, shtyn përpara dhe nxit nevojën e ristrukturimit të policisë gjyqësore, të pjesës tjetër, të *nivelit vendor*, të atashuar si në prokuroritë e shkallës së parë ashtu dhe në Policinë e Shtetit. Po nuk funksionoi policia gjyqësore në nivelet vendore, në hallkat e para të konstatimit të veprës penale, edhe strukturat e specializuara do të çalojnë, ato nuk do të furnizohen me informacione, me të dhëna, për çfarë ndodh përditë në jetën kriminale të shoqërisë dhe shumë shpejtë do e ndjejnë një boshllëk të tillë. Strukturat e posaçme, në fund të fundit duhet të vlerësohen si një ndër hallkat e sistemit hetimor të shtetit dhe ato duhet të mirëkuptohen dhe të mirëfunksionojnë. Detyrimisht është momenti i rishikimit të ligjit organik të policisë gjyqësore, pse jo dhe i ligjit të Policisë së Shtetit, për të sanksionuar ndryshimet që duhet të bëhen në të ardhmen e afërt.

Mbroj idenë e bërjes *de facto* të studimit/2015 “*Mbi organizimin e Policisë së Shtetit në nivelin vendor*”, faza e parë e implementimit të tij në shkallë vendi, pasi është mirëargumentuar ristrukturimi. Ndërkohe që është normale që ky studim të bëhet edhe objekt diskutimi për vendimmarrjen, duke marrë në konsideratë dhe të rejat apo ndryshimet e viteve të fundit. Do të jetë me interes kryerja e analizave të veçanta që t’i shërbejë reformës, si analiza e punës informative-gjurmuese, analiza e treguesve të punës hetimore, që për fatin e keq ka vite të tëra që kanë pësuar rënie, dhe ende nuk janë marrë nismat për ringritjen e këtyre formave e metodave të punës, aq të domosdoshme për parandalimin e ngjarjeve dhe njohjen e situatave kriminale, sidomos të situatave të krimit të organizuar, fenomeneve të korrupsionit, trafikëve të ndryshme dhe akteve terroriste.

Gjithashtu kërkesa e kohës është sigurimi i burimeve njerëzore nga më të kualifikuarat dhe të pastra në drejtim të implikimeve apo qëndrimeve profesionale e qytetare. Mbështetja e këtyre reformave me infrastrukturë të domosdoshme, burime financiare dhe personel të kualifikuar, do e bëjnë që shërbimet e policisë gjyqësore të jenë eficiente, të afta për dokumentimin e aktivitetit kriminal sidomos në seancat e hetimit gjyqësor, aty ku bëhet “ndeshja” midis subjekteve procedurale për procesin e të provuarit, si një nga hallkat me të dobëta deri tani të organit të akuzës dhe bashkë me të dhe të policisë gjyqësore.

«*Ago, A.*
Riorganizimi
i policisë
gjyqësore
në Policinë e
Shtetit, kërkesë
e kohës»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11 2018

¹² Kapitullin 24, “Drejtesia Siguria Liria”, f. 15-16.

Referencat

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligj nr. 76/2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë, 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
3. Kodi Penal në fuqi, miratuar viti 1995 i ndryshuar.
4. Kodi Procedurës Penale në fuqi, miratuar viti 1995, i ndryshuar.
5. Ligj nr. 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
6. Ligj nr. 96/2016, "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
7. Ligj nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".
8. Ligj nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë."
9. Dokument Strategjik për kryerjen e Procesit të Vlerësimit Kalimtar në Strukturat Policia e Shtetit, ShÇBA, Garda e Republikës.
10. Shala, Xhavit, 2015, "Rrjeti Informativ në Policinë e Shtetit / 2005-2010", Studim.
11. Ago, Adriatik, Bill Morrell (Këshilltar ICITAP), 2015, "Organizimi i Policisë së Shtetit në Nivelin Vendor", Faza Parë.
12. Ligji Nr. 8677, datë, 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" i ndryshuar.
13. Ligji nr. 10 301, datë, 15.7.2010, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".
14. Ligj nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.
15. Strategjia e Policisë së Shtetit dhe Plani i Veprimit 2015-2020, miratuar me VKM nr 702, datë 26.08.2015.
16. Urdhër i përbashkët për funksionimin e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, midis dhe Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme me nr. 1227/1, Prot. dt 1.04.2008 dhe nr 1075/1, Prot. Dt. 15. 04.2008.

Ago, A.
« Riorganizimi
i policisë
gjyqësore
në Policinë e
Shtetit, kërkesë
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Riorganizimi i policisë kriminale, si domosdoshmëri e kohës



■ **MSc. Osman QYSTRË**

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
osman.qystri@asp.gov.al

Abstrakt

Në qoftë se do t'i hedhim një sy statistikave të kriminalitetit në përgjithësi dhe krimet të organizuar në veçanti, për vitet 2001-2016, organizatat kriminale të trafikut të drogës, armëve dhe qenieve njerëzore dhe grupet e strukturuar kriminale të trafikut, kontrabandës dhe vrasjes me pagesë, të goditura brenda dhe jashtë vendit konstatojmë se krimet kanë ardhur në rritje të vazhdueshme. Pavarësisht arritjeve dhe rezultateve në luftën kundër tij, me gjithë ndryshimet e thella dhe përmirësimet rrënjësore të legjislacionit dhe strukturës organike të Policisë së Antikrimit, investigimi dhe goditja e krimet të organizuar janë larg pritshmërisë së publiku. Ne jemi duke ndryshuar thuasje tërësisht qasjen reaguese dhe vepruese ndaj çdo forme të veprimtarisë kriminale, me synimin për një reagim proaktiv, dinamik dhe të mirë koordinuar. Prej këtej lind detyrimi, i reformë dhe riorganizimit të strukturës së hetimit, integritet dhe aftësi profesionale të punonjësve të policisë kriminale. Goditje të aseteve kriminale të personave me precedentë penalë apo të dënuar. Mendimi i specialistëve të antikrimit dominohet nga dy opinione, përfaqësuesit e të cilëve ndajnë qëndrimeve të ndryshme, deri dhe të kundërta me njëri-tjetrin. Të parët, i qëndrojnë të palëkundur organizimit dhe praktikës së sotme, ku Policia Kriminale kryen gjurmimin policor dhe hetimin paraprak ose anasjelltas, si procese ose veprimtari të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Të dytët, insistojnë në riorganizimin e Policisë Gjyqësore dhe ristrukturimin e Policisë Kriminale. Sipas tyre lufta kundër krimet të rikonceptohet me dy kolona kryesore, ku njëra, pa hequr dorë nga atributet e policisë gjyqësore, të merret me gjurmimin policor, ndërsa tjetra, të merret me hetimin paraprak ose me veprimet procedurale.

Qystrë, O.
« Riorganizimi
i Policisë
Kriminale, si
domosdoshmëri
e kohës »

Fjalëkyçe:

Policia Kriminale, gjurmimi policor, hetimi paraprak, ndarje gjurmimit nga hetimi, krim i organizuar.

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Hyrje

Në këndvështrimin historik, trajtuar së paku për vitet 2001-2016, kriminaliteti në përgjithësi dhe krimi i organizuar në veçanti (grupet e strukturuar kriminale, bandat e armatosura, organizatat kriminale; trafiku i lëndës narkotike, i qenieve njerëzore, i armëve; gjobëvënia; migrimi i paligjshëm; korrupsioni; kontrabanda; pastrimi i parave; vrasjet me pagesë)¹ kanë ardhur në rritje të vazhdueshme. Aktualisht lufta kundër kriminalitetit organizohet nga disa struktura vendore dhe qendrore të policisë, të cilat kanë bërë në shumë raste përpjekje vetëmohuese për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së shtetasve. Në qendër veprojnë: departamenti për hetimin e krimit të organizuar dhe krimet e rënda; departamenti për sigurinë publike; departamenti për kufirin dhe migracionin; drejtorja e antiterrorit; drejtorja e bashkëpunimit, koordinimit ndërkombëtar, eventeve dhe protokollit², në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilat, krahas të tjerave kanë si mision kryesor zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e autorëve të krimeve. Në vende operojnë strukturat e policisë kriminale në drejtoritë vendore të policisë, në komisariatet e policisë vendore, në drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit³. Për të ardhur deri këtu është dashur shumë punë dhe mund.

2. Ndryshimi i qasjes ndaj veprimtarisë kriminale

Në vlerësimin tim, pavarësisht arritjeve dhe ndryshimeve të thella e të vazhdueshme,

¹ Vlerësimi i riskut të Krimit të Organizuar në Shqipëri; Fondacioni "Shoqëria e hapur për Shqipërinë", Tiranë 2015, Autorë Fabian Zhilla & Besfort Lamallari, f. 33-64.

² Urdhri i MB, nr. 287, datë 19.05.2017 "Miratimi i strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit".

³ Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 "Për Policinë e Shtetit", f. 10-12.

Qystrí, O.

« Riorganizimi i Policisë Kriminale, si domosdoshmëri e kohës »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

përmirësimeve rrënjësore të legjislacionit dhe strukturës organike të Policisë së Antikrimit në dy-tre dekadat e fundit, investigimi dhe goditja e krimit të organizuar nuk i kanë realizuar pritshmërisë së publikut. “Reformë dhe riorganizim i strukturës së hetimit, integritet dhe aftësi profesionale të punonjësve të policisë kriminale.....Goditje të aseteve kriminale të personave me precedentë apo të dënuar”⁴, janë disa nga kërkesat që shtrohen sot para Policisë së Shtetit, për të rritur efektivitetin e saj në luftën kundër krimit të organizuar. Krijimi i BKH, i SPAK-ut dhe grupit të punës (Task-Forcës) shtrojnë nevojën e ndryshimeve të rëndësishme në strukturë, në organizimin dhe në menaxhimin e Policisë Kriminale, me qëllim që ajo të marrë formë dhe përmbajtje të re, ndërsa lufta kundër krimit të organizuar të fitojë terren dhe përmasa zhvillimi. Në këtë vështrim, “ne jemi duke ndryshuar thujasë tërësisht qasjen reaguese dhe vepruese ndaj çdo forme të veprimtarisë kriminale, me synimin për një reagim proaktiv, dinamik dhe të mirë koordinuar”⁵.

Në zinxhirin e sigurisë dhe rendit publik, hallka kryesore mbetet gjurmimi policor dhe hetimit paraprak, dy aktet themelore, rreth të cilave sillen gjithë hallkat e tjera të strukturave të antikrimit. Po t’i analizojmë rezultatit çdo hallke të këtyre strukturave, përmbledhur në atë që quhet Policia Gjyqësore, qoftë së bashku me Policinë Kriminale, qoftë veç e veç me të, arrijmë në përfundimin që ato nuk i kanë realizuar dot as objektivat strategjike, as ato qeveritare në luftën kundër krimit të organizuar. Që të zbulojmë përse, kërkohet një analizë e gjerë dhe e gjatë e faktorëve, të cilët në fakt janë më shumë se kompleks. Nisur nga eksperiencia në Policinë e Shtetit, në menaxhimin dhe drejtimin e strukturave vendore të saj, sidomos në rrethet Berat, Lushnjë, Lezhë, Mirditë, Tiranë, Vlorë mendoj të shpreh disa ide racionale dhe bashkëkohore rreth temës së mësipërme, pa pretenduar se ato janë më të arrirat. Së paku e shtroj çështjen për diskutim dhe debat, me qëllimin e vetëm dhe interesin madhor, të përmirësimit të luftës kundër krimit të organizuar dhe jo vetëm.

3. Mendimi i specialistëve të antikrimit

Përgjithësisht mendimi i specialistëve të antikrimit dominohet nga dy opinione, përfaqësuesit e të cilëve ndajnë qëndrimeve të ndryshme, ndonjëherë dhe të kundërta me njëri-tjetrin. Në fakt ata kanë dallime thelbësore, sa ç’kanë dhe pika të përbashkëta. Gjithsesi në finale synimi i secilit është, se si do mund të ristrukturohet më mirë lufta kundër krimit të organizuar në Shqipëri, se si do mund të menaxhoheshin më mirë se deri më sot ngjarjet dhe situatat kriminale, se si do mund të përdroreshin më me efektivitet mjetet policore dhe procedurale për kërkimin dhe gjetjen e provës, në sigurimin e provave për vërtetimin e faktit kriminal. Për të shkuar deri atje ata përdorin metodologji të ndryshme, ndërsa argumentet që servirin bazohen në perceptime të kundërta në thelbin e asaj që është dhe asaj që duhet të jetë, apo të bëhet Policia Kriminale Shqiptare.

3.1 Mbështetja e organizimit dhe praktikës së sotme

Grupi i parë qëndron i palëkundur në organizimin dhe praktikën e sotme, ku Policia Kriminale kryen gjurmimin policor dhe hetimin paraprak ose anasjelltas, si procese ose

⁴ Fatmir Xhafaj, Ministër i Brendshëm, në takim me drejtuesit e Policisë Kriminale me dt. 16.10.2017.

⁵ Fatmir Xhafaj, Ministër i Brendshëm gjatë organizimit “Forca e Ligjit”, me datë 07.11.2017.

veprimtari të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Aq sa është arritur deri atje sa që të gjitha strukturat e antikrimit, që nga seksionet, sektorët, drejtoritë dhe departamentet të quhen “të hetimit të krimit”. Ndërkohë që është “Prokurori që e ushtron ndjekjen penale, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake. . .”⁶. Gjithashtu “prokuroria dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale”⁷, “Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore”⁸.

Sa më lart, specialisti i antikrimit, ose i hetimit, kryen vetëm hetime paraprake, në dispozicion të prokurorit ose të deleguara prej tij, përjashtuar rastet kur mund të kryejë arrestimin në flagrancë, prandaj kurrsesi s’ mund të quhet “seksion i hetimit të krimit” dhe njëkohësisht të bëjë gjurmimin policor. “Dy kunguj në një sqetull s’mbahen”, thotë i urti popull, prandaj në qoftë se duam t’i shkojmë ngjarjeve të rënda kriminale deri në fund, specialisti i krimeve duhet të merret ose me gjurmimin, ose me hetimin. Ndryshe është shumë e vështirë, për mos thënë e pamundur. Me mënyrën e sotme të organizimit, specialisti i antikrimit s’do bëjë as njërën as tjetrën, ose do bëjë pak nga të dyja, duke mos i shkuar asnjëherë deri në fund zbulimit dhe goditjes së autorëve, të krimit të organizuar sidomos.

Përfaqësuesit e këtij grupimi, e vënë theksin tek veprimet procedurale të specialistit të antikrimit, i cili ka atributet e oficerit të policisë gjyqësore. Por ata nënvleftësojnë informacionin policor, burimet e sigurimit të tij dhe sidomos rrjetin sekret, përgjimin ambiental, vëzhgimin policor dhe kontrollin sekret, kurthin, grackën, pritën, legjendën. Kështu, kjo kategori heq dorë nga veprimet intuitive të policisë, që në periudha të caktuara kanë përbërë çelësin e suksesit të saj. Sipas tyre, përfshirja në Kodin e Procedurës Penale e mjeteve të kërkimit të provës, si këqyrjet,⁹ kontrollat,¹⁰ sekuestrimet,¹¹ përgjimet,¹² ezauron përfundimisht metodat e gjurmimit policor. Ndërsa, bashkëpunimi me drejtësinë,¹³ veprimet simuluese,¹⁴ infiltrimi në përbërje të grupit kriminal,¹⁵ dorëzimi i kontrolluar,¹⁶ i japin procesit vlerë të padiskutueshme dhe të pakthyeshme, në idenë kryesore që çon në ristrukturimin e gjurmimit policor dhe hetimit procedural.

3.2 Mbi ndryshimet e strukturës aktuale të antikrimit

Grupi i dytë insiston në ndryshime të strukturës aktuale të antikrimit, të cilat automatikisht do të çojnë në ndryshime në riorganizimin e Policisë Gjyqësore, dhe ristrukturimin e Policisë Kriminale. Ata e vënë theksin tek informacioni policor dhe arrijnë në përfundimin se lufta kundër krimit të rikonceptohet me dy kolona kryesore, ku njëra, - pa hequr dorë nga atributet e policisë gjyqësore, - të merret me gjurmimin policor, si: me organizimin e rrjetit informativ; me përgjimin, vëzhgimin, kontrollin sekret; me legjendimin dhe infiltrimin e agjenturës në grupet kriminale, nga ku të shkojmë

⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 24, pika 1.

⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 227, pika 1.

⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 227, pika 2.

⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 198.

¹⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 202.

¹¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 208.

¹² Kodi i Procedurës Penale, neni 221.

¹³ Kodi i Procedurës Penale, neni 37/a.

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 294/a.

¹⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 294/b.

¹⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 294/c.

Qystrí, O.

« Riorganizimi i Policisë Kriminale, si domosdoshmëri e kohës »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

tek parandalimi, zbulimi dhe goditja e krimit. Ndërsa tjetra, të merret me hetimin paraprak ose me veprimet procedurale si: pyetje, kontrolle, bllokime, sekuestrime, referime, për çështjet penale që i delegohen vetëm nga prokurori përkatës; ku prej nga fakti/ngjarja kriminale të shkojmë në zbulimin dhe goditjen e autorëve të saj. Për mua është më e lehtë të shkohet tek autori i ngjarjes kriminale nëpërmjet informacionit policor të siguruar nga metodat speciale, që aplikohen në gjurmimin fshehtë, se sa nëpërmjet veprimeve procedurale, qofshin ato edhe sekrete.

Në fakt, gjatë veprimtarisë së përditshme strukturat e gjurmimit policor dhe të hetimit paraprak do të përdorin, mjete dhe metoda të ndryshme, ligjore pa diskutim, për të realizuar të njëjtin mision, për të arritur të njëjtin qëllim, që në fund të fundit është zbulimi, dokumentimi, parandalimi dhe goditja e veprimtarisë kriminale¹⁷. Por ndërsa struktura e gjurmimit do të operojë në fushën e grumbullimit të informacionit kriminal, që është i domosdoshëm për kërkimin dhe gjetjen e provës; struktura e hetimit paraprak do të operojë në fushën e së drejtës për të kryer veprimet procedurale, të specifikuar në Kodin e Procedurës Penale, të deleguara nga prokurori sidomos, të cilat në shumicë absolute kryhen me pjesëmarrjen e shumë aktorëve procedurale dhe për pasojë është gati e pamundur ruajtja e sekretit të hetimit.

4. Qasje analitike lidhur me qëndrimet e specialistëve të antikrimit

Unë bëj pjesë në atë grup që mendojnë se Policinë Kriminale, në gjendjen e sotme, veprimtaria e përditshme e të cilës dominohet nga hetimi, e ka shmangur atë nga roli i saj primar, që është sigurimi i informacionit policor¹⁸, i cili, siç thekson një kolegu ynë është sikurse oksigjeni për qeniet e gjalla. Specialistët e policisë kriminale janë kthyer në hetues të thjeshtë, duke u larguar gjithmonë dhe më shumë nga përdorimi i llojeve të punës operative, zbuluese dhe gjurmuese. Veprimtaria intuitive, e cila ka në thelb kurthin, grackën, legjendimin, kontrollin ose vëzhgimin sekret, infiltrimin e bashkëpunëtorëve në rrjetet kriminale duhet të fitojë terrenin e humbur dhe të gjejë vend në çdo hap të veprimtarisë së policisë.

Mendoj se departamenti i antikrimit, ose siç e quaj unë, “Policia Kriminale”, mund dhe duhet të përbëhet nga dy shtylla bazë, rreth të cilave të ngrihen dhe operojnë dy struktura, ku njëra të bëjë gjurmimin policor dhe tjetra të bëjë hetimin paraprak. Secila prej strukturave të ketë vartësinë e tij hierarkike, gjurmuesit të raportojnë tek shefi i Policisë Kriminale, hetuesit tek prokurori i çështjes. Prokurori dhe shefi i policisë kriminale do të ishin nyja lidhëse mes strukturës së hetimit dhe strukturës së gjurmimit. Ndërsa drejtuesit e tjerë nga komisarë deri në drejtorë, në drejtorinë vendore ose qendrore qoftë, s’duhet dhe s’mund të ndërhyjnë në veprimtarinë procedurale të specialistit të hetimit, duke u përqendruar më mirë se deri më sot, në gjurmimin dhe në informacionin policor, në përdorimin e metodave dhe mjeteve të gjurmimit, në parandalimin, zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale. Vetëm kështu do t’i bëjmë strukturat vartëse të antikrimit me produktivitet maksimal.

Vlerësoj se vetëm me anë të profilizimit, ndarjes së përgjegjësive, ristrukturimit dhe

Qystri, O.
« Riorganizimi
i Policisë
Kriminale, si
domosdoshmëri
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

¹⁷ Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”.

¹⁸ Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 56/1, datë 27.05.2013 “Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave ose informacioneve policore”.

bashkëveprimet do të mund të arrijmë rezultatet e pritshme kundër krimit të organizuar, përndryshe do vazhdojmë të thellohemi në deformimin e misionit, qëllimit dhe rolit të Policisë Kriminale për goditjen e krimit në tersi dhe të krimit të organizuar në veçanti. Specializimi dhe profilizimi i Policisë Kriminale do ta bënte atë shumë më produktive, ndërsa hetimin paraprak më aktiv, më profesional, më kompetitiv në fund të fundit. Sipas disa specialistëve, është utopike që nga/dhe nëpërmjet informacionit kriminal ose policor të shkohet tek prova, tek vërtetimi i faktit, tek dokumentimi i veprimtarisë kriminale dhe goditja e autorit të saj, tek parandalimi i krimit si misioni kryesor i policisë, si detyrë për tu realizuar. Por, ka shumë shembuj që vërtetojnë të kundërtën: plejada e punonjësve të policisë kriminale, që për rezultatet e shkëlqyera dje, drejtojnë sot Policinë e Shtetit; SHÇBA¹⁹ e organizuar ligjërisht me strukturë gjurmimi dhe hetimi; SHISH që kryen gjurmim të posaçëm, struktura kryesore e sigurisë kombëtare organizon veprimtari informative dhe gjurmuese, - janë mjaftueshëm si raste, që të tregojnë se Policia Kriminale mund të organizohet në dy shtylla kryesore: gjurmimi policor dhe hetimi penal, të ndara nga njëra-tjetra, të organizuara bazuar në ligje specifike, të cilat duhen hartuar menjëherë.

Pavarësisht ideve të mësipërme, unë nuk pretendoj të kthehem as në hetuesinë e vitit 1983, e cila përshkohej nga ideologjia komuniste, as në hetuesinë e vitit 1994, efikase në shumë veprime të saj. Por insistoj në riformatimin e një strukture krejt tjetër, e cila në themelet e saj të ketë sa traditën shqiptare të më shumë se një shekulli, aq dhe realitetin e ri demokratik dhe përvojën perëndimore, ku nevojat e publikut për shërbimet e sigurisë janë rritur, ndërsa krimi i organizuar i ka kaluar kufijtë nacionalë. Ambienti kriminal sot ka pësuar ndryshime thelbësore në raport me të shkuarën e largët, por edhe me vitet 1994-1995. Ndërkohë që infrastruktura ligjore, organizimi i policisë gjithashtu, kontrolli dhe hetimi nga SHÇBA, inspektimi dhe verifikimi nga standardet profesionale, drejtimi dhe menaxhimi mbi veprimtarinë e punonjësve të policisë, janë përmirësuar ndjeshëm, duke eliminuar shumë fenomene negative.

Mendimi i disa specialistëve që kanë punuar në strukturat e hetimit të vitit 1994, se ajo solli konflikt strukturash, përplasje mentaliteti, xhelozit individual, korrupsion, dëmtim provash, pezullim hetimesh, është i pamotivuar ligjërisht. Në mendimin tim ato nuk janë shkaqe, por fenomene që lindën për rrjedhojë dhe u vunë re në atë periudhë, kur shteti dhe ligji ishin të brishtë. Por që kurrsesi nuk përbëjnë argumente, për të mos bërë ndryshime në strukturat e antikrimit, që ato t'i përgjigjen më mirë dinamikës së krimit të organizuar. Ne sot jemi vetëm një hap larg fillimit të veprimtarisë së organeve të vetingut, krijimit të Prokurorisë Speciale dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilat do ta përmirësojnë ndjeshëm luftën kundër krimit dhe korrupsionit në Shqipëri. Për pasojë edhe strukturat e antikrimit duhen përmirësuar në cilësi, në përmbajtje, në menaxhim, për t'u përgjigjur më mirë dinamikës së këtyre strukturave të reja.

Këto ishin përgjithësisht disa mendime, opinione, ide, alternativa rreth ndryshimeve dhe përmirësimeve strukturore dhe ligjore të Policisë Kriminale dhe Policisë Gjyqësore²⁰. Në vështrimin tim duken progresiste, novatore dhe duhen kthyer në realitet të prekshëm nga të gjithë. Së paku, ato çelin një diskutim të gjerë profesional të mendimtarëve, - që edhe tek ne nuk mungojnë, - nga ku mund të nisë një reformë e rëndësishme e strukturës së antikrimit në Policinë e Shtetit.

¹⁹ Ligji nr. 70/2014 "Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme & Ankesat në MPB".

²⁰ Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000, (i ndryshuar) "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Qystrí, O.

« Riorganizimi i
Policisë
Kriminale, si
domosdoshmëri
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria

nr.11, 2018

111

5. Përfundime dhe rekomandime

1. Strukturat e luftës kundër krimit të përqendrohen dhe të organizohen në një departament të vetëm: në atë të Policisë Kriminale. Brenda kësaj strukture gjigante të operojnë: drejtoria e krimit të organizuar, drejtoria e krimeve të rënda, drejtoria e krimeve të lehta, drejtoria e krimit me/nga të miturit, drejtoria e krimeve në familje dhe dhuna ndaj gruas, të cilat do ta rrisnin efektivitetin dhe produktivitetin e strukturave operuese në luftën kundër krimit në tërësi dhe të krimit të organizuar në veçanti.

2. Akademia e Sigurisë, të organizohet me tre departamente: departamenti i policisë kriminale, departamenti i policisë së rendit dhe qarkullimit rrugor, dhe departamenti i policisë kufitare, me synim profilizimi. Kjo do krijonte një gjeneratë profesionistësh në luftën me krimin dhe mafien. Në vitin e parë dhe të dytë, në Akademinë e Sigurisë të studiohen lëndë të formimit të përgjithshëm, ndërsa në vitin e tretë ose në “bachelor” të profilizohet, sipas prirjes së studentëve dhe nevojave të terrenit, disa për tu bërë specialistë antikrimi, disa specialistë rendi, të tjerët specialistë kufiri. Specialistët e trajnuar prej tyre, të vazhdonin karrierën në strukturën respektive të Policisë së Shtetit dhe vetëm aty, duke i dhënë fund një herë e mirë kalimit nga njëra strukturë në tjetrën, pa shumë lidhje profesionale me njëra-tjetrën.

3. Ligji “Për Policinë e Shtetit” do duhet të përcaktonte që specialistët e strukturave të hetimit të krimit, të përthithen vetëm nga kategoria e atyre që mbarojnë drejtimin e juridikut ndërsa ata të gjurmimit të krimeve nga Akademia e Sigurisë; specialistët e krimit ekonomik dhe financiar të përthithen nga ata që kanë kryer arsim ekonomi-financë; specialistët e informatikës dhe elektronikës vetëm nga studentët që përfundojnë inxhinierinë elektronike etj., mbështetur gjithmonë në nevojat dhe kërkesat e “tregut” policor, duke ju nënshtruar masterit profesional njëvjeçar në Akademinë e Sigurisë.

Literatura

1. Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 "Për Policinë e Shtetit".
2. Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000, (i ndryshuar) "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
3. Urdhri i MB, nr. 287, datë 19.05.2017 "Miratimi i strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit".
4. Ligji nr. 70/2014 "Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme & Ankesat në Ministrinë e Brendshme".
5. Urdhri i Ministrisë të Brendshme nr. 56/1, datë 27.05.2013 "Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave ose informacioneve policore".
6. Zhilla, Fabian dhe Besfort Lamallari (2015). Vlerësimi i riskut të Krimit të Organizuar në Shqipëri. Tiranë: Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë.
7. Xhafaj, Fatmir, Fjala e mbajtur nga Ministri i Brendshëm, në takim me drejtuesit e Policisë Kriminale.
8. Xhafaj, Fatmir, Fjala e mbajtur nga Ministri i Brendshëm, në prezantimin e Task Forcë, "Forca e Ligjit".

Qystrí, O.
« Riorganizimi i
Policisë
Kriminale, si
domosdoshmëri
e kohës »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Policimi në komunitet: sfidë dhe nevojë



■ **MSc. Roland ALUSHANI**
Drejtoria e Përgjithshme Policisë
roland.alushani@asp.gov.al

Abstrakt

Shekulli 21 ka sjellë sfida të reja për policinë, në vendin tonë, si një demokraci e brishtë dhe në vizionin e demokracive perëndimore. Problemet e rrënjësura sociale, zhvendosjet e mëdha të popullsisë, trafikku, krimi i organizuar, dhuna në familje etj. përbëjnë sot sfida për kontrollin e krimin, të cilat gjithnjë e më shumë po sfidojnë mundësitë dhe aftësitë e policimit tradicional. Janë krijuar agjenci të reja, policia private ndodhet në një 'bum' shpërthyes dhe autoritetet kanë kërkuar që individët, bizneset dhe organizmat e komunitetit të jenë gjithnjë e më të përgjegjshme për sigurinë e tyre. Për të ruajtur ose rifituar pozicionin e drejtimit në këtë agjendë të re, strukturat policore angazhohen të njohin dhe të kuptojnë mjedisin në ndryshim dhe të përballen profesionalisht me sfidat e tij. Qëllimi i këtij shkrimi sillet rreth hulumtimit të rolit dhe funksionit të shërbimit të policisë në këtë periudhë që konsiderohet edhe si "epoka e pasigurisë" aktuale. Ideja themelore bazohet në faktin se, pavarësisht nga rritja e aktorëve të tjerë të angazhimit për menaxhimin e kontrollit të krimin, policia publike është struktura më e përshtatshme për të koordinuar angazhimet jo vetëm ndaj problemeve ekzistuese, por edhe problemeve të reja të krimin, duke përdorur metoda të bazuara në inteligjencë, analizë dhe koordinimi aktiv të aktorëve të tjerë.

Fjalëkyçe:

policimi në komunitet, siguria publike, policimi bashkëkohor, organizata e policisë.

Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Hyrje

Theksojmë që fillimisht, se rreziqet me të cilat ballafaqohet policia publike i bëjnë strukturat e saj të jenë edhe më komplekse në formë dhe në përmbajtje. Policia si ndoshta askush tjetër përballet me sfida më të shumta në shekullin që sapo hymë. Ashtu si edhe në vendet e tjera, problemet e strukturave të policisë në vendin tonë përballen me parandalimin e krimit të organizuar, trafikut, dhunës në familje, kontrollin e popullatës të zhvendosur nga faktorë të ndryshëm ekonomik e social si varfëria dhe frontet e punës etj. Policia gjithashtu po përfshihet gjithnjë e më shumë në adresimin e problemeve sociale siç janë reagimi ndaj disavantazheve të rrënjësura në komunitete të veçanta, njerëzit me probleme psikiko-mendore dhe një rritje e perceptuar në sjelljen antishoqërore. Këto sfida, që në shumicë vijnë në një mjedis të ndryshëm nga ai i mëparshmi por që edhe i pashkëputur në sfondin e problemeve të mëparshme si lufta kundër trafikut të lëndëve narkotike, krimit ndaj pronës dhe parandalimi i dhunës sociale.

Në këtë klimë të ndryshueshme kulturore dhe sociale, policimi bashkëkohor dukshëm përcaktohet nga diversifikimi dhe pasiguria e problemeve të kontrollit të krimit. Modelet e mëparshme të policimit mund të përqendroheshin në kategori relativisht të njohura dhe të qëndrueshme të veprave penale dhe shkelësve, si dhe në përgjigjet tradicionale dhe reflektive ndaj tyre. Problemet e reja zhvillohen më me shpejtësi, varen nga një spektër i gjerë faktorësh politikë, socialë, teknologjikë dhe ekonomikë, dhe kërkojnë si aftësi të reja, por edhe përgjigje të reja dhe fleksibile. Modelet ekzistuese të policimit ndodhen përballë sfidës për t'i pasur këto attribute. Aktualisht duket se strukturat e policisë sfidohen jo vetëm nga paradigma e re, por edhe nga një pozicion konkurrues në referimin si aktorë kryesorë dhe qendrorë të kontrollit të

Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Polici
dhe
Siguria
nr.11, 2018

krimit. Deri kohët e fundit, policia publike dominonte në të qenit në qendër të kontrollit të krimit edhe në periudhën moderne. Por, prirjet e reja dhe ndryshimi strukturor i shoqërisë kanë çuar në pluralizmin dhe privatizimin e përpjekjeve të policisë dhe rritjen e agjencive administrative dhe rregullatorë me funksionet e kontrollit të krimit dhe parandalimit siç shprehet studiuesi Ericson. Përveç kësaj, në shpërndarjen e trendit të përgjegjësisë është nënkuptuar që edhe komunitetet, por edhe individët priten të kontribuojnë në ruajtjen e rendit, sigurisë fizike dhe konceptit më të gjerë të vetë sigurisë (Crawford, 2006). Në këto kushte, shërbimet bashkëkohore të policimit ofrohen gjithnjë e më shumë nga rrjetet e organizatave publike dhe private, dhe në këtë mjedis policimi publik paraqitet si një nyjë e rrjetit.

Përkundër nevojave të komunitetit, modelet e orientuara drejt problemeve, shërbimi policor gjithnjë e më shumë po zhvendoset dhe po nënshtrohet faktorëve dhe modeleve të ndryshme të kontrollit ndaj krimit. Një literaturë gjithnjë e në rritje përshkruan se si funksionet që dikur monopolizoheshin nga policia publike tani ndahen midis ofruesve të ndryshëm të sigurisë, siç janë shërbimet shtetërore dhe private të sigurisë; agjencitë ushtarake, rregullatorë dhe të mirëqenies; organizata transnacionale; dhe interesat private. Kjo prirje ka çuar në nevojën për një ripërkufizim të funksionit të policisë, si dhe një ripërcaktim të rolit që policia publike zë në kuadër të strukturave të reja që janë afruar dhe, që disa herë konkurrojnë (Shearing, 2006).

2. Çfarë është “policimi në komunitet”?

Për gjysmën e parë të shekullit të 20-të, shërbimet e policisë në shumicën e vendeve funksiononin sipas modelit të njohur si modeli “profesional” i policimit. Sipas këtij modeli, struktura policisë organizohet rreth linjave të rrepta hierarkike, përdorin protokollet operacionale të standardizuara dhe theksonin reagimin kryesisht ndaj krimeve të rënda kur ato ndodhnin. Meqenëse nivelet e krimit dhe rreziqeve kërcënuese të shoqërisë filluan të rriteshin veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, zbatuesit e ligjit dhe udhëheqësit e tjerë komunal filluan të rishikojnë rolin e departamenteve të policisë në menaxhimin e sigurisë publike dhe përpjekjeve për reforma në mënyrë që kërkonin të reduktonin krimin nëpërmjet marrëdhënieve më të ngushta dhe të përmirësuara dhe partneritet direkt midis qytetarëve dhe policisë. Këto përpjekje përfundimisht u bashkuan rreth një filozofie të re të zbatimit të ligjit të njohur si “policimi në komunitet”, i cili thekson përfshirjen më të drejtpërdrejtë të strukturave me banorët vendas, të harmonizuara rreth hierarkive dhe protokolleve më pak të ngurta me idenë për të adresuar shkaqet rrënjësore të krimit në zonën dhe në banorët me të cilën lidheshin ngjarjet. lagjen me ndihmën të komunitetit më të madh.¹

3. Komponentët kryesorë të policimit në komunitet

Në terma të përgjithshëm, policimi në komunitet nuk është një program; nuk është një grup aktivitets; nuk është një emërim formal i personelit. Përkundrazi, policimi në komunitet është një filozofi e zbatimit të ligjit, një mënyrë për të menduar për përmirësimin e sigurisë publike. Derisa ekziston mungesa e standardizimit në lidhje me

¹ Diamond & Weiss (2009). *Advancing Community Policing Through Community Governance: A Framework Document*. US Department of Justice.

terminologjinë specifike dhe strategjitë e policimit në komunitet nëpër qytete, përpjekjet e policimit në komunitet mund të grupohen në tre kategoritë: transformimi organizativ, partneriteti i komunitetit dhe zgjidhja e problemeve. Secili prej këtyre komponentëve është përshkruar në disa detaje më poshtë. Sipas përkufizimit, një model gjithëpërfshirës i policimit në komunitet pothuaj se është i pranishëm në të gjitha strukturat duke depërtuar pothuajse në çdo aspekt të një departamenti të policisë dhe elementet e përshkruara më poshtë supozohet se zbatohen më së miri në një departament policie në tërësi.

4. Transformimi organizativ

Komponenti i parë i iniciativave të suksesshme të policimit në komunitet përfshin ndryshimet transformuese në strukturën organizative dhe funksionimin sa më efektiv të një departamenti të policie. Ky transformim mund të përfshijë politikat e menaxhimit, strukturën organizative, praktikat e personelit dhe sistemet e teknologjisë së informacionit, pa shmangur aspektet e tjera të mënyrës se si një shërbim policie është i strukturuar dhe vepron². Ndoshta, themeli i transformimit organizativ është se shërbimet e policisë janë të organizuara rreth detyrave dhe alokimeve të bazuara në njësi organizative gjeografike. Një nga argumentet kryesore të kësaj qasjeje është se detyrat me bazë gjeografike lehtësojnë kontaktin më të ngushtë dhe më të shpeshtë midis oficerëve që u dedikohen atyre zonave dhe njerëzve që jetojnë dhe punojnë në to. Mendimi është se me rritjen e kontaktit vjen një kuptim më i mirë i prioriteteve dhe shqetësimeve të një lagjeje dhe njohuri më të mirë rreth burimeve lokale dhe asetëve që mund të përdoren për të adresuar këto shqetësime.

Një tjetër veçori e policimit në komunitet, është decentralizimi. Në këtë kontekst, decentralizimi i një shërbimi departamenti policor nënkupton me tepër iniciativën dhe jo pritjen e mbështetjes në direktivat e hierarkisë nga lart-poshtë. Procesi i shërbimit në komunitet si në vendimmarrje dhe në strukturë raportimi është më pak hierarkik. Decentralizimi u jep punonjësve, por edhe drejtuesve lokalë më shumë autoritet dhe liri veprimi dhe u mundëson atyre të gjejnë zgjidhje krijuese për problemet specifike, origjinalitet dhe mundësi zhdërvjelltësie edhe në mënyrë individuale, pa kufizimet e masave të zbrazëta, apo edhe të politikave tepër të ngurta.

Si pjesë e përpjekjeve të tyre, policia në komunitet, krijojnë modele të dinamikës e të bashkëveprimit si me qytetarët, drejtuesit lokalë, shkollat, komunitetet në nevojë dhe gjejnë mënyrë si të adresojnë zgjidhjet në harmoni me gjithë aktorët mbi mënyrat më të mira për të adresuar çështjet e tyre të krimit që mund të jenë unike për një komunitet të caktuar³. Punonjësve të policisë u jepet autonomi më e madhe për krijim strategjish efektive, për drejtimin e shqetësimeve specifike të banorëve lokalë. Për të qenë efektiv, transformimi organizativ ndodh në të gjitha nivelet e shërbimit të policisë dhe përshkon një sërë sistemesh dhe praktikash. Për shembull, sistemet e vlerësimit të performancës që lidhen me përpjekjet e policimit në komunitet; rekrutimi dhe punësimi i oficerëve të rinj mund të favorizojnë individët që kanë një "orientim shërbimi" për policimin; dhe, trajnimi që thekson policimin në komunitet e që mund të bëhet pjesë e trajnimit standard, në shërbim.

² Diamond dhe Weiss (2009).

³ Po aty.

Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

5. Partneriteti i komunitetit

Partneritetet me komunitetin janë absolutisht të rëndësishme në mënyrë që angazhimi i policimit në komunitet të jetë efektiv. Hapësira e përfshirjes së komunitetit mund të shtrihet pothuajse në çdo aspekt të një shërbimi. Në shërbimet e policisë që demonstrojnë një angazhim të qartë ndaj filozofisë së policimit në komunitet, punonjësit e policisë dhe komuniteti i japin përparësi dhe zgjidhin çështjet e sigurisë publike që janë më të rëndësishme për komunitetin. Partneritetet e suksesshme janë më shumë se një kontakt më shpeshtë sesa thjesht ndarja e informacionit. Ato përfshijnë përpjekje të vazhdueshme për të punuar së bashku në mënyra kuptimplotë për të adresuar problemet me të cilat përballet një komunitet. Angazhimi dhe marrëdhëniet me komunitetin shtrihen në të gjitha nivelet, nga stafi drejtues deri tek punonjësit e thjeshtë.

Përveç banorëve, termi “partnerë me komunitetin” përfshin një varg grupesh si, shoqatat e komunale, organizimet religjioze, grupet e biznesit, strukturat e qeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve sociale, shkollat (duke përfshirë arsimin fillor dhe të mesëm publik por edhe shkollat private shkollat, deri tek shkollat profesionale dhe universitetet) pa lënë mënjanë bizneset lokale. Këto njësi zakonisht gëzojnë një sërë cilësish që lehtësojnë partneritetet efektive, duke përfshirë strukturat organizative të zhvilluara, hapësira për takime fizike, rrjete shoqërore, politike dhe komerciale, burime materiale dhe njerëzore, udhëheqës me përvojë dhe pjesëmarrje në komunitetin ekzistues. Kjo i bën ata mekanizma natyrore përmes të cilave policia mund të angazhohet me strukturat lokale për të adresuar shqetësimet në komunitet.

Përmirësimi i ndërthurjes së policisë dhe shërbimeve të komunitetit mund të jetë gjithashtu një katalizator efektiv për vetëangazhimin e komunitetit si dhe një mënyrë për të lehtësuar partneritetin me komunitetet. Një shembull i mirë mund të konsiderohet rritja e numrit të komuniteteve në të cilat ofrohen shërbime policore ose realizohet bashkërendimi i tyre me shërbime të tjera qytetare. Një mënyrë efektive mund të konsiderohet shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit për të përmirësuar komunikimin qytetar dhe për të afruara sa më shumë informacion në lidhje me sigurinë publike si në kohë edhe në aftësi. Në mjaft vende të zhvilluara pothuajse të gjitha shërbimet më efektive paraqesin faqet e internetit të shërbimeve që afronin informacione për rreziqet dhe adresat zyrtare të email-it të punonjësve të policisë në mënyrë që banorët të mund të shfaqin shqetësimet, të japin reagime dhe të komunikojnë për problemet.⁴

Në mënyrë që partneriteti me komunitetin të jetë sa më efektiv është e domosdoshme të ekzistojë një shkallë e besimit dhe respektit të ndërsjellë midis të dy aktorëve kryesorë: komunitetit dhe policisë. Është një moment që kërkon mjaft kujdes përse jo studime të mirëfillta për nivelin e besimit reciprok. Sigurisht që të dy aktorët paraqiten të lidhur ngushtë, aq sa besimi mund të konsiderohet tërësisht reciprok dhe ku ndikuesi kryesor janë veprimet e policisë. Nuk janë të rralla rastet kur në mjaft komunitete mungon besimi dhe respekti për njëri-tjetrin. Shumë komunitete kanë përjetuar histori të gjata të kriminalitetit, diferencime deri edhe sjellje jo të denja të policisë, faktorë që kontribuojnë në nivele të ulëta të besimit të qytetarëve marrëdhëniet me policinë dhe më tej në raportet me zbatimin e ligjit. Rindërtimi i këtij besimi është një parakusht kritik për krijimin e partneriteteve efektive

Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

⁴ Maguire and Wells (2009).

dhe specifike ndërmjet komuniteteve dhe policisë.

6. Në kërkim të zgjidhjeve

Ndoshta aspekti më transformues i integritit të policisë në komunitet, mbetet kalimi nga modeli i reagimit, ndaj 'reagimit', ndaj kriminalitetit, drejt zgjidhjes së problemeve, në një "model të orientuar drejt problemit"⁵. Kjo qasje përqendrohet në përpjekjet për parandalimin e krimit para se të ndodhë, duke identifikuar sistematikisht dhe adresuar çështjet specifike shoqërore që lidhen me veprimtarinë kriminale. Policimi i orientuar nga problematika, tenton të inkurajojë angazhimin e përbashkët ndaj problemeve, duke integruar jo vetëm punonjësit e policisë, por edhe aktorë të tjerë e veçanërisht pjesëtarët të komunitetit për të identifikuar rrënjët e problemit dhe pastaj se si t'i adresojë ato më së miri. Në një studim të analistit të shquar amerikan Cambell evidentohet fakti që qasjet e policimit të orientuara në probleme, kishin një ndikim shumë më të ndjeshëm statistikor në përmirësimin e sigurisë publike, sesa modeli i reagimit pas ndodhjes së ngjarjes⁶. Në këtë rast nuk ka kufizime në problematikë dhe, që është e përbashkët si në zona të konsideruara 'tradicional', por edhe në zona të 'reja' me banorë nga zona të ndryshme gjeografike.

Shërbimet e policisë që janë të bazuara në një filozofi të policimit në komunitet, i trajnojnë dhe i përzgjedhin punonjësit e policisë në detyra që janë të fokusuara në zgjidhjen dhe parandalimin e problemeve 'të mbuluara' apo edhe aktive, më tepër sesa thjesht te reagimi ndaj kriminalitetit dhe çrregullimit. Në mënyrë që punonjësit ta bëjnë këtë gjë në mënyrë efektive, kërkohet shkallë autonomie, e cila është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i transformimit organizativ të përshkruar më sipër. Një nga qasjet më të zakonshme në zgjidhjen e problemeve në shërbimet e policisë në komunitet, sipas studiuesve amerikanë është modeli i: skanimit, analizës, përgjigjes dhe vlerësimit (në anglisht modeli SARA). Janë katër hapa të një procesi që ndërtojnë edhe themelin e strategjisë së policimit në komunitet. Për vendet që e përdorin këtë strategji të policimit të orientuar drejt problemit, ka rezultate shumë cilësore që shprehin reduktime të ndjeshme në kriminalitet, krahasuar mbi modelet tradicionale të reagimit⁷.

7. Për një sukses në policimin në komunitet

Ndërsa strukturat e policisë janë të angazhuara për të zbatuar dhe realizuar reforma të rëndësishme në dinamikën e shërbimit policor, do të ishte e dobishme që të analizonim atë që kemi arritur nga përvoja e deritanishme për policimin në komunitet. Çështjet e mëposhtme, janë një reflektim nga 'mësimet e nxjerra' të kësaj përvoje:

- partneriteti me komunitetin ka nevojë për një spektër të gjerë partnerësh, mbi, dhe përtej grupeve aktive rezidente;
- nevoja për të rritur aksesin e shërbimit tek banorët që ju shërbejmë;
- edukimi dhe trajnimi i personelit në çdo nivel të shërbimit me praktikata më të mira

⁵ Goldstein, H (1987). "Toward Community-Oriented Policing: Potential, Basic Requirements, and Threshold Questions." *Crime and Delinquency* Vol. 33 No. 6.

⁶ Weisburd et al. (2010). "Is Problem-Oriented Policing Effective in Reducing Crime and Disorder? Findings From a Campbell Systematic Review." *Criminology & Public Policy* Vol. 9 Issue 1. The American Society of Criminology.

⁷ City Policy Associates (2000). *Safer Neighborhoods Through Community Policing, Volume II: Three Case Studies*. US Conference of Mayors

Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

të policimit në komunitet;

- ngritja e nivelit dhe ndërgjegjësimit të punonjësve të policisë në lidhje me përfitimet nga filozofia e policimit në komunitet;

- integrimi i aktiviteteve të policimit në komunitet me sistemet e vlerësimit të performancës;

- mbështetje dhe njohje për qasjet sistematike dhe të standardizuara për zgjidhjen e problemeve.

Përdorimi nga strukturat e Policisë së Shtetit i modelit të policimit në komunitet si filozofi dhe mënyrë veprimi mund të thuhet se e ka zanafillën që nga viti 1998, duke filluar me takime me komunitetin dhe aktorë të tjerë, në funksion të grumbullimit të armëve dhe municioneve luftarake pa leje. Në vitet në vijim u bënë përpjekje për hartimin e dokumenteve të planifikimit për zhvillimin e kësaj metode pune, si në vitet 2004-2005 u hartuan strategji të policimit në komunitet, ngritja e grupeve të përbashkëta të bashkëpunimit polici-komunitet, krijimi i zyrave të punës së ndihmës specialistit të zonës në territorin ku operojnë, trajnimi i specializuar i punonjësve të policisë të së gjithë niveleve, etj. Përpjekje serioze për implementimin e policimit në komunitet janë bërë edhe nëpërmjet bashkëpunimit të policisë me organizata ndërkombëtare dhe vendase, si:

- DANIDA (viti 1999 - 2003) me objektiv kryesor forcimin e bashkëpunimit polici - shkolla – shërbime sociale dhe realizimin e një projekti pilot në zonën e Dibrës.

- Programi UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara) mbështetje të reformave në sektorin e sigurisë (Programi SSSR) zhvilluar në periudhën 2004 – 2007, me rikonstruksionin e 9 sallave të pritjes në komisaritet e policisë, trajnime të oficerëve të policisë, ngritjen e grupeve konsultative të qytetarëve, ndërtimin e disa zyrave në lagje për SPZ, ku banorët mund të takoheshin me inspektorin e rendit publik, duke ngritur problemet dhe shqetësimet e tyre.

- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) në kuadër të projektit “Promovimi i demokracisë lokale ndërmjet ndërlidhësve komunitarë” dhe projekteve të tjera që kanë synuar bashkëpunimin dhe llogaridhënien.

- Bashkëpunimi dhe mbështetja e institucioneve të tjera shtetërore, organeve të qeverisjes vendore dhe subjekteve juridike e fizike, në fushën e zbatimit të ligjit, etj. Bashkëpunimi me Institucionin e Avokatit të Popullit, organizata dhe institucione ndërkombëtare OSBE, CPT, PAMECA, ICITAP dhe OJF si; Komiteti Shqiptar i Helsinikit, Instituti Evropian i Tiranës, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut etj., në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të personave të arrestuar dhe ndaluar në ambientet e policisë.

- SACP (Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj MPB/PSHSH-së për policimin në komunitet).

- Bashkëpunimi me aktorë të tjerë shtetërorë, institucione ndërkombëtare, OJF në drejtim të parandalimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e të miturve autorë të veprave penale dhe viktimë të veprave penale.

Strukturat vendore të policisë kanë kaluar në proces reformimi e së bashku me to, janë riorganizuar edhe strukturat e policimit në komunitet, duke u krijuar seksionet e policimit në komunitet në 26 komisariate në qendër të drejtorive vendore të policisë dhe komisariateve të rretheve gjyqësore.

Aktualisht Policia e Shtetit ka krijuar kushtet për një ecuri më pozitive të implementimit të policimit në komunitet dhe kryerjes së një hopi cilësor në rritjen e

standardeve të sigurisë në vend. Me miratimin e ligjit të ri “Për Policinë e Shtetit”, është bërë një hap i madh në drejtim të riorganizimit strukturor të Policisë së Shtetit dhe shtimit të limitit organik të punonjësve të policisë të nivelit zbatues, krijimit të sistemit të ri të shkollimit e trajnimit të punonjësve të policisë të së gjithë niveleve, hartimit të disa akteve nënligjore në fushën e policimit në komunitet, krijimit dhe funksionimit të zyrave të shërbimit për qytetarët në drejtoritë vendore/komisariatet e policisë në vend. Forcimit të policimit në komunitet, po i shërbejnë edhe politikat gjithëpërfshirëse në këtë drejtim, të qeverisë shqiptare dhe të Ministrisë së Brendshme. Një shtytje të madhe këtij procesi i ka dhënë e po vazhdon t’i japi edhe programi suedez “Forcimi i policimit në komunitet”.

Nëpërmjet fazës së dytë të këtij programi dhe aplikimit të skemës së granteve për Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë, Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë, synohet fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të koalicioneve me bazë komunitare, rritja e besimit të ndërsjellët dhe përmirësimi i ndërveprimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, për rritjen e cilësisë së shërbimeve në tërësi. Nëpërmjet këtyre granteve synohet krijimi dhe konsolidimi i partneriteteve ndërmjet strukturave të Policisë së Shtetit, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus rininë, si iniciativa në fushën e zgjidhjes së konflikteve, ndërgjegjësimin, pasojat e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rrugor dhe krimin kibernetikë, trafikimin e qenieve njerëzore, krimet homofobike, parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, etj.; me theks të veçantë, masat parandaluese.

Sfidat dhe nevoja për suksesin. Në muajin mars 2018, në zbatim dhe të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë së Policisë së Shtetit 2015 – 2020, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, janë urdhëruar drejtoritë vendore të policisë, të marrin masat për realizimin e objektivit, për një sistem të qëndrueshëm dhe të përhershëm të partneritetit ndërmjet Policisë së Shtetit e aktorëve të tjerë, - në mënyrë të veçantë, me komunitetin, - për sigurimin e ambienteve të punës e shërbimit të ndihmës, për specialistët e policimit në komunitet, pranë njësisve administrative, në gjithë territorin e vendit, me qëllim, forcimin e partneritetit të policisë me komunitetin, që këta punonjës policie të jenë më afër komunitetit dhe të njihen me problemet e shqetësimet e tij.

Institucionalizimi i policimit në komunitet përmes transformimit organizativ kërkon resurse të mjaftueshme dhe përkushtim të qëndrueshëm, jo vetëm nga stafi policor, por edhe nga drejtuesit lokal të komunitetit. Kjo kalon nëpërmjet një ndryshimi të kulturës së një shërbimi tradicional dhe mund të jetë po aq e vështirë, - nëse jo më e vështirë, - sa ndryshimi i politikave, procedurave dhe trajnimit. Krijimi dhe konsolidimi i partneriteteve kuptimplote me komunitetin kërkojnë një edukim të së gjithë aktorëve, përfshirjen e aktorëve ‘të harruar’ dhe një përgjegjësi të përbashkët për rezultatet. Angazhimi në zgjidhjen efektive të problemeve kërkon të dhëna nga disa burime informacioni, të dhëna me cilësi të lartë dhe të besueshme, iniciativa e punonjësve për të planifikuar dhe zbatuar zgjidhje të fokusuara dhe krijuese si dhe komunikim të vazhdueshëm. Asnjë nga këto nuk është e lehtë, por asnjë nga këto nuk është edhe e pamundur.

Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Bibliografi

1. Dokumenti për Sigurinë në Komunitet 2015-2017.
2. Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2015
3. Ligji nr. 19/2016 për masat shtesë të sigurisë publike.
4. Braga, Anthony and Bond, Brenda (2008). "Policing Crime and Disorder Hot Spots: a Randomized Controlled Trial." *Criminology* Vol. 46 No. 3, August 2008.
5. Bratton Group, LLC (2013). *District-Based Investigations in Oakland: Rapid and Effective Response to Robberies, Burglaries, and Shootings*.
6. Cordner, G. (2010). *Reducing Fear of Crime: Strategies For Police. Community Oriented Policing Services*. U.S. Department of Justice.
7. Diamond, D. And Weiss, D. (2009). *Advancing Community Policing Through Community Governance: a Framework Document*. Washington, DC: U.S. Department of Justice.
8. US Department of Justice, *Community-Oriented Policing Services*.
9. Goldstein, H (1987). "Toward Community-Oriented Policing: Potential, Basic Requirements, and Threshold Questions." *Crime and Delinquency* Vol. 33 No. 6.
10. Harnett Associates (2006). *Crime Fighting in Oakland: An Assessment of the Oakland Police Department*.
11. Kelling, G. And Moore, K. (1988). "The Evolving Strategy of Policing." *Perspectives on Policing* No. 4. November 1988.



Alushani, R.
« Policimi
në komunitet:
sfidë dhe
nevojë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Aspektet juridiko-penale të vrasjes në familje, metodika e hetimit dhe mjetet e kërkimit të provave



■ **Dr. (proc.) Besnik MUÇI**
Prokuroria e Krimeve të Rënda
besnik_muci@yahoo.com

Abstrakt

Vrasjet në familje janë një fenomen mjaft shqetësues për shoqërinë tonë. Kalimi nga një shoqëri relativisht konservatore në marrëdhënie familjare, në një shoqëri të hapur dhe të lirë ku çdo pjesëtar i saj ka të drejta të barabarta, ka sjellë përplasje brenda saj. Po ashtu shkatërrimi, me forcë, plotësisht i marrëdhënies të pronësisë gjatë regjimit komunist dhe situata ende pastabilizuar e pronësisë në vendin tonë, edhe brenda familjeve, sjell konflikte të vazhdueshme të cilat përfundojnë dhe në vrasje. Për këto arsye, përballja me këtë fenomen është një sfidë e rëndësishme e shoqërisë tonë dhe në veçanti e institucioneve të zbatimit të ligjit, që kanë për detyrë të identifikojnë, parandalojnë, hetojnë, procedojnë penalisht dhe dënojnë autorët e këtyre veprave penale. Për këtë, në radhë të parë është e nevojshme një analizë dhe kuptim sa më i mirë nga të gjykata, prokuroria dhe policia gjyqësore i elementëve juridiko-penalë të kësaj figure krimi. Analiza dhe kuptimi i të gjitha veçorive juridiko-penale të këtij krimi në objektin juridik dhe material të saj, anën objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, në subjektin dhe anën subjektive të saj. Në veçanti, objekti juridik dhe material si dhe subjekti i kësaj vepre penale të cilat njëkohësisht janë tiparet dalluese për kualifikimin juridik të saj. Ky krim me veçori mjaft specifike, e vështirëson gjetjen dhe administrimin procedural të provave. Ndaj është e nevojshme aplikimi i metodave specifike të hetimit të cilat duhet t'i përshtaten këtij krimi. Në këtë punim bëhet një analizë juridiko-penale e kësaj vepre penale, e metodikës së hetimit, mjeteve të kërkimit të provave dhe mbi provat më tipike në këtë lloj procesi penal.

Fjalëkyçe:

Vrasjet në familje, objekti juridik dhe material i veprës penale, subjekti i veprës penale, metodika e hetimit, provat, mjetet e kërkimit të provave, këqyrje, përgjim.

Muçi, B.
« Aspektet juridiko-penale të vrasjes në familje, metodika e hetimit dhe mjetet e kërkimit të provave »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Analiza juridiko penale e veprës penale të vrasjes në familje

Vrasjet në familje janë një fenomen mjaft shqetësues për shoqërinë tonë. Kalimi nga një shoqëri relativisht konservatore në marrëdhëniet familjare në një shoqëri të hapur dhe të lirë, ku çdo pjesëtar i saj ka të drejta të barabarta ka sjellë përplasje brenda saj. Po ashtu, shkatërrimi me forcë, plotësisht i marrëdhënieve të pronësisë gjatë regjimit komunist dhe situata ende e pastabilizuar e pronësisë në vendin tonë, edhe brenda familjeve, sjell konflikte të vazhdueshme të cilat përfundojnë dhe në vrasje. Ndaj përballja me këtë fenomen është një sfidë e rëndësishme e shoqërisë tonë dhe në veçanti e institucioneve të zbatimit të ligjit që kanë për detyrë të identifikojnë, parandalojnë, hetojnë, procedojnë penalisht dhe dënojnë autorët e këtyre veprave penale. Mbrojtja e familjes duhet të jetë detyrë parësore e shoqërisë sonë. Familja konsiderohet një nga institucionet më të rëndësishme për edukimin e fëmijës... është institucioni ku njerëzit mësojnë si të trajtojnë stresin, krizat dhe problemet e tjera¹.

Për këtë, në radhë të parë, është e nevojshme që sistemi ynë i së drejtës penale të jetë i plotë në parashikimin e këtij krimi si dhe në analizën dhe kuptimin sa më të mirë nga gjykata, prokuroria dhe policia gjyqësore i elementëve juridiko-penalë të kësaj figure krimi. Analiza dhe kuptimi i të gjitha elementëve juridiko-penalë të këtij krimi në objektin juridik dhe material të saj, anën objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, në subjektin dhe anën subjektive të saj është shumë e rëndësishme. Në veçanti, objekti juridik dhe i drejtpërdrejtë si dhe subjekti i kësaj vepre penale të cilat njëkohësisht janë

Muçi, B.
« Aspektet juridiko-penale të vrasjes në familje, metodika e hetimit dhe njetet e kërkimit të provave »

Policimi dhe Siguria nr.11, 2018

¹ Vasilika Hysi, *Kriminologjia*, 2008, f. 365.

tiparet dalluese për kualifikimin juridik të saj.

Në këto kushte ishte e nevojshme që edhe legjislacioni penal shqiptar të parashikonte mbrojtje juridiko-penale të veçantë për këtë kategori personash. Lidhur me inkrimimin e çdo sjellje që cenon jetën e personit autorët J. Pradel, G. Corstens dhe G. Vermeulen në librin e Drejta Penale Europiane theksojnë se « E rëndësishme është që Shtetet kanë detyrimin për të ndjekur penalisht çdo sjellje që është në kundërshtim me të drejtën e jetës... për vrasjen e vullnetshme kërkohet ndjekje penale »². Edhe Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të së Drejtave të Njeriut, së Strasburgut³ kur analizon detyrimin e shtetit për të mbrojtur jetën e njeriut parashikon edhe detyrimin për të krijuar dhe një sistem të së drejtës penale efektiv dhe parandalues të mbështetur nga shërbimet që merren me parandalimin, identifikimin dhe penalizimin efektiv të këtyre veprave penale. Sipas nenit 2 të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Shteti ka « Detyrimin pozitiv për të marrë masa parandaluese me karakter praktik për të mbrojtur individin që i kërcënohet jeta nga veprimet kriminale të dikujt⁴ ».

Në këtë vështrim Kodi ynë Penal në ndryshimet e tij me ligjin nr. 144 të vitit 2013 është plotësuar duke parashikuar si figurë më vete krimin e vrasjes brenda familjes, duke përmblusur në këtë mënyrë dhe detyrimin e shtetit për të krijuar një sistem penal efektiv edhe në këtë fushë. Në Kreun e II, Veprat penale kundër personit, krime kundër jetës, Seksioni I, Krime kundër jetës të kryera me dashje, ka parashikuar në nenin 79/c të tij « Vrasjen për shkak të marrëdhënieve familjare ». Sipas tij, « Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt apo krushqi e afërt me autorin e veprës penale dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm ».

Duke bërë një analizë historike të legjislacionit penal shqiptar në lidhje me këtë vepër penale, konstatojmë se edhe Kodi i parë Penal i shtetit shqiptar, Kodi Penal i Zogut⁵, e parashikonte mbrojtjen e veçantë juridiko-penale për pjesëtarët e familjes duke e parashikuar si figurë krimi më vete. Kodi Penal i Zogut, në Titullin XI, Vrasjet, Kapitulli I, Vrasja, neni 403 parashikon se « Kushdo që me qëllim shkakton vrasjen e tjetrit, ndëshkohet me burgim jo më pak se 20 vjet ». Në nenin 404 parashikohen vrasjet e cilësuar, që janë gjashtë figura krimi më vete, gjashtë paragrafë, ku përsihien dhe vrasjet në familje që është paragrafi i parë i kësaj dispozite. Konkretisht në të parashikohet se: « Ndëshkimi është burgim i përjetshëm në qoftë se vrasja bëhet:

1. kundër bashkëshortit, vëllait, atit ose amës adoptive, djalit apo vajzës adoptive, vjehrrit ose vjehrrës, dhëndrit ose nuses;

2. kundër anëtarëve të parlamentit dhe funksionarëve publikë;

3. duke përdorur lëndë helmuese;

4. me tredhje ose në mënyrë asfiksuese;

5. kundër gruas shtatzënë;

6. dhe ai që vret 2 ose më shumë persona ».

Me vrasje kuptohet ajo vepër, veprim apo mosveprim, i kundërligjshëm me anën e të cilës i hiqet jeta një personi me dashje ose nga pakujdesia⁶. Ky është kuptimi që i ka dhënë e Drejta Penale Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, e mbështetur në traditën

² Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermuelen, *E Drejta Penale Evropiane*, 2010, f. 287.

³ GjEDNj 28/3/2000, *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, f. 96,104.

⁴ GjEDNj 31/5/2007, *Kontrova kundër Sllovakisë*, f. 49.

⁵ *Kodi Penal i Zogut*, Tiranë 1928, neni 403 dhe 404.

⁶ Ismet Elezi, *E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme*, 2016, f. 33.

dhe literaturën e Bashkimit Sovjetik. Sipas saj, me fjalën vrasje, ligji kupton privimin e jetës së një njeriu nga një tjetër. Këtë përkufizim e jep kryesisht teoria e së drejtës. Literatura juridike perëndimore e konsideron jetën të drejtën themelore të njeriut duke i kushtuar mbrojtje shumë të gjerë juridiko-penale. Të drejtat kryesore (ose materiale), përfshi të drejtën për jetën, ekzistojnë jashtë çdo procesi. Ato i takojnë çdo individ⁷.

Objekti i veprës penale të vrasjes në familje janë marrëdhëniet juridike për të siguruar paprekshmërinë e jetës së pjesëtarëve të familjes nga veprimet kriminale të pjesëtarëve të saj. Ky lloj krimi është një vrasje me dashje, por që bëhet e cilësuar sepse dy elementët e saj, objekti dhe subjekti karakterizohen nga rrethana të posaçme. Pra, e veçanta e kësaj figure krimi është se personi që i merret apo cenohet jeta dhe subjekti i saj, personi që me veprimet e tij sjell pasojën kanë lidhje familjare midis tyre, bashkëshortë, gjini ose krushqi e afërt.

Për të pasur figurën e krimit të kryer nevojitet ekzistenca e një veprimi të caktuar të subjektit të krimit dhe konstatimi i ardhjes së vdekjes si rezultat i këtij veprimi. Pra, duhet konstatuar dhe lidhja shkakësore midis veprimit të kryer dhe rezultatit të vërtetuar, d.m.th. privimit të jetës. Kjo përbën dhe anën objektive të figurës së krimit të vrasjes. Edhe në vrasjen në familje kërkohet konstatimi i veprimit të kundërligjshëm kriminal dhe konstatimi i pasojës, të ardhur ose të ngelur në tentativë, si pasojë e tij. Nëse objekti i kësaj figure krimi është i lehtë për t'u kuptuar dhe interpretuar në praktikë, ana objektive përbën elementin më të vështirë për t'u zbuluar si fillim, dhe më pas për t'u provuar. Kjo, pasi kemi një krim me veçori mjaft specifike, i kryer shpesh brenda ambientit të ngushtë familjar, nga ana objektive jo shumë i shfaqur në mjedisin e jashtëm, mungesa shpesh e vullnetit të familjarëve për bashkëpunim me organet e ndjekjes penale madje deri edhe zhdukja dhe fshehja e provave e vështirëson gjetjen dhe administrimin procedural të tyre. Ndaj është i nevojshëm aplikimi i metodave specifike të hetimit të cilat duhet t'i përshtaten këtij krimi.

Subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm dhe e bën të cilësuar këtë vrasje. Ai është familjar i afërt, gjini ose krushqi e afërt me viktimën. Gjithashtu duhet të plotësojë dhe dy kushtet e përgjithshme të përgjegjesisë penale, moshën mbi 14 vjet dhe përgjegjshmërinë. Kjo e fundit përbën një rrethanë mjaft të rëndësishme në procesin penal për faktin se kjo vrasje duke ndodhur midis personave shumë të afërt të një familje përgjithësisht ka një ngarkesë mjaft të lartë emocionale tek autori e cila shpesh sjell uljen e aftësisë së tyre për të kuptuar rëndësinë e veprimit ose veprimeve që kryen. Madje këto krime lënë pasojë shumë të rënda në gjendjen mendore të autorit edhe pas kryerjes së tyre. Në këtë mënyrë kryerja e ekspertimit psikiatriko-ligjor është e detyrueshme në çdo proces për të sqaruar faktin nëse autori ka qenë i përgjegjshëm në momentin e kryerjes së krimit apo në momentin e gjykimit penal.

Nga ana subjektive, këto krime kryhen me dashje. Në këto raste autori është i vetëdijshëm se në përfundim të veprimeve të tij të kundërligjshme do të vijë vdekja e viktimës dhe ai e dëshiron ardhjen e këtij rezultati (vrasje me dashje direkte) ose nuk e dëshiron, por me ndërjegjeje e lejon dhe pranon ardhjen e saj (vrasje me dashje indirekte, eventuale). Ky krim nuk kryet nga pakujdesia.

2. Metodika e hetimit të veprës penale të vrasjes në familje

Me metodikë hetimi ose metodikë kriminalistike kuptojmë një sistem njohurish

⁷ Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermuelen, *E Drejta Penale Evropiane*, 2010, f. 280.

mbi bazën e të cilave përpunohen rekomandime teknike e taktike për organizimin, planifikimin dhe zhvillimin e hetimit në përshtatje me veçoritë që kanë llojet e ndryshme të veprave penale⁸. Vrasja në familje është një nga format më të rënda dhe me rrezikshmëri shoqërore më të lartë të vrasjeve. Varieteti i madh i formave me të cilat realizohet kjo lloj vrasje sjell dhe varietetin e madh të metodave të hetimit. Të kapurit në mënyrë shabllon pas metodave të caktuara hetimore nuk jep rezultate të mira, pasi çdo rast i praktikës hetimore ka karakteristikat e tij të veçanta. Prokurori dhe policia Gjyqësore nuk mund të gjejnë rrugën e drejtë të hetimeve po nuk morën parasysh këto karakteristika të veçanta.

Por, studimi i vëmendshëm i praktikës hetimore na çon në përfundimin se ekzistojnë disa mënyra të përgjithshme, të cilat mund të zbatohen me sukses në hetimin e shumicës së rasteve të këtij krimi. Ky fakt na lejon të ndërtojmë një metodikë unike të hetimit të veprës penale të vrasjes në familje. Por, kjo metodë unike nuk do të ishte e mjaftueshme po të mos ia përshtatim kushteve specifike të veprës penale konkrete. Kështu p.sh.: kohës dhe vendit të realizimit të vrasjes, mjetit dhe mënyrës së kryerjes, natyra e lidhjes familjare me personat e dyshuar etj.

Pavarësisht përpjekjeve që bëhen për të paraqitur një metodikë hetimi për vrasjet në familje, kjo në asnjë mënyrë nuk mund të jetë universale dhe e përshtatur për të gjitha rastet. Më poshtë janë dhënë vetëm tipare të përgjithshme, tipike dhe karakteristike për praktikën e hetimit të kësaj vepre penale.

Gjatë hetimit të çështjeve të vrasjes në familje hetimi duhet të zbardhë këto çështje:

- Çfarë lloj vdekje me dhunë ka pasur viktimja dhe cili ka qenë shkaku i vdekjes?
- Kur është kryer krimi dhe kur ka ardhur vdekja e viktimës?
- Ku është kryer krimi?
- Cilat janë mënyrat dhe mjetet e kryerjes së vrasjes?
- Kush e ka kryer vrasjen dhe a ka bashkëpunëtorë në krim?
- Nëse është vrasje me dashje apo nga pakujdesia dhe në rastin e vrasjes me dashje cilat kanë qenë motivet.

Secili nga këto fakte duhet të konfirmohet nga provat e mbledhura gjatë hetimit. Disa nga këto fakte konstatohen gjatë pyetjes së të afërmeve të viktimës, personave që kanë parë krimin apo që kanë gjetur të parët kufomën apo gjurmë të tjera të krimit. Fakte të tjera konfirmohen me këqyrjen e kufomës dhe të vendit të ngjarjes apo ku është gjetur. Për disa nga faktet e mësipërme kërkohet mendimi i ekspertëve të fushave të ndryshme, ndërsa fakte të tjera provohen me këqyrjen dhe marrjen e provave të ndryshme materiale, dokumenteve, etj. Më në fund, duke pyetur dhe vetë të pandehurin mund të vërtetohen rrethana dhe fakte me rëndësi vendimtare për hetimin e çështjes.

Nga të gjitha këto veprime hetimore të lidhura me hetimin e vrasjes në familje duhet të veçojmë ato që kanë rëndësi të dorës së parë për zbulimin e krimit, sikurse janë këqyrja e vendit të ngjarjes ose të gjetjes së kufomës dhe të provave materiale të gjetura në këtë vend. Praktika ka treguar se këqyrja e kujdesshme e matur dhe e planifikuar mirë e vendit të ngjarjes apo gjetjes së kufomës i jep hetimit prova të rëndësishme. Rëndësi të madhe merr ky veprim në vrasjet në familje, të cilat në shumicën e rasteve ndodhin brenda shtëpisë së viktimës dhe familjarët lëvizin kufomën apo ndryshojnë vendin e ngjarjes për arsye se përgatiten për ceremoninë mortore apo dhe për arsye subjektive me qëllim mbulimin e natyrës së krimit duke e paraqitur si vetëvrasje apo

⁸ Skënder Begeja, *Kriminalistika*, f. 482.

duke dashur të fshehin provat e krimit. Kuptohet se të gjitha të dhënat dhe provat e marra gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes mund të shfrytëzohen me sukses gjatë procesit nëse janë pasqyruar me saktësi dhe qartësi në procesverbalin e këqyrjes.

Në hetimin me sukses të kësaj vrasje duhet theksuar rëndësia e veçantë që ka faktori kohë. Vrasja, nga specifikat që ka si krim, bën pjesë në ato ngjarje në të cilat koha punon në favor të autorit. Sa më shumë kohë t'i mbetet autorit si i pazbuluar, aq më tepër mundësi i mbeten atij për të zhdukur gjurmët e krimit, e më tepër shanse do të ketë ai që të mbështetet në faktin se koha do të zhdukë nga kujtesa e dëshmitarëve detajet e vrasjes, dikur të perceptuara qartë prej tyre, dhe do t'i lejojë, ndonëse në mënyrë fiktive, por me sukses të provojë pafajësinë e tij. Në lidhje me këtë fakt, merr rëndësi të madhe zhvillimi i planifikuar i hetimeve, që siguron kryerjen e tyre në drejtimin e përcaktuar mirë dhe e lejon prokurorin dhe oficerin e policisë gjyqësore që të punojë në mënyrë të përpiktë dhe produktive.

Në këtë kuadër rëndësi ka çështja se cili është momenti kur duhet filluar me përpilimin e një plani hetimi për çështjen. Përpunimi i parakohshëm i planit ashtu si dhe ai i kryer me vonesë mund të shkaktojnë të njëjtat pasoja negative. Në rastin e parë, duke mos ditur, pasur, akoma rrethana me rëndësi, mund të gabohet lehtë në caktimin e drejtimit të hetimeve. Përpilimi me vonesë i planit do të sjellë si pasojë që pjesa më e madhe e hetimit të kryhet pa sistem dhe si rrjedhim t'i shpëtojnë hetimit çështje me rëndësi. Nga ana tjetër, plotësimi i mëvonshëm i boshllëqeve të hetimit shpesh është praktikisht i pamundur. Përpilimi i planit të hetimeve duhet të nisë sapo të jetë siguruar materiali i nevojshëm fillestar, i cili të lejojë qoftë dhe përafërsisht përcaktimin e atyre drejtimeve, në të cilat duhet organizuar hetimi i mëtejshëm, d.m.th., kur të jenë kryer veprimet më emergjente.

Për të krijuar një ide më të qartë të kësaj çështjeje po u referohemi veçorive karakteristike që u takojnë fazës fillestare të hetimit të çështjeve për vrasje; p.sh., oficeri i policisë gjyqësore njoftohet nga spitali që një person është sjellë nga familjarët me dyshimin se është helmuar dhe ka vdekur sapo ka mbërritur dhe që ka disa shenja të lehta dhune në fytyrë dhe në krahë. Do të ishte e gabuar që në këtë gjendje të nisë menjëherë përpilimi i planit të hetimeve lidhur me këtë vdekje. Një plan hetimi i përpiluar në këtë moment, jo vetëm do të pengojë iniciativën e hetimit, por edhe do ta çorientojë atë. Një plan hetimi në kohën e përpilimit të tij duhet të bazohet kurdoherë në disa të dhëna fillestare objektive, qoftë dhe minimale, por të mjaftueshme për të ngritur në mënyrë të arsyetuar versionet dhe rrethin e çështjeve për t'u hetuar pa lënë jashtë konsideratës dhe veçoritë individuale të rastit konkret. Të tilla të dhëna fillestare do të rezultojnë zakonisht vetëm pasi të jenë kryer ato veprime hetimore që në rastin e vrasjeve janë fillestare, të domosdoshme dhe nuk mund të shtyhen. Këto veprime janë:

1. këqyrja e vendit të ngjarjes, ku është kryer vrasja ose ku është gjetur kufoma;
2. këqyrja me ekspertë mjeko-ligjorë e kufomës dhe kryerja e autopsisë;
3. marrja në pyetje e dëshmitarëve okularë.

Nuk ka asnjë nevojë për planifikimin e posaçëm të këtyre veprimeve pasi ato janë të detyrueshme dhe karakteristike për fillimin e hetimeve për pothuajse të gjitha çështjet me vrasje.

Fill pas kryerjes së këtyre veprimeve kalohet në fazën e planifikimit të hetimeve. Dhe faza e parë e këtij planifikimi ka të bëjë me caktimin e drejtë dhe të mirë të së gjitha versioneve lidhur me vrasjen, që mund të lejojë rasti i dhënë. Versionet përfaqësojnë në vetvete supozimet e prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore mbi natyrën e vrasjes

Barjami, XH.
« Buxhetimi
dhe misioni
i policisë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

që hetohet, mbi personat që mund të kenë kryer dhe mbi motivet e kryerjes së saj. Secila nga versionet e ngjarjes duhet të mbështetet pak a shumë mbi materialin faktik të mbledhur deri në këtë moment. Ato përcaktojnë drejtimit që do të ndjekë hetimi. Kjo e detyron organin e hetimit që në përpilimin e planit të hetimeve, nga njëra anë të jetë i matur, duke analizuar në mënyrë të kujdesshme të dhënat që ka në dispozicion, ndërsa nga ana tjetër të ngrejë të gjitha versionet e mundshme, që mund të shpjegojnë krimin e ndodhur, duke marrë në konsideratë të gjitha karakteristikat e veçanta të çështjes në hetim.

Për shembull, në rastin tonë do të vlerësojmë nëse ndodhemi para një vetëvrasje duke pirë helm, jemi para një vrasje duke e helmuar nëpërmjet ushqimit ose pijeve nga ndonjë pjesëtar i familjes për motive pasurore, motive xhelozie, etj., apo një rasti faktor, kur viktimja ka pirë pa dashje lëndë helmuese.

Në këtë moment bëhen zakonisht dy lloj gabimesh. Në disa raste organi i hetimi kapet pas një versioni, që i duket më i mundshëm, duke lënë pas dore versionet e tjera. Kjo është veçanërisht e dëmshme kur një version i tillë i sugjerohet nga një i tretë në hetim. Në raste të tjera në fazën fillestare ngrihen aq shumë versione dhe aq shumë hipoteza të pambështetura në të dhënat objektive fillestare sa që kalojnë në fantazi. Kjo ndodh kur versionet ngrihen para se të jenë mbledhur të dhënat fillestare të domosdoshme dhe është e qartë se edhe në këto raste duke shpërndarë vëmendjen në shumë versione rrezikohet të humbasë vëmendja nga versioni real i ngjarjes.

Çdo version në rastin e vrasjes në familje duhet të ngrihet si rezultat logjik i materialit faktik të mbledhur në përfundim të veprimeve fillestare, të jetë i bazuar mbi të dhëna reale dhe të jetë praktikisht i mundshëm. Kjo kërkon prej prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, aftësi të lartë vëzhgimi, shkathtësi mendore si dhe analizë logjike. Analiza kritike dhe e gjithanshme e materialeve fillestare i lejon që të ndërtojë në mendjen e tij kuadrin e mundshëm të krimit, të ngrejë në mënyrë objektive versionet e tij dhe si pasojë të përpilojë një plan të drejtë dhe të plotë hetimi.

Pas përcaktimit të versioneve hetimore planifikohen me hollësi të gjitha veprimet që duhen kryer, me qëllim për të sqaruar dhe verifikuar në mënyrë të plotë çdo version. Planifikohen të kryhen të gjitha veprimet e mundshme hetimore. Faza e përfundimit të planit është përcaktimi i kohës kur duhet të kryhen veprimet hetimore si dhe radha e kryerjes së tyre. Në këto çështje ka një rëndësi shumë të madhe radhitja e matur dhe taktikisht e drejtë e kryerjes së veprimeve hetimore. Në një çështje mund të jetë taktikisht oportune të kryhet më parë kontrolli i banesës apo personit dhe më pas pyetja e tij, në një rast tjetër mund të kryhet më parë përgjimi, pyetja dhe më pas kontrolli, etj.

Duke caktuar radhën edhe afatet e kryerjes së veprimeve hetimore, me qëllim sqarimin e të gjitha versioneve hetimore, duhet të evitohet verifikimi i versioneve sipas një radhe të caktuar dhe që konsiston në faktin që në fillim verifikohet ai version që duket më shumë i mundshëm dhe vetëm pasi ky të ketë rezultuar i pabazuar fillohet me verifikimin e versionit të dytë e kështu me radhë. Në çështjet e vrasjeve dhe sidomos vrasjeve në familje është totalisht e papranueshme një praktikë e tillë. Derisa të konkludohet që një version është pa baza mund të zhduken të gjitha mundësitë për verifikimin e versioneve të tjera. Prandaj duhet të sigurohet verifikimi i njëkohshëm dhe paralel i të gjitha versioneve dhe secili prej tyre mund të konsiderohet i pa bazuar vetëm pasi të ketë rezultuar i tillë në mënyrë të pakontestueshme nga provat e mbledhura.

Përpilimi i planit të hetimit nuk mund të konsiderohet si qëllim në vetvete, ai nuk është një skemë e ngrirë dhe e palëvizshme pasi një qëndrim i tillë nuk do të kishte praktikisht asnjë kuptim, madje do të pengonte Oficerin e Policisë Gjyqësore në punën hetimore. Hetimi mund dhe duhet të planifikohet vetëm në lidhje të ngushtë me dinamizmin e tij, duke mos e zbatuar atë në mënyrë mekanike por duke i bërë gjatë hetimeve korrigjimet eventuale dhe të nevojshme. Në çdo rast, pas kryerjes së një apo disa veprimeve hetimore duhet t'i drejtohem përsëri planit të hetimit dhe në varësi të rezultatit të veprimeve hetimore të bëjmë plotësimet, ndryshimet ose korrigjimet e nevojshme.

3. Provat dhe mjetet e kërkimit të tyre në hetimin dhe gjykimin e vrasjeve në familje

Në funksion të një metodike specifike hetimi duhet të jenë përcaktuar qartë lloji i provave që duhen mbledhur dhe mjetet e kërkimit dhe marrjes së tyre. Të gjitha provat klasike si dëshmitë, ballafaqimi, njohjet, eksperimenti, ekspertimi, provat materiale dhe dokumentet mund dhe duhet të shërbejnë në procesin e të provuarit të kësaj vepre penale. Por, kujdes shumë i veçantë i duhet kushtuar mjeteve të kërkimit të provës, ku rëndësi të posaçme marrin këqyrjet, kontrollet, sekuestrimet dhe përgjimet.

Në fillim të hetimit të këtij lloji krimi është e nevojshme që të saktësohet se me çfarë veprime hetimore mund të arrihen rezultatet më të mira në rastin konkret. Rrethanat e çështjes duhet të diktojnë veprimet më të drejta dhe radhën e kryerjes së tyre. Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të kësaj vrasje, ndryshe nga të gjitha llojet e vrasjeve të tjera ku familjarët e viktimës janë shumë bashkëpunues dhe të interesuar për zbardhjen e ngjarjes, te vrasja në familje familjarët e tjerë të viktimës, përfshirë dhe autorin, në shumë raste nuk janë bashkëpunues dhe nuk shfaqin interes të dukshëm për zbardhjen e krimit, në të shumtën e rasteve krimi kryhet në ambiente të mbyllura pa praninë e dëshmitarëve, shpesh familjarët pastrojnë dhe ndryshojnë vendin e ngjarjes duke zhdukur ose vështirësuar gjetjen e provave material, etj., mjetet e kërkimit të provave kufizohen dhe vështirësohet gjetja e tyre.

4. Veprimet e fillimit

Një ndër detyrat kryesore të organit procedues, kur njoftohet për një vrasje, është ruajtja dhe shkuarja sa më parë në vendin e ngjarjes⁹. Më pas, vazhdohet me tre veprimet hetimore të përcaktuara dhe të domosdoshme që janë këqyrja e vendit të ngjarjes, këqyrja e kufomës dhe pyetja e dëshmitarëve okularë.

4.1 Këqyrja e kufomës dhe e vendit të ngjarjes

Janë vendosur në një pikë pasi janë dy veprime që duhet të kryhen paralelisht dhe rezultatet e dala prej tyre duhet të analizohen njëkohësisht. Objekti qendror, ekzaminimi i të cilit ka rëndësi primare në vrasjet në familje, është kufoma e viktimës dhe bashkë me të dhe ambienti, objektet dhe sendet midis të cilave është gjetur kufoma. Ndaj, veprimi

⁹ Skënder Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë 2004, f. 527.

i parë dhe i domosdoshëm është këqyrja e kufomës dhe e vendit të ngjarjes. Kur flitet për këqyrjen e vendit të ngjarjes në vrasjet, kuptohet këqyrja në të gjitha rastet e vdekjeve që kanë ndodhur në mënyrë të papritur dhe në rrethana të dyshimta qofshin këto vdekje natyrale apo vdekje me dhunë¹⁰. Sapo mbërrimë në vendngjarje përcaktojmë dhe mënyrën e kryerjes së këqyrjes. Përcaktimi i radhës së kësaj këqyrje ka rëndësi të madhe, sidomos në rastet kur është e domosdoshme që në vendngjarje të gjenden prova të dukshme dhe të padukshme si predha, gëzhoja, mbetje qitje, mikrogjurmë etj¹¹.

Në shumicën e rasteve organi i hetimit do arrijë të zgjidhë një varg problemesh të rëndësishme të hetimit gjatë këqyrjes së kufomës dhe vendit të ngjarjes ku përfshihen:

1. Ku është kryer vrasja, në vendin ku është gjetur kufoma apo në një vend tjetër, nga ku e kanë lëvizur autori apo persona të tjerë që e kanë gjetur?

2. Kur është kryer vrasja d.m.th. sa ditë deri dhe sa orë para zbulimit të kufomës?

3. Në çfarë mënyre, me çfarë mjete është kryer vrasja me armë, me mbytyje në grykë, asfiksion, me goditje me thikë, me varje, me helmim etj. Në këtë kuadër duhet tentohet të sqarohet nëse jemi para një vrasje apo vetëvrasje?

4. Sa persona kanë marrë pjesë në vrasje dhe a ka pasur para vrasjes përlëshje midis autorit ose autorëve dhe viktimës?

Këto të dhëna të marra gjatë këqyrjes së kufomës dhe vendit të ngjarjes, i sqarojnë hetimit kuadrin e përgjithshëm të krimit dhe të lidhura dhe me të dhënat e tjera të hetimit, krijojnë një orientim mbi drejtimin e mëtejshëm të veprimeve hetimore. Këqyrja e kufomës dhe vendit të ngjarjes bëhet dhe në prani të ekspertëve mjeko-ligjorë dhe kriminalistëve pasi këta ndihmojnë oficerin e policisë gjyqësore dhe e drejtojnë vëmendjen mbi prova dhe gjurmë të cilat ai vetë mund të mos i konstatojë, por zbulimi i të cilave mund të ndihmojë në zbardhjen e rrethanave shumë të rëndësishme për hetimin. Vetë procesi i këqyrjes së kufomës dhe vendit të ngjarjes është shumë kompleks dhe përmban shumë elementë që mund të analizohen si radha dhe mënyra e kryerjes në varësi të ambientit që do të këqyret, i hapur apo i mbyllur, kohës, ndriçimit, mënyrës së pasqyrit dhe marrjes së provave materiale, llojet e provave që duhen kërkuar dhe marrë, në varësi të llojit të vrasjes, në vrasjet me armë duhet kërkuar arma, gëzhoja, plumbi, faktorët plotësues të qitjes, etj., në helmimet pjatat ose gotat me të cilat është servur helmi, mbetje nga lënda helmuese, etj. Për shkak të hapësirës së vogël të punimit nuk mund të analizohen të gjitha.

Çështje tepër e rëndësishme në vrasjet në familje është sqarimi i faktit nëse jemi para një vrasje apo vetëvrasje. Në këto lloj vrasjesh ka përpjekje të shpeshta që të paraqiten si vetëvrasje. Dhe mënyrat e realizimit, që janë kryesisht me vrasje me armë zjarri ose thikë, mbytyje me asfiksion ose varje dhe me helmim, ta lejon një mundësi të tillë. Duke kryer me kujdes këqyrjen e kufomës dhe të vendit të ngjarjes mund të evitohet një përpjekje e tillë. Ky është një problem që shpesh specialistët i vë në dilema të mëdha¹², por në rastet e vrasjeve me armë zjarri mbahet në konsideratë fakti që largësia e qitjes është sa të lejon krahu si dhe duhet të ndiqet një procedurë e thjeshtë: së pari duke këqyruar duart e viktimës nëse ka faktorë plotësues të qitjes, të gërvishtura ose mbetje trupore, së dyti duhet ekzaminuar arma për gjurmë papilare, së treti këqyret

¹⁰ Estref Myftari, *Këqyrja e vendit të ngjarjes*, Tiranë 1984, f. 66.

¹¹ Ilir Mandro, *Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri*, Tiranë 2002, f. 25.

¹² Ilir Mandro, *Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri*, Tiranë 2002, f. 55.

drejtimi i hyrje-daljes së plumbit, së katërti këqyrren rrobat e viktimës.

Më e vështirë paraqitet kjo situatë në rastet e vrasjeve me mbytyje me asfiksi ose varje me litar ku në vendngjarje duhen verifikuar shenjat që provojnë që viktima e ka vënë vetë lakun apo ia ka vënë dikush tjetër, mundësia e ngjitjes, shenjat e qëndresës, kujt i përket litari, brazda e strangulacionit e cila është e ndryshme, etj¹³. Në rastin e helmimit duhet pasur në konsideratë fakti që nevojitet një kohë e caktuar që helmi të mund të shkaktojë ndryshimet e brendshme të organizmit dhe të vijë vdekja dhe autorit mund t'i duhet të ndërmarrë dhe veprime fizike, ndaj duhet kërkuar për shenja dhune në trupin e viktimës, çrregullime në dhomë ose në banesë, etj.

4.2 Pyetja e dëshmitarëve okularë

Menjëherë pas këqyrjes së kufomës dhe vendit të ngjarjes, mundësisht në të njëjtën kohë duhet të pyeten dhe dëshmitarët, të cilët plotësojnë të dhënat e zbuluara nga këqyrjet dhe njëkohësisht japin të dhëna të ndryshme të lidhura me vrasjen. Të parët që duhet të pyeten janë dëshmitarët okularë, personat që kanë gjetur të parët kufomën, personat që duhet të ishin afër vendit të ngjarjes në momentin e ndodhjes së krimit, familjarët dhe të njohurit e afërt të viktimës si dhe personat që kanë jetuar së bashku me të dhe që e njohin shumë mirë mënyrën e përgjithshme të jetës së tij. Pyetjet e këtyre personave duhet të orientohen mbi ato rrethana që kanë mbetur të errëta pas këqyrjeve. Thelbi i tyre duhet të jetë:

1. Në çfarë mënyrë u gjendën në vendin e krimit dëshmitarët okularë dhe personat që kanë zbuluar të parët kufomën, ku kanë qenë ata deri në atë moment, çfarë bënin dhe për ku ishin nisur para se të vijnë në këtë vend, si ishte gjendja e vendit të ngjarjes apo zbulimit të kufomës, a i janë afruar kufomës, a e kanë prekur, a kanë bërë ndonjë ndryshim në pozicionin e saj apo në vendin përreth, a e kanë prekur veshjen dhe a e kanë rregulluar nëse ka qenë e çrregullt si dhe a kanë lënë vetë gjurmë këmbësh në këtë vend?

2. Ku ka jetuar viktima kohët e fundit, me se është marrë, ku ka punuar dhe cilat janë kushtet e jetesës së tij?

3. Kush nga dëshmitarët e ka parë viktimën dhe ku e ka parë atë për herë të fundit para vrasjes, në çfarë rrethana ka ndodhur dhe çfarë kanë biseduar, në rast se viktima është gjetur jashtë banesës a e dinë dëshmitarët se për ku dhe përse është larguar nga shtëpia, si ka qenë e mundur të vijë në vendin ku është gjetur i vrarë, nëse ka pasur me vete sende ose vlera monetare të caktuara?

4. Cilat kanë qenë marrëdhëniet që ka pasur viktima me të gjithë pjesëtarët e familjes, me bashkëshortin, fëmijët, prindërit, nusen ose dhëndrin, a kanë pasur konflikte më parë, cila ka qenë natyra e këtyre konflikteve, a kanë çëshje pronësie të hapura në familje, nëse po, kush i ka iniciuar dhe në çfarë gjendje janë, e ka pasur probleme të natyrës së xhelozisë, a ka pasur dyshime për marrëdhënie jashtëmartesore?

5. A ka dëgjuar ndonjë nga dëshmitarët nga vetë viktima mbi të dhëna fakte ose të dhëna mbi të cilat mund të supozohej se ai ka pasur frikë për jetën e tij?

6. Nëse ndonjë nga dëshmitarët hedh dyshime mbi autorin e mundshëm të vrasjes mbi çfarë e bazon dyshimin, si e argumenton këtë dyshim?

¹³ Estref Myftari, *Këqyrja e vendit të ngjarjes*, Tiranë 1984, f. 98.

7. Nëse pas vrasjes midis të afërmeve apo komunitetit ku jetonte viktimja ka pasur komente mbi këtë vrasje, kujt ia atribuojnë vrasjen, kush i ka bërë këto komente, çfarë përfaqëson ky person në raport me viktimën dhe familjen e tij?

Përveç këtyre pyetjeve, që janë standarde në njëfarë mënyrë, dëshmitarët mund të pyeten dhe për fakte apo të dhëna specifike të dalta gjatë këqyrjeve p.sh. gjetja pranë viktimës e sendeve që nuk duhet t'i përkasin atij, etj.

4.3 Autopsia dhe ekspertimi mjekoligjor i kufomës

Veprimi tjetër i detyrueshëm dhe urgjent që duhet të kryhet, mundësisht jo më vonë se dita e nesërme pas këqyrjes së vendit të ngjarjes, është kryerja e autopsisë dhe ekspertimit mjekoligjor të viktimës. Duke çmuar rëndësinë e këtij veprimi, që është i detyrueshëm për të gjitha vrasjet, duhet thënë se sado e imët që të jetë bërë këqyrja e jashtme e kufomës, autopsia dhe ekspertimi mjeko-ligjor japin pothuajse gjithnjë të dhëna të reja që zbardhin rrethanat në të cilat është kryer vrasja si dhe përcakton shpeshherë në shkallë të konsiderueshme vazhdimin e mëtejshëm apo përfundimin e hetimit. Këto veprime zgjidhin disa nga çështjet kryesore vetë hetimit siç janë: shkaku i vdekjes, mjeti me të cilin është shkaktuar, rrethanat në të cilat mund të jetë kryer vrasja, në çfarë kohe janë bërë plagët që kanë shkaktuar vdekjen, etj. Në varësi të rrethanave mund të shtrohen për zgjidhje dhe pyetje të tjera si për shembull në rast në kufomë zbulohen plagë me armë zjarri apo të ftohta rëndësi ka zgjidhja e çështjeve se në çfarë pozicioni ka qenë viktimja kur ka marrë plagët, cili ka qenë drejtimi i goditjes, në rast se ka shumë plagë cila prej tyre është shkaktuar para dhe cila pas vdekjes, a ka qenë në gjendje viktimja të lëvizë, të flasë pas plagëve, etj.

Në rastet e vdekjeve nga helmimi duhet të merren mostra për ekzaminim kimiko-biologjik. Por, para kësaj, gjatë autopsisë dhe më pas gjatë aktit të ekspertimit të sqarohen karakteristikat e helmimit dhe në rast se mundet çfarë lloj helmi është, në çfarë sasive është marrë, në çfarë mënyrë dhe me çfarë mënyrë përzierjeje ushqimi apo pije, etj.

Të gjitha provat e tjera si ballafaqimi, njohjet, eksperimenti, provat materiale dhe dokumentet kanë rëndësi në hetimin e këtij krimi dhe mund të duhet të shërbejnë në procesin e të provuarit të kësaj vepre penale. Disa prej tyre në vetvete mund të mos kenë vlerë, por të marra në raport me provat e tjera dhe të gjithë të dhënat e përfituara nga hetimi mund të shërbejnë si prova vendimtare pasi konfirmojnë dhe u japin vlerë provave të tjera në raport me të provuarit e fakteve objekt hetimi. Por, kujdes shumë i veçantë i duhet kushtuar mjeteve të kërkimit të provës. Rëndësi të posaçme marrin këqyrjet, kontrollet, sekuestrimet dhe përgjimet.

5. Konkluzione

Kam arritur në përfundimin se vrasjet në familje janë një fenomen mjaft shqetësues për shoqërinë tonë. Kalimi nga një shoqëri relativisht konservatore në marrëdhëniet familjare në një shoqëri të hapur dhe të lirë, ku çdo pjesëtar i saj ka të drejta të barabarta ka sjellë përplasje brenda saj. Po ashtu, shkatërrimi me forcë, plotësisht, i marrëdhënieve të pronësisë gjatë regjimit komunist dhe situata ende e pastabilizuar e pronësisë në vendin tonë, edhe brenda familjeve, sjell konflikte të vazhdueshme të cilat përfundojnë dhe në vrasje. Ndaj, përballja me këtë fenomen është një sfidë e rëndësishme e shoqërisë tonë dhe në veçanti e institucioneve të zbatimit të ligjit që kanë për detyrë të identifikojnë,

parandalojnë, hetojnë, procedojnë penalisht dhe dënojnë autorët e këtyre veprave penale.

Kam theksuar nevojën e një analize dhe kuptimi sa më të mirë nga të gjykata, prokuroria dhe policia gjyqësore, të elementëve juridiko-penalë të kësaj figure krimi. Duke theksuar analizën dhe kuptimin e të gjitha veçorive juridiko-penale të këtij krimi në objektin juridik dhe material të saj, anën objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, në subjektin dhe anën subjektive të saj si dhe në veçanti objekti juridik dhe material si dhe subjekti i kësaj vepre penale të cilat njëkohësisht janë tiparet dalluese për kualifikimin juridik të saj.

Kam vlerësuar se si një krim me veçori mjaft specifike, i kryer shpesh brenda ambientit të ngushtë familjar, nga ana objektive jo shumë i shfaqur në mjedisin e jashtëm, mungesa shpesh e vullnetit të familjarëve për bashkëpunim me organet e ndjekjes penale e vështirëson gjetjen dhe administrimin procedural të provave. Ndaj është i nevojshëm aplikimi i metodave specifike të hetimit të cilat duhet t'i përshtaten këtij krimi.

Kam arritur në përfundimin se në funksion të një metodike specifike hetimi duhet të jenë dhe mjete të përcaktuar qartë dhe eficiente në gjetjen dhe marrjen e provave. Të gjitha provat klasike si dëshmitë, ballafaqimi, njohjet, eksperimenti, ekspertimi, provat materiale dhe dokumentet, mund dhe duhet të shërbejnë në procesin e të provuarit të kësaj vepre penale. Por kujdes shumë i veçantë i duhet kushtuar mjeteve të kërkimit të provës. Rëndësi të posaçme marrin këqyrjet, kontrollet dhe përgjimet.

Literatura

1. Vasilika Hysi, *Kriminologjia*, Tiranë 2008.
2. Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermuelen, *E Drejta Penale Evropiane*, Tiranë 2010.
3. *Kodi Penal i Zogut*, Tiranë, 1928.
4. Ismet Elezi, *E drejta Penale, Pjesa e posaçme II*, Tiranë 2016.
5. Skënder Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë 2004.
6. Ilir Mandro, *Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri*, Tiranë 2002.
7. Estref Myftari, *Këqyrja e vendit të ngjarjes*, Tiranë 1984.
8. GjEDNj, 28. 3. 2000, *Mahmut Kaya kundër Turqisë*.
9. GjEDNj, 31. 5. 2007, *Kontrova kundër Sllovakisë*.

Qystrí, O.

« Riorganizimi i Policisë Kriminale, si domosdoshmëri e kohës »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

Kiberdevianca te të miturit dhe roli i punonjësit të policisë e strukturave mbështetëse, në profilaksinë e krimit kibernetik

■ **Cav. Dr. Ervin IBRAHIMI**
Përfaqësuesi i Këshillit të Sigurisë, Itali

■ **Dr. (proc.) Silva IBRAHIMI**
Albanian University
ibrahimi.silva@gmail.com

■ **Dr. Eglantina DERVISHI**
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Teknologjia është një nga mjetet me influencën më të madhe në imazhin e jetës shoqërore të individit. Objektiv i këtij studimi është të eksplorojë disa nga aspektet bazë të marrëdhënieve mes sjelljeve deviante kibernetike dhe rolit të strukturave të ruajtjes së sigurisë dhe mbrojtjes së ligjit që ekzistojnë në procesin e digjitalizimit kibernetik. Ky studim kryqëzon në mënyrë diagonale aspektet e kulturës kibernetike deviante dhe rolit të punonjësit të policisë në depestimin dhe parandalimin e ekstremeve kriminale. Së dyti, ky kërkim ofron edhe një panoramë trajtuese të konsumimit që digjitalizimi sjell në formimin e vazhdueshëm të adoleshentët. Implementimi i strategjive të gabuara të mbrojtjes dhe të sigurisë së konsumatorit nga lundrimi i rrezikshëm ndikon në mënyrë direkte në rritjen e kriminalitetit pasiv dhe aktiv, ndryshimeve cilësore të qëndrimeve dhe të sjelljes duke i drejtuar më tepër drejt deviancës me potencial antisocial dhe cenimit në bazë më të gjerë të sigurisë kombëtare dhe rajonale si dhe varësisë ndaj internetit.

*Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.*

«Kiberdevianca te të miturit dhe roli i punonjësit të policisë e strukturave mbështetëse, në profilaksinë e krimit kibernetik»

Fjalëkyçe:

kiberdeviancë, teknologji kompjuterike dhe e informacionit, siguri kombëtare, i mitur.

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Hyrje

Zhvillimet e teknikës dhe teknologjisë kanë bërë që jeta e njeriut të ndryshojë shumë përgjatë dekadave të fundit. Në kuadër të zhvillimeve dhe përsosjes së teknologjisë në përgjithësi dhe asaj informative në veçanti, bën pjesë edhe hapësira kibernetike. Interneti mund të ketë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin e sistemeve të vlerës dhe formësimin e sjelljes. Shtimi i jashtëzakonshëm i përdorimit të teknologjisë kompjuterike dhe të informacionit, TIK, ka sjellë me vete edhe një shtrirje mjaft të gjerë të mundësive të eksplorimit dhe rrezikshmërisë së ekspozimit në popullatat moshore të mitura. Nisur nga karakteri i vet global dhe i lehtë në akses përmes pajisjeve të lidhura, interneti padyshim që ka ndryshuar formën socio-evolutive të njeriut. Ndikimet e TIK mbi inteligjencën fluide dhe të kristalizuara janë dy argumente të rëndësishëm në mbështetje të kësaj premise. Po kështu, nga ana tjetër, tejhumanizimi i teknologjisë gjithashtu ka ofruar mundësi të reja krimi që mund të shfrytëzojnë të njëjtat avantazhe të ofruara nga këto teknologji për të përmbushur objektivat e veta. Numri në rritje i përdoruesve të internetit i ofron shoqërisë perspektivën për të përshpejtuar komunikimet në jetën e përditshme dhe për qëllime të sendërtimit të marrëdhënieve, për të ulur transaksionet dhe shpenzimet, për të bërë biznes, për të rritur aksesin ndaj informacionit dhe krijuar një identitet global.

Me krijimin e mundësive të reja për zhvillim ekonomik dhe social, shpërndarja e teknologjisë po kështu ka ndryshuar panoramën e deritashme të kuptimit mbi krimin dhe ka shfaqur sfida të reja përballë komunitetit, mikro dhe makropolitikave si dhe të punonjësve të zbatimit të ligjit. Hapësira e përdorimit kibernetik është vazhdimisht një burim i madh i aktiviteteve të ndryshme ilegale që përfshijnë jo vetëm shfaqjen e llojeve

*Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.*
«Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimi
kibernetik»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

të reja të krimit, të tilla si *hacking* apo gjurmimet përmes kodimeve a programeve dëmprurëse si *spam*, por përbën edhe një problematikë specifike në rritje për mbrojtjen e të drejtës mbi sigurinë vetjake dhe më gjerë atë kombëtare.

Nga ana tjetër, devianca agresive kibernetike ka sjellë edhe një fluks të rritur të migrimit të krimit tradicional, si ekspozimi keqbërës, trafikimi, pornografia dhe abuzimi i të miturve, mashtrimet, vjedhjet etj. Nga mënyra se si ndërtohet një profil hetimi, burimet e informacionit, skicimi, stadiet dhe përcaktimi i nevojës dhe ndihmesës që jep një profil mund të ndërtojmë po kështu të dhëna mbi profilin psikologjik të autorit dhe target- grupin si me sjelljen nxitëse e gjendjen psikologjike të një individi në kryerjen e një veprimi dëmprurës kriminal¹.

Padyshim, që lufta kundër krimit kibernetik kërkon forcimin si në nivel juridik, edhe në atë penal e procedural, të instrumenteve që lejojnë hetimin dhe ndjekjen penale të personave që keqpërdorin TIK-ut për kryerjen e veprave të dëmshme kriminale. Dimensionimi tashmë global i krimit në internet dhe natyra ndërkuftare e rrjeteve të informacionit përmes e TIK, gjithashtu sjellin nevojën për harmonizim e qasjeve legjislative dhe veprimeve të koordinuara në parandalimin dhe hetimin e krimit kompjuterik në nivele: kombëtare, rajonale dhe ndërrajonale².

Edhe pse rrjetet TIK janë kryesisht në pronësi private, strategjia gjithëpërfshirëse e trajtimit të krimit kibernetik përfshin gjithashtu zhvillimin e instrumenteve për bashkëpunim efektiv me sektorët industrialë informatikë që nxisin zbatimin e metodave bashkërrregulluese dhe vetërrregulluese. Çdo aktor në këtë mjedis shumëpalësh i interesuara për të luftuar dhe parandaluar krimin në hapësirën kibernetike ballafaqohet me një numër të gjerë sfidash, që mund të jenë të karakterit të problemeve të përgjithshme të lidhura me natyrën globale të kibernetikës ose të karakterit unik që lidhen me ndryshimin e natyrës së detyrave, përgjegjësive dhe funksioneve të palëve e që përdoren për të vepruar në botën reale dhe në hapësirën kibernetike. Policia si një organ përgjegjës dhe rregullator për mbajtjen dhe mbrojtjen e rendit publik, zbulimin, monitorimin dhe parandalimin e krimit është një nga aktorët protagonistë në këtë skenë që përballet me një numër të madh sfidash (Wall, 2007) lidhur me migrimin e krimit tradicional në mjedisin e TIK dhe shfaqjen e formave të reja të veprimtarisë kriminale me në fokus të miturit³.

2. Roli i organeve ligjzbatuese të Policisë në depistimin e krimit kibernetik: problematikat dhe sfidat

Qasjet ekzistuese për të luftuar krimit në botën reale shpesh nuk janë funksionale në hapësirën kibernetike ose nuk mund të jenë të aplikueshme në rastet e keqpërdorimit të TIK-ut për qëllime kriminale. Është kësajsoj me rëndësi propozimi dhe zhvillimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse në një hierarki mikro dhe makrostrukturorë për të trajtuar aspektet e ndryshme të krimit kibernetik bashkë me sfidat unike që duken të reja si për ligjzbatuesit ashtu edhe për organet e hetimit. Qasje të tilla duhet të merren në konsideratë në zhvillimin e strategjive për të luftuar krimin në botën virtuale:

- Sasia dhe numri i përdoruesve. Përhapja e përdorimit të internetit në jetën e

Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.
«Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimit
kibernetik»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

¹ Agastra et al., 2017. *Profilat psikologjike, domosdoshmëri për hetimin*, f. 173.

² Gercke, 2006, 2009.

³ Quille, 2009; Kozlovski, 2005; Wall, 2007.

përditshme të njerëzve dhe si një mënyrë për të kryer biznes është në rritje dramatike në numrin e përdoruesve në vitet e fundit. Kështu në vitin 2005 numri i përdoruesve të internetit vendet në zhvillim për herë të parë tejkaloi numrin e përdoruesve nga vendet e industrializuara⁴.

Në vendin tonë, të dhënat tregojnë se në vitin 2016-2017 nga 175 të rasteve të krimeve kibernetike 143 kanë përfshirje të personave të dëmtuar ose 81.7% e rasteve, nga të cilat në 51% femra. 11.8% e rasteve i përkasin grupmohës 14-18 vjeç ose adoleshencës⁵.

Në perspektivën globale krimi kibernetik është një formë krimi që prek njëkohësisht të dyja gjinitë por ekspozimi në kohë të gjatë të moshave në zhvillim ka ndryshuar tanimë kahun e fokusimit kah këtij target-grupi. Rritja e numrit të përdoruesve lidhur me globalizimin e rrjetit të komunikimit paraqet një sfidë të re për policinë dhe strukturat e mbrojtjes së hapësirës kibernetike për së paku dy arsye: Së pari, një nga pikat kryesore të dobëta që paraqet një mundësi për kriminelët, është mungesa e të kuptuarit të sigurisë online individuale bashkë me aplikimin e teknikave të inxhinierisë sociale dhe *privacy*.⁶ Së dyti, teksa vjedhjet e identitetit, *spam* dhe veprimtaritë e *phishing* mund të kryhen automatikisht⁷ pa investuar shumë para dhe mund, është shumë e vështirë të automatizosh procesin e hetimit⁸.

- Disponibiliteti i mjeteve dhe informacionit. Interneti është projektuar si një rrjet me akses të hapur ndaj informacionit dhe tanimë deviantët ekstremë mund të aksesojnë burime informacioni ose mjete për të kryer krime në internet. Disponibiliteti i programeve o *softuerë* kompjuterike dhe pajisje që lejojnë gjurmimin dhe vjedhjen fjalëkalimeve, automatizimi i sulmeve kibernetike, mundësia e përdorimit të motorëve të kërkimit dhe robotët për qëllime të paligjshme⁹ dhe udhëzime se si të kryhen krime *offline* kanë lehtësuar zhvillimin e krimit si në botën reale ashtu edhe në hapësirën kibernetike.

- Vështirësi në gjurmimin e shkelësve të ligjit. Mundësitë e ndryshme për fshehjen e identitetit në rrjetet TIK dhe mjetet dhe mënyrat e qasjet e ndryshme për të marrë akses anonime, *surfing* dhe komunikimet në rrjete sociale, e vështirësojnë me të vërtetë punën e agjencive të zbatimit të ligjit për të ndjekur dhe monitoruar shkelësit¹⁰.

- Mundësitë për përdorimin e serverëve *proxy*, *anonymisers*, rrjeteve *wireless* publike të pambrojtura dhe përdorimi i shërbimeve të komunikimit anonim¹¹ janë shfrytëzuar gjerësisht nga krimi kibernetik. Kur aktiviteti kriminal përfshin shtete të ndryshme, është shumë e vështirë për të hetuar vepra të tilla që përfshijnë si aspektin ndërkombëtar ashtu edhe identitetin e fshehur.

- Mungesë të mekanizmave të kontrollit. Që në zbulimin e tij të parë, më 1960, Interneti nuk u krijua për të qenë i udhëhequr vertikalisht. Struktura horizontale dhe modeli i decentralizuar i rrjetit pengon kontrollin mbi aktivitetin në internet dhe vështirëson hetimin e krimeve të kryera në hapësirën kibernetike. Qasjet bashkërregulluese dhe vetërregulluese dhe bashkëpunimi me operatorët e infrastrukturës

⁴ Raporti Special i Migracionit dhe Zhvillimit, Shoqëria e Informacionit, 2005.

⁵ Agastra et al., 2017, f. 164.

⁶ Rash et al., 2009.

⁷ Berg, 2007, Ealy, 2003.

⁸ Gercke, 2009, f. 65.

⁹ Long, Skoudis dhe van Eijkelenborg, 2005; Dornfest, Bausch dhe Calishain, 2006.

¹⁰ Lovet, 2009.

¹¹ Gercke, 2009, f. 75.

Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.
«Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimit
kibernetik»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

si dhe me distributorët e shërbimeve të internetit janë të nevojshme kur merret me problemin e keqpërdorimit të TIK-ut¹².

- Mungesa e kufijve në hapësirën kibernetike dhe aspekti ndërkombëtar i krimit kibernetik. Penologjia dhe hetimet penale janë konsideruar një çështje e sovranitetit kombëtar në të drejtën ndërkombëtare dhe sigurinë, ndërsa protokollet e aplikuara për transferimin e të dhënave në internet janë bazuar në kursin më optimal të kalimit të dhënave, pra, proceset e transferimit së të dhënave kalojnë në më shumë se një vend.¹³

Për më tepër, ngase hapësira kibernetike nuk ka kufij, kriminelët dhe viktimat mund të gjenden në vende të ndryshme apo edhe kontinente të ndryshme, që kërkon nga ana tjetër, një shumësi bashkëpunimi së të gjitha vendeve të përfshira në një hetim ndërkombëtar¹⁴. Teksa plotësimi i kërkesave formale për bashkëpunim merr kohën e saj, procesi i hetimit mund të ndeshet shpesh me pengesa¹⁵, të dhënat dhe gjurmët janë shumë delikate dhe mund të zhduken shumë pak kohë pas është kryer krimi. Shtetet, të cilat nuk kanë korniza bashkëpunimi për problematikat e krimit kibernetik, mund të bëhet strehë e sigurt për shkelësit e ligjit që duan të pengojnë procesin e hetimit. Për më tepër, interneti mund të motivojë një individ deviant të jetë fizikisht i pranishëm në një shtet ndërsa kryerjen e një krimi në një shtet tjetër.

Roli që duhet të luajnë policia dhe organet e zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit kibernetik me fokus të miturit, është i rrezikuar nga të gjitha problematikat e lartpërmendura. Jo vetëm hetimi i krimeve në hapësirën kibernetike është i komplikuar, por edhe policia e hetimit të krimit në hapësirën kibernetike mund të pengohet. Është shumë e vështirë për njësitë e policisë të fillojnë kryesisht hetimet për shkak të dukshmërisë së ulët të kësaj dukurie të krimit dhe mungesës së raportimit nga ana e viktimave.¹⁶ Dukuria e mosdeklarimit të krimit kibernetik, ashtu sikundër edhe me mjaft dukuri të tjera të aspektit social, mund të ndodhë për arsye të ndryshme si mosgatishmëria e subjekteve tregtare dhe e kompanive financiare të raportojnë në polici një llogari të caktuar apo sjellje kërcënuese dëmprurëse, neglizhenca e individëve të përfshirë në bullizëm kibernetik për të mos i kushtuar vëmendje këtyre dukurive, mospranimi dhe mosnjohja që krimi kibernetik është i vërtetë dhe mund të ketë përfshirë dhe individin ose mungesa e besimit në strukturat e policisë¹⁷. Për shkak të shkallës së ulët të raportimit, mungesa e burimeve dhe raportimeve në agjencitë e ruajtjes dhe zbatimit të ligjit, këto struktura nuk kanë mundësi të hetojnë dhe ndjekin penalisht më shumë se një fraksion “të vogël” të asaj që ndodh në hapësirën kibernetike¹⁸.

Që nga përdorimi i internetit dhe TIK teknologjitë u ofrojnë autorëve mundësi për të krijuar të ardhura të grumbulluara me ndikim të ulët te një viktimitë specifike (p.sh. duke vjedhur 1 milion euro vetëm një herë), një nga sfidat më të rëndësishme për policinë është justifikimi i shkeljes së rendit publik dhe hapja e procedurave të hetimit. Dallimet në veprat kriminale dhe kundërvajtjet e ndryshme, dallimet kulturore për seriozitetin e krimit, diskrepanca e madhe mbi çfarë duhet të konsiderohet i paligjshëm. Njësitë e policisë janë ndër ato që janë më të prekura nga këto sfida të evolucionit bashkëkohor.¹⁹ Gjetja e një ekuilibri të drejtë midis pushtetit hetues dhe të drejtave të njeriut, aplikimet e masave mbrojtëse dhe ruajtja e natyrës së eksedit të hapur në internet

**Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.**
Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimit
kibernetik

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

¹² Sieber, 2010; Sieber 2000, f. 319-399.

¹³ Sofaer & Goodman, 2001, f. 7.

¹⁴ Putnam & Elliott, 2001, f. 35; Sofaer & Goodman, 2001, f. 1; Roth, 2005.

¹⁵ Gercke, 2006, f. 142; Sofaer & Goodman, 2001, f. 16.

¹⁶ Lovet, 2009, f. 69.

mbeten problematike serioze të njësive policore në hapësirën kibernetike. Mekanizmat mungesore të kontrollit, zhvillimit fillestar të internetit dhe arkitektura e rrjetit kërkojnë zhvillimin e mjeteve për policimin e hapësirës kibernetike, mekanizma për monitorimin e rrjeteve të TIK, parandalimin dhe zbulimin e aktivitete të paligjshme në internet. Po kështu, ideja fillestare e internetit si një hapësirë për diskutime të hapura, shkëmbim dhe ndarje të mendimeve dhe pikëpamjeve si dhe rrjedha e lirë e informacionit nuk duhet të pengohet, pra, sfida është gjithashtu që të ruhet hapja e rrjetit dhe zhvillimet e tij bashkë me zhvillimet sociale. Sipas Qendrës Kombëtare të Byrosë të Interpolit (NCB) të publikuara në prill 2016, 83% e zyrave ndërkombëtare kishin njësi të dedikuara për krimin kibernetik, por mungonte kapaciteti për zhvillimin e incidentës me profil të lartë.²⁰

Kësisoj, një hap tjetër i nevojshëm dhe fort i rëndësishëm është zhvillimi i mekanizmave efektivë të shfrytëzimit të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve për të forcuar mekanizmat e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Për të shtuar efikasitetin e reagimit ndaj luftës kundër krimit kibernetik me fokus grupmohën e të miturve, studimet e agjencive të larta të inteligjencës dhe parandalimit të krimit kanë sugjeruar:

- krijimin e një grupi pune *task-force* brenda strukturave të ruajtjes dhe zbatimit të ligjit me prioritet krimin në hapësirën kibernetike;
- rritjen e kapaciteteve trajnuese për punonjësit e policisë për strukturat psikopatologjike sociale të moshave të miturave, target-grup me incidencën më të lartë për viktimologji kibernetike;
- rritjen e qasjes dhe bashkëpunimit të punonjësit të policisë me komunitetin për të cilin ai përgjigjet, me institucionet arsimore, qendrat e shërbimit të internetit dhe operatorët e sektorit privat;
- zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të trajnuar dhe certifikuar për aspektet e krijimit të databazës, hartës së zonave dhe komuniteteve me rrezikshmëri më të lartë dhe laboratorit kibernetik për kujdes dhe ekzaminim prioritar;
- forcimin e akteve ligjore, civile dhe penale për abuzuesit dhe ata të identifikuar si me potencial të lartë të deviancës kibernetike;
- Koordinimi i strukturave në nivel lokal dhe qendror për parandalimin e krimit kibernetik me target të miturit.

Bashkëndarja e përgjegjësisë dhe bashkëpunimi mes policisë, komunitetit dhe sektorëve të shërbimit shtetëror dhe privat duket të jenë mënyra me efektshme e trajtimit të krimit kibernetik në nivele lokale e kombëtare²¹. Siç është parashtruar edhe në një sërë studimesh dhe publikimesh, një bashkëpunim i tillë së bashku me bashkërrregullimin dhe vetë-rrregullimit mund të japë edhe rezultate më të mira sesa thjesht zbatimi i ligjit penal *in per se*²².

¹⁷ CSI dhe FBI, 2004, 19; Wall, 2007, f. 193.

¹⁸ Vogel, 2007.

¹⁹ Wall, 2007, f. 191.

²⁰ Interpol, 2016, f. 11.

²¹ Komisioni dhe Parlamenti Evropian, Këshilli i Sigurisë dhe Komiteti i Rajoneve, 2007.

²² Sieber, 2000, 319-399; Sieber, 2010.

²³ Raporti i WGIG, 2005.

**Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.**
«Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimit
kibernetik»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

3. Konkluzione

Lufta kundër krimit kibernetik ka nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin zhvillimin, aplikimin dhe rishikimin e masave teknike-ligjore, strukturore dhe sociale së bashku me ndërtimi i strukturave organizative të specifikuar për të trajtuar këtë problematikë me shtrirje globale.

Për më tepër, trajtimi i krimit kibernetik kërkon koordinim efektiv kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me problematikat kibernetike që duhet të ndërtohen mbi koordinimin e politikave në nivel lokal dhe kombëtar.²³ Qasja e pjesëmarrësve të shumtë, përfshirë komunitetin, institucionet e arsimit parauniversitar dhe universitar, organet e mbrojtjes dhe ligjzbatuese, strukturat e mbrojtjes sociale etj., e zbatuar në niveleve kombëtar duhet të jetë koherente me zhvillimet rajone dhe ndërkombëtare ku harmonizimi i mjeteve për trajtimin e krimit kibernetik ka shfaqur rezultate pozitive dhe efikase. Përpjekjet në nivele makrosociale për vendosjen e politikave dhe masave shtrënguese ligjore duhet të jenë domosdoshmërisht të mbështetura në respektimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirisë së Individit²⁴ si dhe nga ekspertiza teknike dhe ekonomike, gatishmëria e shoqërisë civile dhe e lehtësuar nga ndërveprimtaria me organizatat dhe strukturat mbështetëse që zhvillojnë standarde të përbashkëta të aplikimit. Përkundër sfidave me të cilat duhet të përballen, njësitë e strukturave policore dhe mbrojtjes së të miturit, si një nga palët thelbësore në luftën e krimit kibernetik, mund të veprojnë si një model qendror inkurajues për ndërtimin e lidhjeve ndërmjet aktorëve të ndryshëm, krijimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e qasjeve kombëtare dhe ndërkombëtare për të trajtuar problemin e keqpërdorimit dhe dëmprurjes së TIK-ut.

**Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.**

«Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimit
kibernetik»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Referencat

1. Agastra et al., (2017), "Profillet psikologjike, domosdoshmëri për hetimin", *Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë : konferenca 2-të ndërkombëtare*, nëntor 2017, proceedings. Tiranë: Akademia e Sigurisë.
2. Gercke, M. (2006), "The Slow Wake of A Global Approach Against Cybercrime", *Computer Law Review International*.
3. Gercke, M. (2009), *Understanding Cybercrime: A Guide for Developing Countries*, ITU, Geneva.
4. Gjendur online: www.itu.int/ITU-D/cyb/cybersecurity/legislation.htm
5. Quille, M. (2009), Keynote Address. Current Threats and Future Challenges posed by cybercrime. *Octopus Conference*, CoE.
6. Kozlovski, N. (2005), A Paradigm Shift in Online Policing-Designing Accountable Policing, *Yale Law School Dissertation*.
7. Wall, D.S. (2007) Policing Cybercrimes: Situating the Public Police in Networks of Security within Cyberspace, *Police Practice and Research*, 8:2, 1, 2007.
8. Development Gateway's Special Report, *Information Society-Next Steps?*, 2005.
9. Rash, H. et al. (2009), Crime Online. Cybercrime and Illegal Innovation. *NESTA. Research Report*. July, 2009.
10. Berg, T. (2007), The Changing Face of Cybercrime. New Internet Threats Create Challenges to Law Enforcement, *Michigan Bar Journal*, 2007: 18-22.
11. Ealy, K (2003), *A New Evolution in Hack Attacks: A General Overview of Types, Methods, Tools, and Prevention*.
12. Long, J., Skoudis, E. and van Eijkelenborg, A. (2005), *Google Hacking for Penetration Testers*, Syngress.
13. Lovet, G. (2009), "Fighting Cybercrime: Technical, Juridical and ethical Challenges", *Virus Bulletin Conference*, September 2009.
14. Sieber, U. (2000), *Legal Regulation, Law Enforcement and Self-regulation*, in: Watermann, J. and Machill, M. (eds.) *Protecting Our Children on the Internet*, Gütersloh, Bertelsmann Foundation Publishers.
15. Sieber, U. (2010) Internet Crimes - Annex 1 to the Questionnaire for the 18th International Congress of the IACL.
16. Sofaer, A. D. and Goodman, S. E. (2001) Cyber Crime and Security - The Transnational Dimension in: Sofaer, A.D. and Goodman S. E. (ed.) *Transnational Dimension of Cyber Crime and Terrorism*, Hoover Institution Press.
17. Putnam, T. L. and Elliott, D. D. (2001), International Responses to Cyber Crime, in: Sofaer, A. D. and Goodman S. E. (ed.) *Transnational Dimension of Cyber Crime and Terrorism*, Hoover Institution Press, 31-67.
18. Roth, B. (2005), State Sovereignty, International Legality, and Moral Disagreement.
19. CSI and FBI (2004), *Computer Crime and Security Survey*, San Francisco.
20. Vogel, J. (2007), Towards a Global Convention against Cybercrime. World Conference on Penal Law, Guadalajara, Mexico.
21. Interpol (2016), *Crimes against children. Factsheet*.
22. Communication from the Commission to the European Parliament the Council and the Committee of the Regions (2007), *Towards a general policy on the fight against cyber crime*.

**Ibrahimi, E.,
Ibrahimi, S.,
Dervishi, E.**

«Kiberdevianca
te të miturit dhe
roli i punonjësit
të policisë e
strukturave
mbështetëse,
në profilaksinë
e krimit
kibernetik»

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas



■ **Dr. (proc.) Kozeta LIGEJA**
Universiteti i Tiranës
k.oz.i2006@hotmail.com

Abstrakt

Hipoteza që ngrihet në punim është: Prej shumë vitesh ekzistenca e fenomenit të dhunës në familje kryesisht të dhunës ndaj gruas mbetet prioriteti kryesor i politikës sociale në vendin tonë që realizohet nga mekanizma të veçanta. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan Ministria e Brendshme nëpërmjet Policisë së Shtetit. Ajo është një strukturë ndihmëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Por gjatë veprimtarisë së saj policia përballet me mungesën e shërbimeve mbështetëse, mungesa e akomodimit, apo konsultave psikologjike dhe ligjore, shërbimet për fëmijët, mbështetje për strehim afatgjatë, gjithashtu dhe mungesa e ndihmës ekonomike. Kjo e vështirëson akoma më shumë qëllimin për reduktimin e dhunës ndaj gruas. Qëllimi i këtij punimi është të vërtetojë nëpërmjet provave, kryesisht të analizës teorike, por edhe asaj praktike se Shqipëria si shoqëri vazhdon të ketë problematika për zbatimin e kuadrit ligjor në sferën e të dhunës në familje veçanërisht të dhunës ndaj gruas. Punimi mbështetet mbi disa metoda studimore. Përdoret kryesisht metoda induktive, duke kaluar nga fakte të veçanta në përfundime të përgjithshme, por edhe ajo deduktive duke kaluar nga konkluzione të përgjithshme për të nxjerrë përfundime për pasojat e ardhura dhe problemet e veçanta. Nëpërmjet analizës së këtij fenomeni në Shqipëri, të cilat kanë adresuar çështje specifike me rëndësi për zhvillimin e punimit.

Ligeja, K.
« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Fjalëkyçe:

të drejtat e njeriut, gruaja, dhuna, Policia e Shtetit.

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

1. Hyrje

Fenomeni i dhunës ndaj gruas është një problem që e ka zanafillën e historisë së saj në rrënjët e traditës patriarkale. Për këtë fenomen janë realizuar shume shkrime, analiza, dokumentarë, aktivitete shkencore, trajnime seminare të cilat kanë dhënë frytet e tyre progresive për këtë temë. Kjo çështje kaq historike i ka dhënë formën jo të duhur zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Shkencat humane i kanë dhënë shume përkufizime kësaj dukurie që ka krijuar konotacion negativ në shoqëri. Kështu me dhunë në familje do të kuptojmë të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve apo partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve apo partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.¹

Është detyrimi i shtetit ligjor që të marrë masat e tij për parandalimin e dhunës ndaj gruas apo dhunës në familje, të mbrojë viktimat gjithashtu të ndëshkojë dhunuesin. Ky fenomen problematik gjithnjë ka qenë fokus i aktiviteteve të shumta që janë ndërmarrë nga organizata lokale, kombëtare, ndërkombëtare si edhe organizata shtetërore me qëllim thyerjen e shumë tabuve patriarkale dhe ndryshimin e mendësive duke i lënë vend një kulture emancipuese. Qasja e sistemeve politike na vjen në ndihmë me konceptin: Një vend edhe pse mund të ndryshojë sistemin politik por kultura, traditat, normat, parimet sociale të atij vendi duan kohë të gjatë të ndryshojnë. Kështu Shqipëria e cilësuar si një vend me tranzicion të zgjatur mbart problematika të ndryshme sociale të cilat kërkojnë kohën e vet të ndryshimit rrënjësor. Si rrjedhojë fenomeni i dhunës në

¹ *Konventa e Stambollit*, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në 7 prill 2011 dhe hyrë në fuqi në 1 gusht 2014.

familje është dukuri sociale që vijnë si pasojë e ndarjes së ngushtë gjinore, autoritetit patriarkal, respektimi i kodit të nderit dhe turpit, varfëria të skalitura thellë në ndërgjegjen dhe mentalitet njerëzore shfaqin dita ditës këtë fenomen me pasoja të rënda deri në vrasje të viktimitës.

Ministria e Brendshme nëpërmjet Policisë së Shtetit kanë një ndikim të madh në fenomenin e dhunës kundër gruas. Kështu me tej do të njihemi me analizën e procedimit të policimit në këtë çështje. Kështu në veprimtarisë së saj policia përballet me mungesën e shërbimeve mbështetëse, mungesa e akomodimit, apo konsultave psikologjike dhe ligjore, shërbimet për fëmijët, mbështetje për strehim afatgjatë, gjithashtu dhe mungesa e ndihmës ekonomike. Kjo e vështirëson akoma më shumë qëllimin për reduktimin e dhunës ndaj gruas.

2. Vështrim rreth kuadrit ligjor

Legjislacioni Shqiptar është përmirësuar në drejtim të miratimit të ligjeve të reja që kanë për objekt dhunën kundër gruas. Miratimi i konventave ndërkombëtare apo dhe i ligjeve dhe akteve nënligjore plotësojnë kuadrin ligjor kundër dhunës. Miratimi dhe ratifikimi i tyre bëhet me qëllim parandalimin, luftimin, eliminimin e dhunës në ambientet familjare kryesisht. Konkretisht në vitin 2006 hyri në fuqi ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar). Krahas saj kemi dhe ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”; ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Janë hartuar strategjitë kombëtare dhe planet e tyre për veprim siç janë: Strategjia e parë kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje 2007-2017, si dhe Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore, reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje 2011-2015. Gjithashtu me rëndësi është dhe Plani i Veprimit për përfshirjen e burrave dhe djemve si partner të grave, vajzave për arritjen e barazisë gjinore dhe kundër dhunës bazë me bazë gjinore e asaj në familje 2014 – 2019.

Hartimin dhe zbatimin e VKM nr. 334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Parashikimin e dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (me ligjin nr. 23, datë 01.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, si dhe me ligjin nr. 144/2013 datë 2.5.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Ndryshimin në ligjin nr. 10399 datë 17.3.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ku u sanksionua që t’u jepet ndihmë ekonomike edhe grave të dhunuara, në rastet kur ato pajisen me urdhra mbrojtës. Ligjin nr. 143/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 ‘Për ndihmën juridike’ “ ku u shtua në listën e personave që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmën juridike rastet kur personi është viktimë e dhunës në familje. Ratifikimin në shkurt 2013 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (e njohur gjithashtu edhe si Konventa e Stambollit), e cila ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2014, etj².

Ligeja, K.
« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

² Raport-vlerësimi i strukturave kundër dhunës në familje në Policinë e Shtetit, si pjesë e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, korrik 2015.

3. Analizë mbi rolin e policimit

Ashtu siç e theksuam në fillim të artikullit, Ministria e Brendshme nëpërmjet Policisë së Shtetit kanë një ndikim të madh në fenomenin e dhunës kundër gruas. Roli i tyre u bë i rëndësishëm nëpërmjet ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”. Këto struktura shtetërore me kompetencat e tyre do të vijojnë aktivitetin e punës së tyre për të ulur nivelin e dhunës në Shqipëri. Nga praktika vihet re se Ministria e Brendshme ka krijuar sektorin e parandalimit dhe luftën kundër dhunës në familje e cila do ta ushtrojë veprimtarinë e saj në Drejtorinë e Policisë. Gjithashtu Ministria e Brendshme merr masa për trajnimin e stafit të policisë që do të trajtojnë rastet e tilla. Do të shohim më tej sesi funksionojnë hallkat institucionalë për temën në fjalë:

Nga ana tjetër edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është ngritur drejtoria e përgjithshme për sigurinë publike që ka në përgjegjësi sektorin e për të miturit dhe dhunën në familje. Ky sektor funksionon duke ushtruar kompetencat të cilët janë: Policia e Shtetit nëpërmjet të dhënave statistikore që mbledh në mënyrë periodike merr masat e saj për parandalimin, reduktimin e dhunës në familje. Ky sektor ka për detyrë që të bashkëpunojë me institucione të tjera me qëllim të mbledhjes së informacioneve të ndryshme njëkohësisht edhe për dhënien e informatave që shërbejnë për raporte kombëtare për këtë temë. Aktiviteti i Policisë së Shtetit shtrihet edhe në nivel qarku. Kjo do të thotë praktikisht se në Drejtorinë e Policisë punon një specialist/ e në rolin e koordinatorit midis komisariateve të shtetit dhe i jep informacione sektorit për të miturit dhe dhunën në familje në drejtorinë e përgjithshme për sigurinë publike. Krahas këtyre, specialisti/ja bashkërendon me struktura tjera siç mund të jenë: pushteti vendor, prokuroria, gjykata, shëndetësia, arsimit organizata të ndryshme lokale dhe kombëtare, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje apo me trajtimin e rasteve të tilla kryesisht me viktimat që kanë mbijetuar. Pra, për ta konkretizuar skemën e ndodhisë së rasteve themi se:

Kur policia sinjalizohet për ngjarjen e ndodhur, dhunë në familje, për të bërë veprimet e para në vendngjarje shkojnë specialistët e policisë së zonës por nëpërmjet sallës operative mund të shkojnë dhe patrulla e përgjithshme si edhe patrulla e trafikut rrugor.

Pasi është marrë rasti në shqyrtim, specialisti i policisë së zonës fillon të plotësojë procedurat sipas kërkesës së të dëmtuarit. Në qoftë se shikohet se ngjarja është shoqëruar me shenja dhune atëherë menjëherë njoftohet inspektori i krimeve. Ky i fundit paraqitet në ngjarje dhe fillon procedurat duke u bazuar në nenin 130/a të kodit Penal³ për ndalimin e autorit që ka ushtruar dhunë. Kjo procedurë vlen edhe për rastet e dhunës në mënyrë persistente.

Ndërsa në rastin kur i dhunuari nuk ka dëmtime në fizik atëherë jemi në situatën ku personit që është dëmtuar i shpjegohen të gjitha të drejtat që ka duke lëshuar urdhrin e mbrojtjes së menjëhershme. Paralelisht nga specialisti përkatës fillohet që të përgatitet dosja me provat përkatëse duke ia komunikuar prokurorisë paralelisht me të komunikohet me mjekësinë ligjore më pas dosja dërgohet përfundimisht në gjykatë.

Pasi gjykata lëshon vendimin e saj, specialisti i policisë së zonës dhe inspektorët e krimeve kanë për detyrë që të shpjegojnë efektet e vendimit të gjykatës për të dy palët

³ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme, neni 130/a.

Ligeja, K.
« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

të përfshirë në ngjarjen e dhunës. Gjithashtu ato theksojnë dhe pasojat e mos respektimit të vendimit të gjykatës. Pasi përfundon e gjitha kjo, merren masa për ekzekutimin e vendimit dhe specialisti i policisë mbajnë nën vëzhgim familjen që është përfshirë tashmë në problemin e dhunës.

Më tej, pas gjithë procedurave që bëjnë, specialisti i policisë dhe inspektorët e krimit kanë për detyrë që të dërgojnë të dhënat statistikore tek specialisti/ja për të miturit dhe dhunën në familje në drejtorinë e përgjithshme qarkut, për të gjitha rastet që janë prekur nga dhuna në familje. Këta të fundit i dërgojnë të dhënat në sektorin për të mitur dhe dhunën në familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky sektor ka për kompetencë që të gjitha të dhënat t'i dërgojë në Ministrinë e Brendshme, njëkohësisht edhe në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë duke respektuar kërkesat dhe marrëveshjet e shkruara midis mekanizmave institucionale.

4. Sfidat e përballjes së problematikave gjatë policimit

Roli i Policisë së Shtetit është shumë i rëndësishëm në këtë problematikë sociale. Madje duhet pohuar se nga të gjithë aktivitetet kryesore që ndjek policia ndjekja e fenomenit të dhunës në familje është një ndër aktivitetet prioritare të saj. Por, policia gjatë ndjekjeve të rasteve të ndryshme përballet edhe me vështirësi shumë të cilët varen nga struktura të tjera që e kanë për kompetencë këtë objekt social. Kështu gjatë veprimtarisë së saj policia përballet me mungesën e shërbimeve mbështetëse, mungesa e akomodimit, apo konsultave psikologjike dhe ligjore, shërbimet për fëmijët, mbështetje për strehim afatgjatë, gjithashtu dhe mungesa e ndihmës ekonomike. Me miratimin e ligjit për dhunën në familje u morën masa për krijimin e një strukture që do u emëronte mekanizmi i referimit me qëllim për të trajtuar problematikave të dhunës në familje.

Kështu që mekanizmi i referimit është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme⁴. Filozofia e këtij mekanizmi është që sapa një viktimë/e mbijetuar kontakton një nga anëtarët e mekanizmit të referimit, - nuk ka rëndësi se cili anëtar kontaktohet i pari, - anëtari i kontaktuar menjëherë fillon procesin mbështetës duke informuar të paktën një përfaqësues të bashkisë, policisë dhe strukturave shëndetësore. Shërbimet e ofruara për viktimën/të mbijetuarën janë afat-shkurtra dhe afat-gjata. Në afat të shkurtër, këto shërbime përfshijnë: mbrojtje të menjëhershme dhe siguri, mbështetje shëndetësore, strehim (duke përfshirë transportin në vend të sigurt), dhe gjithashtu informacion dhe asistencë për fillimin e procedurave për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes apo për ndjekjen e rastit penalisht. Ndërkohë, çështja i referohet edhe institucioneve të tjera në bazë të nevojave të rastit.

Mbështetja afatgjatë përfshin referimin tek zyrat e punësimit për mbështetje për punësim, për të marrë ndonjë rekomandim profesional, referimin tek departamenti i shërbimeve sociale për ndihmë ekonomike, strehimin afatgjatë, këshilla ligjore dhe ndihmë në rast se i/e mbijetuar dëshiron të fillojë një procedurë divorci apo një ankesë kundër dhunuesit, këshillim dhe psikoterapi për t'u shëruar nga traumat, por edhe për ri-integrim, si dhe ndihma për fëmijët (d.m.th. transferimi në një tjetër kopsht ose në shkollë, këshillime terapi nëse është e nevojshme, etj)⁵.

Policia ka vështirësi me mekanizmin e referimit. Në përgjithësi puna e mekanizmit

Ligeja, K.
« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

⁴ Të tilla si: bashkia, drejtoria e policisë, gjykata, prokuroria, përbarimi, qendra shëndetësore, zyra e punësimit, zyra arsimore dhe OJF të specializuara për çështje të dhunës në familje dhe gruas.

⁵ www.shërbimisocialshtetedor.gov

të referimit është jo shumë e ndjeshme. Kjo do të thotë kur policia ka identifikuar rastin e dhunës në familje anëtarët e mekanizmit nuk i përgjigjen në mënyrë të menjëhershme, shërbimet që ato ofrojnë nuk janë 24-orësh, ka mungesë kapacitetesh për shërbimin e ofruar.

Pushteti vendor si edhe zyrat përmbarimore, qendrat shëndetësore, duhet të luajnë një rol më të madh kryesisht në plotësimin e kërkesave të urdhrat të mbrojtjes apo mbrojtjes së menjëhershme.

Edhe pse mentaliteti i tabusë së denoncimeve ka pësuar ndryshime, policia serish përballet me këtë mendësi të mbyllur. Viktimat e dhunës nuk janë ç'kompleksuar nga mentaliteti i errët për të bërë denoncimet sipas procedurave ligjore. Kështu konkretisht policia e Tiranës përballet me një popullsi që mbartin një sërë problematikash që lindin nga zhvendosja e saj e si rrjedhojë, përplasen më mentalitetin e vendit ku jetojnë. Këta individë të migruar kanë mendësi të theksuar nga vendlindjet e tyre për ndërtimin e marrëdhënieve familjare. E gjitha kjo e vështirëson veprimtarinë efektive të policimit.

Një tjetër problematikë që dallohet qartë është identifikimi i fëmijëve që vuajnë pasojat e dhunës në familje. Policia duhet të tregojë kujdes të veçantë të orientimit të kësaj kategorie në Qendrën Kombëtare Pritëse për viktimat e dhunës në familje. Patjetër, që jo të gjitha rastet trajtohen nga kjo qendër. Për vitin 2016 numërohen 703 fëmijë në total të vendosur në të gjithë institucionet e përkujdesit social publike jopublike, qendra zhvillimi, qendra pritëse për viktimat e trafikimit dhe qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje nga të cilët:

- 248 fëmijë janë të vendosur në institucionet publike;
- 455 fëmijë janë të vendosur në institucionet jopublike;
- 525 fëmijë janë të vendosur në institucione rezidenciale publike dhe jopublike nga të cilët (179 fëmijë në institucionet publike + 346 fëmijë në institucionet jopublike);
- 62 fëmijë janë të vendosur në institucionet rezidenciale të zhvillimit (46 fëmijë në institucionet publike+16 fëmijë në institucionet jopublike);
- 41 fëmijë janë të vendosur në qendrat pritëse për viktimat e trafikimit (5 fëmijë në institucionet publike+36 fëmijë në institucionet jopublike);
- 75 fëmijë janë të vendosur në qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje (18 fëmijë në institucionet publike+57 në institucionet jopublike).

Numri më i madh i fëmijëve janë të vendosur në institucionet të përkujdesit social jo publike , qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje jo publike dhe qendra pritëse për viktimat e trafikimit jo publike gjithsej numërohen 455 fëmijë dhe 248 fëmijë janë të vendosur në të gjitha institucione të përkujdesit social jo publik⁶.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social, znj. Bisha thekson se: “Është thelbësor funksionimi i mekanizmit të referimit për viktimat e dhunës në familje. Ky mekanizëm është tërësisht lokal dhe për fat të keq funksionon në shumë pak raste. Është e dukshme mungesa e reagimit të koordinuar lokal edhe në rastet që vijnë në Qendrën Kombëtare edhe në faktin se gjatë 2016 vetë Shërbimi Social ka menaxhuar 125 raste të dhunës në familje, pikërisht sepse ka munguar reagimi lokal”⁷.

Ligeja, K.
« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

⁶ Agjencia Shtetërore për të drejtat e fëmijëve, *Vjetar Statistikor për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve*, 2016.

⁷ www.shërbimisocialshtetëror.gov, parë për herë të fundit dt 02.3.2018.

5. Përgjegjësia e punonjësve për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes

Në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”⁴⁸ në nenin 5 të ligjit theksohet se drejtoritë e policisë në qarqe janë një prej autoriteteve të ligjit. Ndërsa në nenin 38 të këtij ligji flitet që të gjitha autoritetet duhet të:

- të bashkërendojnë shërbimet;
- të caktojnë personat përgjegjës;
- t’i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat;
- të mbajnë raportet përkatëse;
- t’i mbrojnë viktimat nëpërmjet informimit, sigurimit të transportit ose vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

Gjatë veprimtarisë së saj policia, kur përballet me dhunën e ushtruar evidenton nëse viktimat ka urdhër mbrojtje apo jo. Punonjësi i policisë pasi lexon urdhrin e mbrojtjes shikon çfarë mbrojtje i siguron ai viktimës dhe çfarë detyrimesh përcakton për dyshuesin. Ndërsa gjatë agresionit të dhunës, policia verifikon nëse dhunuesi ka shkelur urdhrin e mbrojtjes, atëherë lind detyrimi ligjor për arrestimin e tij nga ana e policisë sipas nenit Nenin 320 të Kodit Penal për “Pengim në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”⁴⁹.

Ndërsa në rastin kur viktimat nuk është e pajisur me urdhër mbrojtje lind nevoja që punonjësi i policisë ka për detyrë që të këshillojë viktimën për mundësinë që ka për përfitimin e një urdhri të tillë.

Sipas ligjit kundër dhunës në familje, policia mund të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje (neni 13). Policia duhet të tregohet jashtëzakonisht e kujdesshme në zbatimin e kësaj dispozite në mënyrë që viktimës t’i bëhen me dije të drejtat e tij për mbrojtje dhe të jetë e ndjeshme ndaj vullnetit që shpreh ajo. Shpesh viktimat është gjykatësi më i mirë i situatës së tij. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet pranë komisariatit më të afërt të policisë (neni 14). Strukturat policore duhet të kontaktojnë:

Me prokurorin e shërbimit të radhës, i cili mbas komunikimit me gjykatësin merr urdhrin e mbrojtjes.

Me gjyqtarin e gatshëm pranë gjykatës së shkallës së parë, të cilit i paraqet kërkesë dhe prej te cilit merr urdhrin e mbrojtjes.

Një kopje e këtij urdhri, menjëherë i dërgohet policisë (nga prokurori) dhe viktimës kudo që është vendndodhja e tyre. Raportet e policisë, janë dokumente në formën e procesverbaleve të mbajtura prej punonjësve të policisë që trajtojnë rastet e dhunës në familje, të cilat mund të paraqiten si prova në gjykatë (neni 16). Kur viktimat i drejtohen komisariatit të policisë me një kërkesë, atëherë (komisariati i policisë) e ka për detyrë t’i përgjigjet, të bëjë konstatimet përkatëse, t’i evidentojë këto konstatime në dokumentacion dhe të fillojë hetimet kryesisht mbi rastin e dhunës në familje. Gjykata, brenda 24 orësh pas lëshimit të urdhrin, i dërgon një kopje komisariatit të policisë (nenet 19, 17, 22). Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje që është paraqitur nga policia, gjykata mund të kërkojë që punonjës të policisë të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime për ngjarjen dhe rrethanat e saj

Ligeja, K.
« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Policimi dhe Siguria
nr.11, 2018

⁴⁸ Në zbatim të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, *Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*.

⁴⁹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Pjesa e posaçme, neni 320.

(neni 18, 16). Punonjësit e policisë të cilët nuk vepronin në zbatim të këtij ligji, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale duke aplikuar sanksionet e përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të K. P. (Neni 8/5 i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006)¹⁰.

6. Përfundime

Aktualisht fenomeni i dhunës në familje mbetet në nivele të larta në shoqërinë Shqiptare. Trajtimi i këtij fenomen mbetet parësor për qeverinë shqiptare, e cila po punon për reduktimin e këtij problemi social.

Legjislacioni shqiptar është përmirësuar në këtë drejtim me miratimin e ligjit datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, gjithashtu edhe me miratimin e planeve të veprimit, zbatimi i të cilave jep rezultate pozitive. Por, serish shihet që ka vend për përmirësim.

Për reduktimin e kësaj problematike, ekzistojnë bashkërendime midis shumë aktorëve si: qeverisja vendore, shoqata joqeveritare, policia, mekanizma ndërkombëtare që bëjnë të mundur koordinimin e punës për trajtimin e problemit.

Kështu eksperiencia ka treguar se asnjë institucion i vetëm nuk ka mundur ta luftojë problemin në fjalë pa bashkëpunimin dhe përmirësimin e qëllimeve të tyre. Edhe pse është bërë punë sërish ndihet mungesa e infrastrukturës, shërbimeve mbështetëse, financiare, apo programe specifike për viktimat e dhunës për t’u integruar në shoqëri.

Qeveria nëpërmjet institucioneve shtetërore si Ministria e Brendshme dhe Policia me ligjin kundër dhunës në familje kanë ndërmarrë masa konkrete dhe koherente për riorganizimin e punës dhe për eficensën për të mbrojtur marrëdhëniet familjare nga rastet e dhunës. Megjithatë ka sërish nevojë për punë të vazhdueshme për reduktimin e problemit më emergjent në Shqipëri.

7. Rekomandime

Duke studiuar këtë temë kam mbajtur disa shënime në formën e rekomandimeve për këtë temë. Kështu që rekomandimet do të drejtohen në disa drejtime kryesore të mbarëvajtjes së aktiviteteve policore.

- Në drejtim strukture rekomandohet për të zgjeruar strukturën e komisariatit me specialistë të fushës së psikologjisë për rastet e dhunës në familje.

- Krahas psikologëve duhet të shtohen edhe nëpunëse police gra, të cilat e realizojnë me ndjesi graujë përveçse me objektivitet problemin e dhunës ndaj gruas.

- Në drejtim infrastrukture mund të rekomandohet për përmirësimin e ambienteve të policisë dhe komoditeteve për të trajtuar rastet e dhunës në familje.

- Ndërsa në drejtimin e trajnimeve mund të rekomandohet që të ndiqen vazhdimisht trajnime seminare mbi zbatimin e kurrikulave dhe përditësimi i kurrikulave ekzistuese.

- Trajnimi të shtrihet edhe përveçse tek inspektorët apo specialistët e krimeve por edhe tek viktimat e dhunës me qëllim që të mbrohen kur të kenë problematika të ridhunimit nga dhunuesit e tyre dhe të krijohen rrethana për të shpërndarë eksperiencën e trishtë tek njerëz të tjerë që mund të jenë potencial dhune.

- Duhet buxhetuar shërbimet mbështetëse emergjente në rastet e dhunës ndaj gruas

¹⁰ Dhuna në Familje, Përgjegjësitë që ka Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj, Tiranë, mars 2008.

me qëllim që të krijohet mundësia për shpërndarjen për ushqim dhe veshmbathje. Kjo të realizohet në të gjitha territorin e Shqipërisë.

- Nga aktorët e mekanizmit të referimit duhet të shtohen shërbimet të bëhen më cilësore dhe emergjente përgjatë 24 orëve gjithashtu të zbatohen shërbimet afatgjata si: strehim, punësim, edukim, integrim në shoqëri, formim profesional.

- Mbi të gjitha gjithçka sa u përmend më lart merr vlerë kur kemi shpërndarje të burimeve financiare nga qeveria kryesisht nën kompetencën e Ministrisë së Brendshme në drejtim të Policisë së Shtetit kur flitet për adresim nevojash për trajtesat e dhunës në familje.

Bibliografia

1. Agjencia Shtetërore për të drejtat e fëmijëve, *Vjetar statistikor për çështjet e të drejtave të fëmijëve*, 2016.
2. Dhuna në Familje, *Përgjegjësitë që ka Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj*, Tiranë, mars 2008.
3. Ligji nr. 9690 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
4. VKM nr. 334 datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".
5. Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".
6. Ligji nr. 10221 datë 04.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
7. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
8. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*, Pjesa e posaçme.
9. *Raport-vlerësimi i strukturave kundër dhunës në familje në policinë e shtetit, si pjesë e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare*, korrik 2015.
10. Strategjia e Policimit për Sigurinë në Komunitet 2015-2017.
11. *Vrojtimi i parë dhe i dytë kombëtar për Dhunë në Familje në Shqipëri*, INSTAT.

Ligeja, K.

« Sfidat e policimit në fenomenin e dhunës ndaj gruas »

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

ENGLISH

A B S T R A C T S

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 7, SPETEMBER, 2017

Policimi
dhe
Siguria
nr.11, 2018

155

The address of the Italian National Prosecutor on Anti-Mafia and Anti-Terrorism, Mr. Cafiero DE RAO, delivered on 26th February 2018 at the Security Academy in Tirana, Albania*

**- Federico Cafiero De Raho,
Procuratore nazionale antimafia e antiterrorismo, Italia**

Permettetemi innanzi tutto di ringraziare il Ministro dell'Interno della Repubblica di Albania per l'invito e di salutare tutte le Autorità presenti a questa iniziativa. Sono veramente onorato di parlare in un così qualificato contesto e nella prestigiosa Accademia per la Sicurezza dell'amica Repubblica di Albania.

Come qualcuno tra voi sicuramente saprà, prima di essere nominato - dal Consiglio Superiore della Magistratura - Procuratore Nazionale Antimafia ed Antiterrorismo, ho rivestito, tra gli altri, le funzioni di Procuratore Aggiunto presso la Procura di Napoli e di Procuratore della Repubblica di Reggio Calabria. Ho ritenuto di richiamare in questa sede entrambe le esperienze per la loro particolare importanza nel mio percorso professionale: nell'esperienza napoletana ho coordinato le indagini sulla camorra napoletana e, in particolare, su quella frangia di tale organizzazione denominata "clan dei Casalesi", mentre nell'esperienza reggina ho avuto modo di coordinare e dirigere le indagini contro la 'ndrangheta.

La 'ndrangheta e la camorra sono due organizzazioni mafiose che operano nel sud Italia: in particolare, la 'ndrangheta in Calabria e la camorra in Campania. Caratteristica comune a queste due organizzazioni mafiose è la capacità di espandersi fuori dai territori dove si sono tradizionalmente insediate - e nei quali da tempo operano ed agiscono-, al fine di espandere i propri interessi criminali, in particolare al fine di reinvestire nelle attività lecite gli ingentissimi ricavi derivanti dalle attività illecite svolte sull'intero territorio nazionale.

Per queste ragioni sia la 'ndrangheta e camorra hanno esteso la loro presenza non solo in regioni italiane diverse dalla Calabria e dalla Campania ma anche in altre nazioni, sia europee che extra europee. Le modalità nelle quali si è verificata questa espansione sono anch'esse comuni ad entrambe le organizzazioni criminose, seppure con le peculiarità e specificità di ciascuna di esse: la molla che ha inizialmente determinato la presenza delle stesse all'estero è stata quella della conclusione di affari tipicamente criminali.

Infatti, sia la 'ndrangheta che la camorra hanno iniziato ad avere interessi all'estero principalmente per approvvigionarsi di sostanze stupefacenti e, comunque, per Procurarsi quanto occorrente per il migliore svolgimento di alcune specifiche attività criminose. Così la camorra, particolarmente interessata al contrabbando di sigarette, ha preso i suoi contatti con le nazioni dell'Europa dell'est che si affacciano sull'Adriatico o con le nazioni del Nord Africa che si affacciano sul Mediterraneo; così, entrambe le organizzazioni hanno importato alla bisogna armi di tutti i generi dalle nazioni dell'Europa dell'est. L'approvvigionamento delle sostanze stupefacenti, il cui mercato produce guadagni relevantissimi, ha portato le organizzazioni criminali ad essere dinamiche nello scenario internazionale, acquisendo progressivamente un ruolo più rilevante nella filiera di questo mercato.

* **DISCLAIMER:** This is the address of the Italian National Prosecutor on Anti-Mafia and Anti-Terrorism, Mr Cafiero DE RAO, delivered on 26th February 2018 at the Security Academy in Tirana, Albania. Please note that the translation of the text provided is only a courtesy translation in Albanian and therefore it does not represent an official document of the Republic of Italy or the Republic of Albania. It is meant purely as a documentation tool and PAMECA does not assume any liability for its contents.

Da Procuratore di Reggio Calabria ho osservato da vicino la costante espansione del ruolo della 'ndrangheta nel mercato nazionale e internazionale delle sostanze stupefacenti, così come ho osservato il progressivo allargarsi degli orizzonti operativi di tale organizzazione criminale dalla Calabria in tutta Italia, in Europa, in altri continenti. Per questa ragione sono da tempo profondamente convinto che il contrasto alla criminalità organizzata, per avere possibilità di successo, deve necessariamente avvalersi della collaborazione dei Paesi esteri nei quali la stessa opera, vuoi per Procurarsi le materie prime per i propri traffici, vuoi per investire gli illeciti guadagni conseguiti e metterli al sicuro dalle indagini che si svolgono in Italia.

La cooperazione internazionale, pertanto, appare essere l'unica strada percorribile per un efficace contrasto alle organizzazioni mafiose che operano in collegamento con altri gruppi criminali insediati all'estero o che all'estero svolgono una parte rilevante della loro attività criminosa o hanno in tali territori specifici interessi economici. Tale convinzione ha ispirato la mia attività precedente a quella, più recente, di Procuratore Nazionale Antimafia e Antiterrorismo. Nell'incarico da me attualmente rivestito la convinzione della essenzialità della cooperazione internazionale nel contrasto alla criminalità mafiosa e terroristica si è ulteriormente rafforzato, avendo potuto acquisire da un osservatorio più vasto rispetto a quello di una Procura distrettuale ulteriori conoscenze in merito alle organizzazioni mafiose e terroristiche operanti sul territorio italiano.

È fuori di ogni dubbio che un presupposto essenziale per il contrasto alle organizzazioni criminali è la conoscenza delle dinamiche delle organizzazioni stesse, delle loro caratteristiche specifiche, dei rapporti che le stesse hanno con la società civile, della loro forza economica, della loro capacità di infiltrarsi all'interno delle istituzioni e nell'economia reale dei territori nei quali esercitano la loro influenza: tutto questo costituisce l'oggetto specifico delle tante indagini sulle organizzazioni mafiose che si svolgono quotidianamente in Italia e delle quali la direzione Nazionale Antimafia e Antiterrorismo viene costantemente informata dalle procure distrettuali.

L'idea di Giovanni Falcone della creazione della direzione Nazionale Antimafia quale ufficio giudiziario che abbia il compito di raccogliere, coordinare e diffondere le conoscenze sulle organizzazioni criminali operanti in Italia appare, nell'attuale momento storico, decisamente determinante nel contrasto a tutte le forme di criminalità organizzata e terroristica. La raccolta e la diffusione delle informazioni, la loro analisi, il coordinamento delle indagini fra i vari uffici giudiziari, infatti, costituisce un modello operativo ed organizzativo oramai sempre più diffuso a livello internazionale. Dall'idea di fondo che ha ispirato la creazione della direzione Nazionale Antimafia, divenuta poi direzione Nazionale Antimafia e Antiterrorismo, deriva per diretta conseguenza la profonda fiducia che la direzione Nazionale Antimafia ha riposto nello strumento della cooperazione internazionale quale mezzo indispensabile per la lotta alle organizzazioni criminali.

Posso senza dubbio sostenere che la direzione Nazionale Antimafia ha percorso i tempi nell'individuare nella raccolta e nello scambio spontaneo di informazioni uno strumento agile ed efficace per attivare la cooperazione fra diversi uffici giudiziari. Mi piace qui ricordare che correva l'anno 1997 allorquando la direzione Nazionale Antimafia stipulava proprio con la Procura generale della Repubblica d'Albania la prima "proposta di intesa sulla collaborazione nel settore della criminalità organizzata" nella quale si affermava il principio dello scambio spontaneo di informazioni "sulle organizzazioni criminali attive nei rispettivi territori e sul loro modus operandi" (articolo tre) e sulla circostanza che un cittadino del proprio paese sia oggetto di indagine per delitti di criminalità organizzata. Questo protocollo, rimasto in vigore nella sua forma essenziale fino all'anno 2014, ha preceduto di tre anni il protocollo dell'Onu di Palermo, siglato il 12 - 15 dicembre 2000 ed al quale la Direzione Nazionale Antimafia

ha dato un rilevante contributo; il protocollo di Palermo all'articolo 18, quarto comma, finalmente inserisce la possibilità di "trasmettere informazioni in materia penale ad una autorità competente di un altro Stato Parte qualora ritengano che dette informazioni possano essere utili all'autorità ad intraprendere o a concludere con successo inchieste o procedimenti penali o possano dar luogo ad una richiesta formulata dal secondo Stato Parte ai sensi della presente Convenzione".

Da quel momento si sono susseguiti altri memorandum, dello stesso tenore, fino ad arrivare, nell'anno corrente, a 39 memorandum (o protocolli) sottoscritti con altrettante Procure di altre Nazioni e con Organismi internazionali utili alla forma di cooperazione perseguita dal mio Ufficio: lo scambio informale di notizie ed informazioni utili per attivare, in tempi strettissimi, attività di indagine che potrebbero essere irrimediabilmente compromesse dalle lungaggini delle attività rogatorie classiche. Nel tempo anche l'Unione Europea ha percorso la stessa strada, prevedendo, nella convenzione relativa all'assistenza giudiziaria in materia penale tra gli stati membri dell'Unione europea, fatta a Bruxelles il 29 maggio 2000, la possibilità di scambio spontaneo di informazioni. Nel testo del decreto legislativo di ratifica e di attuazione adottato in Italia il 5 aprile 2017 all'art. 9 si legge, infatti "Scambio spontaneo di informazioni. 1. È consentito, nell'ambito di un procedimento penale o di un procedimento amministrativo, lo scambio diretto e spontaneo di informazioni utili e di atti con l'autorità competente di altro Stato Parte. 2. Le informazioni e gli atti ricevuti sono utilizzabili nel rispetto dei limiti indicati dall'autorità competente dello Stato Parte."

Allo stato attuale la legislazione europea in materia di cooperazione penale si è spinta ancora più avanti, con la previsione dell'ordine europeo di indagine e di altri strumenti giuridici finalmente tesi ad accelerare al massimo le procedure di cooperazione giudiziaria. Ma tali strumenti giuridici si applicano solo tra i Paesi appartenenti all'Unione (e nemmeno in maniera uniforme fra tutti) e, nell'attesa che l'Albania entri in Europa (avvenimento che l'Italia auspica a breve termine), non si possono applicare ai rapporti tra i nostri due ordinamenti giudiziari, anche se, permettetemi di dirlo, i rapporti fra l'Italia e l'Albania in questa materia sono così intensi che costituiscono un vero unicum nelle relazioni giudiziarie bilaterali con una Nazione non appartenente all'Unione Europea. Infatti, attraverso gli strumenti degli accordi bilaterali di cooperazione, dei protocolli di cooperazione e di quello strumento essenziale costituito dalla conoscenza, dal rispetto e dalla fiducia reciproca è stata costruita con l'Autorità Giudiziaria Albanese una cooperazione altamente soddisfacente per entrambe le parti.

Con una punta di orgoglio, permettetemi di dire che la Direzione Nazionale (Antimafia prima ed ora Antimafia ed Antiterrorismo) è stata ed è in prima linea nel costruire - giorno dopo giorno e con la sua attività sul campo - il prius di qualsiasi rapporto bilaterale di cooperazione giudiziaria, costituito dal rispetto e dalla fiducia reciproca che derivano dalla conoscenza diretta dell'interlocutore. La Direzione Nazionale ha basato sul rispetto e sulla fiducia reciproca questa cooperazione con l'Albania che, a me sembra, abbia finora dato ottimi frutti, sia sul terreno dello scambio di esperienze finalizzate alla migliore conoscenza reciproca delle rispettive legislazioni nazionali e del supporto all'elaborazione legislativa, sia sul piano dell'attività propriamente giudiziaria (anche se è doveroso rimarcare, ad esempio, che squadre investigative comuni tra Uffici di Procura - fino ad ora - sono state costituite proprio solo con l'Albania e la Svizzera, al di fuori dell'Unione Europea, e che innumerevoli sono state le indagini collegate, frutto della cooperazione anticipata indotta dal rispetto del protocollo del quale ho già parlato, che hanno portato all'esecuzione contemporanea di provvedimenti giudiziari - arresti e persino sequestri finalizzati alla confisca di beni - nei nostri due Paesi).

Anche qui mi piace ricordare che la fiducia nei vantaggi della cooperazione è stata ampiamente dimostrata dall'attuale Ministro dell'Interno (all'epoca Ministro della Giustizia) allorquando ha richiesto l'expertise della Direzione Nazionale Antimafia per l'elaborazione delle modifiche legislative al codice penale e di procedura penale finora conosciute come "pacchetto antimafia" e che la stessa è stata corrisposta prontamente da un mio illustre predecessore, il compianto Piero Vigna, che ritenne di delegare un collega del mio ufficio allo studio di tali riforme, poi puntualmente approvate dal Parlamento.

Ma lo sguardo su questo strettissimo rapporto di cooperazione non può essere solo rivolto al passato, deve necessariamente rivolgersi al futuro;anche se il passato è fatto di tanti episodi e momenti gratificanti,come gli incontri di formazione tenuti da magistrati della D.N.A, presso la Scuola della Magistratura e dei P.M. a Tirana o l'inaugurazione del centro antitraficchi a Valona.

Ancora una volta è la realtà della diffusione in Italia di criminalità composta da soggetti provenienti dall'Albania a sollecitare un incremento ed un miglioramento ulteriore della nostra cooperazione:

alcuni numeri:

I soggetti nati in Albania indagati in Italia per reati di competenza delle Direzioni Distrettuali Antimafia al 30giugno 2017 sono:

979, dei quali 504 in procedimenti nei quali le indagini non si sono ancora concluse. I reati più diffusi sono quelli relativi al traffico transnazionale di sostanze stupefacenti.

La diffusione territoriale delle indagini copre l'intero territorio nazionale.

A quella data erano infatti in corso indagini a carico di persone nate in Albania nelle procure distrettuali di Ancona, Bari, Bologna, Brescia, Cagliari, Caltanissetta, Campobasso, Catania, Catanzaro, Firenze, L'Aquila, Lecce, Napoli, Perugia, Reggio Calabria, Roma, Torino, Trento, Trieste, Venezia e Milano.

Questi numeri, da soli, dimostrano l'essenzialità della cooperazione internazionale nel contrasto alla criminalità organizzata che lega l'Italia all'Albania e la necessità di compiere ogni ulteriore sforzo per migliorare e incrementare tale cooperazione, attualmente a livelli molto alti, fino a raggiungere risultati pressoché ottimali.

Ovviamente, l'ottimizzazione della cooperazione presuppone una profonda conoscenza della procedura penale dei Paesi interessati e della loro legislazione interna.

Il mio ufficio, che da sempre ha seguito con la massima attenzione l'evoluzione della legislazione albanese in materia penale, ha studiato le modificazioni recentemente introdotte nella legislazione albanese sia con riguardo all'organizzazione della giustizia che alla procedura penale ed al diritto penale sostanziale. Le riforme costituzionali hanno delineato un'organizzazione degli uffici giudiziari particolarmente moderna e, a mio avviso, potenzialmente efficace. La previsione della sottoposizione al vaglio di una apposita commissione dell'idoneità dei candidati a rivestire la carica di giudici e pubblici ministeri sia sotto il profilo del background personale che sotto il profilo della congruità degli averi-propri e dei propri familiari - alla attività precedentemente svolta costituisce un filtro particolarmente potente per assicurare la qualità della selezione di coloro che vengono nominati a tali importanti cariche nella Giustizia.

Ma la più rilevante riforma costituzionale, a mio avviso riguarda la struttura dell'ufficio del pubblico ministero: l'articolo 148 della costituzione albanese nell'attuale formulazione espressamente stabilisce che l'ufficio del Procuratore è indipendente e connesso al sistema giudiziario; l'art. 149 istituisce l'organo dell'alto consiglio dei Procuratori, composto da 11 membri, sei dei quali eletti da tutti i apparecchiare i poteri previsti dall'articolo 149 /a della Costituzione ed in particolare la funzione di garantire l'indipendenza, l'affidabilità, la disciplina, lo Status e la carriera dei Procuratori della Repubblica di Albania. Infine viene creato l'ufficio del Procuratore

speciale e l'unità speciale di indagini per la l'accertamento delle reati di corruzione, criminalità organizzata e reati commessi dalle personalità indicate nell'articolo 135 comma secondo della stessa costituzione.

Particolarmente importante, per i suoi riflessi nel campo della cooperazione internazionale tra la Direzione Nazionale Antimafia e all' Autorità Giudiziari dell'Albania, appare la circostanza per la quale l'ufficio del Procuratore speciale è indipendente da quello del Procuratore generale e quella per la quale l'unità speciale di investigazione sarà subordinata all'ufficio del Procuratore speciale.

A queste previsioni fanno corollario quelle relative all'ufficio del Procuratore (articoli 24-29 del codice di procedura penale come emendato dalla legge numero 35-2017) e quelle relative alla polizia giudiziaria (articoli 30-33 del codice di procedura penale) i quali prevedono una diretta connessione fra le sezioni e i servizi di polizia giudiziaria e l'ufficio del pubblico ministero.

L'articolo 32 del codice di procedura penale indica nel dettaglio a quali ufficiali ed agenti di polizia può essere attribuita la funzione di polizia giudiziaria e, al comma terzo, contiene una norma di chiusura includendo nel concetto di polizia giudiziaria i soggetti che sono autorizzati dalla legge a svolgere le funzioni previste dall'articolo 30, che descrive le funzioni della polizia giudiziaria: è evidente che la normativa attualmente in vigore in Albania preveda una strettissima connessione fra polizia giudiziaria e pubblico ministero. Tale connessione è ancora più marcata qualora si consideri che l'ufficio del Procuratore speciale si avvale del "National bureau of investigation" e che gli investigatori di tale ufficio hanno lo status di ufficiali di polizia giudiziaria.

È evidente che l'attuale quadro normativo imponga una strettissima collaborazione fra l'ufficio del pubblico ministero e la polizia giudiziaria. Ancor più stretta è la collaborazione che deve esserci fra gli investigatori del N.B.I. e l'ufficio del Procuratore speciale, peraltro in un contesto, quello delle indagini su criminalità organizzata e corruzione, nel quale è necessaria una elevata reciproca specializzazione ed un alto livello di affidabilità per il successo delle indagini stesse. Ecco, allora, che il ruolo della polizia nelle indagini acquista un valore particolare e non è affatto sminuito dall'attribuzione al pubblico ministero della direzione delle indagini stesse, come previsto dal nuovo codice di procedura penale. L'esperienza italiana ha dimostrato senza alcun dubbio che lo stretto rapporto fra polizia giudiziaria e pubblico ministero, in un quadro simile a quello attualmente vigente in Albania, ha portato ad un accrescimento della professionalità sia dei pubblici ministeri che della polizia giudiziaria.

Intendo dire che i pubblici ministeri hanno potuto avvalersi, in questo rapporto, dell'esperienza specifica della polizia giudiziaria nei protocolli di indagine da questa sperimentati sul campo e la polizia giudiziaria, a sua volta, ha potuto avvalersi della competenza del pubblico ministero che, direttamente responsabile della strategia di indagine finalizzata all'accertamento della notizia di reato, ha effettuato le scelte necessarie per il successo delle investigazioni e la completezza delle stesse.

Nella fase delle indagini preliminari, infatti, finalizzata alla verifica della notizia di reato e caratterizzata dalla decisione finale, attribuita al pubblico ministero, di portare o meno il compendio probatorio alla conoscenza del tribunale, esercitando l'azione penale, oppure, in assenza di elementi sufficienti a promuovere tale azione, di chiedere l'archiviazione, la direzione della polizia giudiziaria è essenziale per chiarire in ogni suo aspetto la vicenda sottoposta alle indagini. Il pubblico ministero può rendersi conto - effettuando una previsione derivante dalla conoscenza delle normative vigenti, della giurisprudenza e delle decisioni delle corti - di quali siano i risultati delle indagini sui quali occorre effettuare un maggiore approfondimento e quali altre prove debbono essere acquisite per potere adempiere al dovere (in Italia, come in Albania, imposto

dal codice di procedura penale) di indagare per l'accertamento della verità, acquisendo anche gli elementi a favore dello stesso indagato.

L'interazione tra polizia giudiziaria e pubblico ministero esige un elevato livello di professionalità, sia da parte del pubblico ministero che da parte della polizia giudiziaria: questo è un presupposto essenziale per il successo delle riforme introdotte nella legislazione della Repubblica d'Albania. La direzione Nazionale Antimafia e Antiterrorismo, come nel passato, è pronta ad offrire, nelle forme e nei modi più utili ed opportuni, la sua esperienza e le sue conoscenze per l'accrescimento professionale sia della polizia giudiziaria che dei pubblici ministeri. Siamo stati da sempre a fianco della Repubblica d'Albania e delle sue istituzioni e non ci sottrarremo nemmeno in questo momento a qualunque richiesta di supporto che dalle istituzioni albanesi dovesse essere rivolta al nostro ufficio. Per quanto concerne la cooperazione, la legislazione lascia agli accordi fra Stati la disciplina speciale; resta ferma, pertanto, la totale disponibilità più volte espressa in merito allo scambio spontaneo di informazioni.

Per quanto riguarda i rapporti tra Italia ed Albania, lo scambio di informazioni è previsto dall'art. V della LEGGE 14 giugno 2011, n. 97 di ratifica della Convenzione bilaterale di assistenza giudiziaria, intitolato: "Scambio spontaneo di informazioni", che dispone:

1. Nei limiti previsti dal diritto interno, le autorità giudiziarie competenti delle Parti contraenti possono procedere ad uno scambio di informazioni, senza che sia presentata una richiesta a tal fine, relative a reati perseguibili da parte dell'autorità destinataria al momento della trasmissione delle informazioni.
2. Le informazioni sono scambiate per iscritto, o con qualsiasi mezzo in grado di produrre una registrazione scritta, alle condizioni che consentano alle Parti contraenti di verificarne l'autenticità.
3. L'autorità che fornisce le informazioni può, secondo il diritto interno, imporre all'autorità giudiziaria destinataria condizioni per l'uso di tali informazioni. L'autorità giudiziaria destinataria rispetta tali condizioni.
4. Tra le autorità giudiziarie competenti previste dal paragrafo 1, per la parte Italiana la Direzione Nazionale Antimafia procede allo scambio di informazioni ed alle altre attività ad essa attribuite dal diritto interno.

La normativa appena richiamata permette pertanto lo scambio diretto di informazioni e la trasmissione diretta delle richieste di assistenza giudiziaria (art. IV della stessa convenzione): le norme speciali contenute nell'accordo bilaterale salvaguardano la rapidità dell'attività di cooperazione, in quanto prevalenti sulla normativa interna (art. 1, comma 2 della legge della Repubblica d'Albania nr. 10 193 del 3.12.2009 sulle relazioni giurisdizionali con le autorità estere che dispone l'inapplicabilità della legge stessa nelle parti disciplinate diversamente dagli accordi internazionali, come questo con l'Italia).

Nell'attuale fase di transizione verso la legislazione recentemente approvata dal parlamento, interlocutori delle Autorità Giudiziarie italiane continueranno ad essere, per la trasmissione diretta delle richieste di assistenza giudiziaria, anche quando riguardi il compimento di attività diverse dallo scambio di informazioni, il Ministero della Giustizia albanese – in generale – e la Procura per i crimini gravi per tutte le attività (dallo scambio di informazioni alla costituzione delle squadre investigative comuni) riguardanti i reati di competenza di tale ufficio. L'art. 75/a del codice di procedura penale albanese dispone che "fino alla costituzione dell'Ufficio del Procuratore Speciale, i casi in corso di indagine per i reati di cui all'art. 75/a del Codice penale saranno indagati dall'Ufficio di Procura presso la corte per i reati gravi

nei casi di cui alla lettera “b): qualsiasi reato commesso da un gruppo criminale strutturato, una organizzazione criminale o terroristica o gruppo armato” e secondo la procedura precedente all’entrata in vigore della legge. Alla base delle riforme approvate dal Parlamento Albanese nel settore della Giustizia c’è il forte desiderio di rafforzare la fiducia dei cittadini nella Giustizia. Per ottenere questo risultato le leggi da sole non bastano: occorrono i fatti. I fatti sono i risultati che la Giustizia albanese riuscirà ad ottenere nella lotta alla criminalità organizzata ed alla corruzione. In Albania, come in molte realtà in Italia, tutti conoscono le persone che si arricchiscono o si sono arricchite con i traffici illeciti e la maggior parte delle persone pensano che il potere del denaro assicuri loro l’impunità: sta a noi dimostrare il contrario, colpendo duramente le organizzazioni criminali e, soprattutto, privandole dei proventi dei reati da esse accumulati. Tutti gli strumenti giuridici devono essere utilizzati senza alcuna esitazione, e la Direzione Nazionale Antimafia ed Antiterrorismo è, come sempre, pronta a fare la sua parte. Consegne controllate, utilizzazione di agenti sotto copertura, squadre investigative comuni, indagini informatiche e scambio immediato di informazioni tra autorità giudiziarie sulle indagini in corso sono solo alcune delle attività che abbiamo già sperimentato essere efficaci nel contrasto alla criminalità organizzata transnazionale e sono attività permesse da entrambe le legislazioni: facciamo ricorso ad esse più spesso e con maggiore fiducia. Chiudo questo mio intervento proprio con questa constatazione: quando abbiamo utilizzato tali strumenti (in particolare quello delle squadre investigative comuni, che coniuga la possibilità di utilizzo di tecnologie avanzate per il compimento di determinate attività con il bagaglio di conoscenza del territorio proprio di chi opera e risiede su quel territorio) i risultati si sono visti e percepiti immediatamente. Dobbiamo continuare a lavorare insieme, con fiducia e con la convinzione che, come diceva Giovanni Falcone, “la mafia è un fenomeno umano e, come tutti i fenomeni umani, ha un principio, una evoluzione ed avrà quindi anche una fine”.

Effective Leadership

- Phd. Bilbil Memaj, Rector of Academy of Security

Abstract

In cases when a police leader is elected, the need for an analysis or balance of work of the organization run by him. The analysis compares the indicators of criminality, the state of order throughout the period that the leader exercised his function. It is also evaluated the internal state of the Police structure, to determine what director we had at the head of this police structure and based on the parameters that the police has to solve the appropriate leader. The quality of police leadership has been the subject of constant interest, strong debates and critical details in recent years. As a result, it took considerable time, energy, effort and analysis to explore the character of the police leadership. Experience has shown that leadership of a police organization not only needs to be a leader, but at the same time you have to adhere to some of the principles that we are going to analyze in this paper. If we need to determine the key to the success of an organization, of course, this must first be sought at the staff of this organization and in the first place comes the choice of the police leader, who will be the visionary and inspiration of all the staff and, the head in chief of the works for realizing the objectives of the organization. This paper, based on theory, examples of practice and my personal experience, highlights some of the qualities of a leader in the organization. All these observations and settings are the features that should be sought by decision-makers to select an effective leader in the police organization.

Kosovo: between responsible state building process and Serbian-Russian threats for its own failure
- Ph.D. Xhavit Shala

Abstract

The objective of this research paper is the treatment and analysis of Kosovo processes of governance and building state through Serbian and Russian threats to failure the state of Kosovo. We can consider the Kosovo responsible process of statehood and state building as part of the Albanian centuries missions and efforts to realize their vision of having a national state near a civilized world, as a finalization objective of Albanian National Renaissance Program. Serbia and Russia have constantly tried to present Kosovo's statehood as a process of violation of international law. But this right of statehood of Albanian citizens of Kosovo has already been accepted internationally. This is reflected in the recognition of the State of Kosovo by nearly 116 UN member states and its admission to dozens of international organizations. The right of statehood can be considered a legally concluded process because after Serbia's request to express the legitimacy of Kosovo independence declaration, the International Court of Justice, which represents the highest level UN tribunal, concluded that "Kosovo independence declaration hasn't violated international law". However, the process of Kosovo statehood should be classified and categorized as a 'continuous threatened process' which should be constantly secured as long as the constitution, Serbia continues to evaluate Kosovo under its dependency because of Kosovo is considered a threat to its security by the Serbian security strategy and when also two permanent member of UN Security Units haven't recognized Kosovo's independence yet, as long as Serbia isn't separated from Russia and their direct engagements to sabotage the state building process and to present Kosovo as a failed and non-functional state, as Russia once did with the Chechen initiative for independency or with Eastern Ukraine nowadays. This threat to the Kosovo statehood process will begin to be deserted only through Kosovo good and responsible state building process and governance. The methods used for the conduction of this work are both quantitative and qualitative ones, including basic research instruments like synthesis and analyses method, comparative, historical, juridical and confrontation analyses, as well as application of case studies. The main findings of this paper reveal that the threat of Kosovo state building process from Serbia and Russia will begin to be deserted only through a responsible state building and good governance process in Kosovo. In the conclusion of this research, Kosovo state building process, in its 10th anniversary of independence based on the political solution for an independent and sovereign state, has managed to fulfill the essential function in the field of security, rule of law, income security, political and institutional legitimacy through free and fair election process and has also made a visible progress in meeting the state functionality expected level. They're all crucial feature of a responsible state building process. This successful process is important not only for Kosovo's security, but it is also a serious investment with major impacts on the Balkan security complex and beyond.

Budgeting and the police mission
- M.Sc. Xhafer Barjami

Abstract

In the short term, the aim is focused on increasing the sensitivity and interest of the

operational and managerial police structures in terms of capacity building and improvement of the knowledge of the State Police budgeting. In the perspective plan, we are looking for the "challenges of measuring the outcomes of police work" is targeted through the training of management structures in the direction of a real building, also comparative, motivational, full budget covering the current cost, priority cost and the strategic cost, policymaking activities, with tangible impact on image and performance, assessed by internationally recognized indicators in measuring the added security in the country, region and wider.

Eugen Fransua Vidok, Great Police Detective
- Prof. As. Dr. Stavri Sinjari

Abstract

The most interesting figure in the history of the Police, perhaps even more controversial in the exact definition of the role and values it brought, is undoubtedly the XIX- th century French policeman Eugen Fransua Vidok. For every researcher, especially in investigating and detecting crime, he remains the first figure, the first police detective and the most prominent. His reputation as a detective has not been achieved by anyone other than in the book characters. For the art of police detecting and investigating the crime, Vidok is founder, creator, participant, leader, everywhere happened, ever made, who always comes out winner. As long as he did, worked and gave it to the police, he is enough to be present. He is generally recognized as a pioneer in modern crime investigation, forensic investigation and an entire crime investigation and crime detection system. French police, R. Peel in England, A. Uollmer and E. Huver in the US learned from the great Vidok. Vidok as a person is also the most famous media policeman, personage of story-telling, novels, theater, films, super-policeman with Jean Valzhan's face, or Sherlock Holmes, a detective that has inspired not only writers and artists but many generations of police detectives and not only belongs to France.

Training of Private Personal Physical Security Services
- M.Sc. Besnik Shehaj

Abstract

The Private Security Service (PSS) is a business activity that has the mission of safeguarding private and public property, life, health and integrity of persons, which has no consolidated tradition in our country, because it didn't exist since the second half of the 20th century. Only after the democratic changes in our country, when the market economy was allowed, there was a need for the organization and functioning of this service, because the State Police hadn't the capacities to preserve of all important public and private facilities. Like any new activity, without a tradition and professional experience and rushed up, this service did not work properly. Some serious events occurring in the facilities maintained by PSS in the last 20 years indicate that this service has failed to mature to be effective in its mission. Even in the field of studies focusing on this activity, it is difficult to find references to a good research and study work in our country, so the undertaking of such an article may not meet all expectation. But let's hope that it will serve as little as an incentive for more in-depth studies, especially in terms of PSS professional training and the efficiency of this service. Within the spaces that allow this article, we have tried to address some

aspects related to: the meaning, importance, organization, functioning and responsibilities of the PSS as a whole, and in particular: training the staff of this service.

Reorganization of Judicial Police in State Police, a time requirement - M.Sc. Adriatik Ago

Abstract

The approval as a conclusion of the main package of laws on judicial reform, with the standards of EU countries, has created a powerful platform for its deepening in terms of reforming the structure of the judicial police. This package has opened the horizon to select for the conditions of our country, the best possible model of the judicial police, as a structure that deals with preliminary investigations of criminal offenses, but already evidenced as one of the weakest links in the structural organization institutional table, both in state police and other institutions, that the law gives the right to have such a structure. Evidence of its low level of efficiency has been made not only by the internal auditing of institutions such as prosecution, state police, courts, but also other external actors. There are many strategic level papers and studies conducted by these actors, which in the security assessment and security assessment have reached these conclusions. The necessity of its restructuring is made by the fact that the reform package in justice, mainly in the prosecution institution, has created other structures with investigative competencies such as the IJB, etc., which need to be taken into consideration and seriously evaluated in the process of the restructuring of the judicial police, especially of what it does today in the state police.

Reorganization of the Criminal Police as a necessity of time - M.Sc. Osman Qystri

Abstract

If we look at crime statistics in general and organized crime in particular, for the years 2001-2016, the criminal trafficking organizations of drugs, arms and human beings and the structured criminal groups of smuggling, smuggling and punishment, struck inside and outside the country, we find that the crimes have been increasing steadily. Regardless the achievements and outcomes in the fight against it, despite the profound changes and radical improvements in the legislation and organic structure of the Anti-Police Police, the investigation and crackdown on organized crime are far from public expectations. We are changing almost completely the responsive and actionable approach to any form of criminal activity, with a view to a proactive, dynamic, and well coordinated response. Hence, the obligation, reform and reorganization of the investigation structure, integrity and professional skills of criminal police officers arise. Blundering criminal assets of persons with criminal or convicted precedents. The opinion of anticrime specialists is dominated by two opinions, the representatives of which share different attitudes, and often opposite each other. The former stand firm in today's organization and practice, where the Criminal Police conducts police tracing and preliminary investigation or vice versa, as processes or activities that are inextricably linked to one another. The latter insist on the reorganization of the Judicial Police "and the restructuring of the Criminal Police. According to them, the fight against crime is re-conceived with two main

pillars, one without giving up the attributes of the judicial police, dealing with police tracing, and the other dealing with preliminary investigation or procedural actions.

Community Policing: Challenge and Need

- M.Sc. Roland Alushani

Abstract

The 21st century has brought new challenges for the police, in our country, as a fragile democracy and in the vision of Western democracies. Embedded social problems, large displacement of population, trafficking, organized crime, domestic violence etc. today pose challenges to the control of crime, which are increasingly challenging traditional policing opportunities and capabilities. New agencies have been set up, private police are in an "explosive boom", and authorities have demanded that individuals, businesses and community organizations to be more accountable for their security. To maintain or regain the leadership position on this new agenda, police structures are committed to know and understand the changing environment and face professionally with its challenges. The purpose of this article is to investigate the role and function of the police service in this period, which is also considered as the "current era of insecurity". The basic idea is focused on the fact that despite the increase of other actors involved in crime control management, public police are the most appropriate structure to coordinate commitments not only to existing problems but also to new crime problems, using methods based on intelligence, analysis and active co-ordination of other actors. We point out that the risks faced by public police make its structures even more complex in shape and content.

Criminal aspects of family murders, method of investigation and the means of finding evidences

- Besnik Muçi, Magistrate, PhDc

Abstract

Family murders are a very concerning phenomena for our society. Transition from a relatively conservative society in the family relationships into an open and free society, where every family member has equal rights, has brought collision within it. Also, the forced and complete demolition of property relations during the communist regime and the still unstable situation concerning the property owners in our country, even between family members, brings continuous conflicts, which may end up even in murder. That is why confronting this issue, is a huge and important challenge for our country and especially for the law enforcement institutions, of whom is the duty to identify, prevent, investigate, prosecute and punish the authors of these criminal offenses. In order to do this, initially is needed an analysis and a better understanding of the legal elements of this figure of crime from the court, the prosecution office and the judicial police. Thus, should be done the breakdown of all the elements, which are: the juridical and material object, objective side of committing a criminal offense, the subject and the subjective side. Particularly, the juridical and material object and the subject of the offense are the distinctive features for its legal qualification. As a very specific crime, committed mostly inside the very close family setting, with the objective side not very obvious to the outsiders and the lack of will of family members to cooperate with the criminal prosecution organs, makes finding and procedural administration of evidences difficult. That is why is highly important the application

of specific methods of investigation to adjust to this particular crime. In the function of a specific investigation method, there should also be clearly specified and efficient means in finding and obtaining evidence. All the classic evidences such as testimony, confronting, identifications, experiments, expertise, material evidence and documents may and should serve in the process of proving of this criminal offense. But, special attention should be paid to means of searching evidence. Particular importance have observations, controls and tape recordings. In this paper we will make a juridical and criminal analysis of this criminal offense, of the investigation method, of the means of finding evidence and of the most typical evidences in this juridical and criminal process.

Juvenile Cyberdeviance and the role of Police Officers and Support Structures in the Prophylaxis of Cybercrime.

- Cav. PhD. Ervin Ibrahim, Silva Ibrahim PhDc, Eglantina Dervishi PhD

Technology is one of the most influential tools in the image of an individual's social life. The objective of this research is to explore some of the basic aspects of the relationship between cyber-deviant behaviors and the role of order security and cyber security structures that exist in the cyber-digitalization process. The present article intersects diagonal aspects of deviant cyber culture and the role of police officers in the screening and prevention of criminal extreme acts. The research also provides a reflective view of consumerism that digitalization brings to the constant formation of adolescents. The implementation of misguided protection strategies and consumer safety from hazardous navigation directly affects the growth of passive and active criminality, qualitative changes in attitudes and behavior by pointing more towards antisocial deviance and crawling at the base ranging from national and regional security and internet addiction

Challenges of policing in the phenomenon of violence against women

- Kozeta Ligeja, PhDc

The hypothesis is: For many years, the existence of the phenomenon of domestic violence, mainly of violence against women, remains the main priority of social policy in our country realized by special mechanisms. An important role in this regard is the Ministry of Interior through the State Police. It is an aid structure for dealing with cases of domestic violence. But during its activity police face lack of support services, lack of accommodation, or psychological and legal consultancy, child services, support for long-term housing, and lack of economic assistance. This makes it harder for the purpose of reducing violence against women. The purpose of the work - is that through evidence, mainly of theoretical analysis, but in many cases also practical observations in Albanian, to prove the hypothesis raised. Methodology: The work will be based on several study methods. Inductive methods will be used the most, going from specific facts to general conclusions, but also the use of deductive methods, starting from general conclusions to deduct conclusions on special problems and consequences, through the analysis of special cases in Albania, which have addressed specific issues with great importance on the continuation of the work in question.

"Policimi dhe siguria",
rev. shkenc.
nr. 11, qershor 2018,
ISSN 2413-1334.
Botues: Akademia e Sigurisë,
Policia e Shtetit, RSH
Përmasa: 160X240 mm

ISSN 2413-1334
AKADEMIA E SIGURISË



2 413 1 334000 3



POLICIMI DHE SIGURIA

QERSHOR 2018



AKADEMIA E SIGURISË

Qendra Kërkimore Shkencore
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



NR

11